

KISHA E JEZU KRISHTIT E SHENJTORËVE TË DITËVE TË MËVONSHME • NËNTOR 2017

Liahona

Fjalime në
Konferencën e
Përgjithshme





© MARK MISSMAN AND MARK MABRY, NUK LEJOHET TE KOPIJOHET

“Si vijnë tek Ai? Prillin e shkuar, Presidenti Rasëll M. Nelson dhe Plaku M. Rasëll Ballard na nxitën që ta studionim dokumentin “Krishti i Gjallë” si pjesë e të mësuarit për Shpëtimtarin . . .

Ndërsa i kam studiuar jetën dhe mësimet e Jezu Krishtit me më shumë përqendrim dhe e kam rrënjësuar në kujtesë tekstin e dokumentit “Krishti i Gjallë”, mirënjohja dhe dashuria ime për Shpëtimtarin është shtuar. Çdo fjali e atij dokumenti të frymëzuar përmban një predikim dhe e ka përmirësuar kuptueshmërinë time për rolet e Tij hyjnore dhe misionin tokësor. Ajo që kam mësuar dhe ndier gjatë kësaj periudhe studimi dhe reflektimi, vërteton se Jezusi është me të vërtetë ‘drita, jeta dhe shpresa e botës’”.

Xhin B. Bingham, Presidente e Përgjithshme e Shoqatës së Ndhimës, “Që Gëzimi Juaj të Jetë i Plotë”, f. 85.

Nëpërmjet Syve të Besimit,
nga Mark Missman dhe
Mark Mabry

Sesioni i Përgjithshëm i Grave

- 6 **Ndizeni Dritën Tuaj**
Sheron Iubank
- 10 **Banimi në Perëndinë dhe Riparimi i të Çarës**
Nill F. Mariot
- 13 **Vlerë e Pamasë**
Xhoi D. Xhons
- 16 **Tri Motra**
Presidenti Diter F. Uhtdorf

Sesioni i Paradites të së Shtunës

- 21 **Dëshirim për Shtëpinë**
Presidenti Diter F. Uhtdorf
- 25 **Nevojat përpara Vetvetes**
Boni L. Oskarson
- 28 **Plani dhe Proklamata**
Plaku Dallin H. Ouks
- 32 **“Unë Kam një Punë për Ty”**
Plaku Xhon C. Pingri i Riu
- 36 **Buka e Gjallë që Zbriti nga Qielli**
Plaku D. Tod Kristoferson
- 40 **Jini, pra, të Përkryer - Përfundimisht**
Plaku Xhefri R. Holland

Sesioni i Pasdites të së Shtunës

- 43 **Mbështetja e Drejtuesve të Kishës**
Presidenti Henri B. Ajring
- 44 **Eklipsi Shpirtëror**
Plaku Geri E. Stivenson
- 48 **Pendimi Është Gjithmonë Pozitiv**
Stiven W. Ouen
- 51 **Të Përditshmen si Përjetësinë**
Plaku Kuentin L. Kuk
- 55 **Sipas Qëllimit Hyjnor**
Plaku Ronald A. Rasband
- 58 **Zemra e së Vesë**
Plaku O. Vinsent Halek
- 60 **Libri i Mormonit: Si do të Ishte Jeta Juaj pa Të?**
Presidenti Rasëll M. Nelson

Sesioni i Përgjithshëm i Priftërisë

- 64 **Priftëria dhe Fuqia Shlyese e Shpëtimtarit**
Plaku Dejll G. Renland
- 68 **E Vërteta e të Gjitha Gjërave**
Plaku Dejvid F. Evans
- 75 **Të Fitoni Mirëbesimin e Zotit dhe të Familjes Suaj**
Plaku Riçard J. Meinis
- 78 **Mbajtës të Dritës Qiellore**
Presidenti Diter F. Uhtdorf
- 81 **Zoti e Udhëheq Kishën e Tij**
Presidenti Henri B. Ajring

Sesioni i Paradites të së Dieles

- 85 **Që Gëzimi Juaj të Jetë i Plotë**
Xhin B. Bingham
- 88 **A Mos Ka Pushuar Dita e Mrekullive?**
Plaku Donald L. Hallstrom
- 90 **Premtimet e Çmueshme dhe Shumë të Mëdha**
Plaku Dejvid A. Bednar
- 94 **Kthehu te Zoti**
Peshkopi W. Kristofer Uadell
- 97 **Zot, A do të m'i Hapësh Sytë?**
Plaku W. Krejg Zuik
- 100 **Mos Kini Frikë të Bëni Mirë**
Presidenti Henri B. Ajring

Sesioni i Pasdites të së Dieles

- 104 **Udhëtimi i Vështirë Vazhdon!**
Plaku M. Rasëll Ballard
- 107 **Dëshmitari i Fuqishëm i Perëndisë: Libri i Mormonit**
Ted R. Kelister
- 110 **Veças, por Ende Një**
Plaku Soni L. Koh
- 112 **A i Mirëbesojmë Atij? Vështirësia Është e Mirë**
Plaku Stenli G. Ellis
- 115 **Të Vërteta Thelbësore - Nevoja Jonë për të Vepruar**
Plaku Adilson de Paula Parreja
- 117 **Kërkoni nga Librat më të Mirë**
Plaku Jan S. Ardern
- 119 **Ta Duam Njëri-Tjetrin sikurse Ai na Ka Dashur**
Plaku Hoze L. Alonso
- 122 **Zëri i Zotit**
Plaku Nil L. Andersen
- 72 **Autoritetet e Përgjithshme dhe Drejtuesit e Përgjithshëm të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme**
- 127 **Treguesi i Ngjarjeve në Konferencë**
- 128 **Lajme të Kishës**
- 137 **Eja, Më Ndiq - Për Priftërinë Melkizedeke dhe Shoqatën e Ndhmës**



Konferenca e Përgjithshme Gjysmëvjetore e 187-të

Sesioni i Përgjithshëm i Grave i Mbrëmjes të së Shtunës, 23 shtator 2017

Drejtimi: Xhin B. Bingham.

Lutja e hapjes: Megumi Jamaguçi.

Lutja e mbylljes: Lezli P. Lejton.

Muzika nga një kor i Shoqatës së Ndhimës nga kunjët e zonës së Park-Sitit të Jutës, Xhejn Fjeldshtedi, drejtuese; Boni Gudlif, organiste: “Sioni n’ Bukuri Le t’ Ngrihet”, *Himne*, nr. 25, përsht. Kasen, bot. nga Jackman; “Sing Praise to Him” [“Këndojuini Lavdi Atij”], *Hymns*, nr. 70, përsht. Fjeldsted dhe Goodliffe; “T’ Vërtet’ Ndaj Besimit”, *Himne*, nr. 162; “We Have Partaken of Thy Love” [“Nga Dashuria Jote Kemi Marrë”], *Hymns*, nr. 155, përsht. Fjeldsted dhe Goodliffe.

Sesioni i Përgjithshëm i Paradites të së Shtunës, 30 shtator 2017

Drejtimi: Presidenti Henri B. Ajring.

Lutja e hapjes: Plaku Leri R. Lorens.

Lutja e mbylljes: Plaku Masimo De Feo.

Muzika nga Tabernacle Choir [Kori i Tabernakullit]; Mak Uilberg dhe Rajën Mërfi, drejtues; Riçard Eliot dhe Endriu Ansuorth, organistë: “Ne që Duam Zotin”, *Himne*, nr. 63; “Arise, O God, and Shine” [“Ngrihu, O Per’ndi, e Shkëlqe”], *Hymns*, nr. 265, përsht. Wilberg, bot. nga Oxford University Press; “Zot Profetin Beko”, *Himne*, nr. 14, përsht. Wilberg; “Ma’ Malit Atje Lart”, *Himne*, nr. 5, “Per’ndia Është Dashuri”, *Himne*, nr. 43, përsht. Murphy; “Faith in Every Footstep” [“Besim në Çdo Hap”], Dayley, bot. nga Jackman.

Sesioni i Përgjithshëm i Pasdites të së Shtunës, 30 shtator 2017

Drejtimi: Presidenti Diter F. Uhtdorf.

Lutja e hapjes: Plaku Lorens E. Korbrich.

Lutja e mbylljes: Plaku Alan F. Paker.

Muzika nga një kor rinie nga kunjët në Midvejl dhe Sendi në Jutë, Lea Terrënti, drejtuese; Linda Margets, organiste: “Eni, Ju F’mij’ të Zotit”, *Himne*, nr. 30, përsht. Wilberg, bot. nga Deseret Book; potpuri, përsht. Sally DeFord: “I’m Trying to Be like Jesus” [“Përpiqem t’Jem si Jezusi”], *Children’s Songbook*, 78–79; “He Sent His Son” [“Ai Dërgoi Birin e Tij”], *Children’s Songbook*, 34–35; “Rrezëllim Ka Sot në Shpirtin Tim”, *Himne*, nr. 142; “Gëzim, Zoti Është Mbret!” *Himne*, nr. 35, përsht. Kasen, bot. nga Jackman.

Sesioni i Përgjithshëm i Priftërisë i Mbrëmjes të së Shtunës, 30 shtator 2017

Drejtimi: Presidenti Henri B. Ajring.

Lutja e hapjes: Plaku Kevin W. Pirson.

Lutja e mbylljes: Plaku Rafael E. Pino.

Muzika nga një kor i etërve dhe bijve nga kunjët në Kontenë e Kashesë, Jutë, Gofri Anderson, drejtues, Klei Kristiansen, organist: “Shpatullat Punës Vëri”, *Himne*, nr. 161, përsht. Dalton, bot. nga LDS Music Source; “Lutja e Fshehtë”, *Himne*, nr. 82, përsht. Kasen, bot. nga Jackman; “Sa i Fort’ një Themel”, *Himne*, nr. 41; “Ne Përher’ Lute mi për Ty”, *Himne*, nr. 17, përsht. Kasen, bot. nga Jackman.

Sesioni i Përgjithshëm i Paradites të së Dielës, 1 tetor 2017

Drejtimi: Presidenti Diter F. Uhtdorf.

Lutja e hapjes: Plaku Majkëll T. Ringud.

Lutja e mbylljes: Plaku Zhozé A. Teisheira.

Muzika nga Tabernacle Choir [Kori i Tabernakullit]; Mak Uilberg, drejtues; Endrju Ensuoorth dhe Klei Kristiansen, organistë: “Praise to the Lord, the Almighty” [“Lavdi Zotit, të Plotfuqishmit”], *Hymns*, nr. 72; “Para, Shenjtor”, *Himne*, nr. 39, përsht. Wilberg; “Consider the Lilies” [“Vini Re Zambakët”], Hoffman, përsht. Lyon, bot. nga Sonos; “Dëgjoni Kombe!” *Himne*, nr. 171, përsht. Wilberg; “Perëndis’ Lart Lavdi”, *Himne*, nr. 34; “Pranë Zembrës së Bariut”, *Himne*, nr. 138, përsht. Wilberg, e pabotuar; “Un’ Besoj në Krisht”, *Himne*, nr. 72, përsht. Wilberg, bot. nga Jackman.

Sesioni i Përgjithshëm i Pasdites të së Dielës, 1 tetor 2017

Drejtimi: Presidenti Henri B. Ajring.

Lutja e hapjes: Plaku Xhozef W. Sitati.

Lutja e mbylljes: Plaku Evan A. Shmuc.

Muzika nga Tabernacle Choir [Kori i Tabernakullit]; Mak Uilberg dhe Rajën Mërfi, drejtues; Boni Gudlif dhe Linda Margets, organiste: “Eja, Mbret i Mbret’ëve”, *Himne*, nr. 31, përsht. Murphy, e pabotuar; “A Kam Bër’ Ndonjë të Mir?” *Himne*, nr. 139, përsht. Zabriskie, bot. nga LDS Music Source; “Tani Le t’Gëzojmë”, *Himne*, nr. 3; “If the Savior Stood Beside Me” [“Nëse Shpëtimtari Pranë më Qëndronte”], DeFord, përsht. Cardon; “Izrael, Per’ndia po Th’rret”, *Himne*, nr. 7, përsht. Wilberg.

Mundësohen Bisedat e Konferencës

Për të gjetur biseda të konferencës së përgjithshme në internet në shumë gjuhë, vizitoni faqen conference.lds.org dhe përzgjidhni një nga gjuhët. Bisedat mundësohen gjithashtu në programin kompjuterik Gospel Library [Biblioteka e Ungjillit]. Informacioni për konferencën e përgjithshme në formate të përdorshme nga anëtarë me paaftësi, mundësohet në faqen disability.lds.org.

Mesazhet e Mësimi të Shtëpisë dhe të Vizitës Mësimore

Për mesazhet e mësimi të shtëpisë dhe të vizitës mësimore, ju lutemi, përzgjidhni atë fjalim që u përgjigjet më mirë nevojave të atyre që vizitoni.

Në Kapak

Përpara: Fotografi nga Leslie Nilsson.

Prapa: Fotografi nga Craig Dimond.

Fotografimi i Konferencës

Fotografitë në Solt-Lejk-Siti u bënë nga Cody Bell, Janae Bingham, Mason Coberly, Randy Collier, Weston Colton, Craig Dimond, Ashlee Larson, Leslie Nilsson, Matt Reier dhe Dave Ward.





Pjesë të Spikatura nga Konferenca e Përgjithshme Gjysmëvjetore e 187-të

*Zot profetin beko;
Past' shëndet dhe qet'si
Zemra e tij.
Te shpërtrat që bekon,
Lënshin mbres' fjal't e tij
Që t'zgjedhim më t'mirën
Me drejtësi.*

(“Zot Profetin Beko”, *Himne*, nr. 14, u këndua gjatë sesionit të paradites së shtunës.)

Për më shumë se 50 vjet, tregimet vetjake prekëse dhe dëshmia e fuqishme për Jezun Krishtin e Presidentit Tomas S. Monson, kanë qenë pjesë e konferencës së përgjithshme. Por, për shkak të shëndetit në rënie, që të dy, si Presidenti Monson ashtu dhe Plaku Robert D. Hejls, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, nuk qenë të pranishëm në konferencë, gjë që ishte shumë e dukshme.

Ata munguan, por nuk u harruan. Megjithëse Presidenti Monson i ndiqte punimet nga shtëpia dhe Plaku Hejls ndërroi jetë paqesisht në spital pak para sesionit të fundit, ata që të dy jo vetëm që ishin në mendimet tona ndërsa luteshim për ta, por edhe ndikimi i tyre që i dukshëm në fjalime.

Presidenti Monson u citua prej më shumë se një duzine folësish, përfshirë Presidentin Rasëll M. Nelson (shih faqe 60), i cili iu referua veçanërisht ftesës së Presidentit Monson në konferencën e fundit që “me lutje ta studiojmë dhe ta përsiatim Librin e Mormonit çdo ditë”¹.

Plaku Nil L. Andersen, folësi përmbyllës (shih faqe 122), tregoi pjesë bisede të cilën Plaku Hejls po e përgatiste për në konferencë, por që nuk që në gjendje ta mbante: “Kur zgjedhim

të kemi besim, ne përgatitemi që të qëndrojmë në praninë e Perëndisë”, shkroi Plaku Hejls. Sigurisht, Plaku Hejls zgjodhi besimin.

Jo të pranishëm, por jo duke munguar vërtet, Presidenti Monson dhe Plaku Hejls nuk qenë në foltore, por ata luajtën rol të rëndësishëm për ta bërë konferencën kuptimplote për shumë njerëz.

*Ne përher' lutemi për ty, profet,
Që Per'ndia qet'sim dhe g'zim të t'jap';
Vitet kalojn', ballin ty t'rrudhosin,
Drita që mban ti, të ndrij' si tani;
Drita që mban ti, të ndrij' si tani.*
(“Ne Përher' Lutemi për Ty”, *Himne*, nr. 17, u këndua gjatë sesionit të përgjithshëm të priftërisë.) ■

SHËNIM

1. Shih Tomas S. Monson, “Fuqia e Librit të Mormonit”, *Liahona*, maj 2017, f. 86.





Nga Sheron Iubank,
Këshilltare e Parë në Presidencën e Përgjithshme të Shoqatës së Ndihmës

Ndizeni Dritën Tuaj

*Profetët po na thërrasin, motrat e mia. A do të jeni të drejta?
A do ta shprehni qartë besimin tuaj? A do ta ndizni dritën tuaj?*

Ju mund të mos e dini këtë, por unë dhe Presidenti Monson jemi binjakë. Ditën që unë linda – në të njëjtën orë – në Kaliforninë veriore, 36-vjeçari Tomas S. Monson u mbështet si Apostulli më i ri. Më pëlqen shumë lidhja ime e veçantë dhe vetjake me profetin e Perëndisë, Presidentin Monson.

Profetët po flasin rreth grave.¹ Ju do t'i dëgjoni disa prej fjalëve të tyre në këtë mbledhje. Për temën time unë po kthehem prapa në kohë, gati 40 vjet, te një profeci e jashtëzakonshme e shkruar nga Presidenti Spenser W. Kimball. Shtatori i vitit 1979 ishte vetëm hera e dytë që gratë e Kishës mbarëbotërore ishin mbledhur në mbledhjen e tyre të përgjithshme. Presidenti Kimball e kishte përgatitur bisedën e tij, por kur erdhi dita e konferencës, ai qe në spital. Kështu që në vend të kësaj, ai i kërkoi bashkëshortes së vet, Kamila Ajring Kimballit, që t'i lexonte shënimet e tij në emër të tij.²

Motra Kimball i lexoi fjalët e profetit, të cilat theksonin ndikimin e grave SHDM te gratë e mira të botës përpara Ardhjes së Dytë të Shpëtimtarit. Nga fundi, grave të Kishës iu dha një përgjegjësi elektrizuese për të cilën kemi folur që prej asaj kohe.

Lejomëni të citoj pak nga ajo që tha Presidenti Kimball:

“Së fundi, motrat e mia të dashura, më lejoni t’ju sugjeroj diçka që nuk është thënë më parë ose të paktën jo saktësisht në këtë mënyrë. Shumica e rritjes së madhe që po i vjen Kishës në ditët e fundit, do të vijë ngaqë shumë prej grave të mira të botës . . . do të tërhiqen në Kishë në numër të madh. Kjo do të ndodhë në masën që gratë e Kishës pasqyrojnë drejtësi e aftësi shprehëse në jetën e tyre dhe në masën që gratë e Kishës shihen si të dallueshme e të ndryshme – në mënyra të lumtura – nga gratë e botës.

Mes heroinave të vërteta në botë, të cilat do të vijnë në Kishë, ka gra që janë më të interesuara për të qenë të



Në shtator 1979, Kamila Ajring Kimballi lexoi bisedën në emër të Presidentit Spenser W. Kimball.

drejta se sa egoiste. Këto heroina të vërteta kanë përlulësi të vërtetë, e cila i jep vlerë më të madhe integritetit se sa asaj që duket. . . .

. . . Do të jenë . . . shembujt femërorë të Kishës [që] do të jenë një *forcë domethënëse* si në rritjen numerike edhe atë shpirtërore të Kishës në ditët e fundit.”³

Ç’thënie profetike është ajo! Sa për ta përmbledhur:

- Do të jenë marrëdhëniet e mira të grave që do ta nxitin shumë prej rritjes së madhe që do t’i vijë Kishës në vitet e ardhshme.
- Miqësitë që gratë e Shoqatës së Ndihmës, të rejtat dhe vajzat e Fillores ndërtojnë me gratë e çiltra, besnike, të perëndishme të besimeve dhe bindjeve të tjera do të jenë një *forcë domethënëse* në mënyrën se si rritet Kisha në ditët e fundit.
- Presidenti Kimball i quajti këto gra me formim kulturor tjetër, “heroina”, të cilat do të jenë më të interesuara për të qenë të drejta se sa egoiste, të cilat do të na tregojnë se integriteti ka më shumë vlerë se ajo që duket.

I kam takuar shumë prej këtyre grave të mira teksa bëj punën time anëmbanë botës. Miqësitë e tyre janë të çmuara për mua. Edhe ju i njihni ato, midis mikeshave dhe fqinjave tuaja. Ato mund të jenë ose jo anëtare të Kishës pikërisht tani, por ne lidhemi nëpërmjet miqësisë, që është shumë e rëndësishme. Si e bëjmë pjesën tonë? Çfarë duhet të bëjmë? Presidenti Kimball përmend pesë gjëra:

E para është që të jemi të drejta. Të jemi të drejta nuk do të thotë që jemi të përkryera ose të mos bëjmë kurrrë gabime. Do të thotë që të zhvillojmë një lidhje të fortë me Perëndinë, të pendohejmë për mëkatet e gabimet tona dhe t’i ndihmojmë të tjerët bujarisht.

Gratë që janë penduar e ndryshojnë rrjedhën e historisë. Kam një mikeshë e cila pësoi një aksident me makinë kur ishte e re, dhe për shkak të kësaj, krijoi varësi ndaj ilaçeve për dhembjen. Më vonë, prindërit e saj u shkurorëzuan. Ajo ngeli shtatzënë nga një marrëdhënie e shkurtër dhe varësitë e saj vazhduan. Por një natë, ajo i hodhi sytë nga pështjellimi dhe rrëmuja e jetës së saj dhe mendoi: “Boll!”. Dhe i bëri thirrje Shpëtimtarit Jezu Krisht që ta ndihmonte. Ajo tha se mësoi që Jezu Krishti ishte më i fortë madje edhe se rrethanat e saj të tmerrshme dhe se ajo mund të mbështetej në forcën e Tij ndërsa ecte në rrugën e pendimit.

Nëpërmjet kthimit të Zotit dhe udhëtimit të Tij, ajo e ndryshoi rrjedhën e historisë së saj dhe të historisë së djalit të saj të vogël dhe të bashkëshortit të saj të ri. Ajo është e drejtë; ajo ka një zemër të madhe për të tjerët, të cilët kanë bërë gabime dhe duan të ndryshojnë. Dhe ashtu si të gjithë ne, ajo nuk është e përsosur, por di si të pendohet dhe të vazhdojë të përpiket.

E dyta është që të jemi të afta për t’u shprehur. Të jemi të afta për t’u shprehur do të thotë të shprehim qartë se si ndihemi rreth diçkaje dhe përse ndihemi kështu. Në fillim të këtij viti, pati një publikim të lajmërimit në Facebook-un tim që e përçmonte krishterimin. E lexova dhe u mërzi pak, por e lashë të kalojë. Por një e njohura ime që nuk është anëtare e besimit tonë, u përgjigj me një koment të saj. Ajo shkroi: “[Kjo është] plotësisht e kundërta e asaj që mbrojti Jezusi – ai ishte . . . radikal [në] kohën e tij ngaqë . . . e trajtoi botën njësoj. . . Ai [i foli] prostitutës[ave], [hëngri] me mbledhësin e taksave . . . , u shoqërua me gra dhe fëmijë të pafuqishëm . . . [dhe] na dha historinë e Samaritanit të Mirë. . . Nga kjo rrjedh që . . . të krishterët e vërtetë



do të përpiqeshin fort për të qenë njerëzit MË TË dashur në botë.” Kur e lexova, thashë me vete: “Përse nuk e shkrova unë atë?”

Secila prej nesh ka nevojë ta përmirësojë të shprehurin e arsyeve për besimin e saj. Çfarë ndieni për Jezu Krishtin? Përse qëndroni në Kishë? Përse e besoni që Libri i Mormonit është shkrim i shenjtë? Ku e gjeni ju paqen tuaj? Përse është e rëndësishme që profeti ka diçka për të thënë në vitin 2017? Nga e dini ju që ai është një profet i vërtetë? Përdoreni zërin tuaj dhe fuqinë tuaj për ta shprehur atë që ndieni dhe dini – në mediat shoqërore, në bisedat e qeta me miqtë tuaj, kur bashkëbisedoni me nipërit e mbesat tuaja. Tregojuni atyre arsye përse besoni, si ndiheni, a dyshuat ndonjëherë, si e kaluat, çfarë domethënieje ka Jezu Krishti për ju. Ashtu siç tha Apostulli Pjetër: “Mos kini asnjë druajtje. . . , madje shenjtëroni Zotin Perëndinë në zemrat tuaja dhe jini gati për t’u përgjigjur në mbrojtjen tuaj kujtdo që ju kërkon shpjegime për shpresën që është në ju”⁴.

E treta është që jemi të ndryshme. Më lejoni t’ju tregoj një histori që ndodhi korrikun e shkuar në plazhin e Panama-Sitit në Florida.⁵ Pasdite vonë, Roberta Ursëri i pa dy djemtë e saj të vegjël duke bërë titur për ndihmë,

90 metra larg në oqean. Ata ishin kapur nga një rrymë e fortë dhe po çoheshin drejt detit. Një çift atje pranë u përpoq që t’i shpëtonte djemtë, por edhe ata u morën nga rryma. Kështu që pjesëtarë të familjes Ursëri u zhytën për t’i shpëtuuar notuesit që po përpëliteshin, dhe shpejt nëntë njerëz u morën nga rryma e bregut.

Nuk kishte litarë. Nuk kishte roja bregdetare. Policia kishte dërguar një barkë shpëtimi, por njerëzit në oqean kishin qenë në vështirësi për 20 minuta, dhe ata ishin të sflitur e kokat e tyre po mbuloheshin nga uji. Mes shikuesve në plazh ishte Xhesika Mej Simonsi. Ajo dhe bashkëshorti i saj patën idenë që të formonin një zinxhir me njerëz. Ata u bënë thirrje njerëzve në plazh që t’i ndihmonin dhe duzina njerëzisht i lidhën krahët e marshuan për në oqean. Xhesika shkroi: “Të shikoje njerëz nga raca e gjini të ndryshme që hynë në veprim për të ndihmuar njerëz TËRËSISHT të panjohur, [ishte] absolutisht mahnitëse që ta shikoje!”⁶ Një zinxhir prej 80 vetash u zgjat drejt notuesve. Shikojeni këtë fotografi të atij çasti të pabesueshëm.

Të gjithë që ishin në plazh, mundën të mendonin vetëm zgjidhje të zakonshme dhe u mpinë fare. Por një çift, sa hap e mbyll sytë, mendoi një zgjidhje të ndryshme. Risia dhe krijimtaria janë

dhurata shpirtërore. Kur ne i mbajmë besëlidhjet tona, kjo mund të na bëjë të ndryshëm nga të tjerët në kulturën dhe shoqërinë tonë, por ajo na jep të drejtën të marrim frymëzim kështu që ne mund të mendojmë për zgjidhje të ndryshme, qasje të ndryshme, zbatime të ndryshme. Ne nuk do të përshtatemi gjithnjë me botën, por të qenit të ndryshme në mënyra pozitive mund të jetë një litar shpëtimi për të tjerët që po hasin vështirësi.

E katërta është që të jemi të dallueshme. E dallueshme do të thotë të identifikohesh me diçka që të dallon qartë. Le të kthehemi te historia rreth Xhesika Mej Simonsit në plazh. Sapo ai zinxhir njerëzish po zgjatej drejt notuesve, ajo e kuptoi se mund të ndihmonte. Xhesika Mej tha: “Mund ta mbaj frymën dhe . . . t’i bie për qark një pishine olimpike me lehtësi! [E dija se si të dilja nga një rrymë bregu.] E dija se mund ta çoja [çdo notues] te zinxhiri i njerëzve.”⁷ Ajo dhe bashkëshorti i saj rrëmbyen nga një dërrasë pluskuese dhe notuan përgjatë zinxhirit derisa ata dhe një shpëtues tjetër i arritën notuesit dhe më pas i çuan një e nga një deri te zinxhiri, që i nxori të sigurt në breg. Xhesika kishte një aftësi të dallueshme: ajo dinte se si të notonte kundër një rryme bregu.

Ungjilli i rivendosur identifikohet si i përcaktuar qartë. Por ne duhet të jemi të dallueshme në mënyrën se si e ndjekim atë. Ashtu si Xhesika ushtroi notin ne kemi nevojë ta ushtrojmë të jetuarin e ungjillit përpara rastit të ngutshëm kështu që, të patrembura, ne do të jemi mjaft të forta për të ndihmuar kur të tjerët po përpohen nga rryma.

Dhe së fundi, e pesta është që t’i bëjmë hapat, nga i pari tek i katërti, në mënyra të lumtura. Të jeni të lumtura nuk do të thotë të keni një buzëqeshje të rreme në fytyrën tuaj

pavarësisht nga ajo që po ndodh. Por do të thotë t’i zbatoni ligjet e Perëndisë dhe t’i ngrini e lartësoni të tjerët.⁸ Kur ne lartësojmë, kur ne e ngremë barrën e të tjerëve, kjo e bekon jetën tonë në mënyra që sprovat tona nuk mund t’i largojnë ato. Kam një citim nga Presidenti Gordon B. Hinkli të vendosur atje ku e shoh çdo ditë. Ai tha: “Ju nuk mund . . . të ndërtoni mbi pesimizmin apo cinizmin. Ju shikoni me optimizëm, punoni me besim dhe gjëra ndodhin.”⁹

Si shembull i asaj fryme të lumtur, optimiste, është një vajzë 13-vjeçare, të cilën unë e njoh, që quhet Elsa, familja e së cilës po shpërngulet në Baton-Ruzh, në Luiziana, 2900 km larg prej miqve të saj. Nuk është shumë e lehtë për një 13-vjeçare të shpërngulet në një vend të ri. Kuptohej që Elsa ishte e pasigurt rreth shpërnguljes, kështu që i ati i dha një bekim. Pikërisht në çastin e bekimit, telefoni i nënës së saj tringëlli nga një mesazh. Të rejat që jetojnë në lagjen në Luiziana kishin dërguar këtë fotografi me diçiturën: “Të lutemi, shpërngulu në lagjen tonë!”¹⁰

Këto të reja ishin optimiste se do ta pëlqenin Elsën edhe pa e takuar atë. Entuziazmi i tyre krijoi optimizëm tek Elsa rreth shpërnguljes së ardhshme

dhe iu përgjigj lutjes së saj mbi faktin a do të shkonte gjithçka mirë.

Ka një energji që buron nga lumturia dhe optimizmi, që jo thjesht na bekon ne – por e lartëson çdo njeri përreth nesh. Çdo gjë e vogël që ju bëni për të ndezur lumturinë e vërtetë tek të tjerët, tregon se ju tashmë po e mbani pishtarin që ndezi Presidenti Kimball.

Isha 15 vjeç në kohën kur u dha biseda e Presidentit Kimball. Ne që jemi më shumë se 40 vjeç, e kemi mbajtur këtë përgjegjësi nga Presidenti Kimball që prej asaj dite. Tani e hedh vështrimin tek 8-vjeçarët, 15-vjeçarët, 20-vjeçarët e 35-vjeçarët, dhe po jua kaloj juve këtë pishtar. Ju jeni udhëqëset e ardhshme në këtë Kishë dhe do të jetë në dorën tuaj që ta çoni këtë dritë përpara dhe të jeni përmbushja e kësaj profecie. Ne që jemi më shumë se 40 vjeç, i bashkojmë krahët tona nëpërmjet tuajve dhe e ndiejmë fuqinë dhe energjinë tuaj. Kemi nevojë për ju.

Vërjani veshin këtij shkrimi të shenjtë që gjendet te DeB 49:26–28. Ai mund të jetë shkruar në rrethana të ndryshme, por sonte nëpërmjet Shpirtit të Shenjtë, unë shpresoj se ju do ta merrni atë si një thirrje vetjake në këtë punë të shenjtë.



Një zinxhir njerëzor prej 80 vullnetarësh zgjatej për të shpëtuar notarët e rrëmbyer nga një rrymë bregu.

“Vini re, unë ju them, shkoni siç ju kam urdhëruar; pendohuni për gjithë mëkatet tuaja; kërkoni e do të merrni; trokisini e do t’ju çelet.

Vini re, unë do të shkoj përpara jush dhe do të jem praparoja juaj; dhe unë do të jem në mes jush e ju nuk do të ngatërroheni.

Vini re, unë jam Jezu Krishti dhe unë vij shpejt.”¹¹

Unë i bëj thirrje secilës prej jush që ta vendosni veten në një vend ku mund ta ndieni dashurinë bujare që ka Perëndia për ju. Ju nuk mund ta vendosni veten tuaj përtej shtrirjes së asaj dashurie. Kur e ndieni dashurinë e Tij, kur e doni Atë, ju do të pendoheni dhe do t’i zbatoni urdhërimet e Tij. Kur i zbatoni urdhërimet e Tij, Ai mund të na përdorë në punën e Tij. Puna dhe lavdia e Tij është ekzaltimi dhe jeta e përvetshme e grave dhe e burrave.

Profetët po na thërrasin, motrat e mia. A do të jeni të drejta? A do ta shprehni qartë besimin tuaj? A mund ta duroni që të jeni të dallueshme dhe të ndryshme? A do t’i tërheqë lumturia juaj, pavarësisht nga sprovat tuaja, të tjerët që janë të mirë e fisnikë dhe që kanë nevojë për miqësinë tuaj? A do ta ndizni dritën tuaj? Dëshmoj se Zoti Jezu Krisht do të shkojë përpara nesh dhe do të jetë mes nesh.

E mbyll me fjalët e profetit tonë shumë të dashur, Tomas S. Monsonit: “Motrat e mia të dashura, kjo është dita juaj, kjo është koha juaj”¹². Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME.

1. Presidenti Brigam Jang: “Le t’i organizojnë [motrat] Shoqatat Femërore të Ndhimës në lagjet e ndryshme. Kemi shumë gra të talentuara mes nesh dhe e duam ndihmën e tyre në këtë çështje. Disa njerëz mund të mendojnë se kjo është një gjë e papërfillshme, por nuk është kështu; dhe ju do të zbuloni se motrat do të jenë shtysa e lëvizjes” (në *Daughters in My Kingdom: The History*



and *Work of Relief Society* [2011], f. 41).

Presidenti Lorenzo Snou: “Ju gjithmonë jeni gjendur përkrah Priftërisë, gati . . . të bëni pjesën tuaj për të ndihmuar për përparimin e interesave të mbretërisë së Perëndisë; dhe ndërsa e keni bërë pjesën tuaj në këto punë, kështu ju do të keni me siguri pjesën tuaj në ngadhënjimin e punës dhe në ekzaltimin e lavdinë të cilat Zoti do t’ua japë fëmijëve të Tij besnikë” (në *Daughters in My Kingdom*, f. 7).

Presidenti Spenser W. Kimball tha: “Ka fuqi në këtë organizatë [të Shoqatës së Ndhimës] që nuk është ushtruar ende plotësisht, për t’i forcuar shtëpitë e Sionit dhe për të ndërtuar Mbretërinë e Perëndisë – që as nuk do të ushtrohet derisa edhe motrat edhe priftëria [vëllezërit] ta rrokin largpamësinë e Shoqatës së Ndhimës” (në *Daughters in My Kingdom*, f. 142).

Presidenti Hauard W. Hanter: “Ka një nevojë të madhe për t’i mbledhur gratë e Kishës që të qëndrojnë me Vëllezërit dhe për Vëllezërit, që ta pengojnë rrymën e ligësisë që na rrethon dhe që ta çojnë përpara veprën e Shpëtimtarit tonë. . . . Prandaj ne ju lutemi të shërbeni me ndikimin tuaj të fuqishëm për mirë në forcimin e familjeve tona, të kishës sonë dhe të komuniteteve tona” (në *Daughters in My Kingdom*, f. 157).

Presidenti Gordon B. Hinkli: “Te gratë e kësaj Kise ka forcë dhe zotësi të madhe. Ka udhëheqje dhe drejtim, një lloj fryme pavarësie dhe, prapëseprapë, kënaqësie të madhe në të qenit pjesë e kësaj, e mbretërisë së Zotit, dhe te puna krahe për krahe me priftërinë për ta çuar atë përpara” (në *Daughters in My Kingdom*, f. 143).

Presidenti Tomas S. Monson, duke cituar Bell Smith Spafordin, Presidenten e nëntë të Përgjithshme të Shoqatës së Ndhimës: “Gratë kurrë nuk kanë pasur një ndikim më të madh se sa kanë në botën e sotme. Kurrë nuk kanë qenë dyert e mundësive më të hapura për to. Kjo është një periudhë kohore tërheqëse, emocionuese, sfiduese dhe kërkuese për gratë. Është një kohë e begatë në shpërblime, nëse e ruajmë

drejtpeshimin, i mësojmë vlerat e vërteta të jetës dhe i përcaktojmë përparësitë me urtësi! [A *Woman’s Reach* (1974), f. 21]. Motrat e mia të dashura, kjo është dita juaj, kjo është koha juaj” (“The Mighty Strength of the Relief Society”, *Ensign*, nëntor 1997, f. 95).

Presidenti Rasëll M. Nelson: “Unë iu lutem motrave të mia të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme të bëjnë një hap përpara! Zëreni vendin tuaj të ligjshëm dhe të nevojshëm në shtëpinë tuaj, në komunitetin tuaj dhe në mbretërinë e Perëndisë – më shumë sesa e keni zënë ndonjëherë më parë. Unë ju lutem që ta përbushni profecinë e Presidentit Kimball. Dhe ju premtoj në emrin e Jezu Krishtit, se kur ta bëni këtë, Fryma e Shenjtë do ta lartësojë ndikimin tuaj në një mënyrë të pashembullt! (“Një Lutje drejtuar Motrave të Mia”, *Liahona*, nëntor 2015, f. 97).

2. Shih materialin filmik të Motrës Kamila Kimball duke lexuar fjalimin e Presidentit Spenser W. Kimball në [lds.org/general-conference/1979/10/the-role-of-righteous-women](https://www.lds.org/general-conference/1979/10/the-role-of-righteous-women); shih edhe Spencer W. Kimball, “The Role of Righteous Women”, *Ensign*, nëntor 1979, f. 102–104.
3. Spencer W. Kimball, “The Role of Righteous Women”, f. 103–104; theksimi i shtuar.
4. 1 Pjetër 3:14–15.
5. Shih McKinley Corbley, “80 Beachgoers Form Human Chain to Save Family Being Dragged Out to Sea by Riptide”, 12 korrik 2017, [goodnewsnetwork.org](https://www.goodnewsnetwork.org).
6. Jessica Mae Simmons, në Corbley, “80 Beachgoers Form Human Chain”.
7. Simmons, në Corbley, “80 Beachgoers Form Human Chain”.
8. Shih Alma 41:10; 34:28; Doktrina e Besëlidhje 38:27; Luka16:19–25.
9. *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Gordon B. Hinkli* (2016), f. 73.
10. Shënim nga familja e Virxhinia Pirsit.
11. Doktrina e Besëlidhje 49:26–28.
12. Thomas S. Monson, “The Mighty Strength of the Relief Society”, *Ensign*, nëntor 1997, f. 95.



Nga Nill F. Mariot,
Këshilltare e Dytë në Presidencën e Përgjithshme të Të Rejave

Banimi në Perëndinë dhe Riparimi i të Çarës

Krishti ka fuqinë të na sjellë në një shoqërim të dashur me Atin dhe me njëri-tjetrin.

Ne kemi nevojë ta thellojmë vazhdimisht njohurinë tonë për Atin Qiellor dhe bindjen tonë ndaj Tij. Marrëdhënia jonë me Të është e përjetshme. Ne jemi fëmijët e Tij të dashur dhe kjo nuk do të ndryshojë. Si do ta pranojmë ne me gjithë zemër ftesën e Tij për t'iu afruar pranë Atij dhe si rrjedhim të gëzojmë bekimet që Ai dëshiron fort të na i japë në këtë jetë dhe në botën e ardhshme?

Zoti i tha Izraelit të lashtë dhe Ai na thotë neve: “Po, të kam dashur me një dashuri të përjetshme; prandaj të kam tërhequr me dashamirësi”¹. Duke folur në mënyrën si flet Ati, Ai gjithashtu na thotë: “Ti do të banosh në mua dhe unë në ty; prandaj ec me mua”². A i mirëbesojmë ne Atij mjaftueshëm sa të banojmë në Të dhe të ecim me Të?

Ne jemi këtu në këtë tokë që të mësojmë e të rritemi dhe mësimi e rritja më e rëndësishme do të rrjedhin nga lidhja jonë e besëlidhjes me Atin Qiellor dhe Jezu Krishtin. Nga marrëdhënia jonë besnike me Ta rrjedh njohuri e perëndishme, dashuri, fuqi dhe aftësi për të shërbyer.

“Ne e kemi për detyrë të mësojmë gjithçka që Perëndia ka zbuluar për

veten e Tij.”³ Ne duhet të kuptojmë se Perëndia, Ati, e udhëzoi Birin e Tij, Jezu Krishtin, që ta krijonte tokën *për rritjen tonë*, se Ati Qiellor e dha Birin e Tij që t'i shlyente kërkesat e drejtësisë *për shpëtimin tonë*, dhe se fuqia e priftërisë e Atit dhe Kisha e vërtetë e Birit me ordinancat e domosdoshme u rivendosën *për bekimet tona*. A mund ta ndieni thellësinë e dashurisë që i përshkoi përgatitjet e Tyre për gëzimin

dhe rritjen tonë? Na nevojitet të dimë se plani i Atit Qiellor për shpëtimin është që ne t'u bindemi ligjeve dhe ordinancave të ungjillit e të fitojmë jetë të përjetshme dhe kështu të bëhemi siç është Perëndia.⁴ Kjo është lumturia e vërtetë dhe e përhershme që na ofron Ati Qiellor. Nuk ka asnjë lumturi tjetër të vërtetë e të përhershme.

Sfidat tona mund të na nxjerrin nga ky shteg i lumturisë. Ne mund ta humbasim lidhjen tonë mirëbesuese me Perëndinë nëse sprovat na bëjnë që të shpërqendrohemi në vend që të gjuhëzohemi [në lutje].

Ky dyvargësh i thjeshtë na kërkon që të bëjmë njëfarë shoshitjeje të përparësive tona:

Disa gjëra kanë rëndësi; disa gjëra nuk kanë.

*Disa gjëra janë të përhershme, por shumica e gjërave nuk janë.*⁵

Motra, çfarë ka rëndësi për ju? Çfarë është e përhershme për ju? Një çështje me vlerë të përhershme për Atin është që ne të mësojmë për Të, ta përlim



veten dhe të rritemi duke iu bindur Atij nëpërmjet përvojave tokësore. Ai dëshiron prej nesh që ta shndërrojmë egoizmin tonë në shërbim, frikën tonë në besim. Këto çështje të përhershme mund të na sprovonjë deri në palcë.

Është *tani*, me kufizimet tona të vdekshmërisë, që Ati na kërkon të duam kur dashuria është gjëja më e vështirë, të shërbejmë kur shërbimi është jo i volitshëm, të falim kur falja duket përtej aftësive tona shpirtërore. Si? Si do ta përmbushim këtë? Ne zgjatemi me zell për të marrë ndihmën e Atit Qiellor, në emrin e Birit të Tij, dhe i bëjmë gjërat sipas mënyrës së Tij në vend që të veprojmë krenarisht sipas mendjes sonë.

Unë dallova krenarinë time kur Presidenti Ezra Taft Benson foli lidhur me pastrimin e brendësisë së enës.⁶ E përfytyrova veten si një brokë. Si do ta nxirrja mbetjen e krenarisë nga broka ime? Sforcimi i vetes në mënyrë të pavarur për të pasur përlulsi dhe përpjekja e pavarur për ta bërë veten që t'i duam të tjerët është e shtirë dhe boshe dhe thjesht nuk funksionon. Mëkatet tona dhe krenaria jonë krijojnë një të çarë – apo një hendek – mes nesh dhe burimit të të gjithë dashurisë, Atit tonë Qiellor.

Vetëm Shlyerja e Shpëtimtarit mund të na pastrojë nga mëkatet tona dhe ta mbyllë atë hendek apo të çarë.

Ne duam të rrethohemi nga krahët e dashurisë dhe udhërrëfimit të Atit tonë Qiellor dhe në këtë mënyrë e vendosim vullnetin e Tij të parin dhe me zemër të thyer përgjrohemi që Krishti do të derdhë rrëqe uji pastrues në brokën tonë. Në fillim ai ujë mund të rrjedhë pikë-pikë, por, ndërsa përpiqemi, kërkohet dhe bindemi, ai do të rrjedhë me bollëk. Ky ujë i gjallë do të fillojë të na ngopë dhe, të mbushur plot e përplot me dashurinë e Tij, ne mund ta anojmë



brokën e shpirtit tonë e t'u japim nga përmbajtja e saj të tjerëve, të cilët kanë etje për shërim, shpresë dhe përkatësi. Kur brendësia e brokës sonë bëhet e pastër, marrëdhëniet tona tokësore fillojnë të shërohen.

Sakrifikimi i dëshirave tona vetjake kërkohet në mënyrë që të bëjmë vend për planet e përjetshme të Perëndisë. Shpëtimtari, i cili flet në emër të Atit, na përgjohet: "M'u afroni pranë dhe unë do të afrohem pranë jush"⁷. Afrimi pranë Atit mund të nënkuptojë mësimin e të vërtetës së Tij nëpërmjet shkrimeve të shenjta, ndjekjes së këshillës profetike dhe përpjekjes për ta kryer më plotësisht vullnetin e Tij.

A e kuptojmë ne që Krishti ka fuqinë të na sjellë në një shoqërim të dashur me Atin dhe me njëri-tjetrin? Ai, nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë, mund të na japë idenë e nevojshme për marrëdhëniet.

Një mësues i Fillores më tregoi rreth një përvoje të fuqishme me klasën e tij të djemve 11-vjeçarë. Njëri prej tyre, të cilin do ta quaj Xhimi, ishte djalë i tërhequr që nuk merrte pjesë në klasë. Një të diel, mësuesi u frymëzua ta linte mënjatë mësimin e tij të përgatitur dhe të tregonte se përse e donte Xhimin. Ai foli rreth mirënjohjes së tij për këtë të

ri dhe rreth besimit të tij tek ai. Më pas, mësuesi u kërkoi anëtarëve të klasës t'i thoshin Xhimit diçka që ata e çmonin tek ai. Ndërsa anëtarë të klasës, një e nga një, i treguan Xhimit se përse ai që i veçantë për ta, djaloshi uli kokën dhe lot filluan t'i rridhnin nëpër faqe. Ky mësues dhe kjo klasë ngritën një urë për të zemra e vetmuar e Xhimit. Dashuria e thjeshtë, e shprehur me ndershmëri, u jep shpresë dhe vlerë të tjerëve. Unë e quaj këtë "riparimi i të çarës apo hendekut".

Mbase, jeta jonë në një botë të dashur paratokësore është në themel të dëshirës sonë për dashuri të vërtetë, të përhershme këtu në tokë. Ne jemi krijuar në mënyrë hyjnore që të japim dashuri e të marrim dashuri dhe dashuria më e thellë vjen kur ne jemi një me Perëndinë. Libri i Mormonit na fton që të "pajtoh[emi] me [Perëndinë], nëpërmjet shlyerjes së Krishtit"⁸.

Isaia foli për ata që e jetojnë me besnikëri ligjin e agjërimit, dhe në këtë mënyrë bëhen për pasardhësit e tyre një riparues i të çarave. Këta janë ata të cilët do të "rindërtojnë rrënojat e lashta"⁹, premtion Isaia. Në mënyrë të ngjashme, Shpëtimtari riparoj të çarën, apo distancën, ndërmjet nesh dhe Atit Qiellor. Ai, nëpërmjet sakrificës së Tij të



madhërisht shlyese, hap udhën për ne që të marrim nga fuqia e dashurisë së Perëndisë dhe paskëtaj ne aftësohemi për t'i riparuar "rrenojat e lashta" në jetën tonë vetjake. Shërimi i ftohtësisë emocionale ndërmjet njëri-tjetrit do të kërkojë pranimin nga ne të dashurisë së Perëndisë, të gërshetuar me një sakrificim të prirjeve tona të natyrishtme të egoizmit dhe frikës.

Në një mbrëmje të paharrueshme, unë dhe një e afërme u grindëm për një çështje politike. Nga një distancë që pjesëtarët e familjes e dëgjuan, ajo në mënyrë të shpejtë e tërësore u kap pas komenteve të mia dhe i kritikoi duke vërtetuar se e kisha gabim. U ndjeva si e pamend dhe e painformuar – dhe ndofta ashtu isha. Atë natë, kur u gju-njézova për t'u lutur, nxitova t'i shpjegoja Atit Qiellor se sa e vështirë ishte kjo e afërme! Fola e fola. Mbase i ndala për një çast ankesat e mia dhe Fryma e Shenjtë pati mundësi të më tërhiqte vëmendjen, pasi më pas, për habinë time, e dëgjova veten të thosha: "Ti ndoshta dëshiron prej meje që ta dua atë". Ta dua atë? Vazhdova të lutesha, duke thënë pak a shumë: "Si mund ta dua atë?"

As nuk mendoj që e pëlqej atë. Zemra më është ashpërsuar; ndjenjat më janë lënduar. Nuk mund ta dua atë."

Pastaj, sigurisht me ndihmë nga Shpirti, pata një mendim të ri ndërsa thashë: "Por Ti e do atë, Ati Qiellor. A do të më japësh një pjesë të dashurisë Tënde për të – në mënyrë që edhe unë të mund ta dua atë?" Ndjenjat e mia të ashpërsuara u zbutën, zemra ime filloi të ndryshonte dhe unë fillova ta shoh këtë person në një mënyrë të ndryshme. Unë fillova ta perceptoja vlerën e saj të vërtetë që Ati Qiellor shihte [tek ajo]. Isaia shkruan: "Zoti do të lidhë plagën e popullit të tij dhe do të shërojë plagën e shkakuar nga goditjet e tij"¹⁰.

Me kalimin e kohës, hendeku mes ne të dyjave u mbyll këndshëm. Por, edhe nëse ajo nuk do ta kishte pranuar zemrën time të ndryshuar, unë mësova se Ati Qiellor do të na ndihmojë t'i duam edhe ata që ne mund të mendojmë se nuk mund t'i duam, nëse përgjrohemi për ndihmën e Tij. Shlyerja e Shpëtimtarit është një udhëkalim për rrjedhjen e vazhdueshme të dashurisë hyjnore nga Ati ynë në Qiell. Ne duhet të zgjedhim që të banojmë në këtë

dashuri me qëllim që të kemi dashuri hyjnore për të gjithë.

Kur ia japim zemrën tonë Atit dhe Birit, ne e ndryshojmë botën tonë – edhe nëse rrethanat përfaqësojnë nesh nuk ndryshojnë. Ne i afrohemi më pranë Atit Qiellor dhe e ndiejmë pranimin e dhembshur prej Tij të përpjekjeve tona për të qenë dishepuj të vërtetë të Krishtit. Aftësia jonë për të dalluar, mirëbesimi dhe besimi ynë rriten.

Mormoni na thotë që të lutemi me të gjithë fuqinë e zemrës për këtë dashuri dhe ajo do të na jepet nga burimi i saj – Ati Qiellor.¹¹ Vetëm atëherë ne mund të bëhemi riparues të të çarave në marrëdhëniet tokësore.

Dashuria e pafundme e Atit tonë zgjatet drejt nesh, për të na kthyer përsëri në lavdinë dhe gëzimin e Tij. Ai dha Birin e Tij të Vetëmlindur, Jezu Krishtin, për të riparuar të çarën që hapet gjerë e gjatë mes nesh dhe Tij. Ribashkimi me Atin në Qiell është thelbi i dashurisë së përhershme dhe i qëllimit të përjetshëm. Ne duhet ta krijojmë lidhjen me Të tani, që të mësojmë atë që ka me të vërtetë rëndësi, që të duam ashtu si do Ai dhe të rritemi që të jemi si Ai. Dëshmoj se marrëdhënia jonë besnike me Atin Qiellor dhe Shpëtimtarin ka rëndësi të përjetshme për Ta dhe për ne. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Jeremia 31:3.
2. Moisiu 6:34.
3. Bruce R. McConkie, "The Mystery of Godliness" (mbledhje rreth vatrës në universitetin "Brigam Jang", 6 janar 1985), f. 1, speeches.byu.edu.
4. Shih Bruce R. McConkie, "The Mystery of Godliness", f. 4.
5. Autori i panjohur.
6. Shih Ezra Taft Benson, "Cleansing the Inner Vessel", *Ensign*, maj 1986, f. 4-7.
7. Doktrina e Besëlidhje 88:63.
8. Jakobi [LiM] 4:11.
9. Isaia 58:12.
10. Isaia 30:26.
11. Shih Moroni 7:48.



Nga Xhoi D. Xhons,
Presidente e Përgjithshme e Fillores

Vlerë e Pamasë

Ne mund t'i shijojmë rregullisht pëshpëritjet e ëmbla të Frymës së Shenjtë, që na provon të vërtetën e vlerës sonë shpirtërore.

Ndërsa po vizitoja vendin e Sierra-Leones në Afrikën Perëndimore, mora pjesë në një mbledhje që drejtohej nga një udhëheqëse e Fillores në kunj. Mariama udhëhiqte me kaq dashuri, hir dhe vetëbesim sa që lehtësisht mund të supozojë se kishte qenë anëtare e Kishës për një kohë të gjatë. Megjithatë, Mariama ishte një e porsakthyer në besim.

Motra e saj më e vogël u bashkua me Kishën dhe e ftoi Mariamën që të merrte pjesë me të në një nga orët mësimore të Kishës. Mariamës i bëri përshtypje të thellë mesazhi. Mësimi ishte për ligjin e dëlirësisë. Ajo iu kërkoi misionarëve që t'i jepnin më shumë mësim dhe shpejt mori një dëshmi për Profetin Jozef Smith. Ajo u pagëzua në vitin 2014 dhe e bija u pagëzua muajin e kaluar. Përfytyroni, dy mësimet bazë që çuan në kthimin në besim të Mariamës ishin ligji i dëlirësisë dhe Profeti Jozef Smith, dy pika që bota shpesh i sheh si pavend, të dala mode ose të papërshtatshme. Por Mariama dëshmoi se ishte si një flutur nate që tërhiqej nga drita. Ajo tha: “Kur e gjeta ungjillin, gjeta vetveten”. Ajo e zbuloi vlerën e saj nëpërmjet parimeve hyjnore. Vlera e saj si bijë e Perëndisë iu zbulua asaj nëpërmjet Frymës së Shenjtë.

Tani le të njihemi me motrat Sink nga India. Renuja, në cep djathtas, e para ndër pesë motrat që u bashkua me Kishën, tregoi këto mendime:

“Përpara se të filloja të kërkoja për Kishën, në të vërtetë nuk e kuptoja se isha tepër e veçantë. Isha thjesht një ndër shumë njerëz dhe shoqëria e kultura ime nuk më mësuan siç duhej se kisha vlerë si individ. Kur e mësova ungjillin dhe mësova se isha një bijë e Atit tonë Qiellor, solli një ndryshim tek unë. Papritmas u ndjeva shumë e veçantë – në fakt Perëndia më kishte



Mariama, në fotografi me të bijën, e zbuloi vlerën e saj pas zbulimit të parimeve hyjnore.

krijuar mua dhe e kishte krijuar shpirtin tim dhe jetën time me vlerë dhe qëllim.

Përpara se ta kisha ungjillin në jetën time, përpiquesha gjithmonë që t'u provoja të tjerëve se isha një njeri i veçantë. Por, kur mësova të vërtetën, se jam një bijë e Perëndisë, nuk më duhej t'i vërtetoja askujt asgjë. Unë e dija se isha e veçantë. . . . Kurrë mos mendoni se jeni një hiç.”

Presidenti Tomas S. Monson e tha në mënyrë të përsosur kur citoi këto fjalë: “Vlera e një shpirti është aftësia e tij për t'u bërë si Perëndia”¹.

Kohët e fundit u bekova [me mundësinë] që të takoja një tjetër të re e cila e kupton këtë të vërtetë të njëjtë. Ajo quhet Tajana. E takova atë te spitali i pediatriisë në Solt-Lejk-Siti. Tajana ishte në klasë të 11-të në shkollë të mesme kur u diagnostikua me kancer. Ajo luftoi një betejë të guximshme për 18 muaj përpara se të ndërronte jetë para disa javësh. Tajana ishte e mbushur plot me dritë dhe dashuri. Ajo njihej për buzëqeshjen e saj ngjitesë dhe shenjë të saj dalluese me “dy gishtat e mëdhenj lart”. Kur të tjerët e pyetnin: “Përse ti,



Dijena se ajo është një bijë e Perëndisë, i dha Tajanës paqe dhe guxim për t'u përballur me sprovën e saj.

Tajana?” përgjigja e saj ishte: “Përse jo unë?” Tajana u përpoq të bëhej si Shpëtimtari, të cilin ajo e donte aq shumë. Gjatë vizitave tona, mësova se Tajana e kuptoi vlerën e saj hyjnore. Dijenja se ajo ishte një bijë e Perëndisë, i dha asaj paqe dhe guxim për ta përballuar sprovën e saj të mundimshme në mënyrë pozitive, sikurse bëri.

Mariama, Renuja dhe Tajana na mësojnë se Shpirti do t’ia pohojë secilit prej nesh individualisht vlerën tonë hyjnore. Dijenja se vërtet jeni bijë e Perëndisë, do të ketë ndikim në çdo aspekt të jetës suaj dhe do t’ju drejtojë në shërbimin që jepni çdo ditë. Presidenti Spenser W. Kimbëll e shpjegoi me këto fjalë të lavdishme:

“Perëndia është Ati juaj. Ai ju do. Ai dhe nëna juaj në qiell ju vlerësojnë pa masë. . . . Ju jeni të veçantë. Të pashoq, të krijuar nga inteligjenca e përjetshme e cila ju jep të drejtën ta pretendoni jetën e përjetshme.

Mos pastë asnjë pyetje në mendjen tuaj lidhur me vlerën tuaj si individ! I gjithë synimi i planit të ungjillit është t’i japë një mundësi secilit prej jush që

të arrijë potencialin e plotë, i cili është përparimi i përjetshëm dhe mundësia për t’u bërë të perëndishëm.”²

Më lejoni të theksoj nevojën për të bërë dallimin midis dy fjalëve të rëndësishme: *vlerë [shpirtërore]* dhe *denjësi*. Ato nuk janë njësoj. *Vlerë* shpirtërore do të thotë ta vlerësosh veten sipas mënyrës që na vlerëson Ati Qiellor, jo siç na vlerëson bota. *Vlera* jonë u përcaktua përpara se të vinim në këtë tokë. “Dashuria e Perëndisë është e pafundme dhe ajo do të zgjatë përgjithmonë.”³

Nga ana tjetër, *denjësia* arrihet nëpërmjet bindjes. Nëse mëkatojmë, ne jemi më pak të denjë, por nuk jemi kurrë pa vlerë! Ne vazhdojmë të pendohemi dhe të përpiqemi që të jemi si Jezusi pa na u cenuar vlera. Sikurse dha mësim Presidenti Brigam Jang: “Edhe shpirti më i mpakur, më i ulët tani mbi tokë . . . vlen sa botë të tëra”⁴. Pavarësisht gjithçkaje, ne kemi gjithnjë vlerë në sytë e Atit tonë Qiellor.

Me gjithë këtë të vërtetë të mrekullueshme, sa prej nesh kanë mundime herë pas here, me mendime ose ndjenja negative për veten? Unë kam. Është një

kurth ku bihet lehtësisht. Satani është ati i të gjitha gënjeshtreve, veçanërisht kur vjen puna te keqinterpretimet rreth natyrës dhe qëllimit tonë hyjnor. Mendimi se vlejme pak nuk sjell ndonjë dobi për ne. Përkundrazi na pengon. Siç na është mësuar shpesh: “Askush nuk mund t’ju bëjë të ndiheni të ulët pa pëlqimin tuaj”⁵. Ne mund të ndalojmë së krahasuari më të këqijat tona me më të mirat e dikujt tjetër. “Krahasimi është vjedhësi i gëzimit.”⁶

Në dallim, Zoti na siguron se, kur kemi mendime të virtutshme, Ai do të na bekojë me vetëbesim, madje me vetëbesimin për të ditur se kush jemi me të vërtetë. Nuk ka pasur kurrë kohë më vendimtare për t’ua vënë veshin fjalëve të Tij. “Virtyti duhet t’i stolisë mendimet e tua pa pushim”, tha Ai. “Atëherë do të forcohet vetbesimi yt në prani të Perëndisë; dhe . . . Fryma e Shenjtë do të jetë shoqëruesi yt i vazhdueshëm.”⁷

Zoti i zbuloi Profetit Jozef Smith këtë të vërtetë të mëtejshme: “Ai që merr nga Perëndia, duhet të jetë i përgjegjshëm për të ndaj Perëndisë; dhe duhet të gëzohet që ai konsiderohet nga Perëndia si i denjë për të marrë”⁸. Kur e ndiejmë Shpirtin, siç shpjegon ky varg, ne e dallojmë se ajo që ndiejmë vjen nga Ati ynë i dashur Qiellor. Ne e falënderojmë dhe i japim lavdi Atij për bekimet që na jep. Ne më pas gëzohemi që konsiderohemi si të denjë për të marrë.

Përfytyroni sikur po i lexoni shkrimet e shenjta një mëngjes dhe Shpirti ju pëshpërit butë se ajo që po lexoni, është e vërtetë. A mund ta dalloni Shpirtin dhe të jeni e lumtur që e ndiet dashurinë e Tij dhe se ishit e denjë për ta marrë?

Nëna, ju mund të gjunjëzoheni pranë birit tuaj katërvjeçar ndërsa bën lutjen e tij të mbrëmjes. Një ndjenje ju përshkon teksa dëgjoni. Ju ndieni ngrohtësi dhe paqe. Ndjenja zgjat



Nëpërmjet ungjillit, Renu Sin (larg në të djathtë) e mësoi vlerën e saj si bijë e Perëndisë dhe u bë e para nga pesë motrat që u bashkua me Kishën.

pak, por e kuptoni se në atë çast jeni konsideruar si e denjë për të marrë. Ne rrallëherë mund të marrim, nëse do të marrim, shfaqje shpirtërore të bujshme në jetën tonë; por ne mund t'i shijojmë rregullisht pëshpëritjet e ëmbla të Frymës së Shenjtë, që na e vërteton të vërtetën e vlerës sonë shpirtërore.

Zoti shpjegoi marrëdhënien midis vlerës sonë dhe flijimit të Tij të madh shlyes kur tha:

“Kujtoni që vlera e shpirtave është e madhe në sytë e Perëndisë;

Sepse, vini re, Zoti, Shëlbuesi juaj vuajti vdekjen në mish; prandaj ai vuajti dhembjen e gjithë njerëzve, që gjithë njerëzit të mund të pendohen e të vijnë tek ai”⁹.

Motra, për shkak të asaj që Ai bëri për ne, “ne lidhemi me Të plot dashuri”¹⁰. Ai tha: “Ati im më dërgoi që të mund të ngrihesha në kryq; dhe pasi u ngrita në kryq, që t'i tërheq të gjithë njerëzit tek unë”¹¹.

Mbreti Benjamin e shpjegoi gjithash-tu këtë lidhje të ngushtë me Shpëtimtarin tonë: “Dhe vini re, ai do të durojë tundime dhe dhembje të trupit, uri, etje dhe lodhje, madje më shumë se sa njeriu mund të vuajë, përveçse në vdekje; pasi shikoni, gjaku del nga çdo por, kaq e madhe do të jetë dhembja e tij për ligësinë dhe neveritë e popullit të tij”¹². Ajo vuajtje dhe pasojat e asaj vuajtje e mbushin zemrën tonë me dashuri dhe mirënjohje. Plaku Pol E. Kolliker dha mësim: “Ndërsa largojmë hutimet që na tërheqin drejt botës dhe ushtrojmë lirinë tonë të zgjedhjes për ta kërkuar Atë, ne hapim zemrat tona drejt një force çelestiale, që na afron drejt Atij”¹³. Nëse dashuria që ndiejmë për Shpëtimtarin dhe për atë që Ai bëri për ne, është më e madhe se energjia që u japim dobësive, dyshimeve për veten, apo zakoneve të këqija, atëherë Ai do të na ndihmojë t'i mposhtim



gjërat që shkaktojnë vuajtje në jetën tonë. Ai na shpëton nga vetvetja.

Më lejoni ta ritheksoj: nëse tërheqja e botës është më e fortë sesa besimi dhe mirëbesimi që kemi te Shpëtimtari, atëherë tërheqja e botës do të mbizotërojë kurdoherë. Nëse zgjedhim të përqendrohemi te mendimet tona negative dhe ta vëmë në mëdyshje vlerën tonë, në vend që të kapemi pas Shpëtimtarit, do të bëhet më e vështirë për t'i ndier përshtypjet e Frymës së Shenjtë.

Motra, le të mos përshtjellohemi rreth faktit se cilat jemi! Ndërsa shpeshherë është më e lehtë që të jemi shpirtërisht jo vepruese sesa të bëjmë përpjekjen shpirtërore për të kujtuar dhe përqafuar identitetin tonë hyjnor, ne nuk mund t'ia lejojmë vetes atë lëshim në këto ditë të mëvonshme. Qofshim ne, si motra, “besnik[e] në Krisht; . . . Krishti të mund të [na] ngrejë dhe qëndroshin në mendjen [tonë] përherë vuajtjet dhe vdekja e tij . . . dhe mëshira dhe durimi i tij, dhe shpresa e lavdisë së tij dhe e jetës së përjetshme”¹⁴. Ndërsa

Shpëtimtari na ngre në një nivel më të lartë, ne mund të kuptojmë më qartë jo vetëm se kush jemi, por që jemi më afër Tij nga se e kemi imagjinuar ndonjëherë. Në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Tomas S. Monson, “Detyrat e Shenjta të Pritërisë që na Janë Besuar”, *Liahona*, maj 2006, f. 55, [Konferenca e Përgjithshme, Prill 2006 f. 89].
2. Spencer W. Kimball, “Privileges and Responsibilities of Sisters”, *Ensign*, nëntor 1978, f. 105.
3. D. Tod Kristoferson, “Qëndroni në Dashurinë Time”, *Liahona*, nëntor 2016, f. 48.
4. Brigham Young, “Remarks”, *Deseret News*, 6 mars 1861, f. 2.
5. I atribuohet Ileonor Ruzveltit.
6. I atribuohet Teodor Ruzveltit.
7. Doktrina e Besëlidhje 121:45, 46.
8. Doktrina e Besëlidhje 50:34.
9. Doktrina e Besëlidhje 18:10–11.
10. “Dashuria e Shpëtimtarit Tonë”, *Himne*, nr. 59.
11. 3 Nefi 27:14.
12. Mosia 3:7.
13. Pol E. Kolliker, “Ai me të Vërtetë na Do”, *Liahona*, maj 2012, f. 18.
14. Moroni 9:25.



Nga Presidenti Diter F. Uhtdorf,
Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë

Tri Motra

Ne jemi përgjegjës për vetë dishepullimin tonë dhe kjo ka pak lidhje - nëse ka ndonjë - me mënyrën se si na trajtojnë të tjerët.

Të dashura motra, të dashura mikeshja, ta fillojmë konferencën e përgjithshme me një sesion mbarëbotëror të motrave është e rëndësishme dhe e mrekullueshme. Thjesht përfytyrojeni motra nga të gjitha moshat, prejardhjet shoqërore, kombësitë dhe gjuhët, të bashkuara me besim dhe dashuri për Zotin Jezu Krisht.

Herën e fundit që u takuam me profetin tonë të dashur, Presidentin Tomas S. Monson, ai na shprehu se sa shumë e do Zotin. Dhe unë e di që Presidenti Monson është shumë mirënjohës për dashurinë tuaj, lutjet tuaja dhe përkushtimin tuaj ndaj Zotit.

Shumë kohë më parë, në një vend të largët, jetonte një familje me tri motra.

Motra e parë ishte **e trishtuar**. Gjithçka, që nga hunda deri te mjekra dhe nga koka deri te gishtat e këmbëve të saj, nuk i dukej mjaft e mirë. Kur fliste, nganjëherë fjalët i dilnin me vësh-tirësi dhe njerëzit qeshnin. Kur dikush e kritikonte ose "harronte" ta ftonte në diçka, ajo do të skuqej, do të largohej dhe do të gjente një vend të fshehtë ku do të lëshonte një psherëtimë të trishtuar dhe do ta pyeste veten përse jeta, si përfundim, i ishte bërë kaq e zymtë dhe e pahareshme.

Motra e dytë ishte **e zemëruar**. Mendonte për veten se ishte shumë e

zgjuar, por gjithmonë gjendej dikush tjetër që merrte nota më të mira në provimet e shkollës. Ajo e konsideronte veten zbavitëse, bukuroshe, moderne dhe mahnitëse. Por gjithmonë dukej se gjendej një tjetër që ishte më zbavitëse, më bukuroshe, më moderne dhe më mahnitëse.

Ajo s'qe kurrë e para në ndonjë gjë dhe këtë nuk mund ta duronte. Jeta nuk duhej të ishte kështu!

Nganjëherë u kthehej me inat të tjerëve dhe dukej se ishte gjithmonë një grimë larg prej të ndierit e fyer nga një gjë apo një tjetër.

Sigurisht, kjo nuk e bëri atë më të pëlqyeshme apo më të njohur. Nganjëherë shtrëngonte dhëmbët, mblidhte grushtet e mendonte: "Jeta është kaq e padrejtë!"

Më pas vinte motra e tretë. Ndryshe nga motra e saj e trishtuar dhe motra e saj e zemëruar, ajo ishte - pra, **e gëzuar**. Dhe kjo nuk ndodhte ngaqë ajo ishte më e mençur apo më e bukur, ose më e zonja se motrat e saj. Jo, nganjëherë njerëzit i shmangeshin ose e shpërfillnin edhe atë. Nganjëherë bënin shaka me gjërat që kishte veshur apo gjërat që po thoshte. Nganjëherë thonin gjëra të këqija rreth saj. Por ajo nuk e linte asgjë të tillë që ta shqetësonte shumë.

Kësaj motre i pëlqente shumë të këndonte. Nuk këndonte dhe aq mirë dhe njerëzit qeshnin për këtë, por kjo s'e ndalte atë. Ajo do të thoshte: "Nuk do t'i lejoj njerëzit e tjerë dhe opinionet e tyre që të më ndalojnë të këndo!"

Pikërisht fakti që ajo vazhdonte të këndonte, e bënte të trishtuar motrën e saj të parë dhe të zemëruar motrën e saj të dytë.





Shumë vite kaluan dhe më së fundi secila motër mbërriti në mbarimin e jetës së saj në tokë.

Motra e parë, e cila zbuloi herë pas here se nuk ka mungesë zhgënjimesh në jetë, përfundimisht vdiq **e trishtuar**.

E dyta, e cila çdo ditë gjeti diçka të re për të mos e pëlqyer, vdiq **e zemëruar**.

Dhe motra e tretë, e cila e kaloi jetën e vet duke e kënduar këngën e saj me gjithë fuqinë e saj dhe me një buzëqeshje plot vetëbesim në fytyrë, vdiq **e gëzuar**.

Sigurisht, jeta nuk është kurrë kaq e thjeshtë dhe njerëzit nuk janë kurrë kaq të pandryshueshëm si tri motrat në këtë tregim. Por edhe shembuj të skajshëm si këta mund të na mësojnë diçka rreth vetvetes. Nëse jeni si shumica prej nesh, mund të keni dalluar pjesë të vetes suaj tek një, dy apo ndoshta që të tria motrat. Le ta shohim më nga afër secilën.

Viktima

Motra e parë e pa veten e saj si një viktimë – si dikë mbi të cilën vepronin të tjerët.¹ Dukej se asaj vazhdonin t'i ndodhnin njëra pas tjetrës gjëra që e bënin të mjeruar. Me këtë qëndrim ndaj jetës, ajo po u jepte të tjerëve kontroll mbi mënyrën se si ndihej e sillej. Kur e bëjmë këtë gjë, ne vihem në lëvizje

nga çdo erë opinioni – dhe në këtë kohë të mjeteve të gjithëpranishme shoqërore të informimit, ato erëra fryjnë me fuqinë e një uragani.

Motra të dashura, përse duhet t'ia dorëzoni lumturinë tuaj dikujt, apo një grupi dikujt-ësh, që tregon shumë pak interes për ju ose lumturinë tuaj?

Nëse shqetësoheni se çfarë thonë për ju njerëzit e tjerë, lejomëni të sugjeroj këtë kundërhelm: kujtoni se cila jeni. Mbajeni mend që jeni nga shtëpia mbretërore e mbretërisë së Perëndisë, bija të Prindërve Qiellorë, të cilët mbretërojnë anekënd gjithësisë.

Ju keni ADN-në shpirtërore të Perëndisë. Keni dhunti të pasqyrore që e patën zanafillën në krijimin tuaj shpirtëror dhe që u zhvilluan gjatë një shtrirjeje të gjerë në jetën tuaj para lindjes. Ju jeni fëmija i Atit tonë të mëshirshëm dhe të përjetshëm në Qiell, Zotit të Ushtrive, Atij që krijoi gjithësinë, përhapit yjet rrotullues përmes një shtrirjeje të gjerë të hapësirës dhe i vendosi planetët në orbitat e tyre të caktuara.

Ju jeni në duart e Tij.

Duar shumë të mira.

Duar të dashura.

Duar përkujdesëse.

Dhe asgjë që thotë për ju kushdo, kurdoqoftë, nuk mund ta ndryshojë atë. Fjalët e tyre janë pa domethënie

kur krahasohen me atë që Perëndia ka thënë rreth jush.

Ju jeni fëmija i Tij i çmuar.

Ai ju do.

Edhe kur pengoheni, edhe kur largoheni prej Tij, Perëndia ju do. Nëse ndiheni të humbura, të braktisura apo të harruara – mos kini frikë. Bariu i Mirë do t'ju gjejë. Do t'ju ngrejë mbi supet e Tij. Dhe do t'ju çojë në shtëpi.²

Motrat e mia të dashura, ju lutem, lejojini këto të vërteta hyjnore të nguliten thellë në zemrat tuaja. Dhe do të gjeni se ka shumë arsye për të mos qenë të trishtuara, sepse ju keni për të përmbushur një të ardhme të përjetshme.

Shpëtimtari i dashur i botës e dha jetën e Tij me qëllim që ju të mund të zgjidhni që ta bëni atë të ardhme një realitet. Keni marrë mbi vete emrin e Tij; jeni dishepullet e Tij. Dhe për shkak të Tij, ju mund të visheni me rroba lavdie të përjetshme.

Urryesja

Motra e dytë ishte e inatosur me botën. Sikurse motra e saj e trishtuar, ajo ndiente se problemet në jetën e saj ishin të gjitha të shkaktuara nga dikush tjetër. Ua hodhi fajin familjes së saj, miqve të saj, drejtorit dhe kolegëve të saj, policisë, fqinjëve, udhëheqësve të Kishës, prirjeve bashkëkohore të

modës, madje fuqisë së stuhive diellore dhe thjesht fatit të keq. Dhe iu kthehej me inat atyre të gjithave.

Nuk mendonte për veten e saj si një njeri të keq. Përkundrazi, e ndiente se vetëm po mbronte vetveten. Kushdo tjetër, besonte ajo, merrte shtysë nga egoizmi, vogëlsirat dhe urrejtja. Ajo, nga ana tjetër, shtyhej nga qëllime të mira – drejtësia, integriteti moral dhe dashuria.

Për fat të keq, mënyra e të menduarit e motrës së zemëruar është e gjitha tepër e zakonit. Kjo u vu në dukje nga një studim i kohëve të fundit që bëri kërkime mbi konfliktin midis grupeve kundërshtarë. Si pjesë e studimit, hulumtuesit intervistuan palestinezë dhe izraelitë në Lindjen e Mesme dhe republikanë e demokratë në Shtetet e Bashkuara. Ata zbuluan që “secila palë mendonte se grupi i tyre shtyhej nga dashuria më shumë sesa urrejtja, por, kur i pyetën përse grupi i tyre kundërshtar përfshihej në konflikt, [ata] vunë në dukje urrejtjen si faktorin kryesor shtytës të grupit [tjetër]”³.

Me fjalë të tjera, secili grup mendoj për veten e vet si “njerëzit e mirë” – të drejtët, dashamirësit dhe të vërtetët. Nga ana tjetër, ata i panë kundërshtarët e tyre si “njerëzit e këqij” – të painformuarit, të pandershmit, madje të ligjtë.

Vitin kur u lindi unë, bota u zhyt në një luftë të tmerrshme që i solli botës dëshpërim pikëllues dhe hidhërim shkatërrues. Kjo luftë u shkaktua nga një grup njerëzish prej vetë kombit tim – nga një grup njerëzish që i përcaktuan grupe të tjera të caktuara si të ligj dhe nxitën urrejtje ndaj tyre.

Ata i bënë të heshtnin njerëzit që nuk i pëlqenin. I turpëruan dhe i paraqitën ata si të këqij. I konsideruan të një klase më të ulët – madje më pak se njerëzorë. Pasi ta nënçmosh një grup njerëzish, ka më shumë të ngjarë që të

shfajësosh fjalët dhe veprimet e dhunës kundër tyre.

Rrëqethem kur mendoj rreth asaj që ndodhi në Gjermaninë e shekullit të 20-të.

Kur dikush na kundërshton ose nuk bie dakord me ne, është tunduese që të hamendësojmë se duhet të ketë diçka që nuk shkon tek ata. Dhe nga ajo pikë është fare e lehtë t’iu bashkëngjitesh shtysat më të këqija fjalëve dhe veprimeve të tyre.

Sigurisht, gjithmonë duhet të mbrojmë atë që është e drejtë dhe ka raste kur duhet t’i ngremë zërat tanë për atë kauzë. Megjithatë, kur e bëjmë këtë me zemërim ose urrejtje në zemrat tona – kur u kthehemi me inat të tjerëve për t’i lënduar e turpëruar ata, apo për t’ua mbyllur gojën atyre – ka të ngjarë që nuk po e bëjmë këtë gjë me drejtësi.

Çfarë dha mësim Shpëtimtari?

“Por unë po ju them: ‘Duani armiq të tuaj, bekoni ata që ju mallkojnë, u bëni të mirë atyre që ju urrejnë, dhe lutuni për ata që ju keqtrajtojnë dhe ju përndjekin,

për të qenë bij të Atit tuaj që është në qiej.’”⁴

Kjo është mënyra e Shpëtimtarit. Është hapi i parë për shembjen e

pengesave që krijojnë kaq shumë zemërim, urrejtje, përçarje dhe dhunë në botë.

“Po”, mund të thoni ju, “do të jem i gatshëm t’i dua armiq të mi – sikur vetëm ata të jenë të gatshëm të bëjnë të njëjtën gjë.”

Por kjo nuk ka rëndësi vërtet, apo jo? Ne jemi përgjegjës për vetë dishepullimin tonë dhe kjo ka pak lidhje – nëse ka ndonjë – me mënyrën se si na trajtojnë të tjerët. Ne sigurisht shpresojmë që ata do të jenë të mirëkuptueshëm e dashamirës ndaj nesh, por dashuria jonë për ta është e pavarur nga ndjenjat e tyre ndaj nesh.

Ndoshta përpjekja jonë për t’i dashur armiq të tanë do t’i zbutë zemrat e tyre dhe do të ndikojë për mirë tek ata. Ndoshta jo. Por kjo nuk e ndryshon zotimin tonë për ta ndjekur Jezu Krishtin.

Prandaj, si anëtarë të Kishës së Jezu Krishtit, ne vërtet do t’i duam armiq të tanë.

Vërtet do ta mposhtim zemërimin ose urrejtjen.

Vërtet do t’i mbushim zemrat tona me dashuri për të gjithë fëmijët e Perëndisë.

Vërtet do të ndihmojmë për t’i bekuar të tjerët dhe për t’u dhënë shërbesë



atyre – edhe atyre që mund të na “keq-trajtojnë dhe [na] përndjekin”⁵.

Dishepullja e Vërtetë

Motra e tretë përfaqëson dishepullen e vërtetë të Jezu Krishtit. Ajo bëri diçka që mund të jetë jashtëzakonisht e vështirë për t'u bërë: i mirëbesoi Perëndisë edhe kur u përball me përqeshje dhe vështirësi. Në njëfarë mënyre ajo e ruajti besimin dhe shpresën e saj, pavarësisht nga përcmimi dhe cinizmi përreth saj. Jetoj plot gëzim jo ngaqë rrethanat e saj ishin plot gëzim, por ngaqë ajo ishte plot gëzim.

Askush prej nesh nuk ia del përmes udhëtimit të jetës pa hasur kundërshtim. Me kaq shumë forca që përpiqen të na largojnë, si ta mbajmë këndvështrimin tonë të përqendruar te lumturia e lavdishme që u premtohet besnikëve?

Besoj se përgjigjja mund të gjendet në një ëndërr që e pati një profet mijëra vjet më parë. Emri i profetit është Lehi dhe ëndrra e tij shënohet në Librin e shtrenjtë dhe të mrekullueshëm të Mormonit.

Në ëndërrën e tij, Lehi pa një fushë të gjerë dhe në të gjendej një pemë e mrekullueshme, e bukur përtej çdo përshkrimi. Ai gjithashtu pa grupe të mëdha njerëzish duke ecur drejt pemës. Ata donin ta shijonin frytin e saj të lavdishëm. Menduan e mirëbesuan se do t'iu jepte lumturi të madhe dhe paqe të qëndrueshme.

Pati një shteg të ngushtë që çonte drejt pemës dhe përgjatë tij ishte një shufër e hekurt, e cila i ndihmoi të qëndronin në shteg. Por pati gjithashtu një mjegull errësire që ua pengoi të shikuarin si të shtegut ashtu edhe të pemës. Dhe ndoshta madje më i rrezikshëm ishte tingulli i të qeshurës dhe talljes së fortë që vinte nga një ndërtesë e gjerë dhe e madhe aty pranë. Në



mënyrë befasuese, përqeshja madje i bindi disa njerëz, të cilët e kishin arritur pemën dhe e kishin shijuar frytin e mrekullueshëm, që të fillonin të ndiheshin të turpëruar dhe të largoheshin duke u endur.⁶

Ndoshta filluan të dyshonin që pema ishte vërtetë aq e bukur sa ç'e kishin menduar dikur. Ndoshta filluan ta vinin në pikëpyetje realitetin e asaj që kishin përjetuar.

Mbase menduan se, në qoftë se do të largoheshin nga pema, jeta do të ishte më e lehtë. Mbase nuk do t'i tallnin apo përqeshnin më.

Dhe ndërkohë, njerëzit që po i përçmonin, dukeshin si njerëz që ishin mjaft të lumtur dhe po ia kalonin mirë. Prandaj ndoshta po ta braktisnin pemën, do të mirëpriteshin në bashkësinë e ndërtesës së gjerë dhe të madhe dhe do të merrnin duartrokitje për gjykimin, inteligjencën dhe sofistifikimin e tyre.

Qëndroni në Shteg

Motra të dashura, mikesha të dashura, nëse e shihni të vështirë që të mbaheni fort te shufra e hekurt dhe të ecni pa u lëkundur drejt shpëtimit; nëse e qeshura dhe tallja e atyre që duken me shumë besim te vetja, ju bëjnë që të lëkundeni; nëse shqetësoheni nga pyetjet pa përgjigje apo doktrinat që ende s'i kuptoni; nëse ndiheni të trishtuara për shkak të zhgënjimeve, unë ju nxit të kujtoni ëndërrën e Lehit.

Qëndroni në shteg!

Kurrë mos e lëshoni shufrën e hekurt – fjalën e Perëndisë!

Dhe kur dikush përpriqet t'ju bëjë të ndiheni të turpëruara ngaqë merrni prej dashurisë së Perëndisë, mos ua vini veshin.

Kurrë mos harroni se ju jeni fëmijë i Perëndisë; bekime prisni përherë; po të mësoni të bëni vullnetin e Tij, me Të do të rroni edhe njëherë!⁷

Premtimet e lavdërimit dhe të pranimit nga bota janë të pasigurta, të pavërteta dhe të pakënaqshme. Premtimet e Perëndisë janë të sigurta, të vërteta dhe të gëzueshme – tani e përgjithmonë.

Ju ftoj ta merrni parasysht fenë dhe besimin nga një këndvështrim më i lartë. Asgjë që ofrohet në godinën e gjerë dhe të madhe, nuk mund të krahasohet me frytin e të jetuarit të ungjillit të Jezu Krishtit.

Me të vërtetë, “ato gjëra që syri nuk i ka parë dhe veshi nuk i ka dëgjuar dhe nuk kanë hyrë në zemër të njeriut, janë ato që Perëndia ka përgatitur për ata që e duan atë”⁸.

Unë vetë kam mësuar se shtegu i dishepullimit në ungjillin e Jezu Krishtit është udha drejt gëzimit. Është udha drejt sigurisë e paqes. Është udha drejt së vërtetës.

Unë dëshmoj që, nëpërmjet dhuratës dhe fuqisë së Frymës së Shenjtë, ju mund ta mësoni këtë gjë për veten tuaj.

Ndërkohë, nëse shtegu bëhet i vështirë për ju, shpresoj që do të gjeni strehë e forcë në organizatat tona të

mrekullueshme të Kishës: në Filloren, Të Rejat dhe Shoqatën e Ndihmës. Ato janë si vendpushime përgjatë shtegut, ku mund të ripërtërin vetëbesimin dhe besimin tuaj për udhëtimin përpara jush. Janë një shtëpi e sigurt, ku mund të përjetoni një ndjenjë përkatësie dhe mund të merrni nxitje nga motrat dhe bashkëdishepullët tuaja.

Gjërat që i mësoni në Fillore, ju përgatitin për të vërtetat shtesë që i mësoni si vajza të reja. Shtegu i dishepullimit në të cilin ecni në klasat tuaja të Të Rejave, ju çon drejt shoqërimit dhe motërisë në Shoqatën e Ndihmës. Me çdo hap përgjatë udhës, juve ju jepen mundësi shtesë për ta treguar dashurinë tuaj për të tjerët nëpërmjet veprimeve të besimit, dhembshurisë, dashurisë hyjnore, virtutit dhe shërbimit.

Zgjedhja e këtij shtegu të dishepullimit do të çojë drejt lumturisë dhe përmbushjes së patreguar të natyrës sonë hyjnore.

Nuk do të jetë e lehtë. Do të kërkojë më të mirën që keni – gjithë inteligjencën, aftësinë krijuese, besimin, integritetin moral, forcën, vendosmërinë dhe dashurinë tuaj. Por një ditë do ta hidhni vështrimin pas te përpjekjet tuaja dhe o, sa mirënjohëse do të jeni që qëndruat të forta, që besuat dhe që nuk u larguat nga shtegu!

Ecni Përpara

Mund të ketë shumë gjëra në jetë që janë përtej kontrollit tuaj. Por në fund të fundit, ju keni fuqinë që të zgjidhni si fatin tuaj ashtu edhe shumë prej përvojave tuaja përgjatë shtegut. Nuk janë dhe aq shumë aftësitë tuaja, por zgjedhjet tuaja që do ta sjellin ndryshimin në jetë.⁹

Nuk mund t'i lejoni rrethanat që t'ju bëjnë të trishtuara.

Nuk mund t'i lejoni ato t'ju bëjnë të zemëruara.



Mund të gëzoheni se jeni një bijë e Perëndisë. Mund të gjeni gëzim e lumturi në hirin e Perëndisë dhe në dashurinë e Jezu Krishtit.

Mund të jeni të gëzuara.

Unë ju nxit që t'i mbushni zemrat tuaja me mirënjohje për mirësinë e begatë dhe të pakufishme të Perëndisë. Motrat e mia të dashura, ju mund ta bëni këtë! Lutem me të gjithë dhembshurinë e shpirtit tim që ju do të bëni zgjedhjen për të ecur përpara drejt pemës së jetës. Lutem që do të zgjidhni ta ngrini zërin tuaj dhe ta bëni jetën tuaj një simfoni të lavdishme përlëvdimi, duke u ngazëlyer në atë që dashuria e Perëndisë, mrekullitë e Kishës së Tij dhe ungjilli i Jezu Krishtit mund t'ia sjellin botës.

Kënga e dishepullimit të vërtetë mund të tingëllojë e stonuar apo madje paksa e fortë për dikë. Që prej fillimit të kohëve, kjo ka qenë kështu.

Por për Atin tonë Qiellor dhe ata që e duan dhe e nderojnë Atë, ajo është kënga më e çmuar dhe më e bukur – kënga madhështore dhe shenjtëruese e dashurisë shëlbuese dhe e shërbimit ndaj Perëndisë e bashkëqenieve.¹⁰

Ju lë bekimin tim si Apostulli i Zotit që ju do të gjeni forcën e guximin për t'u ngazëlyer plot gëzim si një bijë e Perëndisë, ndërkohë që ecni me gëzim çdo ditë në shtegun e lavdishëm të

dishepullimit. Në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih 2 Nefi 2:14, 26.
2. Shih Lluca 15:4–6.
3. Boston College, "Study Finds Intractable Conflicts Stem from Misunderstanding of Motivation", *ScienceDaily*, 4 nëntor 2014, sciencedaily.com.
4. Mateu 5:44–45.
5. Mateu 5:44.
6. Shih 1 Nefi 8.
7. Shih "Fëmi' i Per'ndis' Jam", *Himne*, nr. 196.
8. 1 Korintasve 2:9.
9. Shih "The Most Inspirational Book Quotes of All Time", pegasuspublishers.com/blog.
10. Shih Alma 5:26.





Nga Presidenti Diter F. Uhtdorf,
Këshilltar i Dytë në Presidencinë e Parë

Dëshirim për Shtëpinë

Kthejeni shpirtin tuaj nga drita. Fillojeni rrugëtimin tuaj vetjak e të mrekullueshëm për në shtëpi. Ndërsa bëni kështu, jeta juaj do të jetë më e mirë, më e lumtur dhe më qëllimplotë.

Kohët e fundit, kur u takuam me Presidentin Tomas S. Monson, ai shprehu me solemnitet dhe me një shprehje lumturie, sa shumë e do Zotin dhe se ai e di që Zoti e do atë. Vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, unë e di që Presidenti Monson është shumë mirënjohës për dashurinë tuaj, lutjet tuaja dhe përkushtimin tuaj ndaj Zotit.

Bobi, Qeni i Mrekullisë

Përafërsisht një shekull më parë, një familje nga Oregoni ishte me pushime në Indiana – mbi 3200 km larg – kur humbi qenin e saj të dashur Bobin. Familja e dëshpëruar e kërkoi qenin gjithandej, por më kot. Bobi nuk gjendej.

Me zemër të vrarë, ata morën udhën e kthimit për në shtëpi, ku çdo kilometër i çonte më larg kafshës së tyre të dashur shtëpiake.

Gjashtë muaj më vonë, familja u shtang kur e gjeti Bobin në pragun e derës së saj në Oregon. “I pistë, thatanik, me këmbët kockë e lëkurë – dukej se ai e kishte përshkuar të gjithë distancën . . . vetë.”¹ Ndodhia e Bobit rroku përfytyrimin e njerëzve anembanë Shteteve të Bashkuara dhe ai u bë i njohur si Bobi, Qeni i Mrekullisë.

Bobi nuk është e vetmja kafshë që i ka hutuar shkencëtarët me një ndjesi

të hatashme drejtimi dhe instinkti për të shkuar në shtëpi. Disa popullata fluturash të llojit Monark migrojnë për 4800 km çdo vit drejt vendeve me klimë më të përshtatshme për mbijetesën e tyre. Breshkat detare kockëtrasha udhetojnë nëpër të gjithë Oqeanin Paqësor nga Indonezia drejt brigjeve të Kalifornisë. Balenat me gungë notojnë nga ujërat e ftohta të Polinës Veriore të Jugut drejt ekuatorit dhe në kthim. Ndoshta në mënyrë akoma më të pabesueshme, dallëndyshja arktike e detit fluturon nga Rrethi Arktik drejt Antarktidës dhe në kthim çdo vit, për afro 97000 km.

Kur shkencëtarët e studiojnë këtë sjellje magjepsëse, ata bëjnë pyetje të tilla si: “Nga e dinë ato se ku të shkojnë?” dhe “Si e mëson çdo brez pasardhës këtë sjellje?”

Kur lexoj për këtë instinkt të fuqishëm të kafshët, nuk mund ta lë pa pyetur veten: “A është e mundur që qeniet njerëzore të kenë një dëshirim të ngjashëm – një sistem të brendshëm udhërrëfimi, ta quajmë – që i tërheq ata për të *shtëpia qiellore*?”

Unë besoj se çdo burrë, grua dhe fëmijë e ka ndier thirrjen e qiellit në njëfarë pike të jetës së vet. Thellë brenda nesh ka një mall për ta kaluar disi velin dhe për t’i përqaftuar Prindërit Qiellorë që dikur i njihnim dhe i çmonim.

Disa mund ta shtypin këtë dëshirim dhe t’i bëjnë shpirtat e tyre të pandjeshëm ndaj thirrjes së atij dëshirimi. Por ata që nuk e shuajnë këtë dritë brenda vetvetes, mund të nisin një rrugëtim të pabesueshëm – një migrim të mrekullueshëm drejt klimës qiellore.

Perëndia Ju Thërret

Mesazhi madhështor i Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme është që Perëndia është





Ati ynë, që Ai kujdeset për ne dhe që ka një mënyrë për t'u kthyer tek Ai.

Perëndia ju thërret.

Perëndia e njeh çdo mendim tuajin, keqardhjet tuaja dhe shpresat tuaja më të mëdha. Perëndia i di herët e shumta kur e keni kërkuar. Herët e shumta që keni ndier gëzim pakufi. Herët e shumta që keni qarë në vetmi. Herët e shumta që jeni ndier pa rrugëdalje, të pësjtjelluar ose të zemëruar.

Prapëseprapë, pavarësisht nga historia juaj – nëse jeni të ligështuar, të keni dështuar, të ndiheni të dërrmuar, të hidhëruar, të tradhtuar apo të mundur – dijeni se nuk jeni vetëm. Perëndia prapëseprapë ju thërret.

Shpëtimtari jua zgjat dorën. Dhe, ashtu siç bëri me ata peshkatarë që qëndruan kohë më parë buzë Detit të Galileës, me dashuri të pafundme Ai ju flet: “Eja, më ndiq”.²

Nëse e dëgjoni, Ai do t’ju flasë që sot.

Kur ecni në shtegun e dishepullimit – kur lëvizni drejt Atit Qiellor – ka diçka brenda jush që do t’ju pohojë se e keni dëgjuar thirrjen e Shpëtimtarit dhe e keni drejtuar zemrën tuaj nga drita. Ajo do t’ju thotë që jeni në shtegun e

duhur dhe se po ktheheni në shtëpi.

Që nga fillimi i kohës, profetët e Perëndisë i kanë nxitur njerëzit e kohës së vet që t’i “binde[n] zërit të Zotit, Perëndisë [së tyre], duke respektuar urdhërimet dhe statutet e tij . . . [dhe të] rikth[ehen] tek [Ai], me gjithë zemër dhe me gjithë shpirt”³.

Shkrimet e shenjta na mësojnë një mijë arsye përse duhet ta bëjmë këtë.

Sot, më lini t’ju ofroj dy arsye përse duhet të kthehemi te Zoti.

E para: Jeta juaj do të jetë më e mirë.

E dyta: Perëndia do t’ju përdorë për t’ua përmirësuar jetën të tjerëve.

Jeta Juaj do të Jetë më e Mirë

Unë dëshmoj se, kur nisemi ose e vazhdojmë rrugëtimin e jashtëzakonshëm që na çon te Perëndia, jeta jonë do të jetë më e mirë.

Kjo nuk nënkupton që jeta jonë do të jetë e paprekur nga hidhërimet. Ne të gjithë njohim ndjekës besnikë të Krishtit që vuajnë tragjedi dhe padrejtësi – Vetë Jezu Krishti vuajti më shumë se kushdo. Ashtu sikurse Ati e bën “të lindë diellin . . . mbi të mirët dhe mbi të këqijtë”, Ai gjithashtu lejon

që fatkeqësia të vërë në provë të drejtët dhe të padrejtët.⁴ Në fakt, nganjëherë duket sikur jeta jonë është më e vështirë për arsye se po përpiqemi ta jetojmë besimin tonë.

Jo, ndjekja e Shpëtimtarit nuk do t’ju heqë të gjitha sprovat. Sidoqoftë, ajo do t’i heqë pengesat midis jush dhe ndihmës që Ati Qiellor dëshiron t’ju japë. Perëndia do të jetë me ju. Ai do t’i drejtojë hapat tuaj. Ai do të ecë përkrah jush dhe madje do t’ju mbartë kur të keni më shumë nevojë.

Ju do të përjetoni frytin madhështor të Frymës [që është]: “dashuria, gëzimi, paqja, durimi, mirëdashja, mirësia [dhe] besimi”⁵.

Këto fryte shpirtërore nuk janë rezultat i begatisë materiale, suksesit apo fatit të mirë. Ato vijnë nga ndjekja e Shpëtimtarit dhe mund të jenë ndihmësit tanë besnikë edhe në mes të stuhive më të errëta.

Zjarret dhe trazirat e jetës në vdekshmëri mund të na kërcënojnë dhe trembin, por ata që ia përlulin zemrën Perëndisë, do të rrethohen nga paqja e Tij. Gëzimi i tyre nuk do të pakësohet. Ata nuk do të braktisen apo harrohen.

“Ki besim tek Zoti me gjithë zemër”, na mësojnë shkrimet e shenjta, “dhe mos u mbështet në gjykimin tënd. pranoje në të gjitha rrugët e tua, dhe ai do të drejtojë shtigjet e tua.”⁶

Ata që ia vënë veshin thirrjes së brendshme dhe e kërkojnë Perëndinë, ata që luten, besojnë dhe ecin në shtegun që Shpëtimtari ka përgatitur – edhe nëse nganjëherë pengohen përgjatë shtegut – marrin sigurinë ngushëlluese që “gjithë gjërat do të punojnë së bashku për të mirën [e tyre]”⁷.

Sepse Perëndia “i jep forcë të lodhurit dhe rrit fuqinë e të këputurit”⁸.

“Sepse i drejti bie shtatë herë dhe ngrihet, kurse të pabesët përmbysen në fatkeqësi.”⁹

Dhe Zoti me mirësinë e Tij pyet:
A dëshironi të përjetoni gëzim të qëndrueshëm?

A nuk keni dëshirim për ta ndier brenda zemrës suaj paqen që ia tejkalon çdo zgjuarsie?¹⁰

Atëherë, kthejeni shpirtin tuaj nga drita.

Fillojeni rrugëtimin tuaj vetjak e të mrekullueshëm për në shtëpi.

Ndërsa bëni kështu, jeta juaj do të jetë më e mirë, më e lumtur dhe më qëllimplotë.

Perëndia do t'Ju Përdorë

Nëpër shtegun e kthimit tek Ati Qiellor do ta kuptoni shpejt se ky rrugëtim nuk është vetëm për t'u përqendruar te jeta tuaj vetjake. Jo, ky shteg ju shtyn në mënyrë të pashmangshme që të bëheni një bekim në jetën e fëmijëve të tjerë të Perëndisë – vëllezërve dhe motrave tuaja. Dhe gjëja interesante në këtë rrugëtim është që, teksa i shërbeni Perëndisë dhe teksa kujdeseni dhe i ndihmoni bashkëqeniet tuaja, ju do të shihni përparim të madh në vetë jetën tuaj, në mënyra nuk mund t'i përfytyroni kurrë.

Ndoshta nuk e konsideroni veten edhe aq të dobishëm, ndoshta nuk e konsideroni veten një bekim në jetën e dikujt. Shpesh, kur vështrojmë veten, ne shohim vetëm kufizimet dhe mangësitë tona. Mund të mendojmë se duhet të jemi diçka “më shumë” që Perëndia të na përdorë – më inteligjentë, më të pasur, më frymëzues, më të talentuar, më shpirtërorë. Bekimet nuk do të vijnë edhe aq prej aftësive tuaja, por për shkak të zgjedhjeve tuaja. Dhe Perëndia i universit do të punojë brenda jush dhe nëpërmjet jush, duke i lartësuar përpjekjet tuaja të përlurura për qëllimet e Tij.

Vepra e Tij ka përparuar gjithnjë mbi bazën e këtij parimi të rëndësishëm:



“Nga gjëra të vogla vjen ajo që është e madhe”¹¹.

Kur po u shkruante shenjtorëve në Korint, Apostulli Pal vëzhgoi se jo shumë prej tyre do të konsideroheshin të urtë sipas standardeve të botës. Por kjo nuk kishte rëndësi, sepse “Perëndia ka zgjedhur gjërat e marra të botës për të turpëruar të urtët”¹².

Historia e veprës së Perëndisë është e mbushur me njerëz që e konsideronin veten të papërshtatshëm. Por ata shërbyen përlulesisht, duke u mbështetur në hirin e Perëndisë dhe në premtimin e Tij: “Dhe krahu i tyre do të jetë krahu im, dhe unë do të jem mburoja . . . e tyre dhe ata do të luftojnë burrisht për mua; dhe . . . do t'i ruaj ata”.¹³

Këtë verë që shkoi, familja jonë pati mundësinë e mrekullueshme që të vizitonte disa nga vendet e historisë së hershme të Kishës në lindje të Shteteve të Bashkuara. Në një mënyrë të veçantë, ne e jetuam sërish historinë e asaj kohe. Njerëzit për të cilët kisha lexuar aq shumë, – njerëz si Martin Harrisi,

Oliver Kaudëri dhe Tomas B. Marshi – u bënë më të vërtetë për mua teksa ecnim atje ku ata ecën dhe i përsiatnim sakrificat që ata bënë për ta ndërtuar mbretërinë e Perëndisë.

Ata kishin shumë tipare të shkëlqyera që u lejuan të jepnin ndihmesa domethënëse për Rivendosjen e Kishës së Jezu Krishtit. Por ata ishin gjithashtu njerëzorë, të dobët dhe të gabueshëm – njësoj siç jemi ju dhe unë. Disa e gjetën veten në mospërputhje me Profetin Jozef Smith dhe u larguan nga Kisha. Më vonë, shumë prej po atyre njerëzve patën një ndryshim zemre, u përlulën, e kërkuan dhe e gjetën sërish shoqërimin me shenjtorët.

Ne mund të kemi një prirje për t'i gjykuar këta vëllezër dhe anëtarë të tjerë si ata. Ne mund të themi: “Unë nuk do ta kisha braktisur kurrë Profetin Jozef”.

Ndërkohë që kjo mund të jetë e vërtetë, ne nuk e dimë vërtet se si ishte të jetoje në atë kohë, në ato rrethana. Jo, ata nuk qenë të përkryer,



por sa zemërdhënese është ta dimë se Perëndia mundi t'i përdorte ata gjithësi. Ai i dinte pikat e tyre të forta e të dobëta dhe u dha atyre mundësinë e jashtëzakonshme për të ndihmuar me një varg apo melodi në himnin e lavdishëm të Rivendosjes.

Sa zemërdhënese është ta dimë që, ndonëse *ne* jemi të papërsosur, nëse zemrat tona janë të kthyer drejt Perëndisë, Ai do të jetë bujar dhe dashamirës e do të na përdorë për qëllimet e Tij.

Ata që i duan dhe iu shërbejnë Perëndisë dhe bashkëqenieve të tyre dhe marrin pjesë përfundimisht dhe aktivisht në veprën e Tij, do të shohin gjëra mrekullibërëse të ndodhin në jetën e tyre dhe në jetën e atyre që duan.

Dyer që dukeshin të mbyllura, do të hapen.

Engjëjt do të shkojnë përpara tyre dhe do të përgatitin udhën.

Pavarësisht nga pozicioni juaj në komunitetin tuaj ose në Kishë, Perëndia do t'ju përdorë, nëse jeni të gatshëm. Ai do t'i lartësojë dëshirat tuaja të drejta dhe do t'i kthejë veprimet e dhembshura që mbillni, në të korra të bollshme mirësie.

Ne Nuk Mund të Arrijmë Atje me Pilot Automatik

Ne jemi, secili prej nesh, “të huaj dhe shtegtarë”¹⁴ në këtë botë. Në shumë mënyra, ne jemi larg shtëpisë. Por

kjo nuk do të thotë se duhet të ndihemi se kemi humbur apo jemi vetëm.

Ati ynë i dashur në Qiell na ka dhënë Dritën e Krishtit. Dhe thellë brenda çdonjërit prej nesh, një shtytje hyjnore na nxit t'i kthejmë sytë dhe zemrat tek Ai teksa bëjmë shtegtimin e kthimit për të shtëpia jonë çelestiale.

Kjo kërkon përpjekje. Nuk mund të arrish atje pa u munduar të mësosh prej Tij, t'i kuptosh udhëzimet e Tij, t'i zbatosh ato me zell dhe t'i hedhësh hapat një e nga një.

Jo, jeta nuk është një makinë që lëviz vetë. Nuk është një aeroplan me pilot automatik.

Nuk mundeni thjesht të pluskoni në ujërat e jetës dhe të mirëbesoni se rryma do t'ju çojë kudoqoftë që shpresoni të jeni një ditë. Dishepullimi kërkon gatishmëri nga ana jonë për të notuar kundër rrymës kur nevojitet.

Askush tjetër nuk është përgjegjës për rugëtimin tuaj vetjak. Shpëtimtari do t'ju ndihmojë e do t'ju përgatitë udhën që keni përpara, por zotimi për ta ndjekur Atë dhe për t'i zbatuar urdhërimet e Tij duhet të vijë nga ju. Ajo është barrë vetëm e juaja, privilegj vetëm i juaji.

Kjo është aventura juaj e madhe. Ju lutem, vërbani veshin thirrjes së Shpëtimtarit tuaj.

Ndiqeni Atë.

Zoti e ka themeluar Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme për t'ju ndihmuar për këtë

zotim që t'iu shërbeni Perëndisë dhe bashkëqenieve. Qëllimi i saj është që të japë zemër, të japë mësim, të ngrejë moralisht e të frymëzojë. Kjo Kishë e mrekullueshme siguron mundësi që ju të ushtroni dhembshuri, t'u shkoni në ndihmë të tjerëve dhe që t'i përtërinë e t'i mbani besëlidhjet e shenja. Ajo është projektuar për ta bekuar jetën tuaj dhe për ta përmirësuar shtëpinë, komunitetin dhe kombin tuaj.

Ejani, bashkohuni me ne dhe mirëbesojini Zotit. Jepjani hua talentet tuaja veprës së Tij të mrekullueshme. Ndhimojini, jepuni zemër, shërojeni dhe përkrahini të gjithë ata që dëshirojnë ta ndiejnë e t'ia vënë veshin dëshirimit për shtëpinë tonë hyjnore. Le të bashkoemi në këtë shtegtim të lavdishëm drejt klimës qiellore.

Ungjilli është një mesazh i mahnitshëm shprese, lumturie dhe gëzimi. Ai është shtegu që na çon në shtëpi.

Teksa e përqafojmë ungjillin me besim dhe vepra, çdo ditë dhe çdo orë, ne do t'i afrohem pak më tepër Perëndisë tonë. Jeta jonë do të jetë më e mirë dhe Zoti do të na përdorë në mënyra mbresëlënëse për t'i bekuar ata që janë përreth nesh, dhe për të bërë të ndodhin qëllimet e Tij të përjetshme. Për këtë unë dëshmoj dhe ju lë bekimin tim, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih Susan Stelljes, “Bobbie the Wonder Dog”, *The Oregon Encyclopedia*, oregonencyclopedia.org.
2. Shih Mateu 4:19; Lluqa 18:22.
3. Ligji i Përtërirë 30:10.
4. Mateu 5:45.
5. Galatasve 5:22.
6. Fjalët e Urta 3:5–6.
7. Doktrina e Besëlidhje 90:24.
8. Isaia 40:29.
9. Fjalët e Urta 24:16.
10. Shih Filipianëve 4:7.
11. Doktrina e Besëlidhje 64:33.
12. 1 Korintasve 1:27.
13. Doktrina e Besëlidhje 35:14.
14. Hebrejve 11:13; 1 Pjetër 2:11.



Nga Boni L. Oskarson,
Presidente e Përgjithshme e Të Rejave

Nevojat përpara Vetvetes

Disa nga nevojat më domethënëse që mund të plotësojmë, janë brenda vetë familjeve tona, mes miqve tanë, në lagjet tona dhe në komunitetet tona.

Kohët e fundit ne kemi dëshmuar një numër të madh katastrofash natyrore në Meksikë, Shtetet e Bashkuara, Azi, Karaibe dhe Afrikë. Kjo ka nxjerrë në pah më të mirën te njerëzit, teksa mijëra veta u kanë ardhur në ndihmë njerëzve që janë në rrezik ose nevojë dhe atyre që kanë përjetuar humbje. Kam qenë shumë e emocionuar të shoh vajzat e reja në Teksas e Florida, të cilat, bashkë me shumë të tjerë, kanë veshur bluzat e verdha të Duarve Ndhimtare dhe po ndihmojnë që të pastrojnë shtëpitë nga mbetjet që shkaktuan uraganët e fundit. Mijëra të tjera do të shkonin me kënaqësi aty ku nevoja është më e madhe po të mos ishte largësia. Në vend të kësaj, ju keni ofruar dhurime bujare për ta lehtësuar dhembjen. Bujaria e dhembshuria juaj janë frymëzuese dhe të ngjashme me të Krishtit.

Sot unë dua të përmend një aspekt të shërbimit që e ndiej se është i rëndësishëm për të gjithë – pavarësisht se ku ndodhemi. Për ata nga ne që i kanë parë lajmet e ngjarjeve të fundit dhe janë ndier të pafuqishëm ngaqë nuk dinin se çfarë të bënin, në fakt përgjigjen mund ta kenë përpara syve.

Shpëtimtari dha mësim: “Sepse kush do ta shpëtojë jetën e vet, do ta humbasë: por kush do ta humbasë jetën e vet për shkakun tim, do ta shpëtojë”¹. Presidenti Tomas S. Monson në lidhje me këtë shkrim të shenjtë tha: “Unë besoj se Shpëtimtari po na thotë që, nëse nuk e humbasim veten në shërbim të të tjerëve, ka pak qëllim në vetë jetën tonë. Ata që jetojnë vetëm për vete më



së fundi vshken dhe në mënyrë figurative e humbasin jetën e tyre, ndërsa ata që e humbasin veten në shërbim të të tjerëve, rriten e lulëzojnë – dhe si rrjedhojë e shpëtojnë jetën e tyre.”²

Ne jetojmë në një kulturë ku sa vjen e më shumë përqendrohemi në atë ekranin e vogël që e mbajmë nëpër duar, sesa përqendrohemi te njerëzit përreth nesh. Ne e kemi zëvendësuar me mesazhe në celularë dhe në rjetet shoqërore kontaktin e mirëfilltë sy më sy me dikë dhe buzëqeshjen apo, edhe më të rrallë, bashkëbisedimin ballë për ballë. Ne shpesh shqetësohemi më shumë se sa ndjekës dhe pëlqime kemi, në vend që t'i hedhim krahun një miku dhe t'i tregojmë dashuri, shqetësim dhe interesim të vërtetë. Sado e mrekullueshme që mund të jetë teknologjia bashkëkohore në përhapjen e mesazheve të ungjillit të Jezu Krishtit dhe në ndihmën që na jep për të qenë të lidhur me familjarë e miq, nëse nuk jemi vigilentë në mënyrën se si i përdorim aparatet tona vetjake, edhe ne mund të fillojmë të përqendrohemi vetëm te vetja dhe të harrojmë se thelbi i të jetuarit të ungjillit është shërbimi.

Unë kam një dashuri dhe besim tejet të madh tek ju që jeni në moshën e adoleshencës dhe tek të rinjtë në moshë madhore. E kam parë dhe ndier dëshirën tuaj për të shërbyer dhe për të sjellë një ndryshim në botë. Unë besoj se shumica e anëtarëve gjykojnë se shërbimi është në zemër të besëlidhjeve dhe dishepullimit të tyre. Por mendoj gjithashtu se nganjëherë është e lehtë të humbasim disa prej mundësive më të mëdha për t'u shërbyer të tjerëve, ngaqë jemi të shpërqendruar apo ngaqë po kërkojmë mënyra ambicioze për ta ndryshuar botën dhe nuk shohim se disa nga nevojat më domethënëse që mund të plotësojmë, janë brenda vetë familjeve tona, mes miqve tanë, në lagjet tona dhe në komunitetet tona. Ne



mallëngjehemi kur shohim vuajtjen dhe nevojat e mëdha të njerëzve në anën tjetër të botës, por mund të mos arrijmë të shohim se është dikush që ka nevojë për shoqërinë tonë, i ulur në klasë mu pranë nesh.

Motra Linda K. Barton tregoi historinë e një presidenteje të Shoqatës së Ndhmës së një kunji, e cila duke bashkëpunuar me të tjera, mbledhi jorganë për njerëz në nevojë gjatë viteve 1990. “Ajo dhe bija e saj e nganë kamionin e mbushur me ata jorganë nga Londra për në Kosovë. Në udhëtimin e saj të kthimit për në shtëpi, ajo mori një mbresë të pagabueshme shpirtërore që u zhyt thellë në zemrën e saj. Mbresa ishte kjo: ‘Ajo që ke bërë është një gjë shumë e mirë. Tani shko në shtëpi, kalo nga ana tjetër e rrugës dhe shërbeji fqinjit tënd!’”³

Çfarë dobie ka të shpëtojme botën nëse i shpërfillim nevojat e njerëzve tanë më të afërt dhe të njerëzve që i duam më shumë? Sa vlerë ka të ndreqim botën nëse njerëzit përreth nesh ndihen të shkatërruar dhe ne as që e vëmë re? Ati Qiellor mund t’i ketë vënë pranë nesh ata që kanë nevojë për ne, duke e ditur se jemi njerëzit e duhur për t’i plotësuar nevojat e tyre.

Gjithkush mund të gjejë mënyra për të dhënë shërbim si të Krishtit. Këshilltarja ime, Motra Karol F. Mek-Konki, kohën e fundit më tregoi për mbesën e saj 10-vjeçare, Sarën, e cila, kur e

kuptoi se nëna e saj ishte e sëmurë, vendosi vetë që të ndihmonte. Ajo e ngrinte nga gjumi motrën e saj të vogël, e ndihmonte të vishej, të lante dhëmbët, t’i rregullonte flokët dhe të hante mëngjes, në mënyrë që nëna e saj të çlodhej. Ajo e kreu pa u ndier këtë veprim të thjeshtë shërbimi, pa iu kërkuar, ngaqë pa një nevojë dhe pati dëshirë të ndihmonte. Sara jo vetëm që e bekoj nënën e saj, por jam e sigurt se ajo ndjeu edhe gëzim duke e ditur që e kishte lehtësuar barrën e dikujt që e donte, dhe, me kalimin e kohës, e forcoi marrëdhënien e saj me të motrën. Presidenti Xhejms E. Faust tha: “Shërbimi ndaj të tjerëve mund të fillojë pothuajse në çfarëdo moshe. . . . Nuk ka përse të jetë në shkallë të gjerë dhe shërbimi më fisnik është brenda familjes.”⁴

A e kuptoni ju fëmijë se sa shumë domethënie ka për prindërit tuaj dhe pjesëtarët e familjes suaj kur kërkon mënyra për të shërbyer në shtëpi? Për ata që janë në moshën e adoleshencës, forcimi i pjesëtarëve të familjes dhe shërbimi ndaj tyre duhet të jetë ndër përparësitë tuaja kryesore kur kërkon mënyra për ta ndryshuar botën. Kur tregoni dashamirësi dhe interesim për motrat e vëllezërit dhe prindërit tuaj, kjo gjë ndihmon në krijimin e një atmosfere uniteti dhe e fton Shpirtin në shtëpi. Ndryshimi i botës fillon me forcimin e vetë familjes tuaj.

Një fushë tjetër përqendrimi në shërbimin tonë mund të jetë në familjet e lagjes sonë. Me raste fëmijët tanë do të na bëjnë pyetjen: “Përse duhet të shkoj në aktivitetin e përbashkët?” Nuk është se nxjerr ndonjë dobi të madhe prej tij.”

Po të isha një nënë shembullore në atë çast, do t’i përgjigjesha: “Ç’të shtyn të mendosh se do të shkosh në aktivitetin e përbashkët që ti të nxjerrësh ndonjë dobi prej tij?”

Miqtë e mi të rinj, unë mund t’ju siguroj se do të jetë gjithmonë dikush në çdo mbledhje të Kishës që merrni pjesë, i cili është i vetmuar, i cili po has vështirësi dhe ka nevojë për një mik, apo i cili ndien se ai ose ajo nuk ka vend atje. Ju keni diçka të rëndësishme për të dhënë në çdo mbledhje apo veprimtari dhe Zoti dëshiron që ju të shihni përreth te bashkëmoshatarët tuaj dhe më pas të shërbeni sikurse do të shërbente Ai.

Plaku D. Tod Kristoferson dha mësim: “Një arsye madhore pse Zoti ka një kishë, është që të krijojë një komunitet shenjtorësh që do ta mbështetin njëri-tjetrin në ‘shteg[un] e ngushtë dhe të ngushtuar që të çon në jetën e përjetshme’”. Ai vazhdon duke thënë: “Kjo fe nuk ka të bëjë vetëm me veten; përkundrazi, ne të gjithë thirrremi të shërbejmë. Ne jemi sytë, duart, koka, këmbët dhe gjymtyrët e tjerë të trupit të Krishtit.”⁵

Është e vërtetë që ne i frekuentojmë mbledhjet tona të përjavshme të Kishës për të marrë pjesë në ordianca, për të mësuar doktrinën dhe për t’u frymëzuar, por një arsye tjetër shumë e rëndësishme përse i frekuentojmë është që, si familje e një lagjeje dhe si dishepuj të Shpëtimtarit Jezu Krisht, ne të kujdesemi për njëri-tjetrin, t’i japim zemër njëri-tjetrit dhe të gjejmë mënyra për t’i shërbyer njëri-tjetrit dhe për ta forcuar njëri-tjetrin. Ne nuk jemi thjesht marrës dhe përfitues të asaj që na ofrohet në kishë; na nevojitet të jemi dhënës dhe

furnizues. Të reja dhe të rinj, herën tjetër kur të jeni në aktivitetin e përbashkët, në vend që të merrni celularin e të shihni se çfarë po bëjnë miqtë tuaj, ndaluni, shihni përreth, dhe pyeteni veten: “Kush ka nevojë për mua sot?” Ju mund të jeni mjete për t’iu afruar dikujt dhe për ta prekur jetën e një bashkëmoshatare apo t’i jepni zemër një mikut që në heshtje po kalon vështirësi.

Kërkojini Atit tuaj Qiellor që t’ju tregojë njerëzit përreth jush që kanë nevojë për ndihmën tuaj dhe t’ju frymëzojë se si t’u shërbeni atyre më së miri. Sillni ndërmend se Shpëtimtari më shpesh u dha shërbesë njerëzve një e nga një.

Nipi ynë Ithani është 17 vjeç. Këtë verë u mallëngjeva kur ai më tha se, i frymëzuar nga shembulli i nënës së tij, ai lutet çdo ditë që të ketë mundësi për t’i shërbyer dikujt. Teksa kaluam kohë me familjen e tij, unë vëzhgova se si Ithani i trajton vëllanë dhe motrat e tij me durim, dashuri dhe mirësi dhe se si është ndihmues ndaj prindërve të tij dhe kërkon mënyra për t’iu afruar të tjerëve. Më ka bërë përshtypje mënyra se sa i vetëdijshëm është ai për njerëzit rreth tij dhe për dëshirën që t’u shërbejë atyre. Ai është një shembull për mua. Të bërit siç bën Ithani – duke e ftuar Zotin të na ndihmojë të gjejmë mënyra për të shërbyer – do ta lejojë Shpirtin të na i hapë sytë për të parë nevojat përreth nesh, për të parë “individin” që ka nevojë për ne atë ditë, dhe për të ditur se si t’i shërbejmë atij ose asaj.

Përveç shërbimit ndaj familjes suaj dhe anëtarëve të lagjes tuaj, kërkonit mundësi që të shërbeni në lagjen tuaj të banimit dhe në komunitetin tuaj. Ndonëse herë-herë thirrëmi për të ndihmuar pas një katastrofe të madhe, në jetën e përditshme ne nxitemi të kërkojmë mundësi në vetë zonat tona për të ngritur shpirtërisht dhe ndihmuar njerëzit në nevojë. Kohët e fundit mora

udhëzim nga një President Zone, se të shërbesh në një vend që ka shumë sfida materiale, mënyra më e mirë për të ndihmuar njerëzit në nevojë në pjesë të tjera të botës është të paguani një ofertë bujare agjërimit, të kontribuoni në Fondin e Ndihmës Humanitare të Kishës dhe të kërkonit mënyra që t’u shërbeni njerëzve në komunitetin tuaj kudo ku jetoni. Thjesht përfytyroni se si do të bekohej bota nëse çdokush do ta ndiqte këtë këshillë!

Vëllezër e motra dhe veçanërisht të rinjtë, ndërsa përpiqeni fort të bëheni më shumë si Shpëtimtari Jezu Krisht dhe të jetoni sipas besëlidhjeve tuaja, ju do të vazhdoni të bekoheni me dëshira për t’i lehtësuar dhembjet dhe për t’i ndihmuar njerëzit që janë më pak fatlumë. Kujtoni se disa nga nevojat më të mëdha mund të jenë ato që i keni përpara syve. Fillojeni shërbimin tuaj në vetë shtëpitë tuaja dhe brenda vetë familjeve tuaja.



Këto janë marrëdhëniet që mund të jenë të përgjeshme. Edhe nëse – e ndoshta sidomos nëse – situata juaj familjare është më pak e përsosur, ju mund të gjeni mënyra për të shërbyer, lartësuar dhe forcuar. Fillojeni nga aty ku jeni, duajini ata siç janë dhe përgatituni për familjen që doni të keni në të ardhmen.

Lutuni për ndihmë që t’i dalloni njerëzit në familjet e lagjes suaj, të cilët kanë nevojë për dashuri dhe inkurajim. Në vend që ta frekuentoni kishën me pyetjen “Çfarë do të nxjerr unë prej kësaj mbledhjeje?”, pyetni: “Kush ka nevojë për mua sot? Çfarë kam unë për të dhënë?”

Teksa i bekoni vetë familjet tuaja dhe anëtarët e lagjes, kërkonit mënyra për të bekuar njerëzit në komunitetet tuaja vendore. Edhe nëse keni shumë kohë për shërbim apo nëse mund të shërbeni vetëm pak orë në muaj, përpjekjet tuaja do të bekojnë jetë dhe do t’ju bekojnë edhe ju në mënyra që nuk mund t’i përfytyroni.

Presidenti Spenser W. Kimball dha mësim: “Perëndia na shikon dhe kujdeset për ne. Por zakonisht është nëpërmjet një personi tjetër që ai i plotëson nevojat tona.”⁶ E kuptofshim secili prej nesh privilegjin dhe bekimin që është për të marrë pjesë në përmbushjen e veprës së Atit tonë Qiellor, teksa i plotësojmë nevojat e fëmijëve të Tij, është lutja ime, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Lluca 9:24.
2. Tomas S. Monson, “Çfarë Kam Bërë për Dikë Sot?” *Liahona*, nëntor 2009, f. 85.
3. Linda K. Barton, “Isha i Huaj,” *Liahona*, maj 2016, f. 15.
4. James E. Faust, “Womanhood: The Highest Place of Honor,” *Liahona*, korrik 2000, f. 117.
5. D. Tod Kristoferson, “Përse Kisha”, *Liahona*, nëntor 2015, f. 108, 109.
6. *Teachings of Presidents of the Church: Spenser W. Kimball* (2006), f. 82.



Nga Plaku Dallin H. Oaks,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Plani dhe Proklamata

Proklamata për familjen është ritheksimi nga ana e Zotit i të vërtetave të ungjillit që na nevojiten për të na mbështetur nëpër sfidat e tanishme që ka familja.

A shtu siç është e dukshme në proklamaten tonë për familjen, anëtarët e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme janë bekuar me doktrinë të pashoqe dhe me mënyra të ndryshme për ta parë botën. Ne marrim pjesë dhe madje shquhemi në shumë veprimtari të botës, por në disa çështje ne heqim dorë nga pjesëmarrja, ngaqë kërkojmë t'i ndjekim mësimet e Jezu Krishtit dhe të Apostujve të Tij, të lashtë e të sotëm.

I.

Në një shëmbëlltyrë, Jezusi përshkroi ata që e “dëgjojnë” fjalën, por bëhen të “pafrytshëm” kur fjala “mbytet” nga “shqetësimet e kësaj bote dhe mashtrimet e pasurisë” (Mateu 13:22). Më vonë, Jezusi e qortoi Pjetrin që nuk kishte ndër mend “punët e Perëndisë, por punët e njerëzve”, duke shpallur: “Ç’përfitim ka njeriu nëse fiton gjithë botën dhe pastaj e humb shpirtin e vet?” (Mateu 16:23, 26). Në mësimet e Tij të fundit në vdekshmëri, Ai u tha Apostujve të Tij: “Po të ishit nga bota, bota do të donte të vetët; por sepse nuk jeni nga bota, . . . bota ju urren” (Gjoni 15:19; shih edhe Gjoni 17:14, 16).

Në mënyrë të ngjashme, shkrimet e Apostujve të hershëm të Jezusit shpesh

përdorin figurën e “bot[ës]” për të pasqyruar kundërshtimin ndaj mësimet të ungjillit. “Mos u konformoni me këtë botë” (Romakëve 12:2), dha mësim Apostulli Pal. “Sepse dituria e kësaj bote është marrëzi pranë Perëndisë” (1 Korintasve 3:19). Dhe, “tregoni kujdes” paralajmëroi ai, “se mos ndokush ju bën prenë e tij . . . sipas traditës së njerëzve, sipas elementeve të botës dhe jo sipas Krishtit” (Kolosianëve 2:8). Apostulli Jakob dha mësim se “miqësia me botën është armiqësi me Perëndinë[.]

Ai, pra, që don të jetë mik i botës bëhet armik i Perëndisë” (Jakob [Bibël] 4:4).

Libri i Mormonit e përdor shpesh këtë figurë të kundërshtimit të “bot[ës]”. Nefi profetizoi shkatërrimin përfundimtar të “atlyre” që janë ndërtuar që të bëhen të njohur në sytë e botës, dhe [të] atlyre] që kërkojnë . . . gjërat e botës” (1 Nefi 22:23; shih edhe 2 Nefi 9:30).

Alma i dënoi ata që ishin “fryrë . . . me gjërat e kota të botës” (Alma 31:27). Ëndrra e Lehit tregon se ata që përpiqen ta ndjekin shufrën e hekurit, fjalën e Perëndisë, do të ndeshin kundërshtimin e botës. Banorët e “ndërtesës[s] së gjerë dhe të madhe” që pa Lehi, ishin “duke u tallur dhe duke treguar me gisht” (1 Nefi 8:26–27, 33). Në vegimin e tij që interpretonte këtë ëndërr, Nefi mësoi se kjo përqeshje dhe ky kundërshtim erdhën nga “turmat e tokës . . . bot[a] dhe urtësi[a] e saj; . . . kryelartësia e botës” (1 Nefi 11:34–36).

Cili është kuptimi i këtyre paralajmërimeve dhe urdhërimeve të shkrimit të shenjtë për të mos qenë “nga bota” apo urdhërimi i sotëm për ta “braktis[ur] botën”? (DeB 53:2.) Presidenti Tomas S.



Monson i përmbledhi këto mësimë: “Ne duhet të jemi vigjilentë në një botë që është larguar kaq shumë nga ajo që është shpirtërore. Është thelbësore që ne të mos pranojmë asgjë që nuk përputhet me standardet tona, duke mos pranuar gjatë procesit që të dorëzojmë atë që dëshirojmë shumë: jetën e përvetshme në mbretërinë e Perëndisë.”¹

Perëndia e krijoi këtë tokë sipas planit të Tij, për t’u siguruar fëmijëve të Tij shpirtërorë një vend për të përjetuar vdekshmërinë, si një hap i nevojshëm drejt lavdive që Ai i dëshiron për të gjithë fëmijët e Tij. Ndërkohë që ka mbretëri dhe lavdi të ndryshme, dëshira përfundimtare e Atit tonë Qieullor për fëmijët e Tij është ajo që Presidenti Monson e quajti “jetë e përvetshme në mbretërinë e Perëndisë”, që është ekzaltimi si familje. Kjo është më shumë sesa shpëtim. Presidenti Rasëll M. Nelson na ka kujtuar: “Në planin e përvetshëm të Perëndisë shpëtimi është një çështje individuale; [por] ekzaltimi është një çështje familjare”².

Ungjilli i rivendosur i Jezu Krishtit dhe proklamata e frymëzuar për familjen, për të cilën do të diskutojmë më vonë, janë mësimë thelbësore për të drejtuar përgatitjen në vdekshmëri për ekzaltim. Ashtu siç duhet të jetojmë me ligjet e martesës dhe zakone të tjera në një botë përherë e më të ligë, ata që përpriqen fort për ekzaltim, duhet t’i bëjnë zgjedhjet vetjake në jetën familjare sipas mënyrës së Zotit, kurdoherë që ajo ndryshon nga mënyra e botës.

Në këtë jetë në vdekshmëri, ne nuk kemi një kujtesë të asaj që e parapriu lindjen tonë, dhe tani përjetojmë kundërshtim. Ne rritemi dhe piqemi shpirtërisht duke zgjedhur që t’u bindemi urdhërimeve të Perëndisë me një seri zgjedhjesh të drejta. Këto përfshijnë besëlidhjet dhe ordincat e duhura, dhe pendimin kur zgjedhjet tona janë



të gabuara. Në dallim, nëse na mungon besimi në planin e Perëndisë dhe jemi të pabindur ndaj veprimeve që na kërkon ai, apo u shmangemi atyre qëllimisht, ne heqim dorë nga ajo rritje dhe pjekuri. Libri i Mormonit na mëson: “Kjo jetë është koha për njerëzit që të përgatiten të takohen me Perëndinë” (Alma 34:32).

II.

Shenjtoret e ditëve të mëvonshme që e kuptojnë planin e Perëndisë për shpëtimin, kanë një botëkuptim të pasqorë që i ndihmon ta kuptojnë arsyen për urdhërimet e Perëndisë, natyrën e pandryshueshme të ordincave të kërkuara prej Tij dhe rolin themelor të Shpëtimtarit tonë, Jezu Krishtit. Shlyerja e Shpëtimtarit tonë na shpëton nga vdekja dhe, në varësi nga pendimi ynë, na shpëton nga mëkati. Me atë botëkuptim, shenjtoret e ditëve të mëvonshme kanë përparësi e praktika të dallueshme dhe bekohen me forcën për t’i duruar zhgënjimet dhe dhembjet e jetës në vdekshmëri.

Detyrimisht, veprimet e atyre që përpriqen ta ndjekin planin e Perëndisë për shpëtimin, mund të shkaktojnë keqkuptim ose madje përplasje me pjesëtarë të familjes apo miq që nuk i besojnë parimet e tij. Gjithmonë do të ketë një përplasje të tillë. Çdo brez që

ka kërkuar ta ndjekë planin e Perëndisë, ka pasur sfida. Në lashtësi, profeti Isaia u dha forcë izraelitëve, të cilët i quajti “ju që e njihni drejtësinë, . . . që [keni] në zemër ligjin tim”. Atyre ai u tha: “Mos kini frikë turpërimit nga njerëzit, as mos u trembni nga fyerjet e tyre të rënda” (Isaia 51:7; shih edhe 2 Nefi 8:7). Por cilido qoftë shkaku i përplases me ata që nuk e kuptojnë apo nuk e besojnë planin e Perëndisë, ata që e kuptojnë urdhërohen që gjithmonë të zgjedhin udhën e Zotit në vend që të zgjedhin udhën e botës.

III.

Plani i ungjillit që çdo familje duhet ta ndjekë për t’u përgatitur për jetën e përvetshme dhe ekzaltimin, përvijohet në proklamata të Kishës të vitit 1995, “Familja: Një Proklamata drejtuar Botës”³. Sigurisht, shpalljet e saj janë qartësisht të ndryshme nga disa ligje, praktika dhe mbështetje të tanishme të botës në të cilën jetojmë. Në kohën tonë, ndryshimet më të dukshme janë bashkëjetesa pa martesë, martesë mes së njëjtës gjini dhe rritja e fëmijëve në marrëdhënie të tilla. Ata që nuk besojnë tek ekzaltimi apo nuk e dëshirojnë atë, dhe binden më shumë nga mënyrat e botës, e mendojnë këtë proklamata të familjes thjesht si një



deklarim të rregullores që duhet ndryshuar. Përkundrazi, shenjtoret e ditëve të mëvonshme pohojnë se proklamata për familjen përkufizon llojin e marrëdhënieve familjare ku mund të ndodhë pjesa më e rëndësishme e zhvillimit tonë të përjetshëm.

Ne kemi dëshmuar një praninë publik të shpejtë e në rritje të bashkëjetesës pa martesë dhe të martesës mes së njëjtës gjini. Mbështetja përkatëse në mjetet e informimit, arsimit, madje edhe kërkesat për punësim, përbëjnë sfida të vështira për shenjtoret e ditëve të mëvonshme. Ne duhet të përpiqemi që t'i drejtpeshojmë kërkesat konkurruese të ndjekjes së ligjit të ungjillit në jetën dhe mësimet tona vetjake, edhe kur kërkojmë të tregojmë dashuri për të gjithë.⁴ Duke e bërë këtë, nganjëherë ne përballemi me atë që Isaia e quajti “turpërimi nga njerëzit”, por nuk duhet ta kemi frikë nga kjo.

Shenjtoret e ditëve të mëvonshme, të kthyer në besim, besojnë se proklamata për familjen, që doli gati një çerek shekulli më parë dhe tani e përkthyer në sa e sa gjuhë, është ritheksimi nga ana e Zotit i të vërtetave të ungjillit që na nevojiten për të na mbështetur nëpër sfidat e tanishme që ka familja. Dy shembuj janë martesat mes së njëjtës gjini dhe bashkëjetesa pa martesë. Vetëm

20 vjet pas proklamatës për familjen, Gjykata e Lartë e Shteteve të Bashkuara autorizoi martesën mes së njëjtës gjini, duke përmbysur mijëra vjet martesë, të kufizuar midis një burri dhe një gruaje. Përqindja tronditëse e fëmijëve në Shtetet e Bashkuara të lindur nga një nënë që nuk është e martuar me babanë, u rrit më ngadalë: 5 përqind në vitin 1960⁵, 32 përqind në vitin 1995⁶ dhe tani 40 përqind⁷.

IV.

Proklamata për familjen fillon duke shpallur se “martesa midis një burri dhe një gruaje shugurohet nga Perëndia dhe se familja është thelbësore në planin e Krijuesit për destinacionin e përjetshëm të fëmijëve të Tij”. Ajo gjithashtu pohon se “gjinia është një karakteristikë thelbësore e identitetit dhe qëllimit individual të jetës para lindjes, të jetës së vdekshme dhe asaj të përjetshme”. Më tej ajo shpall se “Perëndia ka urdhëruar që fuqitë e shenjta të krijimit të jetës duhet të përdoren vetëm midis burrit dhe gruas, ligjërisht të martuar si bashkëshort e bashkëshorte”.

Proklamata pohon detyrën e vazhdueshme të bashkëshortit e bashkëshortes që të shumohen e ta mbushin tokën dhe “përgjegjësinë e tyre solemne për të dashur dhe për t’u kujdesur

për njëri-tjetrin dhe për fëmijët e tyre”: “Fëmijët kanë të drejtën të lindin nga prindër brenda lidhjeve të martesës dhe të rriten nga një atë dhe një nënë të cilët i nderojnë me besnikëri të plotë besëlidhjet e martesës”. Ajo solemnisht paralajmëron kundër keqtrajtimit të bashkëshortes/it apo fëmijëve dhe pohon se “lumturia në jetën familjare është e mundur të arrihet më mirë kur bazohet në mësimet e Zotit Jezu Krisht”. Së fundi, ajo bën thirrje për përkrahjen e “masa[ve] të krijuara për të ruajtur dhe forcuar familjen si njësi themelore e shoqërisë”.

Në vitin 1995, një President i Kishës dhe 14 Apostuj të tjerë të Zotit, nxorën këto shpallje të rëndësishme doktrinale. Si njëri nga vetëm shtatë prej atyre Apostujve që jetojnë ende, ndihem i detyruar të tregoj atë që çoi drejt proklamatës për familjen, për dijeninë e të gjithë atyre që e marrin atë parasysht.

Frymëzimi që përcaktoi nevojën për një proklamatë mbi familjen, i erdhi udhëheqjes së Kishës mbi 23 vjet më parë. Ishte një befasi për disa, të cilët mendonin se të vërtetat doktrinale rreth martesës dhe familjes kuptoheshin mirë [edhe] pa një rishpallje.⁸ Megjithatë, ne e ndiem miratimin dhe iu futëm punës. Çështjet u përcaktuan dhe u diskutuan nga anëtarët e Kuoromit të Të Dymbëdhjetëve për gati një vit. U propozua, u shqyrtua dhe u rishikua formulimi. Plot lutje, ne vazhdimisht iu përgjyruam Zotit për frymëzimin e Tij, për atë që duhej të thoshim dhe mënyrën se si duhej ta thoshim. Ne të gjithë mësuam “rresht pas rreshti, parim pas parimi”, ashtu siç ka premtuar Zoti (DeB 98:12).

Gjatë këtij procesi zbulues, Presidencës së Parë iu paraqit një tekst i propozuar, i cili mbikëqyr e shpall mësimet dhe doktrinat e Kishës. Pasi



Presidenca bëri ndryshime të mëtejshme, proklamata për familjen u njoftua nga Presidenti i Kishës, Gordon B. Hinkli. Në mbledhjen e grave të datës 23 shtator 1995, ai e paraqiti proklamatin me këto fjalë: “Me kaq shumë sofizëm që jepet si e vërtetë, me kaq shumë mashtrime lidhur me standardet e vlerat, me kaq shumë joshje dhe tërheqje për ta pranuar ndotjen e ngadaltë të botës, ne e kemi ndier që të lajmërojmë dhe paralajmërojmë”⁹.

Dëshmoj se proklamata për familjen është një shpallje e të vërtetës së përjetshme, vullneti i Zotit për fëmijët e Tij të cilët e kërkojnë jetën e përjetshme. Ajo ka qenë baza e mësimdhënies dhe praktikës së Kishës për 22 vitet e fundit dhe do të vazhdojë të jetë kështu në të ardhmen. Mendojeni atë si të tillë, jepeni mësim atë, jetoni sipas saj dhe ju do të bekoheni ndërsa shkoni përpara drejt jetës së përjetshme.

Dyzet vjet më parë, Presidenti Ezra Taft Benson dha mësim se “çdo brez ka sprovat e tij dhe mundësinë e tij për t’u bërë ballë dhe për ta vënë në provë veten”¹⁰. Unë besoj se qëndrimi ynë ndaj proklamatës për familjen dhe përdorimi i saj, është një nga ato sprova për këtë brez. Lutem që të gjithë shenjtorët e ditëve të mëvonshme të qëndrojnë të vendosur në atë sprovë.

E mbyll me mësimet e Presidentit Gordon B. Hinkli, të shquptuara dy vjet pasi u njoftua proklamata për familjen. Ai tha: “Unë shoh një të ardhme të mrekullueshme në një botë shumë të pasigurt. Nëse do të kapemi pas vlerave tona, nëse do të ndërtojmë mbi trashëgiminë tonë, nëse do të ecim me bindje përpara Zotit, nëse thjesht do ta jetojmë ungjillin, ne do të bekohemi në një mënyrë të mahnitshme dhe të mrekullueshme. Ne do të shihemi si një popull i veçantë, i cili e

ka gjetur çelësin drejt një lumturie të pashoqe.”¹¹

Dëshmoj për të vërtetën dhe rëndësinë e përjetshme të proklamatës për familjen, që Zoti Jezu Krisht ua zbuloi Apostujve të Tij për ekzaltimin e fëmijëve të Perëndisë (shih Doktrina e Besëlidhje 131:1–4), në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Tomas S. Monson, “Qëndroni në Vende të Shenjta”, *Liahona*, nëntor 2011, f. 83.
2. Rasëll M. Nelson, “Shpëtimi dhe Ekzaltimi”, *Liahona*, maj 2008, f. 7.
3. Shih “Familja: Një Proklamata drejtuar Botës”, *Liahona*, nëntor 2010, f. 129.
4. Shih Dallin H. Oaks, “Dashuria dhe Ligji”, *Liahona*, nëntor 2009, f. 26–29.
5. Shih “‘Disastrous’ Illegitimacy Trends”, *Washington Times*, 1 dhjetor 2006, washingtontimes.com.
6. Shih Stephanie J. Ventura dhe të tjerë, “Report of Final Natality Statistics, 1996”, *Monthly Vital Statistics Report*, 30 qershor 1998, f. 9.
7. Shih Brady E. Hamilton dhe të tjerë, “Births: Provisional Data for 2016”, *Vital Statistics Rapid Release*, qershor 2017, f. 10.
8. Presidentja jonë e Përgjithshme e Të Rejave e tha mirë 20 vite më vonë: “Pak e kuptonim në atë kohë se sa dëshpërimisht do të na nevojiteshin këto deklaratat bazë në botën e sotme si kriteri mbi të cilin ne mund të gjykonim çdo erë të re të dogmave të botës që vijnë te ne nga media, interneti, studiuesit, televizioni e filmat dhe madje ligjvënësit. Proklamata mbi familjen është bërë standardi ynë për gjykimin e filozofive të botës dhe unë dëshmoj se parimet e parashtuara në këtë deklaratë janë po aq të vërteta sot saç ishin kur na u dhanë nga një profet i Perëndisë afro 20 vjet më parë” (Boni L. Oskarson, “Mbrojtës të Proklamatës së Familjes”, *Liahona*, maj 2015, f. 14–15).
9. Gordon B. Hinckley, “Stand Strong against the Wiles of the World”, *Ensign*, nëntor 1995, f. 100.
10. Ezra Taft Benson, “Our Obligation and Challenge” (fjalim i mbajtur në seminarin me përfaqësuesit rajonalë, 30 shtator 1977), f. 2; në David A. Bednar, “On the Lord’s Side: Lessons from Zion’s Camp”, *Liahona*, korrik 2017, f. 19.
11. *Mësime të Presidentëve të Kishës: Gordon B. Hinkli* (2016), f. 186; shih edhe Gordon B. Hinckley, “Look to the Future”, *Ensign*, nëntor 1997, f. 69.



Nga Plaku Xhon C. Pingri i Riu,
i Të Shtatëdhjetëve

“Unë Kam një Punë për Ty”

Secili prej nesh ka një rol domethënës për të luajtur në përparimin e punës së Perëndisë.

Moisiut, Perëndia i shpalli: “Unë kam një punë për ty” (Moisiu 1:6). A e keni pyetur ndonjëherë veten a ka Ati Qiellor një punë për ju? A ka gjëra të rëndësishme për të cilat Ai ju ka përgatitur ju – dhe posaçërisht ju – që t’i përmbushni? Dëshmoj se përgjigja është po!

Merreni parasysh Girish Gimirein, i cili u lind e u rrit në shtetin e Nepalit. Kur qe adoleshent, ai studioi në Kinë, ku një shok klase e njohu me ungjillin e Jezu Krishtit. Përfundimisht, Girishi erdhi në Universitetin e Brigam Jangut për punë pasuniversitare dhe u takua me bashkëshorten e tij të ardhshme. Ata u vendosën në luginën e Solt-Lejikut dhe birësuan dy fëmijë nga Nepali.

Vite më vonë, kur më shumë se 1500 refugjatë nga kampet në Nepal u shpërngulën në Jutë,¹ Girishi u ndje i frymëzuar të jepte ndihmë. Me rrjedhshmërinë e gjuhës mëmë dhe kuptimin kulturor, Girishi shërbeu si përkthyes, mësues dhe këshillues. Pasi u sistemuuan në komunitet, disa prej refugjatëve nga Nepali shfaqën interes për ungjillin. U organizua një degë në gjuhën nepaleze dhe Girishi më vonë shërbeu si president i asaj degë. Ai gjithashtu

që mjet aktiv në përkthimin e Librit të Mormonit në gjuhën nepaleze.

A mund ta shihni se si Ati Qiellor e përgatiti dhe po e përdor Girishin?

Perëndia Ka një Punë për Secilin prej Nesh

Vëllezër dhe motra, Perëndia ka punë të rëndësishme për secilin prej nesh. Duke u folur motrave, por duke dhënë mësim të vërteta që gjejnë zbatim për të gjithë, Presidenti Spenser W.



Kimball na mësoi: “Përpara se të vinim [në tokë, na] u dhanë detyra të caktuara. . . . Edhe pse tani nuk i kujtojmë hollësitë, kjo nuk e ndryshon realitetin e lavdishëm të asaj për të cilën ne dikur ramë dakord.”² Çfarë e vërtete fisnikëruese! Ati ynë Qiellor ka gjëra të posaçme dhe domethënëse për t’u përmbushur nga unë dhe ju (shih Efesianëve 2:10).

Këto detyra hyjnore nuk janë paracaktuar për disa [individë] të privilegjuar, por janë për të gjithë ne – pavarësisht nga gjinia, mosha, raca, kombësia, niveli i të ardhurave, pozita shoqërore apo thirrja në Kishë. Secili prej nesh ka një rol domethënës për të luajtur në përparimin e punës së Perëndisë (shih Moisiu 1:39).

Disa prej nesh e vënë në pikëpyetje atë nëse Ati Qiellor mund të na përdorë *ne* për të dhënë ndihmesa të rëndësishme. Por kujtoni, Ai gjithnjë ka përdorur njerëz të zakonshëm për të arritur gjëra të jashtëzakonshme (shih 1 Korintasve 1:27–28; DeB 35:13; 124:1). “[Ne] jlemi veprues për veten” dhe “është në [ne] fuqia” që “të shkaktoj[më] shumë drejtësi” (DeB 58:27–28).³

Presidenti Rasëll M. Nelson shpjegoi: “Zoti ka më shumë plane në mendje për ju sesa keni ju për veten tuaj! Ju jeni ruajtur e mbajtur për këtë kohë dhe vend. . . .

Zoti ka nevojë që ju ta ndryshoni botën. Kur e pranoni dhe e zbatoni vullnetin e Tij për ju, do ta shihni veten duke arritur të pamundurën!”⁴

Po si arrijmë ta kuptojmë dhe ta përmbushim punën që Perëndia ka ndërmend për ne? Më lejoni të tregoj katër parime që do të ndihmojnë.

Përqendrohuni tek të Tjerët

Së pari, përqendrohuni tek të tjerët. Ne mund ta ndjekim Krishtin, “i cili e përshkoi vendin duke bërë mirë”

(Veprat e Apostujve 10:38; shih edhe 2 Nefi 26:24).

Pasi u ktheva nga misioni kohëplotë, më merite malli për qëllimin e përditshëm që më kishte kënaqur. E qartë, më nevojitej të mbaja besëlidhjet e mia, të arsimohesha të krijoja familje dhe të siguroja jetesën. Por pyesja veten nëse kishte diçka më shumë, apo edhe të posaçme, që Zoti donte që unë të bëja. Pasi përsiata për disa muaj, ndesha këtë varg: “Nëse dëshiron, ti do të jesh mjete për të bërë shumë mirësi në këtë brez” (DeB 11:8). Shpirti më ndihmoi të kuptoj se qëllimi kryesor i detyrave hyjnore është që t’i bekojnë të tjerët dhe të bëjnë “shumë mirësi”.

Ne mund t’u qasemi pikave të vendimmarrjes në jetën tonë – si [p.sh.] për çfarë të studiojmë, çfarë pune të bëjmë ose ku të jetojmë – në kontekstin e ndihmës ndaj të tjerëve.

Një familje u zhvendos në një qytet të ri. Në vend që të gjenin shtëpi në një lagje të pasur, ata u ndien të nxitur të vendoseshin në një zonë me nevoja mjaft të mëdha shoqërore dhe ekonomike. Gjatë viteve, Zoti ka punuar përmes tyre për të ndihmuar shumë individë dhe për ta ngritur lagjen dhe kunjin e tyre.

Një specialist mjekësor kishte një klinikë të zakonshme por ndjeu udhëzimin që ta linte mënjanë një ditë çdo javë për t’u dhënë kujdes mjekësor falas individëve që nuk kishin sigurime shëndetësore. Për shkak të gatishmërisë së këtij burri dhe bashkëshortes së tij për t’i bekuar të tjerët, Zoti siguroi një udhë që ata të ndihmonin qindra pacientë në nevojë ndërkohë që rritnin edhe familjen e tyre të madhe.

Zbuloni dhe Zhvilloni Dhuratat Shpirtërore

Së dyti, zbuloni dhe zhvilloni dhuratat shpirtërore. Ati Qiellor na i dha



këto dhuratat për të na ndihmuar që ta përcaktojmë, kryejmë e gëzojmë punën që Ai ka për ne.

Disa prej nesh e pyetin veten: “A kam unë *ndonjë* dhuratë?” Përsëri, përgjigja është po! “Çdo njeriu i jepet një dhuratë me anë të Shpirtit të Perëndisë . . . me qëllim që të gjithë të mund të përfitojnë në këtë mënyrë” (DeB 46:11–12; theksimi i shtuar).⁵ Një numër dhuratash shpirtërore janë shënuar në shkrimin e shenjtë (shih 1 Korintasve 12:1–11, 31; Moroni 10:8–18; DeB 46:8–26), por ka shumë të tjera.⁶ Disa [prej tyre] mund të përfshijnë pasjen e dhembshurisë, shprehjen e shpresës, ndërveprimin e mirë me njerëzit, organizimin me efektshmëri, të folurim ose të shkruarim në mënyrë bindëse, mësimdhënien e qartë dhe punën e zellshme.

Atëherë, si arrijmë t’i njohim dhuratat tona? Ne mund t’i drejtohem bekimit tonë patriarkal, të pyetim ata që na njohin shumë mirë dhe të përcaktojmë vetë se për çfarë gjërash jemi të zotë në mënyrë të natyrshme dhe çfarë gjërash

na gëzojnë. Më e rëndësishmja, ne mund të pyetim Perëndinë (shih Jakobit [Bibël] 1:5; DeB 112:10). Ai i nesh dhuratat tona, meqenëse na i ka dhënë ato (shih DeB 46:26).

Kur i zbulojmë dhuratat tona, ne kemi përgjegjësi t’i zhvillojmë ato (shih Mateu 25:14–30). Edhe Jezu Krishti “nuk e mori plotësinë që në fillim, por [u zhvillua] nga hiri në hir” (DeB 93:13).

Një i ri krijonte ilustrime për të nxitur vlerat fetare. I parapëlqyeri im është një portret i Shpëtimtarit, një kopje e të cilit qëndron varur në shtëpinë tonë. Ky vëlla i zhvilloi dhe i përdori dhuratat e tij artistike. Duke punuar përmes tij, Ati Qiellor ka frymëzuar të tjerë që ta përmirësojnë dishepullimin e tyre.

Ndonjëherë ne ndiejmë se nuk kemi ndonjë dhuratë posaçërisht të rëndësishme. Një ditë, një motër e shkruajuar u përgjërue: “Zot, cila është shërbesa ime vetjake?” Ai u përgjigj: “Trego vëmendje ndaj të tjerëve”. Ajo ishte një dhuratë shpirtërore! Që atëherë, ajo ka gjetur gëzim ndërsa ka treguar



vëmendje ndaj atyre që harrohen rëndom dhe Perëndia ka punuar përmes saj për të bekuar shumë njerëz. Ndërkohë që, disa dhurata shpirtërore mund të mos jenë të shquara sipas standardeve të botës, ato janë thelbësore për Perëndinë dhe punën e Tij.⁷

Shfrytëzoheni Vështirësinë

Së treti, shfrytëzoheni vështirësinë. Sprovat tona na ndihmojnë ta zbulojmë punën që Ati Qiellor ka për ne, dhe të përgatitemi për të. Alma shpjegoi: “Pas shumë mundimesh, Zoti . . . më ka bërë një mjet në duart e tij” (Mosia 23:10).⁸ Ashtu si Shpëtimtari, sakrifica shlyese e të cilit i mundëson Atij të na ndihmojë (shih Alma 7:11–12), ne mund ta përdorim njohurinën e fituar nga përvoja të vështira për t’i ngritur moralisht, për t’i forcuar dhe bekuar të tjerët.

Pasi vendi i punës i një drejtori të suksesshëm të burimeve njerëzore u shkurtua, ai lexoi bekimin e tij patriarkal dhe ndjeu frymëzimin që të krijonte një kompani për të ndihmuar

profesionistë të tjerë të gjenin punë. (Ai madje më ndihmoi mua të gjeja punë kur familja jonë u kthye nga shërbimi në një mision.) Zoti e përdori sprovën e tij si një udhë për t’i bekuar të tjerët, ndërkohë që i siguroi atij një karrierë me kuptimplotë.

Një çift i ri përjetoi lindjen e një fëmije të vdekur. Me zemër të thyer, ata vendosën ta nderonin bijën e tyre duke u dhënë këshillë dhe ndihmë materiale prindërve që përballëshin me situata të ngjashme. Zoti ka vepruar nëpërmjet këtij çifti për shkak të ndjeshmërisë së tyre mjaft të lartë, të zhvilluar përmes vështirësisë.

Mbështetuni te Perëndia

Dhe së katërti, mbështetuni te Perëndia. Kur i kërkojmë Atij me besim e me qëllim të vërtetë, Ai do të na i zbulojë detyrat tona hyjnore.⁹ Pasi t’i zbulojmë, Ai do të na ndihmojë t’i përmbushim ato detyra. “Gjithë gjërat janë të pranishme përpara syve të [Tij]” (DeB 38:2; shih edhe Abraham 2:8) dhe, në kohën e duhur, Ai do të hapë

dyert e nevojshme për ne (shih Zbulesa 3:8). Ai madje e dërgoi Birin e Tij, Jezu Krishtin, në mënyrë që ne të mund të mbështetemi tek Ai për forcë përtej aftësive tona natyrore (shih Filipianëve 4:13; Alma 26:12).

Një vëlla, i shqetësuar nga vendimet e pushtetit vendor, ndjeu nxitjen që të hidhte kandidaturën për një post publik. Me gjithë procesin frikësues të fushatës, ai ushtroi besim dhe i mblo dhi burimet për ta hedhur kandidaturën. Përfundimisht, ai nuk fitoi, por ndjeu se Zoti i dha udhërrëfim e forcë për të ngritur çështje me rëndësi për komunitetin.

Një nënë beqare, që po rriste fëmijë me zhvillim të kufizuar, e vinte në dyshim faktin se mund t’i përmbushte siç duhej nevojat e familjes së saj. Ndonëse ka qenë e vështirë, ajo ndien se ka marrë fuqi nga Zoti për ta përmbushur me sukses misionin e saj më të rëndësishëm.

Një Fjalë Paralajmërimi

Në të njëjtën kohë që Perëndia na ndihmon të përmbushim detyra hyjnore, kundërshtari vepron për të na shpërqendruar e për të na e kthyer mendjen prej jetës [sonë] me kuptim.

Mëkati është mbase pengesa jonë më e madhe, duke e zbehur ndjeshmërinë tonë ndaj Frymës së Shenjtë dhe duke e kufizuar të drejtën tonë për fuqi shpirtërore. Për të kryer punën që Ati Qiellor ka për ne, ne duhet të luftojmë për të qenë të pastër (shih 3 Nefi 8:1). A po jetojmë në një mënyrë të tillë që Perëndia të mund të veprojë nëpërmjet nesh?

Satani gjithashtu përpiqet të na shpërqendrojë me çështje më pak të rëndësishme. Zoti e paralajmëroi një udhëheqës të hershëm të Kishës: “Mendja jote ka qenë në gjërat e tokës më shumë se në gjërat e mia . . . dhe se në shërbesën në të cilën je thirrur”

(DeB 30:2). A jemi ne aq të zënë me gjërat e kësaj bote sa që u jemi shmangur detyrave tona hyjnore?

Përveç kësaj, Satani na shkurajon me ndjenja papërshtatshmërie. Ai e bën punën tonë të duket tepër e vështirë apo shkurajuese. Sidoqoftë, ne mund t'i mirëbesojmë Perëndisë! Ai na do. Ai do që ne t'ia dalim mbanë. Ai "ecën para [nesh]; ai do të jetë me [ne]; nuk do të [na] lërë" (Ligji i Përtërirë 31:8; shih edhe Psalmi 32:8; Fjalët e Urta 3:5–6; Mateu 19:26; DeB 78:18).

Satani gjithashtu mund të na mbushë mendjen që ta shohim punën tonë si më pak të vlefshme sesa puna që u është caktuar të tjerëve. Por çdo detyrë nga Perëndia është e rëndësishme dhe ne do të gjejmë përmbushje kur "lavdërohem[i] për atë që Zoti [na] ka urdhëruar" (Alma 29:9).

Kur Perëndia vepron nëpërmjet nesh, kundërshtari mund të na tundojë që t'i marrim për vete meritat për ndonjë arritje. Mirëpo, ne mund të ndjekim përlësinë e Shpëtimtarit duke e shmangur vetëlavdërimin dhe duke lëvdur Atin (shih Mateu 5:16; Moisiu 4:2). Kur një gazetar u përpoq ta përgëzonte Nënë Terezën për misionin e jetës së saj për të ndihmuar të varfrit, ajo ia ktheu: "Është puna e [Perëndisë]. Unë jam si një . . . laps në dorën e Tij. . . . Mendimet janë të Tijat. Shkrimi është i Tij. Lapsi nuk ka të bëjë fare me të. Lapsi vetëm lejon që ta përdorin."¹⁰

Përfundimi

Vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, unë e ftoj secilin prej nesh që ta "tregoj[ë] veten [e vet] te Perëndia . . . si mje[t] drejtësie për Perëndinë" (Romakëve 6:13). Tregimi i vetvetes [nënshtrimi] përfshin faktin që ne ia bëjmë të ditur Atij se duam të jemi të dobishëm, duke kërkuar drejtësinë e Tij dhe duke marrë nga fuqia e Tij.

Si përherë, ne mund të shikojmë nga Jezu Krishti, shembulli i përkryer për ne. Në jetën paratokësore, Ati Qiellor pyeti: "Kë të dërgoj?"


Dhe Jezusi u përgjigj: "Ja ku jam, dërgomë mua" (Abraham 3:27; shih edhe Isaia 6:8).

Jezu Krishti e pranoi rolin e Tij të parachuguruar si Shpëtimtari e Shëlbuesi ynë, u përgatit për atë rol dhe e përmbushi atë. Ai bëri vullnetin e Atit (shih Gjoni 5:30; 6:38; 3 Nefi 27:13) dhe i përmbushi detyrat e Tij hyjnore.

Kur e ndjekim shembullin e Krishtit dhe ia nënshtrojmë veten Perëndisë, unë dëshmoj se Ai do të na përdorë ne gjithashtu për ta çuar përpara punën e Tij dhe për t'i bekuar të tjerët. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih Refugee Processing Center, "Admissions and Arrivals", ireports.wrapsnet.org/Interactive-Reporting.
2. Spencer W. Kimball, "The Role of Righteous Women", *Ensign*, nëntor 1979, f. 102.
3. Presidenti Gordon B. Hinkli na nxiti: "Besoni te vetja. Besoni në aftësinë tuaj për të bërë gjëra të mëdha. . . . Ju jeni një fëmijë i Perëndisë, me aftësi të pafundme" (*Mësime të Presidentëve të Kishës: Gordon B. Hinkli* [2016], f. 80).
4. Russell M. Nelson, *Accomplishing the Impossible: What God Does, What We Can Do* (2015), f. 147.
5. Presidenti Diter F. Uhtdorf vuri në dukje: "Ati ynë Qiellor e sheh potencialin tonë të vërtetë. Ai di rreth nesh gjëra që as vetë nuk i dimë. Ai na nxit gjatë jetës sonë që të plotësojmë qëllimin e krijimit tonë. . . .
Le të vendosim të ndjekim Shpëtimtarin dhe të punojmë me zell për t'u bërë personi që jemi paracaktuar për t'u bërë. Le t'i dëgjojmë dhe t'u bindemi nxitjeve të Shpirtit të Shenjtë. Ndërsa e bëjmë këtë, Ati Qiellor do të na zbulojë gjëra që kurrë nuk i dimin për veten tonë. Ai do ta ndriçojë shtegun para nesh dhe do të na hapë sytë për të parë talentet tona të panjohura dhe ndoshta të papërfytyruara" ("Lidhur me Keqardhjet dhe Vendimet", ose *Liahona*, nëntor 2012, f. 22, 23).
6. Plaku Brus R. Mek-Konki shpjegoi: "Dhuratat shpirtërore janë të pambarueshme në numër dhe të pafundme në larmi. Ato, të renditura në fjalën e zbuluar, janë thjesht



ilustrime të derdhjes së pakufishme të hirit hyjnor, që një Perëndi i hirshëm ua jep atyre që e duan atë dhe i shërbejnë atij" (*A New Witness for the Articles of Faith* [1985], f. 371).

7. Plaku Marvin J. Ashton dha mësim:

"Të marra rastësisht, më lejon të përmend disa dhunti që nuk janë gjithmonë të dukshme ose me vlerë për t'u shënuar, por që janë shumë të rëndësishme. Midis këtyre mund të jenë dhuratat tuaja – dhurata jo aq të dukshme, por sidoqoftë të vërteta dhe të vlefshme.

Le t'i shqyrtojmë disa nga këto dhunti më pak të dukshme: dhuntia e bërjes së pyetjeve; dhuntia e të dëgjuarit [të tjerëve]; dhuntia e dëgjimit dhe e përdorimit të një zëri të qetë, të ulët; dhuntia e të qenit në gjendje të vajojmë; dhuntia e shmangies së grindjes; dhuntia e të qenit dakord; dhuntia e shmangies së përsëritjes së kotë; dhuntia e kërkimit të asaj që është e drejtë; dhuntia e mosgykimit; dhuntia e të shikuarit te Perëndia për udhërrëfim; dhuntia e të qenit dishepull; dhuntia e përkujdesjes ndaj të tjerëve; dhuntia e aftësisë për të përsiatuar; dhuntia e bërjes së lutjes; dhuntia e dhënies së një dëshmie të fortë dhe dhuntia e marrjes së Frymës së Shenjtë" ("There Are Many Gifts", *Ensign*, nëntor 1987, f. 20).

8. Pali gjithashtu udhëzoi: "[Perëndia] i cili na ngushëllon në çdo shtrëngim tonin, që, nëpërmjet ngushëllimit me të cilin ne jemi ngushëlluar nga Perëndia, të mund të ngushëlojmë ata që janë në çfarëdo shtrëngimi" (2 Korintasve 1:4).

9. Plaku Riçard G. Skot shpjegoi: "Perëndia ka një plan të veçantë për jetën tuaj. Ai do të zbulojë pjesë të atij plani për ju ndërsa e kërkon atë plan me besim dhe bindje të vazhdueshme" ("How to Live Well amid Increasing Evil", *Liahona*, maj 2004, f. 102).

10. Mother Teresa, në Edward W. Desmond, "Interview with Mother Teresa: A Pencil in the Hand of God", *Time*, 4 dhjetor 1989, time.com.



Nga Plaku D. Tod Kristoferson,
i Kuorunit të Dymbëdhjetë Apostujve

Buka e Gjallë që Zbriti nga Qielli

Nëse dëshirojmë fort të banojmë në Krisht dhe Ai të banojë në ne, atëherë shenjtëria është ajo që kërkojmë.

Ditën pasi Jezusi i ushqeu mreku-llisht të pesë mijë vetët në Galile, me vetëm “pesë bukë elbi dhe dy peshq të vegjël”¹, Ai u foli sërish njerëzve në Kapernaum. Shpëtimtari e kuptoi se shumë njerëz nuk ishin aq shumë të interesuar në mësimet e Tij saç ishin të interesuar që të ushqeheshin sërish.² Prandaj, Ai u përpoq që t’i bindte ata për vlerën jashtëzakonisht më të madhe të “ushqimi[t] që mbetet për jetë të përjetshme, të cilin do t’jua japë Biri i njeriut”³. Jezusi shpalli:

“Unë jam buka e jetës.

Etërit tuaj hëngrën manën në shkretirë dhe vdiqën.

Kjo është buka që zbret nga qielli, që një mund të hajë e të mos vdesë.

Unë jam buka e gjallë që zbriti nga qielli; nëse një ha nga kjo bukë do të jetojë përjetë; buka që unë do të jap është mishi im, që unë do ta jap për jetën e botës.”⁴

Domethënia që kishte si qëllim Shpëtimtari, humbi krejtësisht të dëgjuesit e Tij, të cilët e morën deklaratën e Tij vetëm fjalë për fjalë. Duke reaguar me neveri ndaj mendimit, ata pyetnin me vete: “Si mundet ky të na japë të

hamë mishin e tij?”⁵ Jezusi e vazhdoi më tej metaforën e tij:

“Në të vërtetë, në të vërtetë po ju them se, po të mos hani mishin e Birit të njeriut dhe të mos pini gjakun e tij, nuk keni jetën në veten tuaj.

Kush ha mishin tim dhe pi gjakun tim, ka jetë të përjetshme, dhe unë do ta ringjall atë në ditën e fundit.

Sepse mishi im është me të vërtetë ushqim dhe gjaku im është me të vërtetë pije.”⁶

Më pas Ai shprehu domethënien e thellë të metaforës së Tij:

“Kush ha mishin tim dhe pi gjakun tim, mbetet në mua dhe unë në të.



Sikurse Ati i gjallë më ka dërguar dhe unë jetoj për shkak të Atit, ashtu edhe ai që më ha mua do të jetojë edhe ai për shkakun tim.”⁷

Prapëseprapë, dëgjuesit e tij nuk e rrokën atë që Jezusi po thoshte dhe, “kur i dëgjuan këto, shumë nga dishepujt e tij thanë: ‘Kjo e folur është e rëndë, kush mund ta kuptojë?’ . . . [Dhe] që nga ai moment shumë nga dishepujt e vet u tërhoqën dhe nuk shkuan më me të.”⁸

Të hamë mishin e Tij dhe të pimë gjakun e Tij është një mënyrë e pazakontë për të shprehur se sa plotësisht duhet ta sjellim Shpëtimtarin në jetën tonë – në vetë qenien tonë – që të mund të jemi një. Si ndodh kjo?

Së pari, ne e kuptojmë që kur e sakrifikoim mishin dhe gjakun e Tij, Jezusi shleu për mëkatet tona dhe e mposhti vdekjen, si fizike dhe atë shpirtërore.⁹ Atëherë qartësisht, ne marrim nga mishi i Tij dhe pimë nga gjaku i Tij, kur marrim prej Tij fuqinë dhe bekimet e Shlyerjes së Tij.

Doktrina e Krishtit shpreh atë që duhet të bëjmë për ta marrë hirin shlyes. Do të thotë të besoni dhe të keni besim në Krishtin, të pendoheni e të pagëzoheni dhe të merrni Frymën e Shenjtë, “dhe pastaj vjen një heqje e mëkateve tuaja me anë të zjarrit dhe me anë të Frymës së Shenjtë”¹⁰. Kjo është porta, hyrja jonë për te hiri shlyes i Shpëtimtarit dhe për te shtegu i ngushtë e i ngushtuar që na çon në mbretërinë e Tij.

“Prandaj, në qoftë se ju do të shkoni përpara, duke u ushqyer me bollëk mbi fjalën e Krishtit dhe të duroni deri në fund, vini re, kështu thotë Ati: Ju do të keni jetën e përjetshme.

. . . Vini re, kjo është doktrina e Krishtit dhe e vetmja doktrinë e vërtetë e Atit dhe e Birit dhe e Frymës së Shenjtë, që është një Perëndi, pa fund.”¹¹

Simbolika e sakramentit të Darkës së Zotit është e bukur për t'u menduar. Buka dhe uji përfaqësojnë mishin dhe gjakun e Atij që është Buka e Jetës dhe Uji i Gjallë¹², duke na kujtuar me ton prekës çmimin që pagoi Ai për të na shëlbuar. Kur copëtohet buka, ne kujtojmë mishin e copëtuar të Shpëtimtarit. Plaku Dallin H. Ouks dikur vërejtë që “për shkak se ajo është e thyer dhe e copëtuar, çdo copë buke është e veçantë, ashtu siç janë të veçantë individët që e marrin atë. Të gjithë ne kemi mëkatet e ndryshme për t'u penduar. Të gjithë ne kemi nevoja të ndryshme për të forcuar nëpërmjet Shlyerjes së Zotit Jezu Krisht, të cilin ne e kujtojmë në këtë ordinancë”¹³. Kur e pimë ujin, ne mendojmë për gjakun që Ai derdhi në Gjetseman e në kryq dhe fuqinë e tij shenjtëruese.¹⁴ Duke e ditur se “asgjë e papastër nuk mund të hyjë në mbretërinë e tij”, ne zgjedhim të jemi midis “at[yre] që [i] kanë larë rrobat e tyre në gjakun [e Shpëtimtarit], për shkak të besimit të tyre dhe të pendimit për të gjitha mëkatet e tyre dhe të besnikërisë së tyre deri në fund”¹⁵.

Unë kam folur për marrjen e hirit shlyes të Shpëtimtarit, për t'i hequr mëkatet tona dhe njollën e atyre mëkateve te ne. Por figurativisht, ngrënia e mishit të Tij dhe pirja e gjakut të Tij ka një domethënie të mëtejshme, dhe kjo do të thotë që t'i përvetësojmë cilësitë dhe karakterin e Krishtit, duke e zhveshur njeriun e natyrshëm dhe duke u bërë shenjtore “nëpërmjet shlyerjes së Krishtit Zot”¹⁶. Kur e marrim bukën dhe ujin e sakramentit çdo javë, do të ishte mirë të merrnim në shqyrtim se sa plotësisht dhe tërësisht duhet ta përfshijmë karakterin e Tij dhe modelin e jetës së Tij të pamëkatë në vetë jetën dhe qenien tonë. Jezusi nuk do të mund të kishte shlyer për mëkatet e të tjerëve nëse Ai Vetë nuk do të ishte



i pamëkatë. Përdërisa drejtësia nuk kishte pretendim mbi Të, Ai mund ta ofronte Vetën e Tij në vendin tonë për ta kënaqur drejtësinë dhe më pas për të treguar mëshirë. Kur e kujtojmë dhe e nderojmë flijimin e Tij shlyes, ne duhet të mendojmë gjithashtu për jetën e Tij të pamëkatë.

Kjo sugjeron nevojën për një përpjekje të fuqishme nga ana jonë. Nuk mund të jemi të kënaqur të qëndrojmë siç jemi, por duhet të lëvizim vazhdimisht drejt “masë[s] shtatit të plotësisë së Krishtit”¹⁷. Ashtu si babai i mbretit Lamoni në Librin e Mormonit, ne duhet të jemi të gatshëm t'i braktisim të gjitha mëkatet tona¹⁸ dhe të përqendrohemi tek ajo që Zoti pret nga ne, individualisht dhe së bashku.

Jo shumë kohë më parë, një mik më tregoi një përvojë që e kishte pasur ndërsa shërbente si president misioni. Ai i ishte nënshtruar një operacioni që kërkonte disa javë për t'u shëruar. Gjatë shërimit, ai i kushtoi kohë kërkimit në shkrimet e shenjta. Një pasdite tekса përsiaste mbi fjalët e Shpëtimtarit të kapitulli 27 i 3 Nefit, dalëngadalë ra në gjumë. Më pas rrëfeu:

“Pashë një ëndërr në të cilën m'u dha një pamje e paharrueshme, tërësore e jetës sime. M'u treguan mëkatet e

mia, zgjedhjet e mia të këqija, kohët . . . kur i kisha trajtuar njerëzit me padurim, dhe mungesën e gjërave të mira që duhej të kisha thënë apo bërë. . . . Në vetëm pak minuta m'u tregua një [pasqyrim] . . . i plotë i jetës sime, por ai m'u duk shumë më i gjatë. U zgjova, i befasuar dhe . . . papritur rashë në gjunjë, pranë shtratit dhe fillova të lutesha, të përgjroheshja për falje, duke i zbrazur ndjenjat e zemrës sime sikundër nuk e kisha bërë kurrë më parë.

Përpara ëndërrës, nuk e dija se [kisha] kaq shumë nevojë për t'u penduar. Fajet dhe dobësitë e mia papritur u bënë kaq të qarta për mua sa që hapësira midis njeriut që unë isha dhe shenjtërisë e mirësisë së Perëndisë dukej [si] miliona kilometra. Në lutjen time atë pasdite vonë, unë i shpreha me gjithë zemrën time mirënjohjen më të thellë Atit Qiellor dhe Shpëtimtarit për atë që Ata kishin bërë për mua dhe për marrëdhëniet që çmoja me bashkëshorten dhe fëmijët e mi. Ndërkohë që isha në gjunjë unë gjithashtu ndjeva se dashuria dhe mëshira e Perëndisë ishin kaq të prekshme, pavarësisht se ndiheshja kaq i padënjë. . . .

Mund të them se nuk kam qenë më i njëjti që prej asaj dite. . . . Zemra ime ndryshoi. . . . Ajo që pasoi është se



zhvillova më shumë ndjeshmëri ndaj të tjerëve, me një aftësi më të madhe për të dashur, të shoqëruar me një ndjenjë ngutjeje për ta predikuar ungjillin. . . . Mund të bëja lidhje me mesazhet e besimit, shpresës dhe të dhuratës së pendimit që gjenden në Librin e Mormonit [si] kurrë më parë.”¹⁹

Është e rëndësishme që ta kuptojmë se kjo zbuluesë e paharrueshme e mëkateve dhe të metave të këtij burri të mirë, nuk e shkurajoi atë as nuk e çoi në dëshpërim. Po, ai ndjeu tronditje dhe brejtje të ndërgjegjes. E ndjeu fort nevojën për t’u penduar. Ai kishte qenë i përlur, por prapëseprapë ndjeu mirënjohje, paqe dhe shpresë – shpresë të vërtetë – për shkak të Jezus Krishtit, “buk[ës së] gjallë që zbriti nga qielli”²⁰.

Miku im foli për hendekun që dalloi në ëndrrën e tij midis jetës së vet dhe shenjtërisë së Perëndisë. *Shenjtëri* është fjala e duhur. Të hash mishin dhe të pish gjakun e Krishtit do të thotë të ndjekësh shenjtërinë. Perëndia urdhëron: “Jini të shenjtë, sepse unë jam i shenjtë”²¹.

Enoku na këshilloi: “Mësojuani fëmijëve tuaj se të gjithë njerëzit, kudo, duhet të pendohen ose ata nuk mund të trashëgojnë në asnjë mënyrë mbretërinë e Perëndisë, sepse asgjë e papastër nuk mund të banojë atje, ose të banojë

në prani të tij; sepse, në gjuhën e Adamit, Njeriu i Shenjtërisë është emri i tij dhe emri i të Vetëmlindurit të tij është Biri i Njeriut, madje Jezus Krishti”²². Kur isha djalë, pyesja veten përse në Dhiatën e Re Jezusi shpesh përmendet (dhe madje i referohet Vetes së Tij) si Biri i Njeriut kur Ai me të vërtetë është Biri i Perëndisë, por thënia e Enokut sqaron se këto përmendje janë në të vërtetë një pranim i hyznisë dhe shenjtërisë së Tij – Ai është Biri i Njeriut të Shenjtërisë, Perëndisë, Atit.

Nëse dëshirojmë fort të banojmë në Krishtin dhe Ai të banojë në ne²³, atëherë shenjtëria është ajo që kërkojmë, si në trup dhe në shpirt²⁴. E kërkojmë atë në tempull, ku është skulptur “Shenjtëri Zotit”. E kërkojmë atë në martesat, familjet dhe shtëpitë tona. E kërkojmë atë çdo javë ndërsa gjejmë kënaqësi në ditën e shenjtë të Zotit.²⁵ E kërkojmë atë madje në hollësitë e jetës së përditshme: në të folurim tonë, në veshjen tonë, në mendimet tona. Ashtu siç ka thënë Presidenti Tomas S. Monson: “Ne jemi produkt i gjithçkaje që lexojmë, i gjithçkaje që shohim, i gjithçkaje që dëgjojmë dhe i gjithçkaje që mendojmë”²⁶. Ne e kërkojmë shenjtërinë teksa e marrim kryqin tonë çdo ditë.²⁷

Motra Karol F. Mek-Konki, ka vërejtur: “Ne e njohim numrin e madh të provave, tundimeve, dhe mundimeve që mund të na tërheqin larg nga gjithçka që është e vërtetë dhe e denjë për t’u lavdëruar përpara Perëndisë. Por përvojat tona në vdekshmëri na ofrojnë mundësinë të zgjedhim shenjtërinë. Më së shpeshti janë sakrificat që ne bëjmë për t’i mbajtur besëlidhjet tona që na shenjtërojnë dhe na bëjnë të shenjtë.”²⁸ Dhe unë do t’u shtoja “sakrifica[ve] që ne bëjmë”, edhe shërbimin që japim.

E dimë që “kur je[m]li në shërbimin e bashkëqenieve t[ona], [ne] je[m]li vetëm në shërbimin e Perëndisë t[onë]”²⁹. Dhe Zoti na kujton që një shërbim i tillë është thelbësor për jetën dhe karakterin e Tij: “Sepse edhe Biri i njeriut nuk erdhi që t’i shërbejnë, por për të shërbyer dhe për të dhënë jetën e tij si çmim për shpengimin e shumë vetave”³⁰. Ashtu siç Presidenti Marion G. Romni e shpjegoi me mençuri: “Shërbimi nuk është diçka që ne e durojmë në këtë tokë, që të fitojmë të drejtën për të jetuar në mbretërinë çelestiale. Shërbimi është vetë thelbi nga i cili përbëhet jeta e ekzaltuar në mbretërinë çelestiale.”³¹

Zakaria profetizoi që në kohën e mbretërimit mijëvjeçar të Zotit, edhe zillkat e kuajve do të mbanin mbishkrimin “Shenjtëri Zotit”³². Me këtë në mendje, shenjtëritë pionierë në këto lugina, e ngulitën atë kujtues, “Shenjtëri Zotit”, në gjërat në dukje të zakonshme apo të rëndomta, si edhe tek ato gjëra që lidheshin më drejtpërdrejt me ushtrimin fetar. Ajo ishte e skalitur te gotat dhe pjatat e sakramentit dhe ishte e shtypur në certifikatat e shugurimit të Të Shtatëdhjetëve dhe te një banderolë e Shoqatës së Ndihmës. “Shenjtëri Zotit” duket se shfaqet gjithashtu mbi dritaret reklamuese të Institutit Tregtar Kooperativ të Sionit, dyqaneve të shitjes të ITKS-së. Ajo u gjet në kokën



e një çekani dhe në një daulle. “Shenjtëri Zotit” u skalit në dorezat metalike të shtëpisë së Presidentit Brigam Jang. Këto përmendje për shenjtërinë, në vende në dukje të pazakonta apo të papritura, mund të duken të papajteshme, por ato sugjerojnë thjesht se sa depërtues dhe i vazhdueshëm nevojitet të jetë përqendrimi ynë të shenjtëria.

Marrja e mishit të Shpëtimtarit dhe pirja e gjakut të Tij nënkupton që të nxjerrim nga jeta jonë çdo gjë që nuk është në përputhje me një karakter si të Krishtit dhe t’i bëjmë tonat cilësitë e Tij. Ky është kuptimi më i gjerë i pendimit: jo vetëm të largohesh nga mëkati i së shkuarës, por “një kthim i zemrës dhe i vullnetit ndaj Perëndisë”³³, duke shkuar përpara. Siç ndodhi me mikun tim në ëndrrën e tij zbuluese, Perëndia do të na tregojë të metat dhe dështimet tona, por Ai gjithashtu do të na ndihmojë që ta kthejmë dobësinë në forcë.³⁴ Nëse pyetim me çiltërsi: “Çfarë më mungon tjetër?”³⁵, Ai nuk do të na lërë të hamendësojmë, por me dashuri Ai do të na përgjigjet për hir të lumturisë sonë. Dhe Ai do të na japë shpresë.

Kjo është një përpjekje dërrmuese dhe do të ishte shumë e frikshme nëse në përpjekjet tona për shenjtëri ne do të ishim vetëm. E vërteta e lavdishme është që nuk jemi vetëm. Ne kemi dashurinë e Perëndisë, hirin e Krishtit, ngushëllimin dhe udhërrëfimin e

Shpirtit të Shenjtë, dhe shoqërimin e nxitjen e bashkëshenjtorëve në trupin e Krishtit. Le të mos jemi të kënaqur me vendin ku jemi, por as të mos shkurajohemi. Ashtu si na nxit një himn i thjeshtë, por plot mendim:

*Gjej koh’ të jesh i shenjtë, bota po nxiton;
vetëm me Jezusin më shumë koh’ kalo.
Si Ai do t’jesh, duke parë te Jezusi;
pamjen e Tij në sjelljen tënde tek ty
miqtë do shohin.*³⁶

Jap dëshmi për Jezu Krishtin, “buklën e gjallë që zbriti nga qielli”³⁷, dhe se “kush[do që] ha mishin [e Tij] dhe pi gjakun [e Tij], ka jetë të përjetshme”³⁸, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Gjoni 6:9.
2. Shih Gjoni 6:26.
3. Gjoni 6:27.
4. Gjoni 6:48–51.
5. Gjoni 6:52.
6. Gjoni 6:53–55.
7. Gjoni 6:56–57.
8. Gjoni 6:60, 66. Ndodhi në këtë rast që Shpëtimtari i pyeti Të Dymbëdhjetët e Tij: “A doni edhe ju të largoheni?” (Gjoni 6:67). Duke u përgjigjur për Të Dymbëdhjetët me besim të vendosur, Pjetri iu përgjigj: “Zot, te kush të shkojmë? Ti ke fjalë jete të përjetshme. Ne kemi besuar dhe kemi njohur se ti je Krishti, Biri i Perëndisë të gjallë” (Gjoni 6:68–69). Unë nuk e di nëse, në atë çast, Pjetri dhe vëllezërit e tij e kuptuan më mirë atë që Zoti po u mësonte sesa dishepujt që tani po e braktisnin

Mësuesin, por Pjetri e dinte me anë të dëshmisë së sigurt të Shpirtit se Jezusi ishte Krishti, Biri i Perëndisë së gjallë (shih edhe Mateu 16:15–17) dhe se shpëtimi nuk mund të gjendej askund tjetër. Prandaj, ai qe plotësisht i zotuar për ta ndjekur Jezusin pavarësisht nga ç’ndodhte. Nëse kishte pyetje, ato mund të zgjidheshin në kohën e duhur, por atij nuk do t’i prishej mendja që të largohej nga besnikëria ndaj Birit të Perëndisë – duke dhënë një shembull të mrekullueshëm për të gjithë ne.

9. Shih Lluka 22:44; Hebrejve 13:12; Mosia 3:7; 15:7–8; Alma 7:13; Doktrina e Besëlidhje 19:18; 38:4; 45:4–5.
10. 2 Nefi 31:17.
11. 2 Nefi 31:20–21.
12. Shih Gjoni 4:10.
13. Dallin H. Oaks, “Introductory Message” (fjalim i mbajtur në seminarin për presidentët e rinj të misionëve, 25 qershor 2017), f. 2.
14. Shih Moisiu 6:60.
15. 3 Nefi 27:19; shih edhe Moroni 10:32–33.
16. Mosia 3:19.
17. Efesianëve 4:13.
18. Shih Alma 22:18.
19. Letërkëmbim vetjak.
20. Gjoni 6:51.
21. 1 Pjetër 1:16.
22. Moisiu 6:57.
23. Shih Gjoni 6:56.
24. Shih Romakëve 12:1.
25. Shih Isaia 58:13.
26. *Teachings of Thomas S. Monson*, përp. Lynne F. Cannegieter (2011), f. 267.
27. Shih Joseph Smith Translation [Përkthimi prej Joseph Smith-it], Mateu 16:25–26 (te Mateu 16:24, shënimi e në fund të faqes); Lluka 9:23; 14:27–30; Joseph Smith Translation [Përkthimi prej Joseph Smith-it], Lluka 14:27–28 (te Lluka 14:27, shënimi b në fund të faqes); Joseph Smith Translation [Përkthimi prej Joseph Smith-it], Lluka 14:31 (te Lluka 14:30, shënimi a në fund të faqes).
28. Karol F. Mek-Konki, “Bukuria e Shenjtërisë”, *Liahona*, maj 2017, f. 10.
29. Mosia 2:17.
30. Marku 10:45; shih edhe Alma 34:28.
31. Marion G. Romney, “The Celestial Nature of Self-Reliance”, *Liahona*, mars 2009, f. 19.
32. Zakaria 14:20.
33. Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta, “Pendohem, Pendim”.
34. Shih Ethëri 12:27.
35. Mateu 19:20.
36. William D. Longstaff, “Take Time to Be Holy”, *The United Methodist Hymnal* (1989), nr. 395.
37. Gjoni 6:51.
38. Gjoni 6:54.



Nga Plaku Xhefri R. Holland,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve,

Jini, pra, të Përkryer – Përfundimisht

Nëse këmbëngulim, atëherë diku në përjetësi përsosja jonë do të jetë e përfunduar dhe e plotë.

Shkrimet e shenjta u shkruan për të na bekuar e nxitur, dhe sigurisht ato e bëjnë këtë gjë. Ne e falënderojmë qiellin për çdo kapitull e varg që na është dhënë ndonjëherë. Por a e keni vënë re që herë pas here do të shfaqet një fragment që na kujton se nuk *jemi* atje ku duhet? Për shembull, Predikimi në Mal fillon me lumturitë qetësuese, të dhembshura, por në vargjet që pasojnë, na thuhet – mes të tjerash – jo vetëm që të mos vrasim, por gjithashtu që as të mos zemërohem. Na thuhet që jo vetëm të mos shkelim kurorën, por gjithashtu që as të mos kemi mendime të padëlira. Atyre që e kërkojnë, ne duhet t'u japim tunikën tonë dhe më pas t'u japim edhe mantelin tonë. Duhet t'i duam armiqtë tanë, t'i bekojmë ata që na mallkojnë dhe t'u bëjmë mirë atyre që na urrejnë.¹

Nëse ky është leximi juaj i shkrimeve të shenjta në mëngjes dhe pas leximit pikërisht deri këtu ju jeni mjaft të sigurt që nuk do të merrni nota të mira në dëftesën tuaj të shkollës së ungjillit, atëherë urdhërimi i fundit në radhë me siguri që do t'i japë fund çështjes: “Jini, pra, të përkryer, ashtu siç është i përsosur Ati juaj . . . në qiej”².

Me këtë urdhërim përmbyllës, ne duam të shkojmë sërish në shtrat dhe ta mbulojmë edhe kokën. Synime të tilla celestiale duken përtej mundësive tona. Por sigurisht Zoti nuk do të na jepte kurrë një urdhërim që Ai e dinte se nuk mund ta zbatonim. Le të shohim se ku na çon kjo mëdyshje.

Në Kishë dëgjoj shumë veta që hasin vështirësi me këtë çështje: “Thjesht nuk jam i mirë aq sa duhet”. “Nuk jam atje ku duhet.” “Nuk do të jem kurrë në lartësinë e duhur.” E dëgjoj këtë nga



adoleshentët. E dëgjoj nga misionarët. E dëgjoj nga të kthyerit e rinj në besim. E dëgjoj nga ata që kanë qenë anëtarë gjithë jetën. Një shenjtorë mendjemprehtë e ditëve të mëvonshme, Motra Darla Ajzeksën, ka vërejtur se Satani në njëfarë mënyre ia ka dalë mbanë t'i bëjë besëlidhjet dhe urdhërimet të duken si mallkime dhe dënime. Për disa njerëz ai i ka kthyer idealet dhe frymëzimin e ungjillit në shkaktarë të urrejtjes së vetvetes dhe të mjerimit.³

Ajo që them tani në asnjë mënyrë nuk e mohoj apo zhvlerëson ndonjë urdhërim që Perëndia na ka dhënë në çdo kohë. Unë besoj në përsosurinë e Tij dhe e di se jemi bijtë dhe bijat e Tij shpirtërore, me potencial hyjnor që të bëhemi si është Ai. Gjithashtu e di se, si fëmijë të Perëndisë, ne nuk duhet ta ulim vlerën tonë ose ta kritikojmë ashpër veten tonë, a thua se ndëshkimi i vetvetes do të na bëjë në ndonjë mënyrë atë njeri që Perëndia dëshiron për ne që të bëhemi. Jo! Me një gatishmëri për t'u penduar dhe një dëshirë për më shumë drejtësi në zemrat tona gjithmonë, unë do të shpresoj që ne mund ta vazhdonim përmirësimin vetjak në një mënyrë që nuk përfshin shfaqjen e ulcerës apo të anoreksisë, ndjenjën e depresionit apo shkatërrimin e respektit për vetveten. Kjo *nuk* është ajo që Zoti dëshiron për fëmijët e Fillores apo për këdo tjetër që këndon me ndershmëri: “Përpiqem t'jem si Jezusi”⁴.

Për ta vendosur këtë çështje në kontekst, lejomëni t'ju kujtoj se jetojmë në një botë të rënë dhe tani për tani ne jemi një popull i rënë. Ne jemi në mbretërinë *telestiale*, që shkruhet me *t*, jo me *ç*. Siç na ka dhënë mësim Presidenti Rasëll M. Nelson, këtu në vdekshmëri përsosja është ende “e mbetur pezull”⁵.

Prandaj unë besoj se Jezusi nuk kishte për qëllim që predikimi i Tij mbi

këtë temë të ishte një çekan fjalësh që të na godiste për të metat tona. Jo, unë besoj se Ai kishte për qëllim që të ishte një nderim ndaj asaj se kush dhe çfarë është Perëndia, Ati i Amshuar, dhe se çfarë mund të arrijmë ne me Të në përjetësi. Megjithëkëtë, jam mirënjohës të di se pavarësisht nga papërsosuritë e mia, të paktën Perëndia është i përkryer – se të paktën Ai është, për shembull, i aftë që t'i dojë armiqtë e Tij, sepse shumë shpesh, për shkak të burrit dhe gruas “së natyrsh[me]”⁶ brenda nesh, unë dhe ju nganjëherë jemi ai armik. Sa mirënjohës jam që të paktën Perëndia mund t'i bekojë ata, të cilët e keqtrajtojnë Atë sepse, pa dashur ose pa e pasur qëllim që ta bëjmë këtë gjë, ne të gjithë e keqtrajtojmë Atë nganjëherë. Jam mirënjohës që Perëndia është i mëshirshëm dhe një paqebërës, sepse unë kam nevojë për mëshirë dhe bota ka nevojë për paqe. Sigurisht, gjithçka që e themi për virtytet e Atit, ne gjithashtu e themi për Birin e Tij të Vetëmlindur, i cili jetoi dhe vdiq me të njëjtën përsosje.

Nxitoj të them që përqendrimi tek arritjet e Atit dhe të Birit në vend të dështimeve tona, nuk na jep asnjë grimë shfajësimi për jetën e padisiplinuar apo uljen e nivelit të standardeve tona. Jo, që nga fillimi ungjilli ka qenë “për përsosjen e shenjtorëve, . . . derisa të arrijmë . . . te një njeri i përsosur, në masën e shtatit të plotësisë së Krishtit”⁷. Thjesht po sugjeroj se të paktën një qëllim i një shkrimi të shenjtë apo i një urdhërimi mund të jetë që të na kujtojë se sa madhështore është në të vërtetë “mas[a] e shtatit të plotësisë së Krishtit”⁸, duke ngjallur te ne një dashuri dhe admirim më të madh për Të dhe një dëshirë më të madhe për të qenë si Ai.

“Po, ejani te Krishti dhe përsosuni në të . . .”, lutet Moroni. “Ta doni



Perëndinë me gjithë fuqinë, mendjen dhe forcën tuaj, atëherë . . . me anë të hirit të tij ju mund të bëheni të përsosur në Krisht.”⁹ Shpresa jonë e vetme për përsosje të vërtetë është në pranimin e saj si një dhuratë nga qielli – ne nuk mund ta “fitojmë” atë. Prandaj, hiri i Krishtit na ofron jo vetëm shpëtim nga hidhërimi, mëkati dhe vdekja, por gjithashtu shpëtim nga kritika e vazhdueshme ndaj vetes.

Lejomëni të përdor një prej shembëlltyrave të Shpëtimtarit për ta thënë këtë në një mënyrë disi të ndryshme. Një shërbëtor i kishte borxh mbretit të tij një shumë prej 10000 talentash. Duke e dëgjuar përgjërimit e shërbëtorit për durim e mëshirë, “i shtyrë nga dhembshuria, zotëria i atij shërbëtori . . . ia fali detyrimin”. Por më pas, po ai shërbëtor nuk do ta falte një shërbëtor si ai vetë, i cili i kishte borxh 100 denarë. Kur e dëgjoi këtë, mbreti me pikëllim i tha atij, të cilin e kishte falur: “A nuk duhej të kishe mëshirë edhe ti për shokun tënd, ashtu si pata mëshirë unë për ty?”¹⁰

Ka njëfarë ndryshimi në mendim mes studiuesve, lidhur me vlerat monetare të përmendura këtu – dhe më falni që

po përdor vlerat monetare të SHBA-së – por për ta bërë të lehtë matematikën, në qoftë se borxhi më i vogël, i pafalur prej 100 denarësh do të ishte, të themi, 100 dollarë në kohën e sotme, atëherë borxhi prej 10000 talentash, i cili u fal kaq bujarisht, do t'i afrohej 1 miliard dollarëve – ose më shumë!

Si borxh vetjak, kjo është një shifër astronomike – tërësisht përtej kuptueshmërisë sonë. (Askush nuk mund të blejë aq shumë!) Epo, për qëllimet e kësaj shembëlltyre, ai hamendësohet të jetë i pakuptueshëm; hamendësohet të jetë përtej aftësisë sonë për ta marrë vesh, për të mos thënë që është përtej aftësisë sonë për ta ripaguar. Kjo është ngaqë ky nuk është një tregim në Dhiatën e Re rreth dy shërbëtorëve që po grinden. Ai është një tregim rreth nesh, familjes së rënë njerëzore – të gjithë borxhlinjve, shkelësve dhe të burgosurve në vdekshmëri. Çdokush prej nesh është borxhli dhe ndëshkimi ishte burgim për secilin prej nesh. Dhe atje do të kishim mbetur të gjithë ne nëse nuk do të ishte për hirin e një Mbreti, i cili na çliron ngaqë Ai na do dhe “nxitet me pasion kundrejt nesh”¹¹.



Jezusi përdor një njësi matëse të papërfytyrueshme këtu, sepse Shlyerja e Tij është një dhuratë e papërfytyrueshme, e dhënë me një çmim të paimagjinueshëm. Kjo, më duket mua, është së paku pjesë e domethënies që lidhet me urdhrin e Jezusit për të qenë të përkryer. Ne mund të mos jemi ende në gjendje të shfaqim një përsosje prej 10000 talentash që Ati dhe Biri e kanë arritur, por *nuk* është shumë për Ta për të na kërkuar që të jemi pak më të perëndishëm në gjëra të vogla, që të flasim e veprojmë, duam e falim, pendo kemi e përmirëso kemi të paktën në nivelin e përsosjes prej 100 denarësh, gjë e cila është qartësisht brenda aftësisë sonë për ta bërë.

Vëllezërit dhe motrat e mia, përveç Jezusit, nuk ka pasur asnjë shfaqje pa të meta në këtë udhëtim tokësor që po kryejmë, prandaj ndërsa jemi në vdekshmëri, le të përpiqemi fort për një përmirësim të vazhdueshëm, por pa na u kthyer në mani ajo që hulumtuesit e sjelljes e quajnë “përsosuri e helmatisur”¹². Ne duhet ta shmangim atë pritshmëri të tepërt, të sapopërmendur për veten dhe për të tjerët e, mund të shtoj, për ata që thirren për të shërbyer në Kishë – që për shenjtoret e ditëve të mëvonshme do të thotë *çdonjëri*, pasi ne të gjithë thirrëmi për të shërbyer diku.

Lidhur me këtë, Leon Tolstoi shkroi dikur për një prift, i cili u kritikua nga

një njeri në bashkësinë e vet ngaqë nuk po jetonte me aq vendosmëri sa duhej, dhe kritikuesi po arrinte në përfundimin se edhe parimet që jepeshin mësim nga predikuesi që gabonte, duhej të ishin si rrjedhim të gabuara.

Në përgjigje të asaj kritike, prifti thotë: “Vështroje jetën time tani dhe krahasoje atë me jetën time të mëparshme. Do ta shihni se po përpiqem të jetoj të vërtetën që po shpall.” I paaftë që të jetonte sipas idealeve më të larta që jepte mësim, prifti e pranon se ka dështuar. Por ai thërret:

“Më sulmoni [nëse doni], këtë e bëj dhe vetë, por [mos] sulmoni . . . shtegun që unë ndjek. . . . Nëse e di udhën për në shtëpi, [por] eci përgjatë saj i dehur, a s’është ajo udha e duhur thjesht ngaqë më shkojnë këmbët sa andej-këndej?

. . . Mos bërtitni gjithë gaz: ‘Shiheni atë! . . . Ja ku është duke u zvarritur në moçal!’ Jo, mos vështroni me dashakeqësi, por jepini . . . ndihmën tuaj [kujtdo që përpiqet të ecë në udhën e kthimit të Perëndia].”¹³

Vëllezër e motra, secili prej nesh dëshiron një jetë më të mirë si e Krishtit, sesa ajo që shpesh ia dalim të jetojmë. Nëse e pranojmë këtë gjë me ndershmëri dhe përpiqemi të përmirësohemi, nuk jemi hipokritë; jemi njerëzorë. Mos pranofshim t’i lejojmë marrëzitë tona si njerëz të vdekshëm dhe të metat e pashmangshme edhe të burrave e grave më të mira përreth nesh, që të na bëjnë cinikë rreth të vërtetave të ungjillit, vërtetësisë së Kishës, shpresës sonë për të ardhmen tonë ose rreth mundësisë së perëndishmërisë! Nëse këmbëngulim, atëherë diku në përjetësi përsosja jonë do të jetë e përfunduar dhe e plotë – që është kuptimi i Dhiatës së Re për *përkryerjen*.¹⁴

Unë dëshmoj për atë fat të madhërishtëm, të vënë në dispozicion për ne

nëpërmjet Shlyerjes së Zotit Jezu Krisht, i cili Vetë vazhdoi “nga hiri në hir”¹⁵ derisa në pavdekësinë e Tij¹⁶ mori një plotësi të përkryer të lavdisë çelestiale.¹⁷ Unë dëshmoj se në këtë orë dhe në çdo orë Ai, me duart e tij të shenjura nga gozhdët, është duke na dhënë të njëjtin hir, duke mos na braktisur dhe duke na dhënë zemër, duke mos pranuar të na lejojë të shkëputemi derisa të kthehemi të sigurt në shtëpi, në përqaftimin e Prindërve Qiellorë. Për një çast të tillë, vazhdoj të përpiqem fort, edhe pse me ngathtësi. Për një dhuratë të tillë të përkryer, unë vazhdoj të jap falënderime, edhe pse papërshtatshmërisht. E bëj këtë gjë pikërisht në emrin e Përsosurisë vetë, të Atij që nuk ka qenë kurrë i ngathët apo i papërshtatshëm, por që na do ne të gjithëve që jemi të tillë, madje Zotit Jezu Krisht, amen. ■

SHËNIME

1. Shih Mateu 5:1–47.
2. Mateu 5:48.
3. Shih Darla Isackson, “Satan’s Counterfeit Gospel of Perfectionism”, *Meridian Magazine*, 1 qershor 2016, ldsomag.com.
4. “I’m Trying to Be like Jesus” [“Përpiqem t’jam si Jezusi”], *Children’s Songbook*, f. 78–79.
5. Shih Russell M. Nelson, “Perfection Pending”, *Ensign*, nëntor 1995, f. 86–88.
6. Mosisa 3:19.
7. Efesianëve 4:12–13.
8. Efesianëve 4:13.
9. Moroni 10:32; theksimi i shtuar.
10. Shih Mateu 18:24–33.
11. Doktrina e Besëlidhje 121:4.
12. Shih Joanna Benson dhe Lara Jackson, “Nobody’s Perfect: A Look at Toxic Perfectionism and Depression”, *Millennial Star*, 21 mars 2013, millennialstar.org.
13. “The New Way”, *Leo Tolstoy: Spiritual Writings*, përzgji. Charles E. Moore (2006), f. 81–82.
14. Për një shpjegim të kuptimit të fjalës greke të përdorur në Dhiatën e Re për *i përsosur* (“teleios”), shih fjalimin e Presidentit Rasëll M. Nelson në konferencën e përgjithshme të tetorit 1995 “Perfection Pending” (*Ensign*, nëntor 1995, f. 86–87).
15. Doktrina e Besëlidhje 93:13.
16. Shih Lluca 13:32.
17. Shih Doktrina e Besëlidhje 93:13.



Paraqitur nga Presidenti Henri B. Ajring,
Këshilltar i Parë në Presidencën e Parë

Mbështetja e Drejtuesve të Kishës

Vëllezër dhe motra, unë tani do t'ju paraqit Autoritetet e Përgjithshme, Të Shtatëdhjetët Zonalë dhe Presidencat e Përgjithshme të Organizatave Ndihmëse të Kishës për votën tuaj mbështetëse.

Propozohet që ne të mbështetim Tomas Spenser Monsonin si profet, shikues dhe zbulues, dhe si President të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme; Henri Benion

Ajringun si Këshilltar të Parë në Presidencën e Parë; dhe Diter Fridrih Uhtdorfin si Këshilltar të Dytë në Presidencën e Parë.

Ata që janë dakord, mund ta shfaqin atë.

Ata që janë kundër, nëse ka, mund ta tregojnë atë.

Propozohet që ne të mbështetim Rasëll Marion Nelsonin si President të Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

dhe ata që vijojnë, si anëtarë të atij Kuorumi: Rasëll M. Nelson, Dallin H. Ouks, M. Rasëll Ballard, Robert D. Hejls, Xhefri R. Holland, Dejvid A. Bednar, Kuentin L. Kuk, D. Tod Kristoferson, Nil L. Andersen, Ronald A. Rasband, Geri E. Stivenson dhe Dejll G. Renland.

Atyre që janë dakord, u lutemi ta shfaqin.

Ndonjë kundër, mund ta tregojë po ashtu.

Propozohet që ne t'i mbështetim këshilltarët në Presidencën e Parë dhe Kuorumin e Dymbëdhjetë Apostujve si profetë, shikues e zbulues.

Të gjithëve që janë dakord, u lutemi ta shfaqin.

Kundër, në qoftë se ka, me të njëjtën shenjë.

Pleqtë Donald L. Hallstrom dhe Riçard J. Meinis janë liruar nga shërbimi si anëtarë të Presidencës së Të Shtatëdhjetëve.

Të gjithë ata që dëshirojnë t'u tregojnë vlerësim këtyre Vëllezërve për shërbimin që kanë kryer, mund ta bëjnë këtë duke ngritur dorën.

Propozohet që t'i mbështetim Pleqtë Huan A. Uceda dhe Patrik Kiëron, të cilët janë thirrur të shërbejnë si anëtarë të Presidencës së Të Shtatëdhjetëve.

Atyre që janë të gatshëm t'i mbështetin këta Vëllezër në detyrat e tyre të reja, u lutemi ta shfaqin.

Ndonjë që është kundër, mund ta tregojë me të njëjtën shenjë.

Propozohet që t'i lirojmë nga thirrja me vlerësim për shërbimin e tyre të përkushtuar Pleqtë Stenli G. Ellis, Leri R. Lorens dhe W. Krejg Zuik si Autoritete të Përgjithshme Të Shtatëdhjetë dhe t'u japim atyre pozicion nderi.

Atyre që dëshirojnë të bashkohen me ne për t'u shprehur mirënjohje këtyre Vëllezërve për shërbimin e tyre të shquar, u lutemi ta shfaqin.





Nga Plaku Geri E. Stivenson,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Propozohet që t'i lirojmë sa vijojnë nga thirrjet si Të Shtatëdhjetë Zonalë: Pedro U. Aduru, Detlef H. Adler, Anhel H. Alarkon, Uinsor Balderrama, Robert M. Koll, Kristofer Çarls, Xhene R. Çidester, Ralf L. Dusnap, Anhel A. Duarte, Piter F. Evans, Francisko D. N. Granha, Jurij A. Gushçin, Kliford T. Herbertson, Aniefiok Udo Injon, Luis M. Leal, Alehandro Lopez, L. Zhan-Klod Mabaja, Deklan O. Madu, Aleksander T. Mestre, Jared R. Okampo, Endrju M. O'Riordan, Hesus A. Ortiz, Abenir V. Paharo, Siu Hong Pon, Robert C. Rien, Horge Luis Romeu, Horge L. Saldivar, Siro Shmail, Alin Spanaus, Moroni B. Torgan, Stiven L. Toronto dhe Rikardo Vajadares.

Ata që dëshirojnë të bashkohen me ne për t'u shprehur vlerësimin për shërbimin e tyre të shkëlqyer, u lutemi ta shfaqin.

Propozohet që ta mbështetim Torben Engbjergun që të shërbejë si I Shtatëdhjetë Zonal.

Të gjithëve që janë dakord, u lutemi ta shfaqin.

Ata që janë kundër, nëse ka.

Propozohet që ne t'i mbështetim Autoritetet e tjera të Përgjithshme, Të Shtatëdhjetë Zonalë dhe Presidencat e Përgjithshme të Organizatave Ndhmëse me përbërjen e tyre të tanishme.

Të gjithëve që janë dakord, u lutemi ta shfaqin.

Kundër, në qoftë se ka, me të njëjtën shenjë.

Ata që ishin kundër ndonjërit prej propozimeve, duhet të vihen në kontakt me presidentët e tyre të kunjeve.

Vëllezër dhe motra, ne jemi mirënjohës për besimin dhe lutjet tuaja të vazhdueshme në emrin e udhëheqësve të Kishës. ■

Eklipsi Shpirtëror

Mos i lejoni shpërqendrimet e jetës që ta eklipsojnë dritën e qiellit.

Më 21 gusht të këtij viti ndodhën dy ngjarje të rralla, të cilat tërhoqën vëmendjen e njerëzve anembanë botës. E para ishte kremtimi i ditëlindjes së 90-të të profetit tonë të dashur, Presidentit Tomas S. Monson. Në atë kohë, isha me një detyrë në Zonën e Paqësorit dhe u emocionova që shenjtoret në Australi, Vanuatu, Zelandën e Re dhe Polinezinë Franceze jo vetëm që ishin në dijeni për këtë ngjarje të tij të shënuar vetjake, por gjithashtu ngazëlleshin në kremtimin e saj. U ndjeva me fat të dëgjoja shprehjet e tyre të ngrohta të besimit e të dashurisë për këtë burrë të madhërisëm. Çfarë frymëzimi është ta shohësh lidhjen që kanë shenjtoret e ditëve të mëvonshme me profetin e tyre.

Sigurisht, Presidenti Monson, i vëmendshëm ndaj atyre që dëshironin

t'i uronin atij një ditëlindje të lumtur, përshkroi një dhuratë ideale ditëlindjeje: "Gjeni dikë, i cili po kalon një kohë të vështirë apo që është i sëmurë ose i vetmuar, dhe bëni diçka për të. Kjo është gjithë çka do të kërkoja."¹ Ne ju duam dhe ju mbështetim, Presidenti Monson.

Eklipsi Diellor

Ngjarja tjetër e rrallë dhe qiellore që ndodhi në të njëjtën ditë dhe që magjepsi miliona njerëz anembanë botës, ishte një eklips i plotë diellor. Kjo ishte hera e parë në 99 vjet që një eklips i tillë kishte kaluar përmes gjithë Shteteve të Bashkuara.² A keni parë ndonjëherë një eklips diellor? Ndoshta mund ta përshkruaj këtë me më shumë hollësi.

Një eklips i plotë diellor ndodh kur hëna lëviz ndërmjet tokës e diellit, duke e bllokuar pothuajse tërësisht çfarëdo drite nga sipërfaqja e diellit.³ Fakti që kjo mund të ndodhë, është një çudi për mua. Nëse e përfytyroni diellin të kishte madhësinë e një rrote të zakonshme biçiklete, hëna, në krahasim me të, mezi do të kishte madhësinë e një guraleci të vogël.

Si është e mundur që burimi i vërtetë i ngrohtësisë, dritës e jetës sonë mund të mbulohej kaq shumë nga diçka relativisht e parëndësishme në madhësi?

Edhe pse dielli është 400 herë më i madh se hëna, ai është gjithashtu 400



herë më larg nga toka.⁴ Nga këndvështrimi i tokës, kjo geometri i bën diellin dhe hënën të shfaqen sikur janë të së njëjtës madhësi. Kur që të dy vendosen në vijë të drejtë, hëna duket se e errëson të gjithë diellin. Miq dhe familjarë të mitë, të cilët ishin në zonën e eklipsit të plotë, përshkruan se si drita u zëvendësua nga errësira, u shfaqën yjet dhe zogjtë e ndalën këngën. Ajri u bë i ftohtë ngaqë temperatura në një eklips mund të zbrësë me më shumë se 11 gradë Celsius.⁵

Ata përshkruan një ndjenjë mahnitjeje, habie dhe madje ankthi, duke e ditur se një eklips sjell rreziqe të caktuara. Megjithëkëtë, të gjithë ata ushtruan kujdes për të parandaluar dëmtimin e përhershëm të syve ose “verbërinë eklipsore” gjatë ngjarjes së eklipsit. Siguria u bë e mundur pasi ata vunë syze të pajisura me lente të veçanta filtruese, që i mbrojnë sytë nga ndonjë dëmtim i mundshëm.

Analogjia

Në të njëjtën mënyrë që hëna shumë e vogël mund ta bllokojë diellin madhështor, duke e shuar dritën dhe ngrohtësinë e tij, një eklips *shpirtëror* mund të ndodhë kur ne lejojmë pengesa të vogla dhe shqetësuese – ato që i ndeshim në jetën tonë të përditshme – të na afrohen kaq pranë sa ta bllokojnë madhështinë, shkëlqimin, ngrohtësinë e dritës së Jezu Krishtit dhe të ungujllit të Tij.

Plaku Nil A. Maksuell e çoi këtë analogji edhe më tej kur tha: “Edhe diçka aq e vogël sa gisht i madh i një njeriu, kur mbahet shumë pranë syrit, mund ta verbojë atë ndaj diellit shumë të madh. Prapëseprapë dielli është ende atje. Verbëria shkaktohet nga njeriu vetë. Kur afrojmë gjëra të tjera shumë pranë, duke i vendosur ato të parat, ne e errësojmë largpamësinë tonë për qiellin.”⁶



Natyrisht, askush prej nesh nuk dëshiron që ta errësojë largpamësinë tonë për qiellin qëllimisht apo të lejojë të ndodhë në jetën tonë një eklips shpirtëror. Lejomëni të jap disa ide që mund të na ndihmojnë për ta parandaluar eklipsin shpirtëror që të na shkaktojë dëmtim të përhershëm shpirtëror.

Syzet Ungjillore: Ruani një Këndvështrim Ungjillor

A ju kujtohet përshkrimi im i syzeve të veçanta, të përdorura për t'i mbrojtur ata që shohin një eklips diellor prej dëmtimit të syve apo madje verbërisë nga eklipsi? Të shikuarit e një eklipsi shpirtëror përmes lentave mbrojtëse dhe zbutëse të Shpirtit siguron një këndvështrim ungujllor, duke na mbrojtur në këtë mënyrë nga errësira shpirtërore.

Le të marrim në shqyrtim disa shembuj. Me fjalët e profetëve në zemrat tona dhe me Shpirtin e Shenjtë si këshilluesin tonë, ne mund ta vështrojmë dritën pjesërisht të bllokuar qiellore përmes “syzeve ungujllore”, duke iu shmangur dëmtimit të një eklipsi shpirtëror.

Pra, si i vëmë syzet ungujllore? Ja disa shembuj: Syzet tona ungujllore na informojnë se Zoti dëshiron që ne të marrim pjesë në sakrament çdo javë dhe se Ai dëshiron që ne t'i studiojmë shkrimet e shenjta dhe të kemi lutje të përditshme. Ato gjithashtu na njoftojnë se Satani do të na tundojë që të mos i bëjmë ato gjëra. Ne e dimë se plani i tij kërkon ta heqë lirinë tonë të zgjedhjes nëpërmjet shpërqendrimeve dhe tundimeve nga bota. Edhe në kohën e Jobit,

ndoshta pati disa njerëz që po përjetonin një eklips shpirtëror, të përshkruar si: “Gjatë ditës ata hasin në errësirë, bash në mesditë [dhe] ecin me tahmin sikur të ishte natë”⁷.

Vëllezër dhe motra, kur flas për shikimin përmes syzeve ungujllore, ju lutem të dini se nuk po sugjeroj që të mos i njohim apo diskutojmë sfidat që hasim, ose që të ecim në mosnjohje të hareshme të kurtheve dhe ligësive që armiku ka vendosur përpara nesh. Nuk po them që të vendosim kufizues të shikimit – por pikërisht të kundërtën. Po sugjeroj që ne t'i shohim sfidat përmes lentave të ungujllit. Plaku Dallin H. Ouks vërejtë se “këndvështrimi është aftësia për ta parë të gjithë informacionin domethënës në një marrëdhënie të dobishme”⁸. Një këndvështrim i ungujllit e zgjeron shikimin tonë drejt një pamjeje të përjetshme.

Kur i vini syzet ungujllore, ju gjeni këndvështrim, përqendrim e largpamësi të përmirësuar lidhur me mënyrën se si mendoni rreth përparësive tuaja, problemeve tuaja, tundimeve tuaja dhe madje gabimeve tuaja. Do të shihni dritë më të shndritshme, të cilën nuk mund ta shihnit pa to.

Si për ironi, nuk janë vetëm gjërat negative që mund të shkaktojnë një eklips shpirtëror në jetën tonë. Shpesh orvatje të admirueshme ose pozitive, të cilave ua përkushtojmë veten tonë, mund të afrohen kaq pranë sa që e bllokojnë dritën e ungujllit dhe sjellin errësirë. Këto rreziqe ose shpërqendrim mund të përfshijnë arsimimin dhe mirëqenien, pushtetin dhe ndikimin, ambicien, madje talentet dhe dhuntitë.

Presidenti Diter F. Uhtdorf na ka mësuar se “çdo virtyt, kur çohet në skaj, mund të shndërrohet në ves. . . . Vjen një pikë ku synimet mund të bëhen si gurë mulliri dhe ambiciet, si mokra që na varen në qafë.”⁹

Lejomëni të tregoj më me hollësi shembuj që mund të bëhen përshpejtues për t'i shmangur vetë eklipsët tona shpirtërore.

Mediat Shoqërore

Disa muaj më parë fola në Konferencën e Grave në UBJ.¹⁰ Unë përshkrova se si teknologjia, përfshirë mediat shoqërore, e lehtësojnë shpërndarjen e “njohuri[së për] një Shpëtimtar . . . mes çdo kombi, fisi, gjuhe dhe populli”¹¹. Këto teknologji përfshijnë faqe interneti të Kishës, si LDS.org dhe Mormon.org; programet për telefonat celularë, të tilla si Gospel Library, Mormon Channel, LDS Tools e Family Tree; dhe platformat e mediave shoqërore, përfshirë Facebook, Instagram, Twitter dhe Pinterest. Këto programe kanë krijuar qindra mijëra pëlqime, shpërndarje, shikime e ridërgime të mesazheve në Twitter e Pinterest dhe janë bërë shumë frytdhënëse dhe të efektshme për ndarjen e ungjillit me familjen, miqtë dhe bashkëpunëtorët.

Pavarësisht nga të gjitha anët pozitive dhe përdorimi i duhur i këtyre teknologjive, ka rreziqe që lidhen me to që, kur vendosen shumë pranë, mund të na vendosin në një eklips shpirtëror dhe ka të ngjarë që ta bllokojnë shkëlqimin dhe ngrohtësinë e ungjillit.

Përdorimi i mediave shoqërore, programeve për telefonat celularë dhe lojërave mund të jetë humbje e jashtëzakonshme kohe dhe mund ta pakësojë ndërveprimin e njerëzve ballë për ballë. Kjo humbje e bashkëbisedimit vetjak mund të ndikojë te martesat, të zërë vendin e praktikave të vlefshme shpirtërore dhe ta ndrydhë zhvillimin e aftësive shoqërore, veçanërisht mes rinisë.

Dy rreziqe shtesë që lidhen me mediat shoqërore, janë realiteti i idealizuar

dhe krahasimet ligështuese.

Shumë (në mos shumica) prej fotografive të vendosura në mediat shoqërore priren që ta portretizojnë jetën në më të mirën e saj – shpesh në mënyrë jorealiste. Që të gjithë kemi parë fotografi të bukura të zbukurimeve të shtëpisë, vendeve të mrekullueshme të pushimeve, të selfi-ve [fotografive të vetes] plot buzëqeshje, të përgatitjes së ushqimeve të ndërlikuara dhe pamjeve të trupave në dukje të paarritshëm.

Ja, për shembull, një fotografi që mund ta keni parë në llogarinë e dikujt në mediat shoqërore. Megjithatë, ajo nuk tregon mjaftueshëm pamjen *e plotë* të asaj që po ndodh *vërtet* në jetën reale.

Krahasimi i ekzistencës sonë që në dukje është e nivelit mesatar, me atë të të tjerëve të ndryshuar me mjeshtëri të përsosur për t'u dukur e bukur, siç paraqitet në mediat shoqërore, mund të na lërë me ndjenja shkurajimi, zilie dhe madje dështimi.

Dikush që ka treguar afishe të shumta të vetes së saj, mbase duke bërë ca shaka, tha: “Ç’kuptim ka të jesh i lumtur nëse nuk do ta tregosh në mediat shoqërore?”¹²

Sikurse na e kujtoi Motra Boni L. Oscarson këtë mëngjes, sukcesi në jetë nuk vjen nga sasia e pëlqimeve që marrim apo sasia e miqve apo ndjekësve që kemi në rrjetet e mediave shoqërore. Sidoqoftë, kjo vërtet ka të bëjë disi me lidhjen në mënyrë domethënëse me të tjerët dhe shtimin e dritës në jetën e tyre.

Fatmirësisht, ne mund të mësojmë që të jemi më të vërtetë, të gjejmë më shumë humor dhe të përjetojmë më pak shkurajim kur përballemi me pamje që mund ta paraqitin realitetin e idealizuar dhe që shumë shpesh çojnë drejt krahasimeve ligështuese.



Krahasimi siç duket nuk është vetëm një shenjë e kohëve tona, por ishte një

shenjë edhe në të shkuarën. Apostulli Pal i paralajmëroi njerëzit e kohës së tij që “ata, duke matur veten e tyre dhe duke u krahasuar me veten e tyre, nuk kanë mend”¹³.

Me kaq shumë përdorime të duhura dhe frymëzuese të teknologjisë, le ta përdorim atë për të dhënë mësim, për ta frymëzuar e lartësuar veten tonë dhe për t'i nxitur të tjerët që të bëhen më të mirët – në vend që ta portretizojmë veten tonë virtuale të idealizuar. Gjithashtu le t'i mësojmë dhe tregojmë brezit të ri përdorimin e drejtë të teknologjisë dhe le ta paralajmërojmë kundër rreziqeve që lidhen me të, dhe kundër përdorimit shkatërrues të saj. Shikimi i mediave shoqërore përmes lenteve të ungjillit mund ta pengojë atë që të bëhet eklips shpirtëror në jetën tonë.

Krenaria

Tani le të flasim për pengesën e lashtë të krenarisë. Krenaria është e kundërta e përlulësisë, e cila është një “gatishmëri për t’u nënshtruar vullnetit të Zotit”¹⁴. Kur jemi krenarë, ne priremi t’i japim



Imazhi i publikuar në median shoqërore nuk e kishte treguar tërë pamjen se çfarë po ndodhte faktikisht në jetën e vërtetë.

nderim vetvetes në vend që t'u japim nderim të tjerëve, përfshirë Zotin. Krenaria shpesh është konkurruese; është një prirje për t'u përpjekur që të fitojmë më shumë dhe të hamendësojmë se jemi më të mirë se të tjerët. Krenaria shpesh përfundon në ndjenja zemërimi dhe urrejtjeje; e bën dikë që të mbajë mëri ose të mos falë. Megjithatë, krenaria mund të përpiket nga cilësia e përlulesisë si ajo që kishte Krishti.

Marrëdhëniet, edhe me të afërm të familjes dhe njerëz të tjerë të dashur, *veçanërisht* me të afërm të familjes dhe njerëz të tjerë të dashur – madje midis bashkëshortëve e bashkëshorteve – zhvillohen nga përlulesia dhe prishen nga krenaria.

Shumë vite më parë, një drejtues i një kompanie të madhe dyqanesh më mori në telefon që të flisnim rreth kompanisë së tij, e cila po blihej nga njëri prej konkurrentëve të tij. Ai dhe shumë të tjerë nga personeli drejtues ishin jashtëzakonisht të shqetësuar se mund t'i humbnin vendet e tyre të punës. Duke e ditur se i njihja mirë drejtuesit kryesorë të kompanisë blerëse, ai më pyeti nëse do të isha i gatshëm ta paraqitja atë, si edhe të jepja një përshtypje të mirë për të, madje të organizoja një takim për të. Më pas ai e mbylli me thënien vijuese: "Ju e dini se ç'thonë? 'Zemërbutët do të mbarojnë!'"

E kuptova që komenti i tij kishte më shumë të ngjarë të ishte për humor. E kuptova shakanë. Por pati një parim të rëndësishëm që e ndjeva se në fund të fundit mund të ishte i dobishëm për të. U përgjigja: "Në të vërtetë, nuk është ajo që thonë. Në fakt, është pikërisht e kundërta. Ajo që thonë është se 'zemërbutët[t] . . . do ta trashëgojnë tokën'¹⁵".

Në përvojën time në Kishë, si edhe gjatë gjithë karrierës sime profesionale, disa nga njerëzit më të mrekullueshëm, më frydhënës që kam njohur, kanë

qenë mes më zemërbutëve dhe më të përlulurve.

Përlulesia dhe zemërbutësia lidhen si mishi me thuan. Kujtofshim se "askush nuk pranohet para Perëndisë, në qoftë se nuk është i bindur dhe i përlulur në zemër"¹⁶.

Lutem që ne do të përpiqemi fort për ta shmangur eklipsin shpirtëror të krenarisë duke e përqaftuar virtytin e përlulesisë.

Përfundimi

Në përfundim, një eklips diellor është me të vërtetë një fenomen mbresëlënës i natyrës gjatë të cilit bukuria, ngrohtësia dhe drita e diellit mund të mbulohet tërësisht nga një objekt relativisht i parëndësishëm, duke shkaktuar errësirë dhe ftohtësi.

Një fenomen i ngjashëm mund të përsëritet nga një pikëpamje shpirtërore, kur çështje që përndryshe do të ishin të vogla dhe të parëndësishme, afrohen shumë pranë dhe e bllokojnë bukurinë, ngrohtësinë dhe dritën qiellore të ungjillit të Jezu Krishtit, duke e zëvendësuar atë me një errësirë të ftohtë.

Syzet e krijuara për ta mbrojtur shikimin e njerëzve në zonën e një eklipsi të plotë diellor, mund ta parandalojnë dëmtimin e përhershëm dhe madje verbërinë.¹⁷ Syzet e ungjillit, të përbëra nga një njohuri dhe dëshmi për parimet dhe ordinancat e ungjillit, sigurojnë një këndvështrim të ungjillit i cili mund të sigurojë në mënyrë të ngjashme mbrojtje dhe qartësi më të madhe shpirtërore për dikë që qëndron i zbuluar ndaj rreziqeve të një eklipsi shpirtëror.

Nëse zbuloni diçka që duket se po e bllokoi gëzimin dhe dritën e ungjillit në jetën *tuaj*, unë ju ftoj ta shihni sipas një këndvështrimi ungjillor. Shihni përmes një lenteje të ungjillit dhe jini vigjilentë që të mos i lejoni çështje të parëndësishme ose të paqëndrueshme në jetë

t'uua errësojnë pamjen tuaj të përjetshme të planit të madh për lumturinë. Shkurtimeisht, mos i lejoni shpërqendrimet e jetës që ta eklipsojnë dritën e qiellit.

Dëshmia

Unë dëshmoj se, pavarësisht nga pengesa që mund ta bllokojë pamjen tonë të dritës së ungjillit, drita është ende atje. Ai burim i ngrohtësisë, së vërtetës dhe shkëlqimit është ungjilli i Jezu Krishtit. Unë jap dëshmi për një Atë të dashur Qiellor, për Birin e Tij, Jezu Krishtin, dhe për rolin e Birit si Shpëtimtari dhe Shëlbuesi ynë. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Thomas S. Monson, në Sarah Jane Weaver, "What Gift Does President Monson Want for His 90th Birthday?" *Deseret News*, 17 gusht 2017, deseretnews.com.
2. Shih Christina Zdanowicz dhe Judson Jones, "An Eclipse Will Cross the US for the First Time in 99 Years", 24 korrik 2017, cnn.com.
3. Shih "Eclipse: Who? What? Where? When? and How?" eclipse2017.nasa.gov.
4. Shih EarthSky in Space, "Coincidence That Sun and Moon Seem Same Size?" earthsky.org.
5. Shih Brian Lada, "5 Surprising Effects the Total Solar Eclipse Will Have besides Darkness", accuweather.com.
6. Neal A. Maxwell, *Of One Heart: The Glory of the City of Enoch* (1975), f. 19.
7. Jobi 5:14.
8. Dallin H. Oaks, fjalim i paraqitur në takimin shpirtëror të Kunjit Bonëvill për të Rinjtë Beqarë në Moshë Madhore, Solt-Lejk-Siti, Juta, 8 shkurt 2015.
9. Diter F. Uhtdorf, "Për Gjërat që Kanë më Shumë Rëndësi", ose *Liahona*, nëntor 2010, f. 20.
10. Shih Gary E. Stevenson, "The Knowledge of a Savior" (Konferenca e Grave në Universitetin "Brigam Jang", 5 maj 2017).
11. Mosia 3:20.
12. Jade, "The Obsession of Creating a Picture-Perfect Life on Social Media".
13. 2 Korintasve 10:12.
14. Shih *Predikoni Ungjillin Tim: Një Udhëzues për Shërbimin Misionar* (2005), f. 124–125.
15. Mateu 5:5; 3 Nefi 12:5
16. Moroni 7:44.
17. Shih "Solar Eclipse and Your Eyes", preventblindness.org.



Nga Stiven W. Ouen,
President i Përgjithshëm i Të Rinjve

Pendimi Është Gjithmonë Pozitiv

Në çastin kur vëmë këmbën në shtegun e pendimit, ne ftojmë fuqinë shëlbuese të Shpëtimtarit në jetën tonë.

Disa vite më parë, Presidenti Gordon B. Hinkli ishte i pranishëm në një ndeshje futbollit amerikan midis kolegjes. Ai ndodhej atje për të njoftuar se stadiumi do të merrte emrin e trajnerit, për një kohë të gjatë, shumë të dashur të skuadrës, i cili po dilte në pension. Skuadra donte skajshëm ta fitonte ndeshjen për të nderuar trajnerin e saj. Gjatë pjesës së parë, Presidentin Hinkli e ftuan të vizitonte dhomën e lojtarëve dhe t'u thoshte disa fjalë nxitëse. Frymëzuar nga fjalët e tij, ajo skuadër në atë ditë shkoi për ta fituar atë lojë dhe e mbylli sezonin me një rekord fitoresh.

Sot, do të doja t'u flisja atyre që mund të jenë të shqetësuar ngaqë nuk po fitojnë në jetë. E vërteta është, sigurisht, se “të gjithë mëkatuan dhe u privuan nga lavdia e Perëndisë”¹. Ndërkohë që mund të ketë sezone pa humbje në sporte, në jetë nuk ka asnjë. Por unë dëshmoj se Shpëtimtari Jezhu Krisht kreu një Shlyerje të përsosur dhe na dha dhuratën e pendimit – shtegun tonë për t'u kthyer te një ndriçim i përkryer i shpresës dhe një jetë fitimtare.

Pendimi Sjell Lumturi

Tepër shpesh ne e mendojmë pendimin si diçka të mjerë dhe shtypëse. Por plani i Perëndisë është plani i lumturisë, jo plani i mjerimit. Pendimi është lartësues dhe fisnikëruës. Është mëkati që sjell palumturi.² Pendimi është udha jonë e shpëtimit! Sikurse e shpjegoi Plaku D. Tod Kristoferson: “Pa pendim nuk ka përparim ose përmirësim të

vërtetë në jetë. . . . Vetëm nëpërmjet pendimit ne fitojmë të drejtën për hirin shlyes të Jezhu Krishtit dhe për shpëtim. Pendimi . . . na drejton te liria, vetëbesimi dhe paqja.”³ Mesazhi im për të gjithë – posaçërisht për rininë – është se pendimi është gjithmonë pozitiv.

Kur flasim për pendimin, ne nuk po flasim thjesht për përpjekje vetëpërmirësimi. Pendimi i vërtetë është më shumë se kjo – ai frymëzohet nga besimi në Zotin Jezhu Krisht dhe nga fuqia e Tij për të falur mëkatet tona. Plaku Dejll G. Renland na ka mësuar: “Pa Shëlbuesin, . . . pendimi bëhet thjesht një sjellje e mjerë modifikimi”⁴. Ne mund të përpiqemi ta ndryshojmë vetë sjelljen tonë, por vetëm Shpëtimtari mund të na i heqë njollat dhe të ngrejë barrët tona, duke na aftësuar që ta ndjekim shtegun e bindjes me vetëbesim dhe forcë. Gëzimi i pendimit është më shumë se gëzimi i të jetuarit të një jete të kënaqshme. Ai është gëzimi i faljes, i të qenit përsëri i pastër dhe i afrimit me Perëndinë. Pasi ta keni përjetuar atë gëzim, ai bëhet i pazëvendësueshëm.



Pendimi i vërtetë na frymëzon që ta bëjmë bindjen tonë një zotim – një besëlidhje, që fillon me pagëzimin dhe ripërtërihet çdo javë në Darkën e Zotit, sakramentin. Atje ne marrim premtimin që mund “të ke[mi] gjithmonë Shpirtin e Tij me [ne]”⁵, me të gjithë gëzimin dhe paqen që vijnë nga shoqërimi i Tij i përhershëm. Ky është fryti i pendimit dhe kjo është ajo që e bën pendimin të gëzueshëm!

Pendimi Kërkon Këmbëngulje

Unë e pëlqej shumë shëmbëlltyrën e djalit plangprishës.⁶ Ka diçka prekëse te çasti i kthesës kur plangprishësi “erdhi në vete”. Ulur në një stallë derrash, duke dëshiruar “të mbushte barkun me lendet që hanin derrat”, ai më në fund e kuptoi se pati çuar dëm jo vetëm trashëgiminë nga i ati por gjithashtu vetë jetën e vet. Me besim që babai i tij mund ta pranonte kthimin e tij – nëse jo si bir atëherë të paktën si shërbëtor – ai vendosi ta linte pas të kaluarën e tij rebele dhe të shkonte në shtëpi.

Unë shpesh e kam pyetur veten rreth rrugëtimit të gjatë të birit për në shtëpi. A kishte raste kur ai ngurroi dhe pyeti veten: “Si do të më presë babai?” Ndoshta ai madje bëri disa hapa prapa drejt derrave. Përfytyroni si do të kishte qenë ndryshe historia nëse ai do të ishte dorëzuar. Por besimi e mbajti atë në lëvizje dhe besimi e mbajti babanë e tij në vëzhgim e pritje me durim, derisa më në fund:

“Kur ishte ende larg, i ati e pa dhe [pati] dhembshuri; u lëshua vrap, ra mbi qafën e tij dhe e puthi.

Dhe i biri i tha: ‘O atë, mëkatova kundër qiellit dhe para teje dhe nuk jam më i denjë të quhem biri yt’.

Por i ati u tha shërbëtorëve të vet: ‘Sillni këtu rrobën më të bukur dhe visheni, i vini një unazë në gisht dhe sandale në këmbë. . . .



sepse ky biri im kishte vdekur dhe u kthye në jetë, kishte humbur dhe u gjet përsëri.’”

Pendimi Është për Cilindo

Vëllezër dhe motra, ne jemi të gjithë plëngprishës. Ne të gjithë duhet të “[vijmë] në vete” – zakonisht më shumë se një herë – dhe të zgjedhim shtegun që na kthen në shtëpi. Ajo është një zgjedhje që e bëjmë përditë, gjatë gjithë jetës sonë.

Ne shpesh e shoqërojmë pendimin me mëkate të rënda që kërkojnë një “ndryshim [të] madh”⁷. Por pendimi është për cilindo – ata që janë duke u endur nëpër “shtigje të ndaluara dhe [kanë humbur]”⁸ si dhe ata që “[kanë] hyrë në . . . shteg[un e] ngushtë dhe të ngushtuar” dhe tani nevojitet të “shkojnë përpara”. Pendimi edhe na vë në shtegun e duhur, edhe na mban në shtegun e duhur. Është për ata që sapo kanë filluar të besojnë, për ata që kanë besuar gjithmonë, dhe për ata që u nevojitet të fillojnë të besojnë përsëri. Plaku Dejvid A. Bednar na mësoi: “Shumë prej nesh e kuptojnë qartësisht se

Shlyerja është për mëkatarët. Megjithatë, nuk jam aq i sigurt se ne e dimë dhe kuptojmë se Shlyerja është edhe për shenjtorët – për burrat dhe gratë e mira që janë të bindur, të denjë . . . dhe që po përpiqen për t’u bërë më të mirë.”¹⁰

Kohët e fundit vizitova një qendër të trajnimit misionar kur mbërriti një grup misionarësh të sapo thirrur. Unë u preka thellë ndërsa i vështroja dhe vura re dritën në sytë e tyre. Ata dukeshin aq të gëzuar e të lumtur dhe entuziastë. Atëherë më erdhi një mendim: “Ata kanë përjetuar besim deri në pendim. Kjo është arsyeja pse ata janë të mbushur me gëzim dhe shpresë.”

Nuk mendoj se kjo do të thotë që të gjithë patën shkelje serioze në të kaluarën e tyre, por vërtet mendoj se dinin si të pendoheshin; ata e patën mësuar që pendimi është pozitiv dhe ishin gati e të etur që ta ndanin këtë mesazh të gëzueshëm me botën.

Kjo është ajo që ndodh kur ndiejmë gëzimin e pendimit. Merreni parasysht shembullin e Enosit. Ai pati çastin e tij të “[ardhjes] në vete” dhe, pasi “fajësia [e tij] u fshi”, zemra e tij u kthye

menjëherë drejt mirëqenies së të tjerëve. Enosi e kaloi pjesën tjetër të jetës së tij duke i ftuar të gjithë njerëzit të pendoheshin dhe u “[gëzua] më tepër në të sesa në atë të botës”¹¹. Pendimi e bën atë; ai i kthen zemrat tona drejt bashkëqenieve tona, ngaqë ne e dimë se gëzimi që ndiejmë është që ta përjetojë gjithsecili.

Pendimi Është një Kërkim Përgjatë Gjithë Jetës

Kam një mik që u rrit në një familje shenjtorësh të ditëve të mëvonshme pak aktive. Kur ishte i ri në moshë, edhe ai “erdhi në vete” dhe vendosi të përgatitej për një mision.

Ai u bë një misionar i shkëlqyer. Në ditën e tij të fundit përpara se të kthehej në shtëpi, presidenti i misionit e intervistoi dhe i kërkoi të jepte dëshminë e vet. Ai e bëri këtë dhe, pas një përqaftimi me përlojtje, presidenti i tha: “Eldër [Plak], ti mund t’i harrosh apo mohosh brenda pak muajsh të gjitha ato çka sapo dëshmove, nëse nuk do të vazhdosh të bësh gjërat që së pari forcojnë dëshminë tënde”.

Miku im më vonë më tregoi se ai ishte lutur dhe i kishte lexuar shkrimet e shenjta çdo ditë qysh prej kthimit nga misioni i vet. Qenia vazhdimisht “[i ushqyer] nga fjala e mirë e Perëndisë” e mbajti atë “në udhën e drejtë”¹².

Ju që po përgatiteni për misione kohëplota dhe ju që po ktheheni, mbani shënim! Nuk mjafton thjesht të fitoni një dëshmi; ju duhet ta mirëmbani atë dhe ta forconi atë. Sikurse e di çdo misionar, nëse ndaloni së ngari biçikletën, ajo do të bjerë dhe nëse ndaloni së ushqyeri dëshminë tuaj, ajo do të dobësohet. Po ky parim vlen për pendimin – ai është një kërkim përgjatë gjithë jetës, jo një përvojë e vetme në jetë.

Të gjithë ata që kërkojnë falje – rinia, të rinjtë në moshë madhore



beqarë, prindërit, gjyshërit dhe po, madje stërgjyshërit – unë ju ftoj të vini në shtëpi. Tani është koha për të filluar. Mos e shtyni ditën e pendimit tuaj.¹³

Atëherë, sapo ta keni marrë këtë vendim, vijoni të ndiqni shtegun. Ati ynë po pret, i dëshiruar që t’ju presë. Krahët e tij janë shtrirë “gjatë gjithë ditës” për ju.¹⁴ Shpërblimi e meriton përpjekjen.

Mbajini mend këto fjalë nga Nefi: “Ju duhet të shkoni përpara me një vendosmëri në Krisht, duke pasur një ndriçim të përkryer të shpresës dhe një dashuri për Perëndinë dhe për gjithë njerëzit. Prandaj, në qoftë se ju do të shkoni përpara, duke u ushqyer me bollëk mbi fjalën e Krishtit dhe të duroni deri në fund, vini re, kështu thotë Ati: Ju do të keni jetën e përjetshme.”¹⁵

Ndonjëherë udhëtimi do të duket i gjatë – në fund të fundit, ai është udhëtimi drejt jetës së përjetshme. Por ai mund të jetë një udhëtim i gëzueshëm nëse e ndjekim me besim në Jezu Krisht dhe me shpresë të Shlyerja e Tij. Unë dëshmoj se, në çastin kur vëmë këmbën në shtegun e pendimit,

ne ftojmë fuqinë shëlbuese të Shpëtimtarit në jetën tonë. Ajo fuqi do t’i bëjë të qëndrueshme këmbët tona, do ta zgjerojë këndvështrimin tonë dhe do ta thellojë vendosmërinë tonë për të shkuar përpara, hap pas hapi, deri në atë ditë të lavdishme kur ne më në fund do të kthehemi në shtëpinë tonë qiellore dhe do ta dëgjojmë Atin tonë në Qiell të na thotë: “Të lumtë”¹⁶. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Romakëve 3:23.
2. Shih Alma 41:10.
3. D. Tod Kristoferson, “Dhurata Hyjnore e Pendimit”, *Liahona*, nëntor 2011, f. 38.
4. Dejjl G. Renland, “Pendimi: Një Zgjedhje e Gëzueshme”, *Liahona*, nëntor 2016, f. 122.
5. Doktrina e Besëlidhje 20:77.
6. Shih Lluca 15:11–32.
7. Alma 5:12.
8. 1 Nefi 8:28.
9. 2 Nefi 31:19, 20.
10. Dejvid A. Bednar, “Shlyerja dhe Udhëtimi i Vdekshmërisë”, *Liahona*, prill 2012, f. 14.
11. Shih Enosi 1.
12. Moroni 6:4.
13. Shih Alma 13:27.
14. Jakobi [LiM] 6:4.
15. 2 Nefi 31:20.
16. Mateu 25:21.



Nga Plaku Kuentin L. Kuk,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Të Përditshmen si Përjetësinë

Përlësia për atë se cilët jemi dhe për qëllimin e Perëndisë për ne, është thelbësore.

Që nga shërbimi im në Misionin Britanik kur isha i ri, më ka pëlqyer shumë humori britanik. Nganjëherë ai karakterizohet nga një këndvështrim vetëkundërshtues, i thjeshtë, i përlurur ndaj jetës. Një shembull për këtë është mënyra se si portretizohet stina e verës. Vera britanike është relativisht e shkurtër dhe e paparashikueshme. Siç e tha në mënyrë të përmbajtur një shkrimtare: “Më pëlqen shumë vera britanike, është *dita* ime më e parapëlqyer e vitit”¹. Një personazh vizatimor britanik që më pëlqen shumë, u pikturua në shtratin e saj duke u zgjuar nga gjumi vonë në mëngjes dhe duke u shpallur qenve të saj: “E marrtë e mira! Mendoj se fjetëm më shumë nga ç’duhej dhe na iku vera.”²

Ka një analogji në këtë humor me jetën tonë në këtë tokë të bukur. Shkrimet e shenjta janë të qarta se ekzistenca jonë e çmuar në vdekshmëri është për një kohë shumë të shkurtër. Mund të thuhet që nga një këndvështrim i përjetshëm, koha jonë në tokë është po aq kalimtare sa një verë britanike.³

Nganjëherë qëllimi i njeriut dhe vetë ekzistenca e tij gjithashtu

përshkruhen me terma shumë të përlurur. Profeti Moisi u rrit në një mjedis që disa njerëz sot mund ta quajnë të privilegjuar. Siç shënohet në Perlën me Vlerë të Madhe, Zoti, duke e përgatitur Moisiun për detyrën e tij profetike, i jep atij një vështrim të përgjithshëm të botës dhe të gjithë fëmijëve të njerëzve, të cilët janë dhe ishin krijuar.⁴ Reagimi disi i habitur i Moisiut ishte: “Tani . . . unë e di se njeriu është një hiç, gjë të cilën kurrë nuk e kisha menduar më parë”⁵.

Si rrjedhojë, Perëndia, me atë që duket si një kundërshtim ndaj çdo ndjenje të mungesës së rëndësisë, që mund të ketë ndier Moisiu, shpalli qëllimin e Tij të vërtetë: “Sepse, vër re, kjo është vepra ime dhe lavdia ime – të bëj të ndodhë pavdekësia dhe jeta e përjetshme e njeriut”⁶.

Ne jemi të gjithë të barabartë përpara Perëndisë. Doktrina e Tij është e qartë. Në Librin e Mormonit lexojmë: “Të gjithë janë njësoj para Perëndisë”, duke përfshirë “të zinj dhe të bardhë, skllëvër dhe të lirë, burra e gra”⁷. Sipas kësaj, të gjithë ftohen që të vijnë te Zoti.⁸

Çdo njeri që pretendon epërsi sipas planit të Atit, për shkak të karakteristikave të tilla si raca, gjinia, kombësia, gjuha apo rrethanat ekonomike, bën një gabim nga ana morale dhe nuk e kupton qëllimin e vërtetë të Zotit për të gjithë fëmijët e Atit tonë.⁹

Për fat të keq, në kohën tonë pothuajse në çdo segment të shoqërisë, ne shohim të valëvitën vetërendësia dhe arroganca, ndërkohë që përlësia dhe përgjegjshmëria ndaj Perëndisë denigrohen. Shumica e shoqërisë i ka humbur spirancat e saj themelore dhe nuk e kupton arsyen pse jemi në këtë



tokë. Përlësia e vërtetë, e cila është thelbësore për ta arritur qëllimin e Zotit për ne, rrallë është e dukshme.¹⁰

Është e rëndësishme të kuptohet madhështia e përlësisë, drejtësisë, karakterit dhe inteligjencës së Krishtit, siç personifikohen në shkrimet e shenja. Është marrëzi të nënvlerësohet domosdoshmëria e përpjekjes së vazhdueshme për këto cilësi e tipare si të Krishtit, veçanërisht e përlësisë, ditë për ditë.¹¹

Shkrimet e shenja e bëjnë të qartë se teksa kjo jetë është relativisht e shkurtër, ajo është jashtëzakonisht domethënëse. Amuleku, i cili ishte shok misionar i Almës tek Libri i Mormonit, tha: “Vini re, kjo jetë është koha për njerëzit që të përgatiten të takohen me Perëndinë; po, vini re, dita e kësaj jete është dita për njerëzit që të kryejnë punët e tyre”¹². Nuk dëshirojmë, sikurse personazhi im vizatimor, që të flemë gjatë gjithë kësaj jete.

Shembulli i përlësisë dhe i sakrificës së Shpëtimtarit për tërë njerëzimin është ngjarja më e rëndësishme e historisë. Shpëtimtari, edhe si një pjesëtar i Kreut-Perëndi, ishte i gatshëm të vinte në tokë si një foshnjë e vobektë dhe të fillonte një ekzistencë që përfshiu mësimdhënien dhe shërimin e vëllezërve dhe të motrave të Tij dhe më së fundi vuajtjen e një dhembjeje të papërshtueshme në Gjetseman e në kryq, me qëllim që ta përsoste Shlyerjen e Tij. Ky veprim dashurie dhe përlësie nga ana e Krishtit njihet si denjimi i Tij.¹³ Ai e bëri këtë për çdo burrë e çdo grua që Perëndia e ka krijuar ose do ta krijojë.

Ati ynë Qiellor nuk dëshiron që fëmijët e Tij të shkurajohen apo të heqin dorë nga kërkimi vetjak i lavdisë celestiale. Kur i sjellim vërtet ndër mend Perëndinë, Atin, dhe Krishtin, Birin, se cilët janë Ata dhe se çfarë kanë arritur Ata për të mirën tonë, ne mbushemi

me nderim, mahnitje, mirënjohje dhe përlësi.

Përlësia Është Thelbësore për ta Ndhimuar Zotin që të Vendosë Kishën e Tij

Alma bëri një pyetje në kohën e tij e cila është me vend sot: “Në qoftë se keni provuar një ndryshim të zemrës dhe në qoftë se ju keni ndier të këndonit këngën e dashurisë shëlbuese, unë do t’ju pyesja, a ndiheni kështu tani?”¹⁴ Alma vazhdoi: “A mund të thonit, . . . po të thirrshihet që të vdisni në këtë çast, se keni qenë aq sa duhet të përlulur?”¹⁵

Më lë mbresë sa herë që lexoj rreth Almës të Riut, i cili hoqi dorë nga roli i tij si kryetari i shtetit që të predikonte fjalën e Perëndisë.¹⁶ Qartësisht Alma kishte një dëshmi të thellë për Perëndinë, Atin, dhe Jezu Krishtin dhe u ndje i përgjegjshëm para Tyre tërësisht dhe pa asnjë ngurrim. Ai kishte përparësitë e duhura dhe përlësinë që ta braktiste gjendjen dhe pozitën, ngaqë e kuptoi se ishte më e rëndësishme t’i shërbente Zotit.

Pasja e përlësisë së mjaftueshme në jetën tonë që të ndihmojmë për ta themeluar Kishën, është veçanërisht me vlerë. Një shembull i historisë së Kishës e nxjerr këtë në pah. Në qershor të vitit 1837, Profeti Jozef u frymëzua, ndërkohë që ndodhej në Tempullin e Kirtlandit, t’i jepte një thirrje Apostullit Hibër C. Kimball që ta çonte ungjillin e Jezu Krishtit në “Angli . . . dhe të hap[te] derën e shpëtimit për atë komb”¹⁷. Apostulli Orson Hajd dhe disa të tjerë u caktuan që ta shoqëronin atë. Përgjigja e Plakut Kimball ishte mbresëlënëse. “Ideja e të qenit i caktuar në një mision kaq të rëndësishëm ishte gati më shumë nga ç’mund ta përballoja. . . . Isha pothuajse gati të fundosesha nën barrën që ishte vendosur mbi mua.”¹⁸

Megjithatë, ai e ndërmori misionin me besim, zotim e përlësi tërësore.

Nganjëherë përlësi është pranimi i thirrjeve kur nuk ndihemi të përshtatshëm. Nganjëherë përlësi është shërbimi me besnikëri kur ndihemi të aftë për një detyrë të një rëndësie më të madhe. Udhëheqës të përlulur e kanë përcaktuar me anë të fjalëve dhe të shembullit që s’ka rëndësi se ku shërbejmë, por se si shërbejmë me besnikëri.¹⁹ Nganjëherë përlësi është mposhtja e ndjenjave të lëndimit kur ndiejmë që na kanë keq-trajtuar udhëheqësit apo njerëz të tjerë.

Më 23 korrik 1837, Profeti Jozef u takua me Plakun Tomas B. Marsh, Presidentin e Kuorumit të Të Dymbëdhjetëve. Plaku Marsh ishte i shqetësuar dukshëm që Profeti i kishte thirrur dy anëtarë të kuorumit të tij për të shkuar në Angli pa u këshilluar me të. Kur Jozefi u takua me Plakun Marsh, çdo ndjenjë lëndimi u vu nënmenjë dhe Profeti mori një zbulësë mbresëlënëse. Ajo tani është seksioni 112 i Doktrina e Besëlidhje.²⁰ Ajo jep një udhëzim të jashtëzakonshëm nga qielli lidhur me përlësinë dhe punën misionare. Vargu 10 thotë: “*Ji i përlulur*; dhe Zoti, Perëndia yt, do të të udhëheqë përdore dhe do t’u japë përgjigje lutjeve të tua”²¹.

Kjo zbulësë ndodhi po atë ditë që Pleqtë Kimball, Hajd e Xhon Gudsën, plot me përlësi, po e shpallnin Rivendosjen e ungjillit të Jezu Krishtit në godinën kishtarë Voks-holl në Preston të Anglisë.²² Kjo ishte hera e parë që misionarët e kishin shpallur ungjillin e rivendosur jashtë Amerikës Veriore në këtë periudhë të kujdestarisë ungjillore. Përpjekja e tyre misionare solli pagëzime pothuajse të menjëhershme të të kthyerve në besim dhe çoi drejt anëtarëve të shumtë besnikë.²³

Pjesë pasuese të zbulësës e udhërrëfejnë përpjekjen misionare në kohën tonë. Pjesërisht aty lexohet: “Këdo që

do ta dërgoni në emrin tim . . . do të ketë fuqi për të hapur derën e mbretërisë sime për cilindo komb . . . për aq sa ata do të *përuken* përpara meje dhe do t'i binden fjalës sime e do t'ia vënë veshin zërit të Shpirtit tim”²⁴.

Përlësia që e ngriti themelin e kësaj pune të pabesueshme misionare, e lejoi Zotin ta vendoste Kishën e Tij në një mënyrë mbresëlënëse.

Plot mirënjohje, ne vazhdimisht e shohim këtë në Kishë sot. Anëtarët, përfshirë brezin e ri, japin kohën e tyre dhe shtojnë arsimimin e punësimin që të shërbejnë në mision. Shumë anëtarë të moshuar e lënë punësimin dhe bëjnë sakrificë të tjera, me qëllim që t'i shërbejnë Perëndisë në çfarëdo pozicioni që thirren. Ne nuk i lejojmë çështjet vetjake që të na e tërheqin vëmendjen apo të na shmangin nga përmbushja e qëllimeve të Tij.²⁵ Shërbimi në Kishë kërkon përlësi. Ne përlësisht shërbejmë në rolin që thirremi, me gjithë fuqinë, mendjen e forcën tonë. Në çdo nivel të Kishës, është e rëndësishme ta kuptojmë tiparin si i Krishtit të përlësisë.

Përlësia e Përditshme Është Thelbësore për t'i Ndihmuar Individët që të Përgatiten për t'u Takuar me Perëndinë

Synimi për ta nderuar Zotin dhe për ta nënshtruar veten ndaj vullnetit të Tij²⁶ nuk vlerësohet në shoqërinë e sotme aq sa është vlerësuar në të shkuarën. Disa udhëheqës të krishterë të besimeve të tjera besojnë se po jetojmë në një botë ku krishterimi nuk është më domethënëse.²⁷

Për shumë breza, virtyti i përlësisë, i bazuar te feja, dhe virtytet shoqërore të thjeshtësisë dhe rezervimit në vlerësim kanë qenë standardi mbizotërues.

Në botën e sotme, ka një theksim në rritje për krenarinë, vetëlavdërimin dhe të ashtuquajturën “vërtetësi”, e cila nganjëherë çon drejt një mungese të

përlësisë reale. Disa sugjerojnë që vlerat morale për lumturinë sot përfshijnë “të qenit i vërtetë, të qenit i fortë, të qenit frytdhënës – dhe më e rëndësishmja, të mos mbështetesh te njerëz të tjerë . . . sepse fati yt është . . . në vetë duart e tua”²⁸.

Shkrimet e shenjta këshillojnë një metodë të ndryshme. Ato sugjerojnë që ne duhet të jemi dishepuj të vërtetë të Jezu Krishtit. Kjo përfshin krijimin e një ndjenje të fuqishme të përgjegjshmërisë ndaj Perëndisë dhe një këndvështrim të përlurur ndaj jetës. Mbreti Beniamin dha mësim që njeriu i natyrshëm është një armik ndaj Perëndisë dhe këshilloi që ne kemi nevojë të dëgjojmë “thirrjet e Frymës së Shenjtë”. Ai shpjegoi, mes gjërave të tjera, se kjo kërkon që të bëhemi “[të] nënshtruar, [të] bindur, [të] përlurur, [të] duruar [dhe] plot me dashuri”²⁹.

Disa njerëz e keqpërdorin *të qenit të vërtetë* për të nënkuptuar një kremtim të njeriut të natyrshëm dhe të cilësive që janë të kundërta me përlësinë, mirësinë, mëshirën, faljen dhe njerëzinë. Ne mund ta kremtojmë veçantinë tonë individuale si fëmijë të Perëndisë pa e përdorur si justifikim për një sjellje jo si të Krishtit.

Në kërkimin tonë për përlësi, interneti bashkëkohor krijon sfida për shmangien e krenarisë. Dy shembuj janë metoda vetëkënaqëse “më shiko mua” ose sulmi ndaj të tjerëve duke bërë komente idhnake në mjetet shoqërore të informimit. Një shembull tjetër është “mburra e përlur”. Kjo përkufizohet si “një thënie [ose figurë] gjoja e thjeshtë ose vetëmospranuese, qëllimi i vërtetë i së cilës është të tërheqë vëmendjen ndaj diçkaje për të cilën një njeri është krenar”³⁰. Profetët gjithmonë na kanë paralajmëruar ndaj krenarisë dhe theksimit të gjërave të kota të botës.³¹

Përkeqësimi i gjithëpërhapur i diskutimit mbi qytetarinë është gjithashtu një



shqetësim. Parimi i përjetshëm i lirisë së zgjedhjes kërkon që ne të respektojmë shumë zgjedhje me të cilat nuk biem dakord. Konflikti dhe grindja tani shpesh i dhunojnë “kufijtë e mirësjelljes së përbashkët”³². Na nevojitet më shumë thjeshtësi e përlësi.

Alma këshillon kundër “fry[rjes] në krenarinë e zemrave tuaja”, “të mend[uarin] se njëri është më i mirë se tjetri” dhe përndjekjes së të përlururve që “ecin sipas urdhrat të shenjtë të Perëndisë”³³.

Kam gjetur një dashamirësi të çiltër mes njerëzve të të gjitha besimeve fetare, të cilët janë të përlurur e ndihen të përgjegjshëm ndaj Perëndisë. Shumë prej tyre i ndjekin mësimet e profetit të Dhiatës së Vjetër, Mikeas, i cili shpalli: “Çfarë tjetër kërkon Zoti nga ti, përveç se të zbatosh drejtësinë, të duash mëshirën dhe të ecësh përlësisht me Perëndinë tënd”³⁴.

Kur jemi me të vërtetë të përlurur, ne lutemi për falje dhe i falim të tjerët. Siç lexojmë te Mosia, Alma dha mësim se kurdo që pendohemi, Zoti do të na i falë shkeljet tona.³⁵ Nga ana tjetër, siç tregohet në Lutjen e Zotit,³⁶ kur nuk ua falim të tjerëve shkeljet e tyre, ne e çojmë veten tonë në dënim.³⁷ Për shkak të Shlyerjes së Jezu Krishtit, me anë të pendimit mëkatet tona falen. Kur nuk i falim ata që bëjnë shkelje kundrejt nesh, ne në fakt nuk po e pranojmë Shlyerjen e Shpëtimtarit. Mbatja e mërisë, mospranimi për të falur dhe mospranimi për t'iu drejtuar

marrëdhënieve tona me përlësi, në një mënyrë si e Krishtit, me të vërtetë na çojnë në dënim. Mbajtja e mërisë është helmuese për shpirtat tanë.³⁸

Lejomëni t'ju paralajmëroj edhe ndaj çdo forme të arrogancës. Zoti, nëpërmjet profetit Moroni, bën një dallim të qartë midis arrogantit dhe të përlulurit: "Të marrët tallen, por ata do të vajtojnë; dhe hiri im është i mjaftueshëm për të përlulurit". Zoti më tej shpalli: "Unë u jap njerëzve dobësi, që ata të jenë të përlulur; dhe hiri im është i mjaftueshëm për të gjithë njerëzit që përlulen para meje; pasi në qoftë se ata përlulen para meje dhe kanë besim tek unë, atëherë unë do të bëj që gjërat e dobëta, të bëhen të forta në ta"³⁹.

Përlësia gjithashtu përfshin të qenit mirënjohës për bekimet tona të shumta dhe ndihmën hyjnore. Përlësia nuk është njëfarë arritje madhështore e përcaktueshme dhe as kapërcimi i disa sfidave madhore. Është shenjë e forcës shpirtërore. Është të kemi vetëbesimit të heshtur që ditë pas dite dhe orë pas ore ne mund të mbështetemi te Zoti, t'i shërbejmë Atij dhe të plotësojmë qëllimet e Tij. Është lutja ime që në këtë botë plot grindje ne vërtet do të përpiqemi vazhdimisht për përlësinë e vërtetë çdo ditë. Një poemë e parapëlqyer, e shpreh atë në këtë mënyrë:

*Është prova e madhësisë
Mënyra se si e kalon të Përditshmen
si përjetësinë.*⁴⁰

Unë jap një dëshmi të sigurt për Shpëtimtarin dhe Shlyerjen e Tij dhe për rëndësinë mbizotëruese për t'i shërbyer Atij me përlësi gjithnjë e çdo ditë. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Kathy Lette, in "Town and Country Notebook", bot. Victoria Marston, *Country Life*, 7 qershor 2017, f. 32; theksimi i shtuar.

2. Annie Tempest, "Tottering-by-Gently", *Country Life*, 3 tetor 2012, f. 128.
3. Shih Psalmeve 90:4. Qoftë e shkurtër apo e gjatë për sa u përket viteve tokësore, periudha e jetës sonë është shumë e shkurtër nga një këndvështrim i përjetshëm. "E gjitha është si një ditë për Perëndinë dhe koha matet vetëm për njerëzit" (Alma 40:8). Apostulli Pjetër shpalli: "Por, shumë të dashur, mos harroni këtë gjë: se për Zotin një ditë është si një mijë vjet, dhe një mijë vjet si një ditë" (2 Pjetër 3:8).
4. Shih Moisiu 1:6–9. Ky është Krishti që po flet me veshjen hyjnore të autoritetit (shih *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Filding Smith* [2013], f. 48, poshtëshënimi 11).
5. Moisiu 1:10.
6. Moisiu 1:39.
7. 2 Nefi 26:33; shih edhe Doktrina e Besëlidhje 1:34–35; 38:16; Deklarata Zyrtare 2.
8. Doktrina e Besëlidhje 20:37 fillon: "Gjithë ata që përlulen përpara Perëndisë". Më pas ajo shtjellon kërkesat për pagëzim. Shih edhe Mateu 11:28.
9. Shih Doktrina e Besëlidhje 20:37.
10. Ne e dimë që, në qoftë se nuk pendohe mi, nuk i marrim ordiancat dhe nuk e ndjekim shtegun e besëlidhjeve që na përgatit për përjetësinë, "atëherë vjen nata e errësirës, gjatë së cilës nuk mund të kryhet asnjë punë" (Alma 34:33).
11. Shih 3 Nefi 27:27.
12. Alma 34:32.
13. Shih 1 Nefi 11:26–33; 2 Nefi 9:53; Jakobi [LIM] 4:7; Doktrina e Besëlidhje 122:8.
14. Alma 5:26.
15. Alma 5:27.
16. Shih Alma 4:19.
17. Joseph Smith, në Heber C. Kimball, "History of Heber Chase Kimball by His Own Dictation", rreth 1842–1856, Heber C. Kimball Papers, f. 54, Biblioteka e Historisë së Kishës; shih edhe Orson F. Whitney, *Life of Heber C. Kimball, an Apostle; the Father and Founder of the British Mission* (1888), f. 116.
18. Heber C. Kimball, "History of Heber Chase Kimball by His Own Dictation", f. 54; shih edhe Orson F. Whitney, *Life of Heber C. Kimball*, f. 116.
19. Presidenti J. Ruben Klark i Riu dha mësim: "Në shërbimin e Zotit, nuk ka rëndësi se ku shërbeni, por si shërbeni. Në Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, një njeri zë vendin tek i cili është thirrur siç duhet, vend të cilin as nuk e kërkon, as nuk e refuzon" (në Conference Report, prill 1951, f. 154).
20. Shih *The Joseph Smith Papers, Documents, Volume 5: October 1835-January 1838*,

- bot. Brent M. Rogers dhe të tjerë (2017), f. 412–417. Vajlet Kimballi raportoi në një letër drejtuar bashkëshortit të saj, Hibër C. Kimballit, se ajo e kishte kopjuar zbuluesën nga "Libri i Plakut Marsh siç ai e shkroi nga goja e Jozefit" (Vilate Murray Kimball to Heber C. Kimball, 6 shtator 1837, në *The Joseph Smith Papers, Documents, Volume 5: October 1835-January 1838*, f. 412).
21. Doktrina e Besëlidhje 112:10; theksimi i shtuar.
22. Shih Orson F. Whitney, *Life of Heber C. Kimball*, f. 136–137.
23. Shih Orson F. Whitney, *Life of Heber C. Kimball*, f. 149.
24. Doktrina e Besëlidhje 112:21–22; theksimi i shtuar.
25. "Teksa nuk kërkojmë të lirohemi nga një thirrje, nëse rrethanat tona ndryshojnë, është tërësisht në rregull për ne që të këshillohemi me ata që e kanë dhënë thirrjen dhe më pas t'ua lëmë atyre vendimin" (Boyd K. Packer, "Called to Serve", *Ensign*, nëntor 1997, f. 8).
26. Shih "Përlësia", në kapitullin 6 të *Predikoni Ungjillin Tim: Një Udhëzues për Shërbimin Misionar* (2005), f. 124.
27. Shih Charles J. Chaput, *Strangers in a Strange Land* (2017), f. 14–15; shih edhe Rod Dreher, *The Benedict Option* (2017).
28. Carl Cederstrom, "The Dangers of Happiness", *New York Times*, 19 korrik 2015, SR8.
29. Mosia 3:19.
30. *English Oxford Living Dictionaries*, "humblebrag" ["mburrja e përlulur"], oxforddictionaries.com.
31. Në një farë mënyre kjo na sjell ndërmend përshkrimin në librin e Almës për ata që i kishin fituar "të gjitha llojet e gjërave të çmueshme që ata kishin marrë nëpërmjet zellit të tyre për punë; . . . [por] . . . u ngritën lart në krenarinë e syve të tyre" (Alma 4:6). Është vënë në dukje se një "mburrje e përlulur" prapë është mburrje.
32. David Brooks, "Finding a Way to Roll Back Fanaticism", *New York Times*, 15 gusht 2017, A23.
33. Alma 5:53, 54.
34. Mikea 6:8.
35. Shih Mosia 26:30.
36. Shih Mateu 6:12, 15.
37. Shih Mosia 26:31.
38. Sikurse tha Nelson Mandela: "Mëria është si të pish helm dhe më pas të shpresosh se ai do t'i vrasë armiqët e tu" (në Jessica Durando, "15 of Nelson Mandela's Best Quotes", *USA Today*, 5 dhjetor 2013, usatoday.com).
39. Ethëri 12:26, 27; theksimi i shtuar.
40. Edmund Vance Cooke, "The Eternal Day", *Impertinent Poems* (1907), f. 21.



Nga Plaku Ronald A. Rasband,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Sipas Qëllimit Hyjnor

Dora e Zotit po ju udhërrëfen. Sipas “qëllimit hyjnor”, Ai është në hollësitë e vogla të jetës suaj si edhe në arritjet e mëdha.

Vëllezër e motra, ndërsa qëndroj këtu në këtë konferencë të përgjithshme mbarëbotërore frymëzuese dhe ndjej forcën tuaj e shpirtin tuaj, nuk mund të bëj gjë tjetër veçse të mendoj për fjalët e Apostullit Pjetër: “[Zot], për ne është mirë të rrijmë këtu”¹.

Kjo nuk është saktësisht ajo që tha Alma pasi u predikoi njerëzve në Amonihë. Alma u largua nga qyteti për shkak të ligësisë së njerëzve. Pas pak, një engjëll iu shfaq Almës dhe i tha të “kthehej] në qytetin e Amonihës dhe të prediko[n]te] përsëri mes popullit të qytetit”².

Alma e bëri këtë “me të shpejtë”, duke hyrë në “qytet nga një udhë tjetër”³.

“Kur hyri në qytet, ai ishte i uritur dhe i tha një njeriu: A do t’i japësh një shërbëtori të përlulur të Perëndisë diçka për të ngrënë?”

Dhe njeriu i tha atij: Unë jam një Nefit dhe unë e di se ti je një profet i shenjtë i Perëndisë, pasi ti je njeriu për të cilin një engjëll më tha në një vegim: Ti do ta pranosh.”⁴

Ai burrë ishte Amuleku.

Tani, a ndodhi thjesht që Alma u takua me Amulekun? Jo, nuk ishte rastësi që ai hyri në qytet nga udha që do ta çonte atë te ky burrë besnik, i cili do të bëhej shoku i tij misionar.

Plaku Nil A. Maksuell një herë shpjegoi: “Asnjëri prej nesh kurrë nuk i shfrytëzon plotësisht mundësitë njerëzore që na sigurohen nëpërmjet rrethit të miqve tanë. Unë dhe ju mund t’i quajmë këto marrëdhënie ‘rastësi’. Është e kuptueshme që të vdekshmit ta përdorin këtë fjalë, por *rastësi* nuk është fjala e duhur për të përshkruar veprimet e një Perëndie të gjithëdijshëm. Ai nuk i bën gjërat sipas ‘rastësisë’, por . . . sipas ‘qëllimit hyjnor’.”⁵

Jeta jonë është si një fushë shahu dhe Zoti na lëviz nga një vend në tjetrin – nëse u përgjigjemi nxitjeve shpirtërore. Kur e hedhim vështrimin prapa, ne mund ta shohim dorën e Tij në jetën tonë.



Ne mund ta shohim një ndërhyrje të tillë qiellore kur Nefi kthehet për të marrë fletët nga Labani. Ai “[u] dhëh[oa] nga Shpirti, duke mos ditur më parë gjërat që [ai] duhej] të bë[n]te.”⁶ Pak pas kësaj, Labani ishte përpara tij në gjendje të dehur dhe Nefi e vrau, i mori fletët dhe ia mbathi për te vëllezërit e tij. A ishte thjesht me fat që e takoi Labanin? Apo ishte sipas “qëllimit hyjnor”?

Në ungjill dhe në Kishë ndodhin ngjarje domethënëse që e çojnë më tej mbretërinë e Perëndisë në tokë. Ato nuk janë të rastit, por sipas planit të Perëndisë. Ai që i dha formë kësaj bote, mund të qetësojë dete me fjalën e Tij dhe mund ta udhëheqë si Almën ashtu edhe Amulekun, dhe Nefin e Labanin që të jenë në vendin e duhur pikërisht në kohën e duhur.

Po kështu, në jetën e secilit prej nesh ndodhin ngjarje dhe krijohen shqëri që e çojnë më tej punën e Perëndisë në tokë.

I shtrenjti Plaku Jozef B. Uirthlin, foli për një rast kur Presidenti Tomas S. Monson i tha atij: “Ka një dorë udhërrëfyese në të gjitha gjërat. Shpesh, kur gjërat ndodhin, nuk janë të rastit. Një ditë, kur ta hedhim vështrimin prapa, te rastësitë në dukje në jetën tonë, ne do të kuptojmë se ndoshta, tek e fundit, ato nuk ishin kaq të rastësishme”⁷.

Shumë shpesh, veprat tona të mira njihen vetëm nga pak njerëz. Sidoqoftë, ato shënohen në qiell. Një ditë, ne do të qëndrojmë si dëshmitar i përkushtimit tonë me gjithë zemër ndaj veprave të drejtësisë. Asnjë sprovë apo fatkeqësi nuk mund ta prishë planin e Perëndisë për lumturinë. Me të vërtetë, sipas “qëllimit hyjnor”, “në mëngjes shpërthen një britmë gëzimi”⁸. “Unë erdha në botë për të bërë vullnetin e Atit tim”⁹, dha mësim Jezusi. Të dashur vëllezër e motra, edhe ne duhet ta bëjmë atë.



Nëpërmjet përvojës së udhëtimit të vetë jetës sime, unë e di se Zoti do të na lëvizë në atë fushë shahu në dukje për të bërë punën e Tij. Ajo që mund të duket se është një rastësi, në fakt po mbikëqyret nga një Atë i dashur në Qiell, i cili mund të numërojë fjetet e flokut të çdo koke.¹⁰ As edhe një harabel nuk bie përtokë pa dijeninë e Atit tonë.¹¹ Zoti është në hollësitë e vogla të jetës sonë, dhe ato ngjarje e mundësi duhet të na përgatitin për t'i lartësuar familjet tona dhe të tjerët, ndërsa e ndërtojmë mbretërinë e Perëndisë në tokë. Mbajeni mend atë që Zoti i tha Abrahamit: “E njoh mbarimin që nga fillimi; si rrjedhim dora ime do të jetë mbi ty”¹².

Zoti më vendosi në një shtëpi me prindër të drejtë. Sipas standardeve të botës, ata ishin njerëz shumë të zakonshëm; babai im, një njeri i përkushtuar, ishte shofer kamioni; nëna ime engjëlllore, ishte shtëpiake. Zoti më ndihmoi të gjej bashkëshorten time të dashur, Melaninë. Ai e nxiti një sipërmarrës, i cili u bë një mik i shtrenjtë, të më jepte një mundësi punësimi. Zoti më thirri të shërbej në fushën e misionit, edhe si i ri edhe si president misioni; Ai më thirri në Kuorumin e Të Shtatëdhjetëve dhe tani Ai më ka thirrur si Apostull. Kur e hedh vështrimin prapa, kuptoj se nuk isha unë që i planifikova ato lëvizje;

Zoti i planifikoi, ashtu siç po planifikon lëvizje të rëndësishme për ju dhe ata që ju i doni.

Çfarë duhet të jeni duke kërkuar në vetë jetën tuaj? Cilat janë mrekullitë e Perëndisë që ju kujtojnë se Ai është pranë, duke thënë: “Jam këtu”? Mendoni për ato raste, disa edhe të përditshme, kur Zoti ka vepruar në jetën tuaj – dhe më pas veprimi serish. Çmujini ato si çaste kur Zoti ka treguar besim te ju dhe zgjedhjet tuaja. Por lëreni Atë t’ju bëjë një njeri më të mrekullueshëm sesa mund të bëheni vetë. Çmujeni përfshirjen e Tij. Nganjëherë ne i gjykojmë ndryshimet në planet tona si hapa të gabuar në udhëtimin tonë. Shikojini ato më shumë si hapa të parë të qenit në “pun[ën] e Zotit”¹³.

Disa muaj më parë, mbesa jonë iu bashkua një grupi të rinjsh për të vizituar disa vende historike të Kishës. Itinerari përfundimtar tregonte se ajo do të kalonte pikërisht përmes zonës ku po shërbente vëllai i saj misionar, nipi ynë. Mbesa jonë nuk kishte ndër mend që ta shihte vëllanë e saj në mision. Megjithatë, kur autobusi hyri në qytetin ku po shërbente i vëllai, mund të shiheshin dy misionarë që po ecnin në rrugë. Njëri prej misionarëve ishte vëllai i saj.

Padurimi e mbushi autobusin ndërsa të rinjtë i kërkuan shoferit që të

ndalonte, në mënyrë që ajo të mund ta përshëndeste të vëllanë. Në më pak se një minutë, pas lotëve dhe fjalëve të dashura, vëllai i saj vazhdoi rrugën për të përmbushur detyrat e tij misionare. Më vonë ne mësuam se vëllai i saj kishte qenë në atë rrugë për më pak se pesë minuta, duke u kthyer nga një takim për te makina e tij.

Ati Qiellor mund të na vendosë në situata me një qëllim të veçantë në mendje. Ai e ka bërë këtë në jetën time dhe Ai po e bën këtë në jetën tuaj, ashtu siç Ai e bëri në jetën e nipit dhe të mbesës sonë të dashur.

Secili prej nesh është i çmuar dhe i dashur për Zotin, i cili shqetësohet, pëshpërit dhe kujdeset në mënyra të pashoqe për secilin prej nesh. Ai është pafundësisht më i mençur dhe më i fuqishëm se burrat dhe gratë e vdekshme. Ai i di sfidat tona, fitoret tona dhe dëshirat e drejta të zemrave tona.

Mbi një vit më parë, ndërsa kaloja përmes Sheshit të Tempullit, një nga motrat misionare m’u afrua dhe më pyeti: “A më mbani mend? Jam nga Florida.” Më tha emrin e saj, Motra Aida Çilan. Po, m’u kujtua që e kisha takuar atë dhe familjen e saj. Presidenti i saj i kunjit kishte sugjeruar që ta vizitonim familjen e saj. U bë e qartë se ne ishim atje për vajzën e tyre, Aidën, e cila nuk ishte pagëzuar. Pas vizitës sonë dhe pas më shumë se një viti mësimdhënieje dhe shoqërimi, Aida u pagëzua.

Pasi biseduam në Sheshin e Tempullit, ajo më shkroi një letër. Ajo tha: “E di me gjithë zemrën time se Ati Qiellor e njej secilin prej nesh dhe se Ai vazhdon të na vendosë në shtigjet e njëri-tjetrit për një arsye. Faleminderit që ishe një nga misionarët e mi, që më ndihmove dhe më gjepte pesë vite më parë.”¹⁴ Aida më dërgoi edhe historinë e saj të kthimit në besim, duke përshkruar “rastësitë hyjnore” që kanë

ndodhur në jetën e saj, të cilat çuan drejt pagëzimit e konfirmimit të saj, shërbimit të një misioni në Sheshin e Tempullit dhe martesës së saj kohët e fundit në tempull.¹⁵

A ishte thjesht rastësi që presidenti i kunjit na kishte drejtuar te shtëpia Çilan apo që unë dhe ajo do të takoheshim më vonë në Sheshin e Tempullit? Dëshmia e Aidës dëshmon se e gjitha kjo ishte pjesë e “qëllimit hyjnor” të Perëndisë.

Zotit i pëlqen shumë të jetë me ne. Nuk është rastësi që, kur ju po e ndieni Shpirtin e Tij dhe po veproni sipas nxitjeve të para, ju e ndieni Atë ashtu siç premtoi: “Unë do të shkoj përpara fytyrës suaj. Unë do të jem në të djathtën e në të majtën tuaj dhe Shpirti im do të jetë në zemrat tuaja e engjëjt e mi përreth jush, për t’ju ngritur lart.”¹⁶

Ne të gjithëve na kanë ndodhur gjëra të ngjashme në jetën tonë. Ne mund të takojmë dikë që na duket i njohur, të përtërijmë një njohje apo të gjejmë gjëra të përbashkëta me një të huaj. Kur ato gjëra ndodhin, ndoshta Zoti po na kujton se ne të gjithë jemi me të vërtetë vëllezër e motra. Ne përfshiemi me të vërtetë në të njëjtën kauzë – në atë që Jozef Smithi e quajti “kauz[a] e Krishtit”¹⁷.

Si gjen vend liria jonë e zgjedhjes në një “qëllim hyjnor”? Ne kemi zgjedhjen ta ndjekim ose jo Shpëtimtarin tonë dhe udhëheqësit e Tij të zgjedhur. Modeli është i qartë në Librin e Mormonit, kur nefitët ishin larguar prej Zotit. Mormoni vajtoi:

“Dhe ata panë . . . se Shpirti i Zotit nuk i ruante më; po, ishte larguar prej tyre, pasi Shpirti i Zotit nuk banon në tempuj jo të shenjtë –

Prandaj, Zoti nuk i ruajti më me fuqinë e tij mrekulluese dhe të pashembullt, pasi kishin rënë në një gjendje mosbesimi dhe ligësie të tmerrshme.”¹⁸



Jo gjithçka që na kërkon Zoti është rrjedhojë e asaj se sa të fortë jemi, sa besnikë jemi apo çka mund të dimë. Mendoni për Saulin, të cilin Zoti e ndaloi rrugës për në Damask. Ai po shkonte në drejtimin e gabuar në jetën e vet dhe kjo nuk kishte të bënte fare me veriun apo jugun. Saulit iu ndryshua drejtimi në mënyrë hyjnore. Kur më vonë ai u bë i njohur si Pali, shërbesa e tij apostolike pasqyroj atë që Zoti e dinte tashmë se ai qe në gjendje të bënte dhe të bëhej, jo atë që ai kishte vendosur të bënte si Saul. Në të njëjtën mënyrë, Zoti e di atë që secili prej nesh është i aftë të bëjë dhe të bëhet. Çfarë dha mësim Apostulli Pali? “Dhe ne e dimë se të gjitha gjërat bashkëveprojnë për të mirë për ata që e duan Perëndinë, për ata që janë të thirrur sipas qëllimit të tij.”¹⁹

Kur jemi të drejtë, të gatshëm e të aftë, kur përpiqemi fort të jemi të denjë e të kualifikuar, ne përparojmë drejt vendeve që kurrë nuk i kishim përfituar dhe bëhemi pjesë e “qëllimit hyjnor” të Atit Qiellor. Secili prej nesh e ka natyrën hyjnore brenda vetes. Kur e shohim Perëndinë të veprojë përmes nesh dhe me ne, qofshim të nxitur, madje mirënjohës për atë udhërrëfim. Kur Ati ynë në Qiell tha: “Kjo është vepra ime dhe lavdia ime – të bëj të ndodhë pavdekësia dhe jeta e

përvetshme e njeriut”²⁰, Ai po fliste për të gjithë fëmijët e Tij – ju në veçanti.

Dora e Zotit po ju udhërrëfen. Sipas “qëllimit hyjnor”, Ai është në hollësitë e vogla të jetës suaj si edhe në arritjet e mëdha. Ashtu siç thuhet te Fjalët e Urta: “Ki besim te Zoti me gjithë zemër . . . dhe ai do të drejtojë shtigjet e tua”²¹. Dëshmoj se Ai do t’ju bekojë, do t’ju mbështetë e do t’ju sjellë paqe. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Lluca 9:33.
2. Alma 8:16.
3. Alma 8:18.
4. Alma 8:19–20.
5. Neal A. Maxwell, “Brim with Joy” (takim shpirtëror në Universitetin “Brigam Jang”, 23 janar 1996), f. 2, speeches.byu.edu.
6. 1 Nefi 4:6.
7. Joseph B. Wirthlin, “Lessons Learned in the Journey of Life”, *Liahona*, maj 2001, f. 38; marrë nga një bisedë e dhënë nga Plaku Uirthlin në një mbledhje rreth vatrës të Sistemit Arsimor të Kishës në Universitetin “Brigam Jang”, 7 nëntor 1999.
8. Psalmeve 30:5.
9. 3 Nefi 27:13.
10. Shih Lluca 12:7.
11. Shih Mateu 10:29.
12. Abraham 2:8.
13. Doktrina e Besëlidhje 64:29.
14. Letër nga Aida Çilan, 20 prill 2017.
15. Letër nga Aida Çilan, 30 maj 2017.
16. Doktrina e Besëlidhje 84:88.
17. Shih *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2009), 373–382.
18. Helamani 4:24–25.
19. Romakëve 8:28.
20. Moisiu 1:39.
21. Fjalët e Urta 3:5–6.



Nga Plaku O. Vinsent Halek,
i Të Shtatëdhjetëve

Zemra e së Vesë

Ne duhet të bëjmë atë që është e nevojshme për ta pasur zemrën e së vesë, duke u gëzuar me të vërtetë nga bekimet që do ta mbushin "skamjen" që pason.

Kam pasur bekimin e madh që të shërbej mes shenjtërove të Paqësorit për pjesën më të madhe jetësime si i rritur. Besimi, dashuria dhe sakrificat mahnitëse të këtyre shenjtërore të përkushtuar më mbushin me frymëzim, mirënjohje dhe gëzim. Historitë e tyre janë sikurse tuajat.

Kam pasur mendimin se këta shenjtërorë kanë shumë gjëra të përbashkëta me të venë, të cilën Shpëtimtari e vëzhgoi tekta "u ul përballë arkës së thesarit dhe vërente se njerëzit hidhnin aty denar; shumë të pasur hidhnin shumë.

Erdhi një e ve e varfër dhe hodhi dy monedha të vogla. . . .

Dhe Jezusi i thirri dishepujt e vet pranë vetes dhe u tha atyre: 'Ju them në të vërtetë se kjo e ve e varfër ka hedhur në thesar më shumë se të gjithë të tjerët.

Sepse . . . [ata] hodhën aty nga tepërica e tyre, kurse ajo, me skamjen e vet, hodhi gjithë sa kishte për të jetuar.'"¹

Edhe pse dy monedhat e saj të vogla ishin një ndihmesë e paktë, për Shpëtimtarin dhurata e saj kishte një vlerë të madhërishtme, sepse ajo dha gjithçka. Në atë çast, Shpëtimtari e njohu tërësisht të venë ngaqë dhurata e saj i tregoi Atij zemrën e saj. Cilësia dhe thellësia e dashurisë dhe e besimit të

saj ishin të tilla sa ajo dha duke e ditur që "skamj[a]" e saj do të merrte ndihmë.

E kam parë po atë zemër te shenjtërorët e Paqësorit. Në një fshat të vogël, në njërin prej këtyre ishujve, një burrë i moshuar dhe bashkëshortja e tij e pranuan ftesën e misionarëve për t'i kërkuar çiltërsisht Zotit nëse ishin të vërteta mësimet që po u jepeshin. Në këtë proces, ata gjithashtu morën parasysh pasojat e zotimeve që do të kishin nevojë t'i bënin nëse përgjigja që merrnin, do t'i çonte drejt pranimit të ungjillit të rivendosur. Agjëruan dhe

u lutën që të dinin vërtetësinë e Kishës dhe saktësinë e Librit të Mormonit. Përgjigja ndaj lutjeve të tyre erdhi në formën e një pohimi të ëmbël, por të qartë: "Po! Është e vërtetë!"

Pasi e morën këtë dëshmi, ata zgjodhën të pagëzoheshin. Kjo nuk ishte një zgjedhje pa pasojat negative për ta. Vendimi i tyre për ta pranuar ungjillin dhe për t'u pagëzuar mbarti me vete një çmim të lartë. Ata e humbën punësimin, e sakrifkuan pozitën shoqërore, humbën miqësi të rëndësishme dhe u larguan mbështetja, dashuria dhe respekti prej familjes. Tani ata ecnin për në Kishë çdo të diel, duke shkëmbyer vështrime të sikletshme me miqtë e fqinjët, të cilët po ecnin në drejtimin e kundërt.

Në këto rrethana të vështira, këtëj vëllai të mirë iu bë pyetja se çfarë mendonte rreth vendimit të tyre që të bashkoheshin me Kishën. Përgjigja e tij e thjeshtë dhe e palëkundshme ishte: "Është e vërtetë, apo jo? Zgjedhja jonë ishte e qartë."

Këta dy shenjtërorë të porsakthyer në besim me të vërtetë kishin zemrën e së vesë. Ata, sikurse e veja, "hodh[ën] gjithë" sa mund të jepnin, duke dhënë me



vetëdije nga "skamja" e tyre. Si rrjedhojë e zemrës së tyre besuese dhe e besimit të tyre durues gjatë atyre kohëve të vështira, barrët e tyre u lehtësuan. Ata u ndihmuan dhe u rrethuan nga anëtarë përkrahës e shërbyes të Kishës dhe u forcuan personalisht nga shërbimi i tyre në thirrjet e Kishës.

Pasi hodhën "gjith[çkanë]" e tyre, dita më e mrekullueshme erdhi kur u vulosën në tempull si një familje e përjetshme. Sikurse veproi Ai me të kthyerit në besim nën udhëheqjen e Almës, "Zoti i forcoi ata që të mund të duronin barrat e tyre me lehtësi dhe ata iu nënshtuan me gëzim dhe me durim gjithë vullnetit të Zotit"². E tillë është zemra e së vesë, e personifikuar te ky çift i mrekullueshëm.

Lejomëni të flas për një përvojë tjetër ku zemra e së vesë u shfaq me një pamje të plotë. Në Samoa, ne punojmë me këshillat e fshatrave për të marrë leje që misionarët të predikojnë ungjillin. Disa vite më parë, pata një bashkëbisedim me një kryetar nga një fshat ku misionarët nuk ishin lejuar për shumë, shumë vite. Bashkëbisedimi im ndodhi jo shumë kohë pasi kryetari drejtues ia kishte hapur fshatin Kishës, duke i lejuar misionarët tanë që t'iu jepnin mesim njerëzve të interesuar për të mësuar rreth ungjillit dhe doktrinave të tij.

Pas kaq shumë vitesh, kur e patëm këtë ndryshim të mrekullueshëm të ngjarjeve, unë u bëra kureshtar të mësoja rreth asaj që kishte ndodhur që e kishte bërë kryetarin drejtues ta ndërmerre këtë veprim. Pyeta për këtë dhe kryetari me të cilin po bashkëbisedoja, u përgjigj: "Një njeri mund të jetojë në errësirë për njëfarë periudhe, por do të vijë një kohë kur ai do të jetë fort i dëshiruar që të vijë në dritë".

Kryetari drejtues, në hapjen e fshatit, shfaqti zemrën e së vesë – një zemër që zbutet kur i zbulohet ngrohtësia dhe

drita e së vërtetës. Ky udhëheqës ishte i gatshëm të hiqte dorë prej shumë vitesh tradite, të ndeshej me shumë kundërshtim dhe të qëndronte i palëkundur që të tjerët të mund të bekoheshin. Ky ishte një udhëheqës zemra e të cilit u përqendrua te mirëqenia dhe lumturia e popullit të tij, në vend që të mbante parasysht traditën, kulturën dhe pushtetin vetjak. Ai hoqi dorë prej atyre shqetësimeve në përkrahje të asaj që na ka dhënë mësim Presidenti Tomas S. Monson: "Kur e ndjekim shembullin e Shpëtimtarit, e jona do të jetë mundësia për të qenë një dritë në jetën e njerëzve të tjerë"³.

Më së fundi, lejomëni t'ju tregoj edhe një përvojë tjetër mes shenjtorëve të Paqësorit, që mbetet e ngulitur thellësisht e shpirtërisht në qenien time. Disa vite më parë isha një këshilltar i ri i një peshkopi në një lagje të re në Samoan Amerikane. Kishim 99 anëtarë që përbëheshin nga fermerë që prodhonin vetëm për familjet e tyre, punonjës konservimi, punonjës të qeverisë dhe familjet e tyre. Kur Presidenca e Parë shpalli në vitin 1977 se një tempull do të ndërtohej në Samoa, pati gëzim e dhënie falënderimi të shprehura nga ne të gjithë. Të shkoje nga Samoa Amerikane në tempull në atë kohë duhej të udhëtoje për në Havai ose për në Zelandën e Re. Ky qe një udhëtim i shtrenjtë që ishte përtej mundësisë së shumë anëtarëve besnikë të Kishës.

Gjatë kësaj periudhe kohore, anëtarët u nxitën që të dhuronin për një fond ndërtimi, për të dhënë ndihmesë në ndërtimin e tempujve. Me këtë frymë, peshkopata jonë u kërkoi anëtarëve të lagjes që me lutje të merrnin parasysht se çfarë mund të jepnin. U caktua një datë që familjet të mblidheshin për t'i dhënë dhurimet e tyre. Më vonë, kur këto dhurime u hapën në fshehtësi, peshkopata jonë u ndje e përulur dhe e prekur nga besimi dhe

zemërgjerësia e anëtarëve të mrekullueshëm të lagjes sonë.

Duke e njohur secilën familje dhe duke i ditur rrethanat e tyre, unë pata një ndjesi të thellë e të qëndrueshme mahnitjeje, respekti e përlulesie. Këto ishin, në çfarëdo mënyre, monedhat e vogla të së vesë bashkëkohore, të dhëna nga "skamja" e tyre me dëshirë, me gëzim për bekimin e premtuar të ndërtimit të një tempulli të Zotit në Samoa. Këto familje ia kishin përkushtuar Zotit gjithçka që mundeshin, me besimin që nuk do të liheshin pa këtë bekim. Dhurata e tyre tregoi që zemrat e tyre ishin si zemra e së vesë. Të gjithë ata që dhanë, e bënë këtë gjë me gatishmëri e gëzim ngaqë zemra e së vesë brenda tyre mund të shihte me syrin e besimit bekimet e madhërishtme kurorëzuese, të ruajtura për familjet e tyre dhe për të gjithë njerëzit e Samoas dhe të Samoas Amerikane për brezat që do të vinin. E di se dhurimet e tyre të përkushtuara, monedhat e tyre të vogla të të vesë, u njohën dhe u pranuan nga Zoti.

Zemra e së vesë, e cila i dha dy monedhat e saj të vogla, është një zemër që do të japë gjithçka nëpërmjet bërjes së sakrificave; nëpërmjet durimit të vështirësive, përndjekjes dhe mospranimit; dhe nëpërmjet mbartjes së barrëve të shumë llojeve. Zemra e së vesë është një zemër që e kupton, e ndien dhe e njeh dritën e së vërtetës dhe do të japë çfarëdo gjëje për ta përqaftuar atë të vërtetë. Ajo gjithashtu i ndihmon të tjerët që ta shohin po atë dritë dhe që të vijnë tek e njëjta masë lumturie dhe gëzimi të përjetshëm. Më së fundi, zemra e së vesë përcaktohet nga një gatishmëri për të dhënë gjithçka për ndërtimin e mbretërisë së Perëndisë në tokë.


Ne duhet të bashkohemi si shenjtorë anëmbanë botës që të bëjmë atë që

është e nevojshme për ta pasur zemrën e së vesë, duke u gëzuar me të vërtetë nga bekimet që do ta mbushin “skamjen” që pason. Lutja ime për secilin prej nesh është një përgjërëm që të kemi zemrën për t’i mbajtur barrët tona, për të bërë sakrifica të nevojshme dhe për të pasur vullnetin që të bëjnë e të japin. Premtoj se Zoti nuk do t’ju lërë pa bekime. Zemra e së vesë mbushet me falënderim që Shpëtimtari ishte një “njeri i dhembjeve, njohës i vuajtjes”⁴, kështu që neve nuk do të na nevojitej ta shijonim “kupë[n] e hidhur”⁵. Pavarësisht nga dobësitë e dështimet tona dhe për shkak të tyre, Ai vazhdon t’i ofrojë duart e Tij, që u shpuan për hatërin tonë. Ai do të na lartësojë nëse jemi të gatshëm të vijmë te drita e ungjillit të Tij, ta përqafojmë Atë dhe ta lejojmë të na e përmbushë “skamjen” tonë.

Unë jap dëshminë time për dashurinë e madhe që mund të tregojmë si dishepuj dhe pasues të Zotit Jezu Krisht. Unë e dua dhe e mbështet Presidentin Tomas S. Monson si profetin e Perëndisë në tokë. Libri i Mormonit është një dëshmi tjetër e Jezu Krishtit drejtuar botës dhe ju ftoj të gjithëve ta lexoni dhe të zbuloni mesazhin e tij për ju. Të gjithë ata që e pranojnë ftesën e Zotit për të ardhur tek Ai, do të gjejnë paqe, dashuri e dritë. Jezu Krishti është Shembulli dhe Shëlbuesi ynë i madhërishtë. Është vetëm nëpërmjet Jezu Krishtit dhe mrekullisë së Shlyerjes së Tij të pafundme, që ne mund të marrim jetë të përjetshme. Për këtë unë jap dëshmi në emrin e Tij të shenjtë, madje Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Marku 12:41–44.
2. Mosia 24:15.
3. Tomas S. Monson, “Jini një Shembull dhe një Dritë”, *Liahona*, nëntor 2015, f. 88.
4. Isaia 53:3.
5. 3 Nefi 11:11.



Nga Presidenti Rasëll M. Nelson,
President i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Libri i Mormonit: Si do të ishte Jeta Juaj pa Të?

Në një mënyrë shumë të mrekullueshme dhe të pashoqe, Libri i Mormonit na mëson rreth Jezu Krishtit dhe ungjillit të Tij.

Në vitin 1986 mora ftesën për të dhënë një leksion të veçantë në një universitet në Akra të Ganës. Atje takova një numër personalitetesh, përfshirë një mbret të një fisi afrikan. Ndërsa po bisedonim përpara leksionit, mbreti më foli vetëm nëpërmjet përkthyesit të tij, i cili më pas përktheu për mua. Unë iu përgjigja përkthyesit dhe ai më pas ia përkthente përgjigjet e mia mbretit.

Pas leksionit tim, mbreti u afrua drejt meje, por kësaj here pa përkthyesin e vet. Për habinë time, ai më foli shkëlqyeshëm në anglisht – anglishten mbretërore britanike, mund të shtoj!

Mbreti dukej i pështjelluar. “Kush jeni ju?” pyeti ai.

Iu përgjigja: “Unë jam një Apostull i shuguruar i Jezu Krishtit”.

Mbreti më pyeti: “Çfarë mund të më mësoni për Jezu Krishtin?”

Iu përgjigja me një pyetje: “A mund t’ju pyes se çfarë dini rreth Tij?”

Përgjigja e mbretit zbuloi se ai ishte një student i mirëfilltë i Biblës dhe dikush që e donte Zotin.

Më pas unë e pyeta nëse ai kishte njohuri për shërbesën e Jezu Krishtit te njerëzit në Amerikën e lashtë.

Siç e prisja, ai nuk dinte gjë.

I shpjegova se, pas Kryqëzimit dhe Ringjalljes së Shpëtimtarit, Ai erdhi te populli i Amerikës së lashtë, ku dha mësim ungjillin e Tij. Ai e organizoi Kishën e Tij dhe u kërkoi dishepujve të Vet që të mbanin një anal për shërbesën e Tij mes tyre.

“Ai anal”, vazhdova unë, “është ai që ne e njohim si Libri i Mormonit. Ai është një dëshmi tjetër e Jezu Krishtit. Është një shkrim i shenjtë shoqëruar i Biblës së Shenjtë.”

Në këtë pikë, mbreti u bë shumë i interesuar. U ktheva nga presidenti i misionit që më shoqëronte, dhe e pyeta nëse kishte një kopje shtesë të Librit të Mormonit me vete. Ai nxori një kopje nga çanta e dorës.

E hapa te 3 Nefi, kapitulli i 11-të, dhe së bashku me mbretin lexuam predikimin e Shpëtimtarit te nefitët. Më pas ia dhashë atij kopjen e Librit të Mormonit. Përgjigja e tij m’u ngulit përgjithmonë në mendje e në zemër: “Ju mund të më kishit dhënë diamante ose rubinë, por asgjë nuk është më e çmueshme për mua sesa kjo njohuri shtesë rreth Zotit Jezu Krisht”.


Pasi e përjetoi fuqinë e fjalëve të Shpëtimtarit të 3 Nefi, mbreti tha: “Nëse do të kthehem në besim dhe bashkohem me Kishën, do ta sjell gjithë fisin tim me vete”.

“O, mbret”, iu përgjigja, “nuk funksionon në atë mënyrë. Kthimi në besim është një çështje individuale. Shpëtimtari u shërbeu nefeitëve një e nga një. Çdo individ merr një dëshmim dhe një dëshmi për ungjillin e Jezu Krishtit.”¹

Vëllezërit dhe motrat e mia, sa i çmuar *është* Libri i Mormonit për ju? Nëse do t’ju ofronin diamante apo rubinë ose Librin e Mormonit, cilin do të zgjidhni? Sinqerisht, cila *ka* më shumë vlerë për ju?

Kujtoni se në sesionin e paradites të së dielës të konferencës së përgjithshme të prillit 2017, Presidenti Tomas S. Monson iu përgjyera “secilit prej nesh që me lutje ta studioj[m]ë dhe ta përsiat[im] Librin e Mormonit çdo ditë”². Shumë i janë përgjigjur përgjërimit të profetit tonë.

Më lejoni t’ju them se as unë e as Rajlli tetëvjeçar nuk e dinim se do të na merrte dikush në fotografi. Vëreni se Rajlli po e lexon Librin e tij të Mormonit me ndihmën e një libërshenjuesi që titullohet “Fëmijë i Perëndisë Jam”.



Rajlli duke lexuar Librin e tij të Mormonit me ndihmën e një libërshenjuesi me ilustrimin “Fëmijë i Perëndisë Jam”.



Presidenti Nelson po e ndjek këshillën e Presidentit Tomas S. Monson, të dhënë në konferencën e përgjithshme të prillit 2017, për ta studiuar dhe përsiatur Librin e Mormonit çdo ditë.

Diçka e mrekullueshme ndodh kur një fëmijë i Perëndisë kërkon të dijë më shumë rreth Tij dhe Birit të Tij të Dashur. Askund tjetër nuk jepen mësim më qartë dhe më fuqishëm këto të vërteta sesa në Librin e Mormonit.

Që nga sfida e Presidentit Monson gjashtë muaj më parë, unë jam përpjekur ta ndjek këshillën e tij. Mes gjërash të tjera, kam bërë lista se çfarë *është* Libri i Mormonit, çfarë *pohon*, çfarë *përgënjeshtron*, çfarë *përmbush*, çfarë *sqaron* dhe çfarë *zbulon*. Qasja ndaj Librit të Mormonit në atë këndvështrim ka qenë një ushtrim mbresëlënës dhe frymëzues! Jua rekomandoj secilit prej jush.

Gjatë këtyre gjashtë muajve, kam ftuar grupe të ndryshme – përfshirë Vëllezërit e mi në Kuorumin e Të Dymbëdhjetëve, misionarë në Kili dhe presidentët e misioneve dhe bashkëshortet e tyre të mbledhur në Argjentinë – për të shqyrtuar tri pyetje që lidhen njëra me tjetrën, ndaj të cilave ju ftoj që të mendoni sot:

Së pari, si do të ishte jeta juaj *pa* Librin e Mormonit? Së dyti, çfarë *nuk do të dinit*? Dhe së treti, çfarë *nuk do të kishit*?

Përgjigjet entuziazmuese nga këto grupe erdhën direkt nga zemra e tyre. Ja vetëm disa prej komenteve të tyre:

“Pa Librin e Mormonit, do të isha i pështjelluar nga mësimet dhe opinione që bien ndesh për kaq *shumë* gjëra. Do të isha njësoj siç isha përpara se ta gjeja Kishën, kur po kërkoja njohuri, besim dhe shpresë.”

Një tjetër tha: “Unë nuk do të dija rreth rolit që Fryma e Shenjtë mund të luajë në jetën time”.

Një tjetër: “Nuk do ta kuptoja plotësisht qëllimin tim këtu në tokë!”

Një komentues tjetër tha: “Nuk do ta dija se ka një përparim të vazhdueshëm pas kësaj jete. Për shkak të Librit të Mormonit, unë e di se ka vërtet jetë pas vdekjes. Ky është synimi përfundimtar për të cilin po punojmë.”



Nga Libri i Mormonit ne mësojmë rreth mbledhjes së Izraelit të shpërndarë. Ne e dimë arsyen përse jemi këtu në tokë. Këto dhe të vërteta të tjera janë dhënë mësim në mënyrën më të fuqishme dhe bindëse në Librin e Mormonit sesa në ndonjë libër tjetër. Fuqia e plotë e ungjillit të Jezu Krishtit përmbahet në Librin e Mormonit. Pa dyshim.

Libri i Mormonit u jep dritë mësimëve të Mësuesit sikurse dhe nxjerr në pah taktikat e kundërshtarit.⁷ Libri i Mormonit jep mësim doktrinën e vërtetë për të zhdukur traditat e rreme fetare – të tilla si praktika e gabuar e kryerjes së pagëzimit të foshnjave.⁸ Libri i Mormonit i jep qëllim jetës duke na nxitur që të meditojmë mundësinë e jetës së përjetshme dhe të “lumturi[së] pafund”.⁹ Libri i Mormonit i shuan bindjet e rreme se lumturia mund të gjendet në ligësi¹⁰ dhe se mirësia e individit është gjithçka që kërkohet për t’u kthyer në praninë e Perëndisë.¹¹ Ai i shpërbën përgjithmonë konceptet e rreme se zbulesa mbaroi me Biblën dhe se qiejt janë të vulosur sot.

Kur unë mendoj për Librin e Mormonit, mendoj për fjalën *fuqi*. Të vërtetat e Librit të Mormonit kanë *fuqinë* ta shërojnë, ngushëllojnë, rivendosin, ndihmojnë, forcojnë, përkrahin dhe gëzojnë shpirtin tonë.

Vëllezërit dhe motra e mia të dashura, unë ju premtoj se, kur e studioni me lutje Librin e Mormonit *çdo ditë*, ju do të merrni vendime më të mira – *çdo ditë*. Ju premtoj se, teksa e përsiatni atë që studioni, dritaret e qiellit do të hapen dhe ju do të merrni përgjigje për vetë pyetjet tuaja dhe drejtim për vetë jetën tuaj. Ju premtoj se, ndërsa e zhytni veten përditë në Librin e Mormonit, ju mund të fitoni imunitet kundër të ligave të ditës, përfshirë edhe murtajen dërrmuese të pornografisë dhe varësive të tjera që na mpijnë mendjen.

Ky koment i fundit më bëri të reflektoj për jetën time dekada më parë, kur isha një kirurg praktikant i ri në moshë. Një nga përgjegjësitë kryesore që ka një kirurg, sipas rastit, është që ta vërë në dijeni familjen kur një njeri i dashur ndërrohet jetë. Në një spital ku punoja, u ndërtua një dhomë e veçantë me mure të veshura [me shtresë të butë], ku pjesëtarët e familjes mund t’i merrnin lajme të tilla. Atje, disa njerëz e shprehnin pikëllimin e tyre duke e përplasar kokën tek ato mure të veshura. Jam përpjekur aq shumë që t’u mësoja atyre individëve se vdekja, sado e vështirë që është për njerëzit e dashur që jetojnë, është një pjesë e nevojshme e ekzistencës sonë të pavdekshme. Vdekja na lejon të përparojmë në botën tjetër.³

Një komentues tjetër ndaj pyetjes sime tha: “Nuk kisha një jetë deri në çastin kur lexova Librin e Mormonit. Edhe pse isha lutur dhe kisha shkuar në kishë gjithë jetën time, Libri i Mormonit më ndihmoi që, për herë të parë, të komunikoj me të vërtetë me Atin Qiellor.”

Një tjetër tha: “Pa Librin e Mormonit nuk do ta kuptoja se Shpëtimtari jo vetëm që vuajti për mëkatet e mia, por që Ai mund t’i shërojë dhembjet dhe hidhërimet e mia.”⁴

Dhe sërish një tjetër tha: “Nuk do ta dija se kemi profetë që na udhëheqin”.

Ta zhytësh veten rregullisht në të vërtetat e Librit të Mormonit mund të jetë një përvojë që të ndryshon jetën.

Një nga mbesat e mia misionare, Motra Olivia Nelson, i premtoi një kërkuesi se, po ta lexonte Librin e Mormonit çdo ditë, pikët në provimet e tij në universitet do të përmirësoheshin. Ai e bëri këtë dhe pikët u përmirësuan.

Vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, unë dëshmoj se Libri i Mormonit është vërtet fjala e Perëndisë. Ai përmban përgjigjet për pyetjet më të vështira të jetës. Ai na mëson doktrinën e Krishtit.⁵ Ai e zgjeron dhe e qartëson shumicën e të vërtetave të “qarta dhe të çmueshme”⁶ që humbën ndër shekujt e kohës dhe prej përkthimeve të shumta të Biblës.

Libri i Mormonit jep kuptueshmëri më të plotë dhe më të besueshme për Shlyerjen e Jezu Krishtit që gjendet në ndonjë vend. Ai na mëson se çfarë do të thotë vërtet të lindesh sërish.



Mbesa e Presidentit Nelson, Olivia.

Sa herë që dëgjoj dikë, përfshirë dhe veten, të thotë: “E di se Libri i Mormonit është i vërtetë”, dua ta them me zë të lartë: “Gjë e mirë, por nuk mjafton!” Neve na nevojitet të ndiejmë, në “pjes[ën] më [të] thellë” të zemrës sonë¹², se Libri i Mormonit është pa dyshim fjala e Perëndisë. Ne duhet ta ndiejmë atë kaq thellësisht sa kurrë nuk do të duam të jetojmë qoftë edhe një ditë pa të. Unë mund ta parafrazoj Presidentin Brigam Jang kur tha: “Do të doja të kisha zërin e shtatë bubullimave që t’i zgjoja njerëzit”¹³ ndaj së vërtetës dhe fuqisë së Librit të Mormonit.

Na nevojitet të jemi si ky misionar i ri që shërben në Europë, i cili i ndjeu kaq thellësisht të vërtetat e Librit të Mormonit sa që me plot kuptimin e fjalës vranoi me një kopje të këtij anali të shenjtë, drejt një burri në park që sapo e kishin gjetur ai dhe shoku i tij i misionit.

Unë dëshmoj se Jozef Smithi ishte dhe është *profeti* i kësaj periudhe të fundit ungjillore. Ishte ai i cili, me anë të dhuratës dhe fuqisë së Perëndisë, e përktheu këtë libër të shenjtë. Ky është *libri* që do të ndihmojë për ta përgatitur botën për Ardhjen e Dytë të Zotit.



Një misionar i ri vrapon për t’ia dhënë Librin e Mormonit një burri në një park.

Unë dëshmoj se Jezu Krishti është Biri i drejtpërdrejtë dhe i gjallë i Perëndisë sonë të gjallë. Ai është Shpëtimtari ynë, Shëlbuesi ynë, Shembulli ynë i madhërishtëm dhe Avokati ynë me Atin. Ai ishte Mesia i premtuar, Mesia i vdekshëm dhe do të jetë Mesia i mijëvjeçarit. Unë dëshmoj me gjithë shpirtin tim se, në një mënyrë shumë të mrekullueshme dhe të pashoqe, Libri i Mormonit na mëson rreth Jezu Krishtit dhe ungjillit të Tij.

Unë e di se Presidenti Tomas S. Monson është profeti i Perëndisë në tokë sot. Unë e dua dhe e mbështet atë me gjithë zemrën time. Unë dëshmoj kështu, në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen. ■

Listat e Librit të Mormonit të Presidentit Nelson.

Libri i Mormonit është:

- Një Dëshmi Tjetër e Jezu Krishtit. Shkruesit e tij kryesorë – Nefi, Jakobi, Mormoni, Moroni – dhe përkthyesi i Tij, Jozef Smithi, ishin të gjithë dëshmitarë okularë të Zotit.
- Një anal i shërbesës së Tij të njerëzit që jetuan në Amerikën e lashtë.
- I vërtetë, siç pohohet nga vetë Zoti.

Libri i Mormonit pohon:

- Identitetin individual të Atit Qiellor dhe Birit të Tij të Dashur, Jezu Krishtit.
- Domosdoshmërinë e Rënies së Adamit dhe të urtësisë së Evës, që njerëzit të mund të kenë gëzim.

Libri i Mormonit përgënjeshtro

pikëpamjet se:

- Zbulesa mbaroi me Biblën.
- Foshnjat kanë nevojë të pagëzohen.
- Lumturia mund të gjendet në ligësi.
- Mirësia individuale është çka duhet për ekzaltimin. (Ordinancat dhe besëlidhjet janë të nevojshme).
- Rënia e Adamit e njollosoi njerëzimin me “mëkatën fillestar”.

Libri i Mormonit përmbush profecitë

biblike se:

- “Dele të tjera” do ta dëgjojnë zërin e Tij.
- Perëndia do të bëjë “një vepër të mrekullueshme dhe një çudi” duke folur nga “pluhuri”.
- “Druri [i] Judës” dhe “druri [i] Jozefit” do të bëhen një.
- Izraeli i shpërndarë do të mblidhet “në mbarim të ditëve” dhe se si do të ndodhë kjo.

- Vendi i trashëgimisë për pasardhësit e Jozefit është hemisfera perëndimore.

Libri i Mormonit sqaron kuptueshmërinë rreth:

- Ekzistencës sonë para lindjes.
- Vdekjes. Ajo është një përbërës i domosdoshëm i planit të madh të Perëndisë për lumturinë.
- Ekzistencës para lindjes, e cila fillon në parajsë.
- Mënyrës se si ringjallja e trupit, e ribashkuar me shpirtin, bëhet një shpirt i pavdekshëm.
- Mënyrës se si gjykimi i Zotit për ne do të jetë sipas veprave dhe dëshirave tona të zemrës.
- Mënyrën se si kryhen siç duhet ordinancat: për shembull, pagëzimi, sakramenti, dhënia e Frymës së Shenjtë.
- Shlyerjes së Jezu Krishtit.
- Ringjalljes.
- Rolit të rëndësishëm të engjëjve.
- Natyrës së përjetshme të priftërisë.
- Mënyrës se si ndikohet sjellja njerëzore më shumë nëpërmjet fuqisë së fjalës sesa fuqisë së shpatës.

Libri i Mormonit zbulon informacion të panjohur më parë:

- Pagëzime u kryen përpara se Jezu Krishti të lindte.
- Tempuj u ndërtuan dhe u përdorën nga njerëzit në Amerikën e lashtë.
- Jozefi, biri i 11-të i Izraelit, parashikoi rolin profetik të Jozef Smithit.
- Nefi (në vitet 600–592 pr.K.) parashikoi zbulimin dhe kolonizimin e Amerikës.
- Pjesë të qarta e të çmueshme të Biblës janë humbur.
- Drita e Krishtit i është dhënë çdo njeriu.
- Rëndësia e lirisë individuale të zgjedhjes dhe nevoja për kundërshtim në të gjitha gjërat.
- Paralajmërimet rreth “lidhje[ve] të fshehta”.

SHËNIME

1. Shih 3 Nefi 17:9–12.
2. Tomas S. Monson, “Fuqia e Librit të Mormonit”, *Liahona*, maj 2017, f. 87.
3. Shih Alma 42:8.
4. Shih Alma 7:11–12.
5. Shih, për shembull, 2 Nefi 31:2–21.
6. Shih 1 Nefi 13:29–33.
7. Shih 2 Nefi 26–33.
8. Shih Moroni 8:11–15.
9. Mosia 2:41; shih edhe Alma 28:12.
10. Shih Alma 41:10–11.
11. Ordinanca dhe besëlidhje të veçanta, të shenjta kërkohen gjithashtu.
12. Shih Alma 13:27.
13. Shih *Teachings of Presidents of the Church: Brigham Young* (1997), f. 299. Ai po i referohej rëndësisë së tempullit dhe të punës për historinë familjare.



Nga Plaku Dejjl G. Renland,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Priftëria dhe Fuqia Shlyese e Shpëtimtarit

Në mënyrë që qëllimet e Atit Qiellor të përmbushen, fuqia shlyese e Krishtit duhet t'u vihet në dispozicion fëmijëve të Perëndisë. Priftëria i përçon këto mundësi.

Përfytyrojeni bashkë me mua një raketë të cilën po e manovrojnë drejt një pike lëshimi në mënyrë që të përgatitet për nisje. Tani, imagjinojeni ndezjen. Lënda djegëse, me një djegie të kontrolluar, kthehet në gaz të nxehtë që del jashtë vrullshëm, duke siguruar shtytjen e nevojshme për ta çuar raketën në hapësirë. Së fundmi, parafytyrojeni ngarkesën e çmuar apo pajisjen që qëndron në majë të raketës. Vlera e ngarkesës së çmuar së raketës kuptohet plotësisht vetëm kur ajo arrin atje ku duhet të jetë dhe funksionon siç duhet. Ju nuk keni nevojë të jeni shkencëtarë raketash për të kuptuar se një satelit i kushtueshëm komunikimi botëror ka pak vlerë nëse rri në magazinë. Misioni i raketës është thjesht që ta çojë një ngarkesë të çmuar [aty ku duhet].

Këtë mbrëmje, do të doja ta krahasoja *priftërinë që ne mbajmë* me një raketë dhe *mundësinë për të përfituar nga fuqia shlyese e Shpëtimtarit* me ngarkesën e çmuar që një raketë çon.

Për shkak të sakrificës së Tij shlyese, Jezu Krishti ka fuqinë dhe autoritetin për ta shëlbuar të gjithë njerëzimin.

Për ta bërë të përdorshme fuqinë e Tij shlyese, Ai ia ka deleguar një pjesë të fuqisë dhe autoritetit të Tij burrave në tokë. Kjo fuqi dhe ky autoritet i deleguar quhet *priftëri*. Ajo u lejon mbajtësve të priftërisë ta ndihmojnë Atin Qiellor dhe Jezu Krishtin në punën e Tyre – për të sjellë shpëtimin dhe ekzaltimin e fëmijëve të Perëndisë. Ajo e bën atë ngaqë u siguron fëmijëve

të Tij mundësinë për të marrë bekimet e fuqisë shlyese të Shpëtimtarit.

Fuqia shlyese e Jezu Krishtit është thelbësore ngaqë asnjëri prej nesh nuk mund të rikthehet në shtëpinë tonë qiellore pa ndihmë. Në vdekshmëri, ne përherë bëjmë gabime dhe i shkelim ligjet e Perëndisë. Ne njollosemi nga mëkati dhe nuk mund të lejohe mi që të kthehemi të jetojmë në praninë e Perëndisë. Ne kemi nevojë për fuqinë shlyese të Shpëtimtarit që të mund të pajtohemi me Atin Qiellor. Jezu Krishti i këputi lidhjet e vdekjes fizike, duke lejuar ringjalljen për të gjithë. Ai ofron falje për mëkatet, të kushtëzuar nga bindja ndaj ligjeve dhe ordinancave të ungjillit të Tij. Nëpërmjet Tij, ofrohet ekzaltimi. Mundësia për të përfituar nga fuqia shlyese e Shpëtimtarit është ngarkesa e çmuar më e rëndësishme e krijimit.

Në mënyrë që qëllimet e Atit Qiellor të përmbushen, fuqia shlyese e Krishtit duhet t'u vihet në dispozicion fëmijëve të Perëndisë.¹ Priftëria i përçon këto mundësi. Ajo është raketa. Priftëria është thelbësore pasi ordinancat dhe





besëlidhjet e domosdoshme në tokë administrohen vetëm nëpërmjet autoritetit të saj. Nëse priftëria nuk arrin ta përçojë mundësinë për të përfutur nga fuqia shlyese e Shpëtimtarit, cili do të ishte qëllimi i saj? A nuk do të ishte ajo thjesht një fishekzjarr i ndërlikuar për të tërhequr vëmendjen? Perëndia ka për qëllim që priftëria të përdoret për më tepër sesa vetëm një orë mësimore të dielën apo vetëm si mundësi shërbimi. Ai ka për qëllim që ajo të çojë ngarjesën e çmuar.

Defekte të vogla në raketë mund të shkaktojnë dështim të misionit. Guarnicione të vjetërsuara dhe dobësimi i materialeve mund ta bëjnë një raketë që të keqfunksionojë. Në mënyrë metaforike, për ta ruajtur priftërinë nga guarnicionet e vjetërsuara dhe dobësimi i materialeve, Perëndia e mbron edhe dhënien, edhe përdorimin e saj.² Dhënia e priftërisë ruhet nga çelësat e priftërisë, të cilët janë të drejtat e kryesimit që i janë dhënë njeriut.³ Përdorimi i priftërisë ruhet në të njëjtën mënyrë nga çelësat e priftërisë, por edhe nga besëlidhjet që bën mbajtësi i priftërisë. Përdorimi i priftërisë, për rrjedhojë, udhëhiqet edhe nga çelësat e priftërisë, edhe nga besëlidhjet. Autorizimi në priftëri i një burri jepet individualisht

dhe është pjesë e pandashme prej tij;⁴ priftëria nuk është një burim i patrajtë i fuqisë autonome.

Si priftëria Aarone, ashtu edhe ajo Melkizedeke merren me anë të një besëlidhjeje.⁵ Perëndia i përcakton kushtet dhe njeriu i pranon. E thënë në vija të trasha, mbajtësit e priftërisë bëjnë besëlidhje që ta ndihmojnë Perëndinë në punën e Tij. Në fillimet e kësaj periudhe ungjillore, Jezu Krishti shpjegoi se besëlidhja e priftërisë “është dhënë mbi ju për hirin tuaj dhe jo vetëm për hirin tuaj, por për hir të të gjithë botës . . . ngaqë ata nuk vijnë tek unë”⁶.

Kjo na mëson se qëllimi i priftërisë është që t’i ftojë të tjerët të vijnë te Krishti duke i ndihmuar ata të marrin ungjillin e rivendosur. Ne e kemi priftërinë në mënyrë që të mund t’i ndihmojmë fëmijët e Atit Qiellor të çlirohen nga barra e mëkatit dhe të bëhen si Ai. Nëpërmjet priftërisë, fuqia e perëndishmërisë manifestohet në jetën e të gjithë atyre që i bëjnë dhe i mbajnë besëlidhjet e ungjillit dhe i marrin ordinancat e lidhura [me to].⁷ Kjo është mënyra se si secili prej nesh vjen te Krishti, pastrohet dhe pajtohet me Perëndinë. Fuqia shlyese e Krishtit bëhet e përdorshme nëpërmjet priftërisë, e cila e çon ngarjesën e çmuar.

Besëlidhjet me Perëndinë janë serioze dhe solemne. Një burrë duhet të përgatitet për besëlidhje të tilla, të mësojë rreth tyre dhe të hyjë në ato besëlidhje me qëllimin për t’i nderuar. Besëlidhja bëhet një zotim i vetes. Duke parafrazuar dramaturgun anglez Robert Bolt, një burrë bën një besëlidhje vetëm kur ai dëshiron ta zotojë vetveten në mënyrë krejt të jashtëzakonshme ndaj një premtimi. Ai krijon një lidhje ndërmjet të vërtetës së premtimit dhe virtutit të tij vetjak. Kur një burrë bën një besëlidhje, ai po e mban veten sikurse ujin me pëllëmbët e veta të mbledhura. Dhe nëse i hap gishtat, ai nuk ka kurrsesi arsye të shpresojë se do ta gjejë më veten. Një shkelës besëlidhjeje nuk ka më një vetvete që ta zotojë apo një garanci që ta japë.⁸

Një mbajtës i Priftërisë Aarone bën besëlidhje që ta shmangë të ligën, t’i ndihmojë të tjerët të pajtohen me Perëndinë dhe të përgatitet për të marrë Priftërinë Melkizedeke.⁹ Këto përgjegjësi të shenjta përmbushen kur ai jep mësim, pagëzon, i forcon anëtarët e Kishës dhe i fton të tjerët ta pranojnë ungjillin. Këto janë funksionet e tij “raketore”. Në këmbim, Perëndia premtton shpresë, falje, shërbesën e engjëjve



dhe çelësat e ungjillit të pendimit dhe pagëzimit.¹⁰

Një mbajtës i Priftërisë Melkizedeke bën besëlidhje për t'i përmbushur përgjegjësitë e lidhura me Priftërinë Aarone dhe për ta lartësuar thirrjen e tij në Priftërinë Melkizedeke.¹¹ Ai e bën atë nëpërmjet mbajtjes së urdhërimeve të lidhura me besëlidhjen. Këto urdhërime përfshijnë mbajtjen “vesh me zell [të] fjalëve të jetës së përjetshme” duke jetuar me çdo fjalë që del nga goja e Perëndisë,¹² dhënien e dëshmisë për Jezu Krishtin dhe veprën e Tij të ditëve të mëvonshme,¹³ mosburrjen e vetvetes¹⁴ dhe bërjen mik me Shpëtimtarin, duke i mirëbesuar Atij siç do të bënte një mik.¹⁵

Në këmbim, Perëndia premtonte se një mbajtës i Priftërisë Melkizedeke do të marrë çelësa për t'i kuptuar misteret e Perëndisë. Ai do të bëhet i përkryer, në mënyrë që të mund të qëndrojë në prani të Perëndisë. Ai do të jetë në gjendje ta përmbushë rolin e tij në punën e shpëtimit. Jezu Krishti do ta përgatitë udhën përpara mbajtësit të priftërisë dhe do të jetë me të. Fryma e Shenjtë do të jetë në zemrën e mbajtësit të priftërisë dhe engjëjt do ta ngrenë atë lart. Trupi i Tij do të forcohet e ripërtërihet. Ai do të bëhet trashëgimtar i bekimeve të Abrahamit dhe, së bashku me gruan e tij, bashkëtrashëgimtar me Jezu Krishtin i mbretërisë së Atit Qiellor.¹⁶ Këto janë “premtime [të] çmueshme dhe shumë

të mëdha”¹⁷. Premtime më të mëdha nuk mund të imagjinohen.

Secilit burrë që merr Priftërinë Melkizedeke, Perëndia ia pohon premtimet e Tij të besëlidhjes me një betim.¹⁸ Ky betim i përket vetëm Priftërisë Melkizedeke¹⁹ dhe është Perëndia, jo mbajtësi i priftërisë, që e bën betimin.²⁰ Për shkak se kjo situatë e pashoqe përfshin fuqinë dhe autoritetin e Tij hyjnor, Perëndia përdor një betim, duke përdorur të folurin më të fuqishëm që mundet, për të na siguruar për natyrën detyruese dhe të pakthyeshme të premtimeve të Tij.

Pasojë të ashpra rrjedhin nga thyerja e besëlidhjeve të priftërisë dhe nga largimi tërësisht prej tyre.²¹ Të qenit i shkujdesur apo i plogësht në një thirrje priftërie është si të përfshish material të dobësuar në një komponent të raketës. Ajo e vë në rrezik besëlidhjen e priftërisë për shkak se mund të çojë në dështim të misionit. Mosbindja ndaj urdhërimeve të Perëndisë e thyen besëlidhjen. Bekimet e premtuara zmbarsen për një shkelës të vazhdueshëm, të papenduar të besëlidhjeve.

Unë arrita ta kuptoj më plotësisht marrëdhënien midis raketës së “priftërisë” dhe ngarkesës së çmuar së “mundësisë për të përfituar nga fuqia shlyese e Krishtit” disa vite më parë. Gjatë një fundjave, kisha dy detyra. E para ishte që të krijoja kunjin e parë në një vend dhe tjetra ishte që të intervistoja një të ri dhe, nëse çdo gjë ishte në rregull, t'i riktheja priftërinë

dhe bekimet e tempullit. Ky burrë 30-vjeçar që bashkuar me Kishën nga fundi i adoleshencës së tij. Ai shërbeu një mision plot nder. Por, kur u kthye në shtëpi, e humbi udhën dhe humbi anëtarësinë e tij në Kishë. Pas disa vitesh, “erdhi në vete”²² dhe me ndihmën e udhëheqësve të përzemërt të priftërisë dhe anëtarëve të dashur, u pendua dhe u ripranua nëpërmjet pagëzimit në Kishë.

Më vonë, ai bëri kërkesë për rikthimin e priftërisë dhe bekimeve të tij të tempullit. Ne vendosëm një takim për të shtunën në orën 10 paradite në shtëpinë e mbledhjeve. Kur mbërrita për intervistat e para, ai ishte tanimë atje. Ishte aq në ankth për ta marrë sërish priftërinë, saqë thjesht nuk mund të priste.

Gjatë intervistës sonë, i tregova letrën që shpjegonte se Presidenti Tomas S. Monson e kishte shqyrtuar personalisht kërkesën e tij dhe e kishte autorizuar intervistën. Ky i ri ndonëse stoik, qau. Më pas, i thashë se data e intervistës sonë nuk do të kishte kurrfarë domethënie zyrtare në këtë jetë. Ai shikoi i hutuar. I bëra të ditur se pasi t'ia riktheja bekimet, dokumenti i tij i anëtarësisë do të shfaqte vetëm datat fillestare të pagëzimit, konfirmimit, shugurimit në priftëri dhe marrjes së indaumentit [dhurimit]. Iu mbajt fryma sërish.

I kërkoja që të lexonte nga Doktrina e Besëlidhje:

“Vini re, ai që është penduar për mëkatet e tij, po ai falet dhe unë, Zoti, nuk i kujtoj më ato.

Në këtë mënyrë ju mund të dini nëse një njeri pendohet për mëkatet e tij—vini re, ai do t'i rrefejë ato e do t'i braktisë ato.”²³

Sytë iu mbushën me lot për herë të tretë. Më pas, i vendosa duart mbi kokën e tij dhe në emrin e Jezu Krishtit e me anë të autoritetit të Priftërisë

Melkizedeke, dhe me autorizimin e Presidentit të Kishës, ia riktheva priftërinë dhe bekimet e tempullit.

Gëzimi që na pushtoi që i thellë. Ai e dinte se ishte përsëri i autorizuar ta mbante dhe ta ushtronte priftërinë e Perëndisë. Ai e dinte se bekimet e tij të tempullit u kthyen tërësisht në fuqi. Kishte një hov në ecjen e tij dhe dritë rrëzëlluese në të. Isha kaq krenar për të dhe ndjeva se sa krenar ishte Ati Qiellor për të, gjithashtu.

Pas kësaj, u organizua kunji. Mbledhjet patën pjesëmarrje të mirë nga shenjtorë të entuziazuar, besnikë dhe u mbështet një presidencë e mrekullueshme kunji. Sidoqoftë, për mua, ngjarja historike e organizimit të këtij kunji të parë në vend mbeti prapa nga gëzimi që ndjeva për rikthimin e bekimeve këtij të riu.

Kam arritur të kuptoj se qëllimi i organizimit të një kunji, apo i përdorimit të priftërisë së Perëndisë në çfarëdo mënyre, është që ta ndihmojnë Atin Qiellor dhe Jezu Krishtin në punën e Tyre – për t'i siguruar mundësinë për shëlbim dhe ekzaltim secilit fëmijë të Perëndisë. Ashtu si raketa qëllimi i së cilës është që të çojë një ngarkesë të çmuar, priftëria e përçon ungjillin e Jezu Krishtit, duke u dhënë mundësi të gjithëve që të bëjnë besëlidhje dhe të marrin ordinancat e lidhura [me to]. “Gjaku shlyes [i] Krishtit”²⁴ mund të zbatohet në këtë mënyrë në jetën tonë ndërsa përjetojmë ndikimin shenjtërisht të Frymës së Shenjtë dhe marrim bekimet që premtan Perëndia.

Përveç bindjes ndaj ligjeve dhe ordinancave të ungjillit nga ana juaj, ju ftoj që të bëni e mbani besëlidhjet e priftërisë. Merreni betimin e Perëndisë dhe premtimin e Tij. Lartësojini përgjegjësitë tuaja në priftëri për ta ndihmuar Atin Qiellor dhe Jezu Krishtin. Përdorini priftërinë që të ndihmoni për t'a

përçuar për te dikush tjetër mundësinë për të përfutur nga fuqia shlyese e Shpëtimtarit! Ndërsa e bëni atë, bekime të mrekullueshme do t'ju vijnë juve dhe familjes suaj. Dëshmoj se Shëlbuesi jeton dhe e udhëheq këtë punë, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih 1 Nefi 11:31; 2 Nefi 2:8.
2. Shih Doktrina e Besëlidhje 121:36.
3. Shih Doktrina e Besëlidhje 42:11; shih edhe Dallin H. Oaks, “Çelësat dhe Autoriteti i Priftërisë”, *Liahona*, maj 2014, f. 49–52.
4. Shih Doktrina e Besëlidhje 124:95, 130, 132. Priftëria që merr një burrë është po aq pjesë [e pandashme] e tij sa fuqia shlyese e Krishtit është pjesë [e pandashme] e Krishtit.
5. Referencat për një besëlidhje të lidhur me priftërinë më të ulët gjenden te Numrat 25:10–13; Nehemia 13:29; dhe Malakia 2:2–8. Referencat për një besëlidhje të lidhur me Priftërinë Melkizedeke gjenden te Përkthimi prej Joseph Smith-it, Zanafilla 14:26–37 (tek Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta, f. 219–220); Psalmeve 110:1, 4; dhe Doktrina e Besëlidhje 84:39–42. Shih edhe Bruce R. McConkie, “The Doctrine of the Priesthood”, *Ensign*, maj 1982, f. 32–34.
6. Doktrina e Besëlidhje 84:48, 50.
7. Shih Doktrina e Besëlidhje 84:19–21.



8. Shih Robert Bolt, *A Man for All Seasons: A Play in Two Acts* (1990), f. xiii–xiv, 140.
9. Shih Numrat 25:12–13; Nehemia 13:29; Ezekieli 34:2–6; Malakia 2:2–9; Doktrina e Besëlidhje 13:1; 20:46–59; 84:33–40.
10. Shih Hebrejve 7:19; Doktrina e Besëlidhje 84:26–27.
11. Shih Doktrina e Besëlidhje 84:33.
12. Shih Doktrina e Besëlidhje 84:43–44.
13. Shih Doktrina e Besëlidhje 84:61–62.
14. Shih Doktrina e Besëlidhje 84:73.
15. Shih Doktrina e Besëlidhje 84:77–88.
16. Shih Përkthimi prej Joseph Smith-it, Zanafilla 14:26–37 (tek Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta, f. 219–220); Hebrejve 7:11; Doktrina e Besëlidhje 84:19, 33–34, 38, 42, 77–88.
17. 2 Pjetër 1:4.
18. Shih Përkthimi prej Joseph Smith-it, Zanafilla 14:27–31 (tek Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta, f. 219–220); Psalmeve 110:1, 4; Përkthimi prej Joseph Smith-it, Hebrejve 7:19–21 (te Bible Dictionary [Fjalori Biblik] në variantin SHDM të Biblës në anglisht); Doktrina e Besëlidhje 84:33–40, 48.
19. Shih *The Teachings of Ezra Taft Benson* (1988), f. 223; Joseph Fielding Smith, në Conference Report, prill 1970, f. 59; *Teachings of the Prophet Joseph Smith*, përgj. Joseph Fielding Smith (1976), f. 323.
20. Nuk ka ndonjë referencë apo rrëfim të shkrimet e shenjtë të bërjes nga marrësi të një betimi kur bën besëlidhjen e Priftërisë Melkizedeke. Përkundrazi, te Përkthimi prej Joseph Smith-it, Zanafilla 14:27–31 (tek Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta, f. 219–220); Psalmeve 110:1, 4; Hebrejve 7:21; dhe Doktrina e Besëlidhje 84:40, është Perëndia që bën një betim kur e bën besëlidhjen me marrësin. Plaku Brus R. Mek-Konki tha: “Zoti betohet me një betim në vetë emrin e Tij . . . që cilido që e mban besëlidhjen e bërë në lidhje me Priftërinë Melkizedeke do të trashëgojë, marrë dhe zotërojë të gjitha gjërat në mbretërinë e Tij të pambarim . . . Perëndia u betua me një betim se Krishti do të ekzaltohej dhe Ai betohet rishitas, në kohën kur secili prej nesh merr Priftërinë Melkizedeke, që ne do të kemi një ekzaltim të ngjashëm nëse jemi të vërtetë dhe besnikë në të gjitha gjërat” (“The Doctrine of the Priesthood”, f. 33).
21. Shih Doktrina e Besëlidhje 84:41–42. Pendimi është përherë i mundur për ata që janë të gatshëm të ndryshojnë. Shih, për shembull, Dejll G. Renland, “Pendimi: Një Zgjedhje e Gëzueshme”, *Liahona*, nëntor 2016, f. 121–124.
22. Lluca 15:17.
23. Doktrina e Besëlidhje 58:42–43.
24. Mosia 4:2.



Nga Plaku Dejvid F. Evans,
i Të Shtatëdhjetëve

E Vërteta e të Gjitha Gjërave

Secili prej nesh ka përgjegjësi vetjake që të bëjë atë çka është e nevojshme për ta marrë dhe për ta ruajtur një dëshmi të fortë.

Sonte vijmë me shpresën dhe besimin që në njëfarë mënyre, ne do të largohemi që këtu të forcuar e të bekuar nga Fryma e Shenjtë, që na mëson të vërtetën.¹ Është rreth kërkimit tonë individual për të vërtetën që dëshiroj të flas.

Kur isha i ri, kisha shumë pyetje rreth Kishës. Disa nga pyetjet e mia ishin të sinqerta. Të tjerat nuk ishin dhe pasqyronin dyshimet e të tjerëve.

Shpesh i diskutoja pyetjet e mia me nënën time. Jam i sigurt që ajo mund ta kuptonte se shumë prej pyetjeve të mia ishin të sinqerta dhe nga zemra. Mendoj se ajo ishte paksa e zhgënjyer prej atyre pyetjeve që ishin më pak të sinqerta dhe më shumë debatuese. Megjithatë, kurrë nuk më bëri të ndihesha keq ngaqë kisha pyetje. Ajo më dëgjonte dhe përpiquej t'u jepte atyre përgjigje. Kur e ndiente se kishte thënë gjithçka që mund të thoshte dhe unë akoma kisha pyetje, ajo do të thoshte diçka të tillë: "Dejvid, ajo është një pyetje e mirë. Ndërkohë që *ti* po kërkon, lexon e lutesh për përgjigje, përse s'i bën gjërat që *ti* e di se duhet t'i bësh, dhe të mos i bësh gjërat që e di se nuk duhet t'i bësh?" Ky u bë modeli i kërkimit tim

për të vërtetën. Nëpërmjet studimit, lutjes dhe zbatimit të urdhërimeve, zbulova se ka përgjigje për të gjitha pyetjet e mia të rëndësishme. Gjithashtu zbulova se për disa pyetje, nevojiten besim i vazhdueshëm, durim e zbuluesë.²

Nëna e vuri përgjegjësinë e zhvillimit të besimit dhe të gjetjes së përgjigjeve mbi mua. Ajo e dinte se përgjigjet e rëndësishme do të vinin nga kërkimi

im për të vërtetën sipas mënyrës që e ka përshkruar Ati Qiellor. E dinte se kisha nevojë ta gjeja të vërtetën. E dinte se kisha nevojë të isha i sinqertë me pyetjet e mia dhe të isha i gatshëm të veproja me atë që tashmë e dija se ishte e vërtetë. E dinte se kisha nevojë të studioja e të lutesha dhe që kisha nevojë të zhvilloja durim më të madh teksa kërkoja përgjigje nga Zoti. Gatishmëria për të qenë të duruar është pjesë e kërkimit tonë për të vërtetën dhe pjesë e modelit të Zotit për ta zbuluar të vërtetën.³

Me kalimin e kohës arrita të di se nëna ime po më mësonte modelin e Atit Qiellor për kërkimin e së vërtetës. Besimi u rrit, përgjigjet filluan të vinin dhe unë pranova një thirrje për në mision.

Erdhi një kohë, në fillim të misionit tim, kur e kuptova që duhej ta dija vetë nëse Kisha ishte e vërtetë dhe Jozef Smithi ishte një profet i Perëndisë. Mendova atë që Presidenti Tomas S. Monson e shprehu kaq qartë në konferencën tonë të përgjithshme,



të fundit: “Nëse nuk keni një dëshmi të qëndrueshme për këto gjëra, bëni atë çka është e nevojshme për të marrë një të tillë. Është thelbësore që ju të keni dëshminë tuaj vetjake në këto kohë të vështira, pasi dëshmitë e të tjerëve nuk do t’ju çojnë shumë larg.”⁴ E dija se ç’ishte e nevojshme. Më nevojitej ta lexoja Librin e Mormonit me një zemër të sinqertë, me qëllim të vërtetë dhe ta pyesja Perëndinë nëse është i vërtetë.

Dëgjojeni premtimin mbresëlënës të Atit tonë Qiellor, të dhënë nëpërmjet profetit Moroni: “Dhe kur ju t’i merrni këto gjëra, unë do t’ju këshilloja që të pyesni Perëndinë, Atin e Amshuar, në emrin e Krishtit, në qoftë se këto gjëra nuk janë të vërteta; dhe në qoftë se ju do të kërkonti me një zemër të sinqertë, me qëllim të vërtetë duke pasur besim në Krisht, ai do t’ju tregojë të vërtetën, nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë”⁵.

Me qëllim që ta merrja atë që ishte në Librin e Mormonit, kisha nevojë ta lexoja atë. E nisa që nga fillimi librin dhe lexova çdo ditë. Disa njerëz marrin dëshmi shumë shpejt. Për të tjerë, do të duhet më shumë kohë e më shumë lutje dhe mund të përfshijë leximin e librit disa herë. Unë pata nevojë ta lexoja të gjithë librin përpara se ta merrja dëshminë e premtuar. Megjithatë, Perëndia ma tregoi të vërtetën e librit nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë.

Në ditarin tim si misionar, përshkrova gëzimin tim që e dija të vërtetën, si edhe shprehjen time vetjake të zotimit dhe qëllimit të vërtetë për të vepruar sipas së vërtetës që kisha marrë. Shkrova: “Unë i jam betuar Atit tim në Qiell dhe vetes sime se do të bëj gjithçka mundem, do të jap 100 përqind për pjesën tjetër të jetës sime, çfarëdo që të më kërkohet, do ta bëj, por për tani kam pjesën e mbetur të misionit tim dhe do ta bëj atë një mision të



mrekullueshëm, një mision për të cilin nuk do të ndihem keq, por jo për mua, po për Zotin. E dua Zotin dhe e dua punën, dhe thjesht lutem që ajo ndjenjë të mos më largohet kurrë.”

Arrita të di se nevojiten ushqimi i pandërprerë shpirtëror dhe përpjekja e vazhdueshme për t’u pënuar dhe për t’i zbatuar urdhërimet që ajo ndjenjë të mos largohet kurrë. Presidenti Monson tha: “[Dëshmia] duhet të mbahet jetike dhe e gjallë përmes bindjes së vazhdueshme ndaj urdhërimeve të Perëndisë dhe përmes lutjes dhe studimit të përditshëm të shkrimeve të shenja”⁶.

Përgjatë viteve i kam pyetur misionarët dhe të rinjtë nëpër botë se si e filluan përpjekjen e tyre vetjake për të kërkuar të vërtetën dhe për të fituar një dëshmi. Pothuajse pa përjashtim, ata u përgjigjën se përpjekja e tyre për të fituar një dëshmi vetjake filloi me vendimin vetjak që ta lexonin Librin e Mormonit që nga fillimi dhe t’i kërkonin Perëndisë nëse është i vërtetë. Duke e bërë këtë, ata zgjodhën që të “vepro[nin]” në vend që të “pëso[nin]”⁷ prej dyshimeve të të tjerëve.

Për ta ditur të vërtetën, na nevojitet që ta jetojmë ungjillin⁸ dhe të bëjmë një “provë”⁹ me fjalën. Na kërkohet të tregojmë kujdes që të mos e kundërshtojmë Shpirtin e Zotit.¹⁰ Pendimi, i shoqëruar me një vendosmëri për t’i zbatuar urdhërimet, është një pjesë e

rëndësishme e kërkimit të çdo individi për të vërtetën.¹¹ Në fakt, neve mund të na nevojitet të jemi të gatshëm që “t’i braktis[im] të gjitha” mëkatet tona me qëllim që ta dimë të vërtetën.¹²

Ne urdhërohemi që të “kërkojmë” të mësojmë, madje me anë të studimit dhe gjithashtu me anë të besimit” dhe të “kërkojmë” nga librat më të mirë fjalët e urtësisë”¹³. Kërkimi ynë për të vërtetën duhet të përqendrohet te “librat më të mirë” dhe burimet më të mira. Mes më të mirëve janë shkrimet e shenja dhe fjalët e profetëve të gjallë.

Presidenti Monson i ka kërkuar secilit prej nesh që të “bëj[ë] atë çka është e nevojshme” për ta marrë dhe për ta ruajtur një dëshmi të fortë.¹⁴ Çfarë është e nevojshme që ta thëlloni dhe forconi dëshminë tuaj? Secili prej nesh ka përgjegjësi vetjake që të bëjë atë çka është e nevojshme për ta marrë dhe për ta mbajtur një dëshmi të fortë.

Mbajtja me durim e besëlidhjeve tona ndërkohë që “bëj[më] atë çka është e nevojshme” për të marrë përgjigje nga Zoti, është pjesë e modelit të Perëndisë për të mësuar të vërtetën. Veçanërisht kur gjërat janë të vështira, neve mund të na kërkohet t’i “nënshtr[ohemi] me gëzim dhe me durim gjithë vullnetit të Zotit”¹⁵. Mbajtja me durim e besëlidhjeve e rrit përlulesinë tonë, e thëllon dëshirën tonë për të ditur të vërtetën dhe e lejon Frymën e Shenjtë që të na



“udhëheq[ë] në udhët e urtësisë, që [ne] të mund të je[m]i të bekuar, të begatuar dhe të ruajtur”¹⁶.

Unë dhe gruaja ime, Meri, njohim dikë që e duam shumë, e cila ka hasur vështirësi në pjesën më të madhe të jetës së saj me aspekte të caktuara të Kishës. Ajo e do ungjillin dhe e do Kishën, por ende ka pyetje. Ajo është e vulosur në tempull, është aktive në Kishë, i përmbush thirrjet e saj dhe është një nënë dhe bashkëshorte e mrekullueshme. Përgjatë viteve është përpjekur të bëjë ato gjëra që i dinte se ishin të drejta dhe t'i shmanget bërjes së atyre gjërave që i dinte se ishin të gabuara. I ka mbajtur besëlidhjet e saj dhe ka vazhduar të kërkojë. Me raste ka qenë mirënjohëse të mbështetej te besimi i të tjerëve.

Jo shumë kohë më parë peshkopi i saj kërkoi të takohej me të dhe burrin e saj. U kërkoi të pranonin një detyrë në tempull që të vepronin si mëkëmbës për ata që kishin nevojë për ordianca tempulli. Kjo thirrje i befasoi, por ata e pranuan dhe filluan shërbimin e tyre në shtëpinë e Zotit. Biri i tyre adoleshent kohët e fundit kishte marrë pjesë në kërkimin për historinë familjare dhe kishte gjetur një emër të familjes për të cilin nuk ishin plotësuar ordiancat e tempullit. Më pas ata vepruan si mëkëmbës dhe i kryen ordiancat e tempullit për këtë person dhe familjen e tij. Kur u gjuhëzuan tek altari

dhe po kryhej ordianca vulosëse, kjo grua e mrekullueshme, e duruar, e cila ka qenë duke kërkuar për kaq shumë kohë, pati një përvojë të fshehtë shpirtërore me anë të së cilës ajo arriti të dinte se tempulli dhe ordiancat e kryera atje, janë të vërteta dhe reale. Ajo mori në telefon nënën e saj, i tregoi për përvojën e saj dhe i tha se, ndërkohe që ende ka disa pyetje, ajo e di që tempulli është i vërtetë, që ordiancat e tempullit janë të vërteta dhe që Kisha është e vërtetë. Nëna e saj qau me mirënjohje për një Atë Qiellor të dashur, të durueshëm dhe për një bijë e cila vazhdon me durim të kërkojë.

Mbajtja me durim e besëlidhjeve sjell bekimet e qiellit në jetën tonë.¹⁷

Unë kam gjetur ngushëllim të madh në premtimin e Zotit se “nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë, ju mund të dini të vërtetën e të gjitha gjërave”¹⁸. Ne mund ta dimë të vërtetën pa ditur gjithçka. Ne mund ta dimë se Libri i Mormonit është i vërtetë. Në fakt, sikurse na mësoi Presidenti Rasëll M. Nelson këtë pasdite, ne mund “të ndiejmë, në ‘pjes[ën] më të thellë’ të zemrës sonë [shih Alma 13:27], se Libri i Mormonit është pa dyshim fjala e Perëndisë”. Dhe ne “mund ta ndiejmë atë kaq thellësisht sa kurrë nuk do të duam ta jetojmë qoftë edhe një ditë pa të”¹⁹.

Ne mund ta dimë që Perëndia është Ati ynë, i cili na do, dhe që Biri i Tij, Jezu Krishti, është Shpëtimtari dhe Shëlbuesi ynë. Ne mund të dimë që anëtarësia në Kishën e Tij duhet të jetë ngazëlluese dhe që marrja e përjavshme e sakramentit do të na ndihmojë ne dhe familjen tonë që të jemi të siguar. Ne mund ta dimë se nëpërmjet ordiancave të tempullit, familjet me të vërtetë mund të jenë së bashku përgjithmonë. Ne mund ta dimë se Shlyerja e Jezu Krishtit dhe bekimet e pendimit dhe të faljes janë të vërteta

dhe reale. Ne mund ta dimë se profeti ynë i dashur, Presidenti Tomas S. Monson, është profeti i Zotit dhe se këshilltarët e tij dhe anëtarët e Kuorumit të Të Dymbëdhjetëve janë apostuj, profetë, shikues dhe zbulues.

Të gjithë këtë unë e di që është e vërtetë dhe e jap dëshminë time në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih Moroni 10:5.
2. Një pyetje e tillë lidhet me disponueshmërinë e priftërisë për të gjithë burrat e denjë. Kjo pyetje mori përgjigje nga një zbulues e marrë prej Presidentit Spenser W. Kimball, këshilltarëve të tij dhe anëtarëve të Të Dymbëdhjetëve, më 1 qershor 1978. Kjo zbulues është Deklarata Zyrtare 2 te Doktrina e Besëlidhjeve.
3. Shih, për shembull, Lluca 21:15; Romakëve 8:5; Alma 32:41–43; Ethëri 12:19; Doktrina e Besëlidhjeve 21:5; 101:38; 107:30–31.
4. Tomas S. Monson, “Fuqia e Librit të Mormonit”, *Liahona*, maj 2017, f. 87.
5. Moroni 10:4.
6. Tomas S. Monson, “Fuqia e Librit të Mormonit”, f. 87.
7. 2 Nefi 2:14; shih edhe David A. Bednar, “Seek Learning by Faith”, *Liahona*, shtator 2007, f. 19–21.
8. Shih, për shembull, Gjonin 7:17, në të cilin Zoti premtoi: “Në qoftë se dikush don të bëjë vullnetin e tij, do ta njohë nëse kjo doktrinë vjen nga Perëndia apo që unë flas nga vetja ime”. Shih edhe Alma 32.
9. Shih Alma 32:27.
10. Shih Alma 32:28.
11. Shih Alma 22:18; Doktrina e Besëlidhjeve 93:27–28.
12. Alma 22:18.
13. Doktrina e Besëlidhjeve 88:118.
14. Tomas S. Monson, “Fuqia e Librit të Mormonit”, f. 87.
15. Mosia 24:15; shih edhe Mosia 24:13–14; Dejvid A. Bednar, “I Duronin Barrët e Tyre me Lehtësi”, *Liahona*, maj 2014, f. 87–90.
16. Mosia 2:36.
17. Shih Jeffrey R. Holland, “An High Priest of Good Things to Come”, *Liahona*, janar 2000, f. 45. Në këtë mesazh, Plaku Holland shpalli: “Disa bekime vijnë shpejt, disa vijnë vonë dhe disa nuk vijnë derisa të jemi në qiell; por për ata që e përqafojnë ungjillin e Jezu Krishtit, ato vijnë”.
18. Moroni 10:5.
19. Rasëll M. Nelson, “Libri i Mormonit: Si do të ishte Jeta Juaj pa Të?” *Liahona*, nëntor 2017, f. 63.



Autoritetet e Përgjithshme dhe Drejtuesit e Përgjithshëm të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme

PRESIDENCA E PARË



Henri B. Airing
Këshilltar i Parë



Tomas S. Monson
President



Dieter F. Uchtdorf
Këshilltar i Dytë

KUORUMI I DYMBËDHJETË APOSTUJVE



Rasëll M. Nelson



Dallin H. Oaks



M. Rasëll Ballard



Xhefiri R. Holland



Dejvid A. Bednar



Kuentin L. Kuk



D. Tod Kristoferson



Nil L. Andersen



Ronald A. Rasband



Geri E. Stivenson



Dejll G. Renland

PRESIDENCA E TË SHTATËDHJETËVE



L. Uthri Klejton



Kregj C. Kftensens



Ulbes Soresh



Lin G. Robins



Gerit W. Gong









Huan A. Uceda



Patrick Klean

AUTORITETET E PËRGJITHSHME TË SHITATËDHJETË

(sipas rendit alfabetik në anglisht)















															
															
															
															
															
															

PESHKOPATA KRYESEJUE



Dini M. Dejlvis
Zherald Kosë
W. Kristofer Ubaelli
W. Kristofer Ubaelli
W. Kristofer Ubaelli

DREJTUESIT E PËRGJITHSHËM

SHKOLLA E SË DIELËS

TË REJAT

SHOQATA E NDIHMËS

FILLORIA

TË RINITE





Nga Plaku Riçard J. Meinis,
i Të Shtatëdhjetëve

Të Fitoni Mirëbesimin e Zotit dhe të Familjes Suaj

Burrat që kanë “integritet të zemrës”, janë burra tek të cilët mund të mirëbesosh, sepse mirëbesimi ndërtohet mbi integritetin moral.

Vëllezër, ndoshta nuk ka përgëzim më të madh që mund të marrim nga Zoti, sesa të dimë që Ai na mirëbeson se jemi mbajtës të denjë të priftërisë dhe bashkëshortë e etër të mrekullueshëm.

Një gjë është e sigurt, të fitosh mirëbesimin e Zotit është një bekim që vjen nëpërmjet përpjekjes së madhe nga ana jonë. Mirëbesimi është një bekim i bazuar te bindja ndaj ligjeve të Perëndisë. Të fitosh mirëbesimin e Zotit vjen si rrjedhojë e të qenit i vërtetë ndaj besëlidhjeve që kemi bërë në ujërat e pagëzimit dhe në tempullin e shenjtë. Kur i mbajmë premtimet që i kemi bërë Zotit, mirëbesimi i Tij ndaj nesh rritet.

Më pëlqejnë shumë të dyja, si shkrimet e shenja të lashta dhe ato bashkëkohore që përdorin frazën “integritet të zemrës” kur përshkruajnë karakterin e drejtë të një personi.¹ Integriteti moral ose mungesa e integritetit moral është një përbërës themelor i karakterit të një personi. Burrat që kanë “integritet të zemrës”, janë burra tek të cilët

mund të mirëbesosh, sepse mirëbesimi ndërtohet mbi integritetin moral.

Të qenit një burrë me integritet moral thjesht nënkupton se qëllimet e tua, si dhe veprat e tua, janë të dëlira dhe të drejta në të gjitha aspektet e jetës tënde, si në publik, ashtu edhe në mjedis privat. Në çdo vendim që marrim, ne ose e meritojmë më shumë

mirëbesimin e Perëndisë ose e zvogëlojmë mirëbesimin e Tij [ndaj nesh]. Ndoshta ky parim tregohet më qartë në përgjegjësitë tona të caktuara në mënyrë hyjnore si bashkëshortë dhe etër.

Si bashkëshortë dhe etër, ne kemi marrë një përgjegjësi hyjnore nga profetët, shikuesit dhe zbuluesit e ditëve moderne në dokumentin “Familja: Një Proklamata drejtuar Botës”. Ky dokument na mëson që: 1) “etërit duhet të kryesojnë familjet e tyre me dashuri e drejtësi”, 2) “etërit janë përgjegjës për të siguruar gjërat e nevojshme për jetën” dhe 3) etërit janë përgjegjës për të mbrojtur familjet e tyre.²

Që ne ta fitojmë mirëbesimin e Perëndisë, do të na duhet t'i përmbushim këto tri përgjegjësi të caktuara në mënyrë hyjnore ndaj familjeve tona sipas mënyrës së Zotit. Siç shpallet më tej në proklamata të familjes, mënyra e Zotit është që ne t'i përmbushim këto përgjegjësi së bashku me bashkëshortin tonë “si partnerë të barabartë”.³ Për mua, kjo do të thotë se ne nuk përparojmë në marrjen e ndonjë vendimi të rëndësishëm lidhur me këto tri përgjegjësi, pa unitet të plotë me bashkëshortin tonë.





Hapi i parë në synimin tonë për të fituar mirëbesimin e Zotit është ta vendosim mirëbesimin tonë tek Ai. Profeti Nefi e ilustroi këtë lloj zotimi kur u lut: “O Zot, unë kam besuar te ti dhe unë do të besoj te ti përgjithmonë. Unë nuk do ta vë besimin tim në krahun prej mi-shi.”⁴ Nefi ishte krejtësisht i zotuar për të bërë vullnetin e Zotit. Përveçse *tha* se do të “bë[nte] gjërat që Zoti ka urdhëruar”, Nefi nuk u lëkund nga zotimi i tij për t’i *përmbushur* detyrat e tij siç tregohet në këtë thënie: “Ashtu si Zoti jeton dhe ashtu si ne jetojmë, ne nuk do të kthehemi tek ati ynë në vendin e shkretë, derisa ne të kemi plotësuar gjënë që Zoti na ka urdhëruar”⁵.

Për shkak se Nefi i mërbesoi së pari Perëndisë, Perëndia vendosi mirëbesim të madh te Nefi. Zoti e bekoji atë me derdhje të madhe të Shpirtit që e bekoji jetën e tij, jetën e familjes së tij dhe jetën e popullit të tij. Për shkak se Nefi kryesoi me dashuri dhe drejtësi dhe siguroi mirëqenie për familjen e tij, dhe e mbrojti atë e popullin e tij, ai shënon: “Ne jetuam sipas mënyrës së lumturisë”⁶.

Në mënyrë që të përfaqësoja këndvështrimin e një gruaje mbi këtë temë, iu kërkova dy bijave të mia të martuara që të më ndihmonin. I pyeta a mund të më thoshin një ose dy fjali mbi mënyrën se si e shihnin rëndësinë e mirëbesimit teksa ndikon në martesën dhe jetën e tyre familjare. Këtu kemi mendimet e Lara Herrisit dhe Kristina Hensënit.

E para, Lara: “Një nga gjërat më të rëndësishme për mua është që e di se gjatë ditës bashkëshorti im bën zgjedhje që tregojnë respekt dhe dashuri kundrejt meje. Kur ne i mirëbesojmë njëri-tjetrit në këtë mënyrë, kjo sjell paqe në shtëpinë tonë, ku mund të shijojmë së bashku rritjen e familjes sonë.”

Tani mendimet e Kristinës: “Të mirëbesosh te dikush është njësoj si të kesh besim te dikush. Pa atë mirëbesim dhe besim, ka frikë dhe dyshim. Për mua, një nga bekimet më të mëdha që vjen nga mundësia për t’i mirëbesuar plotësisht bashkëshortit tim, është paqja – paqja e mendjes duke e ditur se ai vërtet e bën atë që thotë se do të bëjë. Mirëbesimi sjell paqe, dashuri dhe një mjedis ku ajo dashuri mund të shtohet.”

Lara dhe Kristina nuk e panë kurrë atë që tjetra kishte shkruar. Për mua



është shumë interesante se, që të dyja në mënyrë të pavarur, e cilësuan bekimin e paqes në shtëpi si një rrjedhojë e drejtpërdrejtë e pasjes së një bashkëshorti të cilit mund t’i mirëbesonin. Siç u ilustrua nga shembulli i dy bijave të mia, parimi i mirëbesimit luan një rol tej mase të rëndësishëm në zhvillimin e një shtëpie të përqendruar te Krishti.

Unë qeshë gjithashtu në gjendje të gëzoja po atë kulturë të përqendruar te Krishti, kur po rritesha në një shtëpi ku im atë e nderonte priftërinë e tij dhe e fitonte mirëbesimin e gjithë familjes në saje të “integritetit të zemrës së tij”⁷. Më lejoni të ndaj me ju një përvojë nga rinia ime e cila tregon ndikimin e përhershëm pozitiv që një atë, i cili e kupton dhe e jeton parimin e mirëbesimit të bazuar mbi integritetin moral, mund të ketë në familjen e tij.

Kur isha djalosh, im atë ngriti një kompani që ishte e specializuar për automatizimet e fabrikave. Ky biznes projektonte, prodhonte dhe instalonte linja prodhimi të automatizuara në mbarë botën.

Kur isha në nëntëvjeçare, im atë donte që të më mësonte se si të punoja. Ai donte të më mësonte gjithashtu biznesin që nga themelet. Puna ime e parë përfshinte mirëmbajtjen e ambienteve të gjelbërta dhe lyerjet në pjesët e godinës që nuk shiheshin nga publiku i gjerë.

Kur hyra në shkollë të mesme, u ngrita në detyrë për të punuar me punonjësit e fabrikës. Fillova të mësoja se si të lexoja një skicë dhe si të vija në punë makinerinë për përpunimin e metaleve të rënda. Pas diplomimit në shkollën e mesme, ndoqa universitetin dhe më pas shkova në fushën e misionit. Kur u ktheva nga misioni, shkova menjëherë në punë. Duhej të fitoja para për shpenzimet e shkollës për vitin pasues.

Një ditë fill pas misionit, po punoja në fabrikë kur im atë më thirri në zyrë dhe më pyeti nëse do të kisha dëshirë të shkoja me të në një udhëtim pune në Los Anxhelos. Kjo ishte hera e parë që im atë më ftonte ta shoqëroja në një udhëtim pune. Në fakt, ai po më lejonte të paraqitesha në publik për ta ndihmuar që të përfaqësonim kompaninë.

Përpara se të niseshim për udhëtim, ai më përgatiti duke më dhënë detaje rreth këtij klienti të ri të mundshëm. Së pari, klienti ishte një sipërmarrje shumëkombëshe. Së dyti, ata po i përmirësonin linjat e tyre të prodhimit në mbarë botën me teknologjinë më të fundit për automatizimet. Së treti, kompania jonë nuk i kishte furnizuar kurrë më parë ata me shërbime apo teknologji inxhinierike. Dhe së fundi, drejtuesi i tyre kryesor i sipërmarrjes, përgjegjës për blerjen, e kishte kërkuar këtë mbledhje për të shqyrtuar ofertën tonë për një projekt të ri. Kjo mbledhje përfaqësonte një mundësi të re dhe me gjasë të rëndësishme për kompaninë tonë.

Pasi mbërritëm në Los Anxhelos, unë dhe im atë shkuam te hoteli i drejtuesit ekzekutiv për mbledhjen. Pika e parë e punës ishte që të diskutonim dhe t'i analizonim hollësitë e hartimit inxhinierik të projektit. Pika e radhës e diskutimit kishte të bënte me hollësitë operative, përfshirë logjistikën dhe datat e dorëzimit. Pjesa përmbyllëse e rendit të ditës u përqendrua te çmimet, kërkesat dhe kushtet. Në këtë pikë gjërat u bënë interesante.

Drejtuesi i sipërmarrjes na shpjegoi se çmimi që kishim propozuar ne, ishte më i ulëti nga ata që kishin dorëzuar oferta për projektin. Më pas, për çudi na tregoi ofertën e parafundit me çmimin më të ulët. Më pas ai na pyeti nëse do të ishim të gatshëm ta kthenim mbrapsht propozimin tonë dhe

t'ia ridërgonim. Ai tha se çmimi ynë i ri duhet të renditej fill poshtë ofertës tjetër me çmimin më të lartë. Më pas ai shpjegoi se duhet t'i ndanim me të dollarët shtesë, me fitim gjysmë për gjysmë. Ai e arsyetoi këtë duke thënë se të gjithë do të dilnin të fituar. Kompania jonë do të dilte e fituar sepse do të fitonim goxha më shumë para sesa oferta fillestare që bëmë. Kompania e tij do të dilte e fituar sepse prapëseprapë do të bashkëpunonte me ofruesin e çmimit më të ulët. Dhe sigurisht, ai do të përfitonte duke marrë përqindjen e tij për shkak se do të bënte të mundur këtë marrëveshje të shkëlqyer.

Më pas, na dha numrin e një kutie postare ku mund t'ia dërgonim paratë që kërkoi. Pas gjithë kësaj, ai pa tim atë dhe e pyeti: "Kështu pra, a arritëm në një marrëveshje?" Për habinë time të madhe, im atë u çua, i shtrëngoi dorën dhe i tha se do t'i kthente përgjigje më vonë.

Pasi u larguam nga mbledhja, ne hipëm në makinën e marrë me qira dhe im atë u kthye drejt meje dhe më pyeti: "Epo, çfarë mendon se duhet të bëjmë?"

Iu përgjigja duke i thënë se nuk mendoja se duhej ta pranonim këtë ofertë.

Im atë më pas pyeti: "A nuk mendon se kemi një përgjegjësi kundrejt gjithë punonjësve tanë për të mbajtur një ngarkesë të mjaftueshme pune?"

Ndërsa po e bluaja në mendje pyetjen e tij dhe përpara se t'i përgjigjesha, ai iu përgjigj vetë pyetjes që bëri. Ai tha: "Dëgjo Rik, kur e pranoni njëherë ryshfetin ose bën lëshime tek integriteti yt moral, është shumë e vështirë ta rifitosh sërish atë. Mos e bëj kurrë atë, as edhe një herë të vetme."

Fakti që po e tregoj këtë përvojë, do të thotë se nuk e kam harruar kurrë atë që më mësoi im atë në atë udhëtim të



parë pune me të. E tregova këtë përvojë për të treguar ndikimin e përhershëm që kemi si etër. Ju mund ta përfytyroni mirëbesimin që kisha tek im atë në saje të integritetit të zemrës së tij. Ai i jetoi të njëjtat parime në jetën e tij private me nënën time, fëmijët e tij dhe me të gjithë njerëzit me të cilët u shoqërua.

Vëllezër, lutja ime këtë mbrëmje është që ne të gjithë të mund ta vendosim së pari mirëbesimin tonë te Zoti, siç shpjegoi Nefi, dhe më pas, me anë të integritetit tonë të zemrës, të fitojmë mirëbesimin e Zotit, si dhe mirëbesimin e bashkëshortes dhe fëmijëve tanë. Kur e kuptojmë dhe e zbatojmë këtë parim të shenjtë që mirëbesimi ndërtohet mbi integritetin moral, ne do të jemi të vërtetë ndaj besëlidhjeve tona të shenjta. Ne do t'ia dalim mbanë gjithashtu për të kryesuar në familjet tona me dashuri dhe drejtësi, duke siguruar nevojat e jetës dhe duke e mbrojtur familjen tonë nga të ligat e botës. Për këto të vërteta unë dëshmoj me përlulesi, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih, për shembull, 1 Mbretërve 9:4; Doktrina e Besëlidhje 124:15.
2. "Familja: Një Proklamatë drejtuar Botës", *Liahona*, nëntor 2010, f. 129.
3. "Familja: Një Proklamatë drejtuar Botës", f. 129.
4. 2 Nefi 4:34.
5. 1 Nefi 3:7, 15.
6. 2 Nefi 5:27.
7. Doktrina e Besëlidhje 124:15.



Nga Presidenti Diter F. Uhtdorf,
Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë

Mbajtës të Dritës Qiellore

Si mbajtës i priftërisë së Perëndisë dhe si dishepull i Jezu Krishtit, ju jeni mbajtës i dritës.

Një burrë i moshuar po rrinte në radhë te zyra postare për të blerë pulla poste te banaku i shërbimeve. Një e re e vuri re që ai ecte me vështirësi, dhe u ofrua t'i tregonte se si t'i blinte pullat e postës nga një makineri për të kursyer kohë. Zotëria i thyer në moshë tha: "Ju faleminderit, por parapëlqej të pres. Makinaria nuk do t'ia dijë për artritin tim."

Nganjëherë na ndihmon të flasim me dikë që interesohet për shqetësimet tona.

Dhembja, trishtimi dhe sëmundja janë përvoja të cilat ne të gjithë i kemi të përbashkëta – çastet e incidenteve, mjerimit dhe fatkeqësisë mund të zënë [një pjesë] mjaft të madhe të mendimeve në diskutim e brendshëm të shpirtit tonë.

Kur është fjala për mirëqenien tonë trupore, ne e pranojmë plakjen dhe sëmundjen si pjesë të udhëtimit tonë në vdekshmëri. Ne kërkojmë këshillë nga profesionistë të cilët e kuptojnë trupin fizik. Kur vuajmë nga ankth emocional apo sëmundje mendore, ne kërkojmë ndihmën e specialistëve që i trajtojnë këto lloje lëngatash.

Ashtu siç përballemi me sprova trupore dhe emocionale në këtë vdekshmëri, ne përballemi edhe me sfida shpirtërore. Shumica prej nesh ka përjetuar në jetën e vet periudha kur dëshmia jonë shkëlqen fort. Ne gjithashtu mund të kemi përjetuar periudha kur Ati ynë Qiellor na duket i largët. Ka periudha kur ne i çmojmë si thesar gjërat e Shpirtit me gjithë zemër. Mund të ketë gjithashtu periudha kur ato duken më pak të çmueshme ose me më pak domethënie.

Sot dëshiroj të flas për mirëqenien shpirtërore – për mënyrën se si ne mund të gjejmë shërim prej amullisë dhe se si të ndjekim një shteg të shëndetit të shndritshëm shpirtëror.

Sëmundja Shpirtërore

Ndonjëherë sëmundja shpirtërore vjen si pasojë e mëkatit apo e plagëve emocionale. Ndonjëherë, rrënimet shpirtërore vijnë kaq ngadalë sa që ne zor se mund ta kuptojmë çfarë po ndodh. Ashtu si shtresat e shkëmbinjve sedimentarë, dhembja dhe pikëllimi shpirtëror mund të shtohen me kalimin e kohës, duke rënduar mbi shpirtin tonë derisa të jenë thuajse tepër të

rënda për t'u mbajtur. Për shembull, kjo mund të ndodhë, kur përgjegjësitë tona në punë, shtëpi dhe kishë bëhen kaq dërrmuese sa që e harrojmë gëzimin e unguillit. Ne madje mund të ndiejmë sikur nuk kemi më shumë për të dhënë apo se të jetuarit e urdhërimeve të Perëndisë është përtej forcës sonë.

Por vetëm ngaqë sprovat shpirtërore janë reale, kjo nuk do të thotë se ato janë të pashërueshme.

Ne mund të shërohemi shpirtërisht.

Edhe plagët më të thella shpirtërore – po, edhe ato që mund të duket se janë të pashërueshme – mund të shërohen.

Miqtë e mi të dashur, fuqia shëruese e Jezu Krishtit nuk mungon në kohën tonë.

Prekja shëruese e Shpëtimtarit mund t'ua ndryshojë jetën [njerëzve] në kohën tonë ashtu siç bëri në kohën e Tij. Në qoftë se vetëm do të kemi besim, Ai mund të na kapë prej dore, të mbushë shpirtat tanë me dritë qiellore e shërim dhe të na thotë fjalët e bekuara: "Çohu, merr vigun tënd dhe ec"¹.

Errësira dhe Drita

Çfarëdo që i shkakton lëngatat tona shpirtërore, ato kanë të gjitha një gjë të përbashkët: mungesën e dritës hyjnore.

Errësira e ul aftësinë tonë për të parë në mënyrë të qartë. Ajo na e zbeh shikimin e asaj që më parë ishte e qartë dhe e kthjellët. Kur jemi në errësirë, ka më shumë gjasa të bëjmë zgjedhje të këqija, ngaqë nuk mund t'i shohim rreziqet në shtegun tonë. Kur jemi në errësirë, ka më shumë gjasa ta humbasim shpresën, ngaqë nuk mund ta shohim paqen e gëzimin që na presin nëse vetëm vazhdojmë të bëjmë përpara.

Drita, nga ana tjetër, na lejon t'i shohim gjërat siç janë në të vërtetë. Ajo na lejon të bëjmë dallimin

ndërmjet të vërtetës dhe gabimit, ndër-
mjet jetikes dhe të parëndësishmes.
Kur jemi në dritë, ne mund të bëjmë
zgjedhje të drejta të bazuara në parime
të vërteta. Kur jemi në dritë, ne kemi
“një ndriçim të përkryer të shpresës”²,
pasi ne mund t’i shohim sprovat tona
në vdekshmëri nga një këndvështrim i
përfundimtar.

Ne do të gjejmë shërim shpirtëror
kur largohemi nga hijet e botës për në
Dritën e pafundme të Krishtit.

Sa më shumë e kuptojmë dhe e
zbatojmë konceptin doktrinor të dritës,
aq më shumë mund t’u shmangemi
sëmundjeve shpirtërore që na pikëllojnë
apo shqetësojnë anë e kënd, dhe aq më
mirë ne mund të shërbejmë si mbajtës
energjikë, të guximshëm, të dashur
dhe të përlulur të priftërisë së shenjtë –
shërbëtorë e dishepuj të vërtetë të
Mbretit tonë të dashur e të përfundimtar.

Drita e Botës

Jezu Krishti tha: “Unë jam drita e
botës; kush më ndjek nuk do të ecë në
errësirë, por do të ketë dritën e jetës”³.

Çfarë do të thotë kjo?

Thjesht këtë: Ai që e ndjek me për-
ulësi Jezu Krishtin, do të provojë dritën
e Tij e do të ketë pjesë në të. Dhe ajo
dritë do të rritet derisa përfundimisht e
davarit edhe errësirën më të thellë.

Kjo do të thotë se ka një fuqi, një
ndikim të fortë, që buron nga Shpë-
timtari. Ajo del “nga prania e Perëndisë
për të mbushur pafundësinë e hapë-
sirës”⁴. Për shkak se kjo fuqi e ndri-
çon, e ngre dhe i jep dritë jetës sonë,
shkrimet e shenja shpesh e quajnë atë
dritë, por ajo përmendet edhe si shpirt
dhe e vërtetë.

Te Doktrina e Besëlidhje lexojmë:
“Sepse fjala e Zotit është e vërtetë dhe
çfarëdo që është e vërtetë, është dritë,
dhe çfarëdo që është dritë, është Shpirt,
madje Shpirti i Jezu Krishtit”⁵.



Kjo pikëpamje e thellë – që drita
është shpirt, që është e vërtetë dhe se
kjo dritë ndriçon çdo shpirt që vjen në
botë – është po aq e rëndësishme sa
edhe shpresëdhënëse. Drita e Krishtit i
ndriçon dhe i mbush tërësisht shpirtat
e të gjithë atyre që i binden zërit të
Shpirtit.⁶

Drita e Krishtit e mbush universin.
Ajo e mbush tokën.

Dhe ajo mund të mbushë çdo
zemër.

“Perëndia nuk tregohet i anshëm.”⁷

Drita e Tij është në dispozicion për
të gjithë – të mëdhenj a të vegjël, të
pasur a të varfër, të privilegjuar a të
privuar.

Nëse e hapni mendjen dhe zemrën
tuaj për ta marrë Dritën e Krishtit dhe
e ndiqni përlulësisht Shpëtimtarin, ju
do të merrni më shumë dritë. Rresht
pas rreshti, pak këtu e pak atje, ju do
të mblidhni më shumë dritë e të vërtetë
në shpirtin tuaj derisa errësira të jetë
dëbuar tërësisht nga jeta juaj.⁸

Perëndia do t’ju hapë sytë.

Perëndia do t’ju japë një zemër të re.

Dashuria e Perëndisë, drita dhe e
vërteta do të bëjnë që gjërat e fjetura të
vijjnë në jetë dhe ju do të rilindeni në
risinë e jetës në Krishtin Jezus.⁹

Zoti ka premtuar: “Nëse syri juaj
drejtohet te lavdia ime, tërë trupat tuaj
do të mbushen me dritë dhe nuk do të
ketë errësirë në ju; dhe ai trup që mbu-
shet me dritë, kupton gjithçka”¹⁰.

Ky është ilaçi themeltar për sëmund-
jen shpirtërore. Errësira zhduket në
prani të dritës.

Një Metaforë për Errësirën Shpirtërore

Megjithatë, Perëndia nuk do të na
detyrojë ta përqafojmë dritën e Tij.

Nëse zëmë rehat në errësirë, ka
pak të ngjarë që zemrat tona do të
ndryshojnë.

Që ndryshimi të ndodhë, ne duhet
që aktivisht ta lëmë dritën të hyjë.

Gjatë fluturimeve të mia si kapi-
ten avioni nëpër planetin tonë tokë,
mahnitesha përherë nga bukuria dhe
përsosuria e krijimeve të Perëndisë.
Më dukej veçanërisht magjepsëse
marrëdhënia ndërmjet tokës dhe diellit.
Unë e shikoj atë si një mësim të thellë
simbolik për mënyrën se si ekzistojnë
errësira dhe drita.

Siç e dimë të gjithë, brenda çdo 24
orësh nata kthehet në ditë dhe dita
kthehet në natë.

Pra, atëherë, çfarë është nata?

Nata nuk është asgjë më shumë sesa
një hije.

Edhe në më të errëtën e netëve,
dielli nuk pushon së rrezatuari dritën
e tij. Ai vazhdon të ndriçojë po aq fort
sa përherë. Por gjysma e tokës është në
errësirë.

Mungesa e dritës shkakton errësirë.

Kur bie errësira e natës, ne nuk
dëshpërohemi apo shqetësohemi
që dielli është asgjësuar. Ne nuk

arsyetojmë apriori se dielli nuk ekziston më apo është shuar. Ne e kuptojmë se jemi në hije, se toka do të vazhdojë të rrotullohet dhe se përfundimisht rrezet e diellit do të na arrijnë përsëri.

Errësira nuk nënkupton se nuk ka dritë. Më së shpeshti, ajo thjesht do të thotë se ne nuk jemi në vendin e duhur për të marrë dritë. Gjatë eklipsit diellor të kohëve të fundit, shumë veta bënë përpjekje të mëdha për të shkuar tek ai brez i ngushtë hijeje i krijuar nga hëna, në mes të një dite të shndritshme me diell.

Në një mënyrë shumë të ngjashme, drita shpirtërore ndriçon në mënyrë të vazhdueshme mbi të gjitha krijimet e Perëndisë. Satani do të bëjë gjithfarë përpjekjesh që të krijojë një hije apo që të na futë në një hije të krijuar nga ne vetë. Ai do të na shtrëngojë që të krijojmë eklipsin tonë vetjak; ai do të na shtyjë në errësirën e zgavrës së tij të ligë.

Errësira shpirtërore mund të hedhë një vel harrese madje edhe përqark atyre që dikur ecnin në dritë dhe gëzoheshin në Zotin. Sidoqoftë, edhe në çastet e errësirës më të madhe, Perëndia i dëgjon kërkesat tona të përlurura, kur lutemi: “Unë besoj, o Zot, ndihmo mosbesimin tim”¹¹.

Në kohën e Almës, kishte shumë njerëz që kishin vështirësi t’i praninin gjërat shpirtërore dhe, “për shkak të mosbesimit të tyre”, drita dhe e vërteta e Perëndisë nuk mund të hynin në shpirtrat e tyre “dhe zemrat e tyre ishin ngurtësuar”¹².

Ne Jemi Mbajtës të Dritës

Vëllezër, ne e kemi vetë në dorë që të jemi në vendin e duhur për të parë dritën hyjnore dhe të vërtetën e ungjillit të Jezu Krishtit. Edhe kur ka rënë nata dhe bota duket në errësirë, ne mund të zgjedhim të ecim në dritën e Krishtit, t’i mbajmë urdhërimet e Tij dhe të



dëshmojmë me guxim për realitetin e Tij dhe madhësinë e Tij.

Si mbajtës i priftërisë së Perëndisë dhe si dishepull i Jezu Krishtit, ju jeni mbajtës i dritës. Vazhdoni t’i bëni gjërat që do ta ushqejnë dritën e Tij hyjnore. “Mbani lart dritën tuaj”¹³ dhe “le të shndritë [ajo] para njerëzve” – jo në mënyrë që ata do t’ju shohin e admirojnë ju, por “që [ata] të shohin veprat tuaja të mira dhe ta lëvdojnë Atin tuaj që është në qiej”¹⁴.

Vëllezërit e mi të dashur, ju jeni mjete në duart e Zotit me qëllimin për t’i sjellë dritë e shërim shpirtit të fëmijëve të Atit Qiellor. Mbase nuk ndiheni të aftë t’i shëroni ata që janë shpirtërisht të sëmurë – me siguri jo më shumë sesa një punonjës i zyrës postare është i aftë të ndihmojë për artritin. Mbase përballeni me sfida shpirtërore tuajat. Sidoqoftë, Zoti ju ka thirrur ju. Ai ju ka dhënë juve autoritet dhe përgjegjësi për t’i ndihmuar ata që janë në nevojë. Ai ju ka dhuruar fuqinë e Tij të shenjtë të priftërisë për të sjellë dritë në errësirë dhe për t’i ngritur moralisht e bekuar fëmijët e Perëndisë. Perëndia e ka rivendosur Kishën e Tij dhe ungjillin e Tij të çmuar, “që shëron shpirtin e plagosur”¹⁵. Ai e ka përgatitur shtegun për të mirëqenia shpirtërore, që të gjejmë shërim nga amullia dhe të lëvizim drejt

shëndetit të shndritshëm shpirtëror.

Sa herë e ktheni zemrën te Perëndia në lutje të përlurur, ju e përjetoni dritën e Tij. Sa herë e kërkoni fjalën dhe vullnetin e Tij në shkrimet e shenja, drita rritet në shkëlqim. Sa herë vini re dikë në nevojë dhe e sakrifikoni rehatinë tuaj vetjake për të ndihmuar me dashuri, drita rritet dhe shtohet. Sa herë që e flakni tundimin dhe zgjidhni pastërtinë, sa herë që kërkoni apo jepni falje, sa herë që dëshmoni me guxim për të vërtetën, drita e dëbon errësirën dhe tërheq të tjerë që po e kërkojnë gjithashtu dritën e të vërtetën.

Mendoni për përvojat tuaja vetjake, çastet e shërbimit ndaj Perëndisë dhe bashkëqenieve kur drita hyjnore shndriti në jetën tuaj – në tempullin e shenjtë, tek tryeza e sakramentit, në një çast të qetë përsiatjeje plot lutje, në mbledhjet e familjes suaj apo gjatë një veprë shërbimi priftërie. Tregojani ato çaste familjes, miqve dhe veçanërisht të rinjve tanë që po kërkojnë dritë. Ata kanë nevojë që të dëgjojnë nga ju se me këtë dritë vjen shpresë e shërim, madje edhe në një botë plot errësirë.

Drita e Krishtit sjell shpresë, lumturi dhe shërim nga çdo plagë apo lëngatë shpirtërore.¹⁶ Ata që e përjetojnë këtë ndikim përmirësues, bëhen mjete në duart e Dritës së Botës për t’u dhënë



Nga Presidenti Henri B. Ajring,
Këshilltar i Parë në Presidencën e Parë

dritë të tjerëve.¹⁷ Ata do të ndiejnë atë që përjetoi Mbreti Lamoni: “Kjo dritë i kishte futur kaq gëzim në shpirtin e tij, sa ia kishte zhdukur renë e errësirës dhe drita e jetës së përhershme ndriçonte në shpirtin e tij”¹⁸.

Vëllezërit e mi të dashur, miqtë e mi të dashur, është misioni ynë madhor që të përpiqemi ta gjejmë Zotin derisa drita e Tij e jetës së përhershme të shkëlqejë fort përbrenda nesh dhe dëshmia jonë të bëhet e sigurt dhe e fortë edhe në mes të errësirës.

Është lutja dhe bekimi im që ju do t’ia dilni mbanë në përmbushjen e fatit tuaj si mbajtës të priftërisë së Perëndisë të Plotfuqishëm dhe do të jeni përherë mbajtës gëzimplotë të dritës së Tij qiellore. Në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, Mësuesit tonë, amen. ■

SHËNIME

1. Gjoni 5:8.
2. 2 Nefi 31:20.
3. Gjoni 8:12.
4. Doktrina e Besëlidhje 88:12; shih edhe Doktrina e Besëlidhje 88:6–7.
5. Doktrina e Besëlidhje 84:45.
6. Shih Doktrina e Besëlidhje 84:46.
7. Veprat e Apostujve 10:34.
8. Doktrina e Besëlidhje 88:40 na mëson se “drita kapet pas dritës”. Me fjalë të tjera, sa më shumë dritë, të vërtetë, urtësi dhe virtyt që marrim, aq më shumë [nga ato] do të tërheqim në jetën tonë. “Ai që merr dritë e vazhdon në Perëndinë, merr më shumë dritë; dhe ajo dritë shkëlqen gjithnjë e më shumë, derisa dita është e plotë” (Doktrina e Besëlidhje 50:24).
9. Ky është një prej premtimeve të pagëzimit – që ndërsa e varrosim jetën tonë të vdekshme, trupore, ne dalim nga ujërat e pagëzimit të gjallë në Krishtin. Ne dalim si krijesa të reja të cilat ecin në risinë e jetës (shih Romakëve 6:4; 2 Korintasve 5:17).
10. Doktrina e Besëlidhje 88:67; shih edhe Mateu 6:22.
11. Marku 9:24.
12. Mosia 26:3.
13. 3 Nefi 18:24.
14. Mateu 5:16.
15. Jakobi [LiM] 2:8.
16. Shih 1 Gjoni 1:7; Alma 7:11–13.
17. Shih Mateu 5:14.
18. Alma 19:6.

Zoti e Udhëheq Kishën e Tij

Udhëheqja nga Zoti e Kishës së Tij kërkon besim të madh dhe të qëndrueshëm nga të gjithë ata që i shërbejnë Atij në tokë.

Vëllezërit e mi të dashur që mbani priftërinë e Perëndisë, sonte dëshiroj të flas për mënyrën e mrekullueshme në të cilën Zoti e udhëheq mbretërinë e Tij në tokë. Ju tanimë i dini gjërat themeltare. Lutem që Fryma e Shenjtë do t’jua pohojë ato.

Së pari, Jezu Krishti është kreu i Kishës në të gjithë tokën.

Së dyti, Ai e udhëheq Kishën e Tij sot duke iu folur burrave të thirrur si profetë dhe Ai e bën atë nëpërmjet zbulesës.

Së treti, Ai iu dha zbulesë profetëve të Tij shumë kohë më parë, ende u jep zbulesë dhe do të vazhdojë ta bëjë atë.

Së katërti, Ai u jep zbulesë pohuese atyre që shërbejnë nën udhëheqjen e profetëve të Tij.

Nga ato gjëra themeltare, ne dallojmë se udhëheqja nga Zoti e Kishës së Tij kërkon besim të madh dhe të qëndrueshëm nga të gjithë ata që i shërbejnë Atij në tokë.

Për shembull, do besim për të mirëbesuar se Zoti i ringjallur po kujdeset





për hollësitë e përditshme të mbretërisë së Tij. Do besim për të mirëbesuar se Ai thërret njerëz të papërsosur në pozicione të besuara. Do besim për të mirëbesuar se Ai i njeh njerëzit që i thërret, në mënyrë të përsosur, si aftësitë e tyre, edhe potencialin e tyre, dhe kështu që nuk bën gabime rreth atyre që thërret.

Kjo mund t'i shkaktojë një buzëqeshje apo tundje koke disave në këtë auditor – si atyre të cilët mendojnë se vetë thirrja e tyre për të shërbyer mund të ketë qenë një gabim, gjithashtu edhe atyre të cilëve u vijnë në mendje njerëz që njohin, të cilët u duken jo të përshtatshëm për pozicionin e tyre në mbretërinë e Zotit. Këshilla ime është që t'i shtyni gjykime të tilla derisa të mund ta shihni më mirë atë që sheh Zoti.

Gjykimi që duhet të bëni, në vend të asaj, është se *ju* e keni aftësinë të merrni zbuluesë dhe të veproni sipas saj pa frikë.

Do besim për ta bërë atë. Do besim edhe më të madh për të mirëbesuar se Zoti ka thirrur shërbëtorë njerëzorë të papërsosur për t'ju udhëhequr ju. Qëllimi im sonte është që ta forcoj besimin tuaj se Perëndia ju drejton në shërbimin tuaj ndaj Tij. Dhe madje më me rëndësi, shpresa ime është që ta forcoj besimin tuaj, se Zoti po i

frymëzon individët e papërsosur të cilët Ai i ka thirrur si udhëheqës të tuaj.

Ju mund të mendoni, si fillim, se një besim i tillë nuk është i rëndësishëm për suksesin e Kishës dhe të mbretërisë së Zotit. Megjithatë, ju mund të zbuloni – pavarësisht se në çfarë pozicioni jeni në zinxhirin e shërbimit në priftëri, qoftë profeti i Zotit apo një mbajtës i ri i Priftërisë Aarone – se besimi është thelbësor.

Le të fillojmë me atë se çfarë do të thotë besim për një president të kuorumit të mësuesve apo dhjakëve. Është e rëndësishme për të që të ketë besim se Zoti e thirri atë personalisht, duke qenë në dijeni të pikave të dobëta dhe të forta të atij mësuesi. Ai gjithashtu duhet të ketë besim se burri që e dha thirrjen, mori zbuluesë nga Shpirti i Perëndisë. Këshilltarët e tij dhe anëtarët e kuorumit të tij kanë nevojë për të njëjtin besim për ta ndjekur atë me siguri të patundur.

Unë e pashë një siguri të tillë kur një djalë u ul me presidencën e tij të dhjakëve një mëngjes të diele. Ai ishte sekretari i tyre i sapothirrur. Ajo presidencë e re u këshillua së bashku. Ata folën rreth disa mënyrave se si mund ta plotësonin kërkesën e peshkopit për ta rikthyer në kishë një djalë më pak aktiv.

Pas lutjes dhe diskutimit, ata e caktuan sekretarin që të shkonte te shtëpia e djalit, i cili nuk kishte ardhur asnjëherë në një mbledhje, dhe ta ftonë atë.

Sekretari nuk e njihte djalin, por ai e dinte se një prej prindërve të djalit që më pak aktiv dhe tjetri nuk ishte anëtar dhe as miqësor. Sekretari ndjeu ankth, por jo frikë. Ai e dinte se profeti i Perëndisë u kishte kërkuar mbajtësve të priftërisë që t'i rikthenin delet e humbura. Dhe ai e kishte dëgjuar lutjen e presidencës së tij. Ai i dëgjoi ata të binin dakord për emrin e djalit për t'u shpëtuar dhe për vetë emrin e tij.

Po e ndiqja me sy kur sekretari eci përpjetë rrugës drejt shtëpisë së djalit më pak aktiv. Ai ecte ngadalë sikur po shkonte drejt rrezikut të madh. Por, brenda gjysmë ore, ai u kthye sërish teposhtë rrugës bashkë me djalin, duke buzëqeshur i lumtur. Nuk jam i sigurt nëse e kuptoi atëherë, por ai kishte shkuar me besimin se ishte duke bërë punën e Zotit. Ai besim ka qëndruar me të dhe është rritur me kalimin e viteve të tij si misionar, baba, udhëheqës i të rinjve dhe peshkop.

Le të flasim për atë çfarë do të thotë një besim i tillë për një peshkop. Një peshkop ndonjëherë thirret për t'u shërbyer njerëzve që e njohin mirë atë. Anëtarë të lagjes kanë njëfarë dijenie për dobësitë e tij njerëzore dhe aftësitë e tij shpirtërore dhe ata e dinë se të tjerë në lagje mund të ishin thirrur [në atë pozitë] – të tjerë që duken më të mirëshkolluar, më me përvojë, më të këndshëm apo madje me pamje më të bukur.

Këta anëtarë duhet të dinë se thirrja për të shërbyer si peshkop erdhi nga Zoti, me anë të zbuluesës. Pa besimin e tyre, peshkopi që u thirrur nga Perëndia, do ta ketë më të vështirë të marrë zbuluesën që i duhet, për t'i ndihmuar ata. Ai nuk do t'ia dalë mbanë pa besimin e anëtarëve për ta mbështetur atë.

Fatmirësisht, e kundërta është gjithashtu e vërtetë. Mendoni për shërbëtorin e Zotit, mbretin Beniamin, i cili e udhëhoqi popullin e tij drejt pendimit. Zemrat e njerëzve qenë zbutur prej besimit të tyre se ai qe thirrur nga Perëndia, pavarësisht nga dobësitë e tij njerëzore, dhe se fjalët e tij rridhnin nga Perëndia. Ju e mbani mend atë që thahet në njerëzit: “Po, ne i besojmë të gjitha fjalët që ti na ke folur; . . . ne . . . dimë për sigurinë dhe vërtetësinë e tyre, për shkak të Shpirtit të Zotit të Plotfuqishëm, i cili ka bërë një ndryshim të madh te ne, ose në zemrat tona, që ne nuk kemi më prije të bëjmë keq, por të bëjmë mirë vazhdimisht” (Mosia 5:2).

Që një udhëheqës t’ia dalë mbanë në punën e Zotit, mirëbesimi i njerëzve se ai është thirrur nga Perëndia, duhet ta tejkalojë pikëpamjen e tyre për kufizimet dhe dobësitë e tij si i vdekshëm. Ju e mbani mend mënyrën se si mbreti Beniamin e shpjegoi vetë rolin e tij udhëheqës:

“Unë nuk ju kam urdhëruar të vini deri këtu që të më keni frikë, ose që ju të mendoni se unë vetë jam më shumë se një njeri i vdekshëm.

Por, unë jam sikurse ju, mund të prekem nga të gjitha llojet e dobësive në trup dhe mendje; megjithëkëtë, unë jam zgjedhur nga ky popull dhe përkushtuar nga ati im dhe u lejua nga dora e Zotit, që unë duhej të isha një sundimtar dhe mbret mbi këtë popull; dhe jam mbajtur dhe ruajtur nga fuqia e tij e pakrahasueshme, për t’ju shërbyer juve me të gjithë fuqinë, mendjen dhe forcën që Zoti më ka dhënë” (Mosia 2:10–11).

Udhëheqësi juaj në Kishën e Zotit mund t’ju duket i dobët dhe njerëzor, ose mund t’ju duket i fuqishëm dhe i frymëzuar. Realiteti është që çdo udhëheqës është një përzjerje e atyre veçorive dhe ca më tepër. Ajo çfarë u vjen në ndihmë shërbëtorëve të Zotit të

cilët janë thirrur të na udhëheqin, është kur ne arrijmë t’i shohim ata ashtu siç i pa Zoti kur i thirri.

Zoti i sheh në mënyrë të përkryer shërbëtorët e Tij. Ai e sheh potencialin e tyre dhe të ardhmen e tyre. Dhe Ai e di se si vetë natyra e tyre mund të ndryshohet. Ai gjithashtu e di se si ata mund të ndryshohen nga përvojat e tyre me njerëzit që do të udhëheqin.

Ju mund të keni pasur përvojën kur jeni bërë më të fortë prej njerëzve të cilët u thirrën t’i shërbenit. Unë dikur u thirra si peshkop i të rinjve në moshë madhore beqarë. Nuk jam i sigurt nëse qëllimet e Zotit kishin të bënin më shumë me ndryshimet që mund ta ndihmoja Zotin të sillte tek ata, apo me ndryshimet që Ai e dinte se ata do të sillnin tek unë.

Në një shkallë që unë nuk e kuptoj, shumica e këtyre të rinjve në atë lagje vepronin si të isha thirrur nga Perëndia posaçërisht për ta. Ata i shikonin dobësitë e mia, por shihnin përtej tyre.

Më kujtohet një i ri, i cili kërkoi këshillë rreth zgjedhjeve të tija për arsimim. Ai qe student i vitit të parë në një universitet shumë të mirë. Një javë pasi i kisha dhënë këshillën, ai caktoi një takim me mua.



Kur erdhi në zyrë, ai më habiti kur më pyeti: “Peshkop, a mund të lutem përpara se të flasim? Dhe a mund të ulemi në gjunjë? Dhe a mund të lutem unë?”

Kërkesat e tij më habitën. Por edhe më tepër më habiti lutja e tij. Ishte pak a shumë e tillë: “Ati Qiellor, Ti e di se Peshkopi Ajring më dha këshillë javën e kaluar dhe se ajo nuk funksionoi. Të lutem frymëzoje atë që të dijë se çfarë duhet të bëj unë tani.”

Tani ju mund të qeshni me këtë, por unë nuk qesha. Ai e dinte tanimë atë që Zoti donte që ai të bënte. Por, ai e nderonte detyrën e peshkopit në Kishën e Zotit dhe ndoshta dëshironte që unë të kisha mundësinë të fitoja siguri më të madhe për të marrë zbulësë në atë thirrje.

Funksionoi. Sapo u ngritëm dhe më pas u ulëm, zbulësia më erdhi. I thashë atë që ndjeva se Zoti donte që ai të bënte. Ai ishte vetëm 18 vjeç atëherë, por ai ishte i pjekur për nga mosha shpirtërore.

Ai e dinte tanimë se nuk i duhej të shkonte te peshkopi për një problem të tillë. Por ai kishte mësuar ta mbështeste shërbëtorin e Zotit edhe në dobësitë e tija si i vdekshëm. Ai më së fundi u bë president kunji. Ai e mbajti [përherë] me vete mësimin që morëm së bashku: nëse keni besim se Zoti e udhëheq Kishën e Tij nëpërmjet zbulësës dhënë atyre shërbëtorëve të papërsosur që Ai thërret, Zoti do t’i hapë pragjet e qiellit për ata, si edhe për ju.

Nga ajo përvojë, unë mora mësimin se besimi i njerëzve të cilëve u shërbejmë, ndonjëherë më i madh se vetë besimi ynë, na sjell zbulësë në shërbim të Zotit.

Pati [dhe] një mësim tjetër për mua. Nëse ai djalë do të më kishte gjykuar për mospësuksin tim në dhënie e një këshille të mirë atij herën e parë, ai



kurrë nuk do të ishte kthyer ta kërkon-te përsëri. Dhe kështu, duke zgjedhur të mos më gjykonte, ai mori konfirmimin e dëshiruar.

Edhe një mësim tjetër nga ajo përvojë më ka shërbyer shumë. Me aq sa kam dijeni, ai kurrë nuk i tha ndokujt në lagje se nuk i kisha dhënë këshillë të mirë në fillim. Nëse do ta kishte bërë atë, ajo mund ta kishte ulur besimin e të tjerëve në lagje për të mirëbesuar të frymëzimi i peshkopit.

Unë përpiqem të mos i gjykoj shërbëtorët e Zotit apo të flas rreth dobësive të tyre të jashtme. Dhe unë përpiqem t'ua mësoj atë fëmijëve të mi nëpërmjet shembullit. Presidenti Xhejms E. Faust tregoi një parim bazë që unë po përpiqem ta përvetësoj. Unë jua paraqes atë:

“Nevojitet . . . t'i mbështetim dhe t'i përkrahim udhëheqësit tanë vendorë, pasi . . . ata janë të 'thirrur dhe [të] zgjedhur'. Çdo anëtar i kësaj Kishë mund të këshillohet nga një peshkop apo president dege, nga një president kunji ose misioni dhe nga Presidenti i Kishës dhe shokët e tij. Asnjëri prej këtyre vëllezërve nuk e kërkoi thirrjen e tij. Asnjëri nuk është i përsosur. E megjithatë, ata janë shërbëtorët e Zotit, të thirrur prej Tij nëpërmjet atyre që kanë të drejtën e frymëzimit. Ata që janë thirrur, mbështetur dhe veçuar kanë të drejtën e përkrahjes sonë mbështetëse.

. . . Mosrespektimi i udhëheqësve kishtarë ka bërë që shumë të vuajnë

dobësi shpirtërore dhe rënie. Nuk duhet të vëmë re ndonjë papërsosmëri të dukshme, gabime apo të meta të njerëzve që janë thirrur për të na kryesuar dhe për të mbajtur pozicionin që mbajnë” (“Called and Chosen”, *Liahona*, nëntor 2005, f. 54–55; [Konferenca e Përgjithshme, tetor 2005, “Të Thirrur dhe të Zgjedhur”, f. 76]).

Ajo këshillë i bekon shërbëtorët e Perëndisë në të gjitha rrethanat.

Në ditët e hershme të Kishës së Zotit, udhëheqës që ishin pranë Profetit Jozef Smith, filluan të flisnin rreth gabimeve të tij. Me gjithë atë që kishin parë dhe që dinin për pozitën e tij në raport me Zotin, fryma e tyre e kritikës dhe e xhelozisë u përhap si murtajë. Njëri prej Të Dymbëdhjetëve dha për të gjithë ne standardin e besimit dhe besnikërisë që ne duhet ta kemi nëse do të shërbejmë në mbretërinë e Zotit.

Ja ku është parashtrësja: “Disa pleq i thirrën në një mbledhje në tempull të gjithë ata që e quanin Jozef Smithin një Profet të rënë. Ata kishin qëllim ta caktinin Dejvid Uitmerin si udhëheqësin e ri të Kishës. . . . Pasi i dëgjoji argumentet kundër Profetit, Brigam [Jangu] u ngrit e dëshmoi: ‘Jozefi ishte një Profet dhe unë e dija atë, dhe se ata mund ta shanin e përgojnin atë sa të donin, [porse] ata nuk mund ta shkatërronin caktimin e Profetit nga Perëndia; ata vetëm mund të shkatërronin vetë autoritetin e tyre, ta prisnin fillin lidhës që i mbante ata të lidhur me Profetin dhe

me Perëndinë dhe të fundoseshin për vete në ferr’” (*Church History in the Fulness of Times Student Manual* [manual i Sistemit Arsimit të Kishës, 2003], bot. i 2-të, f. 174; shih edhe *Teachings of Presidents of the Church: Brigham Young* [1997], f. 79).

Ka një fill lidhës i cili na lidh me Zotin në shërbimin tonë. Ai zgjatet prej kudo qofshim thirrur ne për të shërbyer në mbretëri, deri lart përmes atyre që janë thirrur për të na kryesuar në priftëri e deri te profeti, i cili është i lidhur me Zotin. Do besim e përlulesi që të shërbejmë në pozitën në të cilën jemi thirrur, që të mirëbesojmë se Zoti na thirri ne dhe ata që na kryesojnë ne, dhe që t'i mbështetim ata me besim të plotë.

Do të ketë periudha kohe, siç pati në ditët e Kirtlandit, kur ne do të na duhet të kemi besimin dhe integritetin e një Brigam Jangu për të qëndruar në pozitën në të cilën na ka thirrur Zoti, besnikë ndaj profetit të Tij dhe udhëheqësve që Ai ka thirrur.

Unë ju jap dëshminë time solemne dhe prapëseprapë të gëzuar se Zoti Jezu Krisht është në timon. Ai i udhëheq Kishën e Tij dhe shërbëtorët e Tij. Unë jap dëshmi se Tomas S. Monsoni është i vetmi njeri i cili i mban dhe i ushtron të gjithë çelësat e priftërisë së shenjtë në tokë në këtë kohë. Dhe unë lutem për bekime për të gjithë shërbëtorët e përlulur, të cilët shërbejnë me kaq gatishmëri dhe mirë në Kishën e rivendosur të Jezu Krishtit, të cilën Ai vetë e udhëheq. Unë dëshmoj se Jozef Smithi e pa Perëndinë, Atin, dhe Jezu Krishtin. Ata i folën atij. Çelësat e priftërisë u rivendosën për bekimin e të gjithë fëmijëve të Atit Qiellor. Është misioni ynë dhe na është mirëbesuar neve që të shërbejmë në pozicionin tonë neve kauzën e Zotit. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■



Nga Xhin B. Bingham,
Presidente e Përgjithshme e Shoqatës së Ndhmës

Që Gëzimi Juaj të Jetë i Plotë

Jezu Krishti është burimi i të gjithë shërimit, paqes dhe përparimit të përvetshëm.

Vëllezër e motra, jam e gëzuar të jem me ju sot. Dhe kjo është ajo për të cilën do të doja të flisja me ju këtë mëngjes – të pasurit e një plotësie gëzimi.

Një titull i lajmeve të kohëve të fundit thotë: “Shkatërrimet tronditin kombin [dhe] botën”¹. Nga uraganet dhe përmbytjet e deri te valët e të nxehtit dhe thatësit, nga zjarret e mëdha dhe tërmetet e deri te luftërat dhe sëmundjet shkatërruese, duket sikur “i gjithë dheu [është] në rrëmujë”².

Miliona njerëz janë shpërngulur dhe jetë të panumërta janë prerë në mes nga këto sfida. Grindja në familje dhe komunitete, si edhe beteja të brendshme me frikën, dyshimin dhe pritshmëri të papëmbushura na lënë gjithashtu të trazuar. Mund të jetë e vështirë ta ndieni gëzimin që dha mësimi i Lehi se është qëllimi i jetës.³ Me raste, ne të gjithë kemi pyetur: “Ku mund të gjej paqe? Ku kam ngushëllim . . . ?”⁴ Ne vrasim mendjen: “Si të gjej gëzim pavarësisht nga vështirësitë e jetës në vdekshmëri?”

Përgjigja mund të duket tepër e thjeshtë, por ajo është provuar se është e vërtetë që nga ditët e Adamit. Gëzimi

i përhershëm gjendet kur përqendrohem te Shpëtimtari ynë, Jezu Krishti, dhe kur e jetojmë ungjillin ashtu siç tregohet dhe jepet mësim prej Tij. Sa më shumë të mësojmë rreth Jezu Krishtit, të kemi besim në Të dhe t’i përngjasim Atij, aq më shumë arrijmë të kuptojmë se Ai është burimi i të gjithë shërimit, paqes dhe përparimit të përvetshëm. Ai e fton secilin prej nesh që të vijë tek Ai⁵, një ftesë që Presidenti Henri B. Ajring e ka karakterizuar si “ftesa më e rëndësishme që çdokush mund të pranojë”⁶.

Mësoni për Jezu Krishtin

Si vijmë tek Ai? Prillin e shkuar, Presidenti Rasëll M. Nelson dhe Plaku M. Rasëll Ballard na nxitën që ta studionim dokumentin “Krishti i Gjallë”⁷ si pjesë e të mësuarit për Shpëtimtarin. Shumë anëtarë e kanë pranuar sfidën dhe janë bekuar. Jo shumë kohë më parë, një mikeshë e dashur i dha secilit prej fëmijëve të saj të rritur kopje të këtij dokumenti, me figura të ungjillit që ilustronin secilën frazë. Ajo i nixti fëmijët e saj që t’i ndihmonin nipërit e mbesat e saj ta kuptonin dhe ta mësonin atë përmendsh. Ca kohë më vonë, mikeshja ime më tregoi një material filmik të mbesës së saj gjashtëvjeçare, Lejnit, duke e recituar variantin e saj të mësuar përmendsh me entuziazëm e vetësiguri. Kuptova që, nëse një gjashtëvjeçare mund ta bëjë atë, edhe unë mundem!

Ndërsa i kam studiuar jetën dhe mësimet e Jezu Krishtit me më shumë përqendrim dhe e kam rrënjësuar në kujtesë tekstin e dokumentit “Krishti i Gjallë”, mirënjohja dhe dashuria ime për Shpëtimtarin tonë janë shtuar. Çdo fjali e atij dokumenti të frymëzuar përbën një predikim dhe e ka përmirësuar të kuptuarit e mi për rolet e Tij hyjnore



dhe misionin e Tij tokësor. Ajo që kam mësuar dhe ndier gjatë kësaj periudhe studimi dhe reflektimi, vërteton se Jezusi është me të vërtetë “drita, jeta dhe shpresa e botës”⁸. Shkrimi i shenjtë i lashtë dhe fjalët e profetëve të ditëve të mëvonshme, të shkruara apo të thëna, në përlëvdim të Atij, dëshmojnë se “udha e Tij është shtegu që të çon drejt lumturisë në këtë jetë dhe jetës së përjetshme në botën që vjen”⁹.

Kini Besim te Jezu Krishti

Kur e studioni jetën dhe mësimet e Krishtit në një mori mënyrash, besimi juaj në Të do të rritet. Ju do të arrini ta dini se Ai ju do individualisht dhe ju kupton përsosurisht. Në 33 vitet e Tij në vdekshmëri, Ai vuajti mospranim, përndjekje, uri trupore, etje dhe lodhje¹⁰, vetmi, dhunë verbale e fizike dhe, përfundimisht, një vdekje mizore në duart e njerëzve mëkatarë.¹¹ Në Kopshtin e Gjetsemanit dhe në kryqin e Kalvarit, Ai ndjeu gjithë dhembjet, hidhërimet, tundimet, sëmundjet dhe dobësitë *tona*¹².

Pavarësisht nga ajo që kemi vuajtur, Ai është burimi i *shërimit*. Atyre që kanë përjetuar ndonjë lloj dhune, humbje shkatërrimtare, sëmundje kronike apo vuajtje gjymtuese, akuza të pavërteta, përndjekje të egër ose dëmtim shpirtëror nga mëkati apo keqkuptimet, të gjitha mund të shërohen nëpërmjet Shëlbuesit të botës. Gjithsesi, Ai nuk do të hyjë pa u ftuar. Ne duhet të vijmë tek Ai dhe ta lejojmë Atë t'i kryejë mrekullitë e Tij.

Një ditë pranvere të bukur e lashë derën hapur për t'iu kënaqur ajrit të freskët. Një zog i vogël fluturoi nëpërmjet derës së hapur dhe më pas kuptoi se nuk ishte atje ku donte të ishte. Fluturonte me dëshpërim për qark dhomës, duke fluturuar vazhdimisht drejt dritares prej xhami, në përpjekje për t'u

larguar. U përpoqa që ta udhërrëfeja butësisht drejt derës së hapur, por ai që i frikësuar dhe vazhdonte të largohej vrullshëm. Më në fund qëndroi në majë të perdeve të dritares, i hutuar e i rras-kapitur. Mora një fshesë dhe ngadalë e ngrita pjesën e fijeve të fshesës atje ku zogu kishte zënë vend me nervozizëm. Ndërsa e mbajta kokën e fshesës pranë këmbëve të tij, zogu me ngurrim hipi mbi fijet e trasha. Ngadalë, shumë ngadalë, eca drejt derës së hapur, duke e mbajtur fshesën sa më qëndrueshëm që mundesha. Sapo mbërritëm te dera e hapur, zogu fluturoi vrik drejt lirisë.

Ashtu si ai zog, ndonjëherë ne kemi frikë të mirëbesojmë ngaqë nuk e kuptojmë dashurinë dhe dëshirën absolute të Perëndisë për të na ndihmuar. Por kur e studiojmë planin e Atit Qiellor dhe misionin e Jezu Krishtit, ne e kuptojmë se objektivi i Tyre i vetëm është lumturia dhe përparimi ynë i përjetshëm.¹³ Ata kënaqen të na ndihmojnë kur ne pyesim, kërkojmë e trokasim.¹⁴ Kur ushtrojmë besim dhe përlësisht jemi të hapur ndaj përgjigjeve të Tyre, ne çlirohemi



nga kufizimet e keqkuptimeve dhe hamendësimeve tona dhe neve mund të na tregohet udha përpara.

Jezu Krishti është gjithashtu burimi i *paqes*. Ai na fton të “mbështetemi në krahun e [Tij] të fuqishëm”¹⁵ dhe premtion “paq[en] . . . që ia tejkalon çdo zgjuarsie”¹⁶, një ndjenjë që vjen kur Shpirti i Tij “i qetëso[n] shpirtat tanë”¹⁷, pavarësisht nga sfidat që na rrethojnë. Qofshin ato vështirësi vetjake, shqetësime familjare apo kriza në komunitet, paqja do të vijë kur besojmë se Biri i Vetëmlindur i Perëndisë ka fuqi për ta qetësuar shpirtin tonë të vuajtur.

Snjezhana Podvinski, një prej shenjtove të pakta në Karlovac të Kroacisë, u mbështet në Shpëtimtari kur bashkëshorti i saj si dhe të dy prindërit e saj vdiqën brenda një periudhe gjashtëmujore vitin e kaluar. E tronditur nga pikëllimi, por duke pasur një dëshmi se familjet janë përgjithmonë, ajo i përdori gjithë kursimet e saj për të udhëtuar për në tempull, ku ajo u vulos me bashkëshortin dhe prindërit e saj. Ajo tregoi se ato ditë në tempull ishin një pikë kulmore në jetën e saj. Për shkak të dëshmisë së saj të palëkundur për Jezu Krishtin dhe Shlyerjen e Tij, ajo ka ndier paqe dhe ka përjetuar shërim, të cilat kanë qenë gjithashtu një forcë për njerëzit përreth saj.

Besimi në Jezu Krisht sjell edhe më shumë dhurata sesa shërim e paqe. Ashtu siç tregoi Presidenti Henri B. Ajring: “Kam qenë mirënjohës për mënyrat e shumta se si Zoti më ka vizituar me Ngushëlluesin kur kisha nevojë për paqe. Prapëseprapë, Ati ynë në Qiell nuk është i shqetësuar vetëm për ngushëllimin tonë, por akoma më shumë për përparimin tonë të madh.”¹⁸

Për shkak të Shlyerjes së Jezu Krishtit, e cila përfshin dhuratat e shëlbimit dhe të ringjalljes, ne jemi në gjendje të pendohemi, të ndryshojmë dhe të

përparojmë përjetësisht. Për shkak të fuqisë që Ai na jep kur jemi të bindur, ne jemi në gjendje të bëhemi më shumë sesa mund të bëheshim ndonjëherë vetë. Ne mund të mos ta kuptojmë plotësisht mënyrën, por secili prej nesh që e ka ndier besimin në Krisht t'i rritet, ka marrë gjithashtu një kuptueshmëri më të madhe të identitetit dhe qëllimit tonë hyjnor, që na çojnë drejt zgjedhjeve që janë në përputhje me atë njohuri.

Pavarësisht se bota do të përpiqet të na ulë në nivelin e “thjesht kafsh[ëve]”¹⁹, njohuria se Perëndia është Ati ynë na siguron se ne kemi potencial hyjnor dhe premtim mbretëror. Pavarësisht se bota na tregon që kjo jetë është një rrugë pa krye, njohuria se Biri i Vetëmlindur i Perëndisë ka bërë të mundur që ne të shëlbehemi dhe të ringjallemi, na jep shpresë për përparim të përjetshëm.

Përngjasojini Jezu Krishtit

Kur mësojmë më shumë rreth Jezu Krishtit, ne zhvillojmë besim më të madh tek Ai dhe natyrshëm duam ta ndjekim shembullin e Tij. Zbatimi i urdhërimeve të Tij bëhet dëshira jonë më e madhe. Zemrat tona digjen për t'ua lehtësuar vuajtjen të tjerëve, ashtu siç bëri Ai, dhe ne duam që ata të përjetojnë paqen dhe lumturinë që kemi gjetur ne.

Përse përpjekja për të vepruar siç veproi Ai është kaq e fuqishme? Për shkak se, kur e vëmë në veprim besimin tonë, Fryma e Shenjtë dëshmon për të vërtetën e përjetshme.²⁰ Jezusi i udhëzon dishepujt e Tij që t'i zbatojnë urdhërimet e Tij ngaqë Ai e di se, kur ne e ndjekim shembullin e Tij, ne do të fillojmë të përjetojmë gëzim dhe kur vazhdojmë në udhën e Tij, ne do të arrijmë te një plotësi gëzimi. Ai shpjegoi: “Këto gjëra jua kam thënë që gëzimi im të qëndrojë në ju dhe gëzimi juaj të jetë i plotë”²¹.



A janë dëshmitë tona të ndërtuara mbi themelin e patundur të Jezu Krishtit dhe ungjillit të Tij? Kur stuhitë e jetës ushtrojnë trysni mbi ne, a kërkojmë si të çmendur një libër udhëzimesh apo një publikim në internet për ndihmë? Gjetja e kohës për ta ndërtuar dhe forcuar njohurinë dhe dëshminë tonë për Jezu Krishtin do të prodhojë shpërblime të begata në kohë sprovashe dhe fatkeqësish. Leximi i përditshëm i shkrimeve të shenja dhe përsiatja e fjalëve të profetëve të gjallë, përfshirja në lutje vetjake kuptimplote, marrja me ndërgjegje e sakramentit çdo javë, dhënia e shërbimit ashtu siç do ta jepte Shpëtimtari – secila prej këtyre veprimtarive të thjeshta bëhet bazë për një jetë të gëzueshme.

Çfarë ju sjell gëzim? Të shikoni njerëzit tuaj të dashur në fund të një dite të gjatë? Kënaqësia e një pune të bërë mirë? Drita në sytë e dikujt kur ju e mbani me ta barrën e tyre? Fjalët e një himni që depërton thellë në zemrën tuaj? Shtrëngimi i duarve me një mik të ngushtë? Kaloni një çast me veten për të menduar mbi bekimet tuaja dhe pastaj gjeni mënyra për t'i treguar ato. Teksa vazhdoni që të shtrini dorën për t'u shërbyer dhe për t'i lartësuar vëllezërit dhe motrat tuaja në lagjen tuaj ose anëmbanë kësaj bote që është në rrëmujë, ju do të ndieni paqe dhe shërim më të madh, dhe madje do të përparoni.

Ejani tek Ai. Dëshmoj se, kur e përqendroni jetën tuaj te Jezu Krishti,

ju do të gjeni gëzim në rrethanat tuaja, cilado qofshin ato. Me të vërtetë, përgjigjja është: “Vetëm Ai”²². Gjeni kohë dhe merrni kohë që të arrini ta njihni Jezu Krishtin nëpërmjet studimit me zell, zhvillimit të një besimi më të madh tek Ai dhe përpjekjes për t'u bërë përherë e më shumë si Ai. Kur e bëjmë këtë, edhe ne do të nxitemi të themi, me të voglën Lejini: “I qofshim falë Perëndisë për dhuratën e pashoqe që na ka bërë duke na dhënë Birin e Tij hyjnor”²³. Në emrin e bekuar dhe të shenjtë të Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Tamara Lush dhe Jay Reeves, “Disasters Rock the Nation, World”, *Deseret News*, 10 shtator 2017, A1.
2. Doktrina e Besëlidhje 45:26.
3. Shih 2 Nefi 2:25.
4. “Ku Mund të Gjej Paqe?” *Himne*, nr. 67.
5. Shih 3 Nefi 9:14, 22.
6. Henry B. Eyring, “Come unto Christ”, *Liahona*, mars 2008, f. 49.
7. Shih “Krishti i Gjallë: Dëshmia e Apostujve”, *Liahona*, prill 2000, f. 2–3.
8. “Krishti i Gjallë”, f. 3.
9. “Krishti i Gjallë”, f. 3.
10. Shih Mosia 3:7.
11. Shih Lluqa 24:7.
12. Shih Alma 7:11–12.
13. Shih Moisiu 1:39.
14. Shih Mateu 7:7.
15. “Lean on My Ample Arm”, *Hymns*, nr. 120.
16. Filipianëve 4:7.
17. Alma 58:11.
18. Henri B. Ajring, “Unë Po Ju Lë Paqen”, *Liahona*, maj 2017, f. 17.
19. “Të Dish K’të, Çdo Shpirt Është i Lir’”, *Himne*, nr. 151.
20. Shih Gjoni 7:17.
21. Gjoni 15:11.
22. “Ku Mund të Gjej Paqe?” nr. 67.
23. “Krishti i Gjallë”, f. 3.



Nga Plaku Donald L. Hallstrom,
i Të Shtatëdhjetëve

A Mos Ka Pushuar Dita e Mrekullive?

Përqendrimi ynë më i lartë duhet të jetë te mrekullitë shpirtërore që janë në dispozicion për të gjithë fëmijët e Perëndisë.

Një vit më parë, në një detyrë në shtetin e Kalifornisë, bashkë me një president kunji, shkova të takoja Klark e Holli Fejllsin me familjen në shtëpinë e tyre. Më kishin thënë se kohët e fundit ata kishin përjetuar një mrekulli. Kur mbërritëm, Klarku e pati të vështirë të ngrihej dhe të na përshëndeste sepse kishte vënë një mbajtëse shpine, një qafore dhe mbajtëse në krahët e tij.

Vetëm pak më shumë se para dy muajsh, Klarku, i biri i tij, Taji, dhe rreth 30 të rinj dhe udhëheqës të tjerë, u nisën për një aktivitet kunji sfidues në natyrë, që të ngjiteshin në majën 4322 m të lartë të malit Shasta, një nga majat më të larta në Kaliforni. Në ditën e dytë të ngjitjes së lodhshme, shumica e alpinistëve e arritën majën – një arritje emocionuese e mundësuar nga muaj të tërë përgatitjeje.

Një nga njerëzit e parë që arritën në majë atë ditë, ishte Klarku. Pas një pushimi të shkurtër afër skajit të majës, ai u ngrit dhe filloi të ecte. Teksa po ecte, ai u pengua dhe ra me kurriz nga buza e një shkëmbi duke pësuar një rënie të lirë për rreth 12 m dhe pastaj një rrokullisje të pakontrolluar nëpër shpatin e

veshur me akull për rreth 91 m të tjerë. Për çudi Klarku mbijetoi, por ishte plagosur rëndë dhe nuk mund të lëvizte.

Mrekullitë që Klarku përjetoi gjatë kësaj ngjarjeje tronditëse, ishin thjesht fillimi. Disa nga të parët që arritën tek ai, “rastisi” të ishin një grup alpinistësh që përfshinte udhërrëfyes shpëtimi malor dhe profesionistë mjekësorë të urgjencës. Ata menjëherë e trajtuan Klarkun për goditjen dhe siguruan pajisje për ta mbajtur ngrohtë. Ky grup gjithashtu “rastisi” që po vinte në provë

një mjet të ri komunikimi dhe dërgoi një kërkesë urgjence për ndihmë nga një zonë ku telefonat celularë nuk mund të merrnin sinjal. Një helikopter i vogël u dërgua menjëherë për në malin Shasta nga [një vend] një orë larg. Pas dy përpjekjeve të pasuksesshme për t’u ulur në një lartësi që thuhet se kalonte aftësitë e mjetit dhe duke u mundur nga gjendja e rrezikshme e erërave, piloti nisi një përpjekje të tretë dhe përfundimtare. Ndërsa helikopteri u afrua nga një kënd i ndryshëm, “rastisi” që erërat ndryshuan dhe mjeti u ul në tokë vetëm aq kohë sa për t’i lejuar grupit të vogël që ta fuste Klarkun me ngut dhe dhembje në hapësirën e vogël pas ndenjës së pilotit.

Kur gjendja e Klarkut u vlerësua në një qendër traume, analizat zbuluan se ai kishte pësuar thyerje të shumëfishta në qafë, kurriz, brinjë dhe kyçe, se kishte një mushkëri të shpuar dhe një mori prerjesh dhe gërvishtjesh. Një kirurg neurotraume i famshëm “rastisi” të ishte në shërbim atë ditë; ai shkon në këtë spital vetëm disa herë në vit. Ky mjek më vonë deklaroi se ai nuk kishte parë kurrë dikë të pësonte kaq shumë dëmtim në shtyllën kurrizore dhe



arteriet karotide dhe të jetonte. Klarku pritej që jo vetëm të jetonte, por edhe që të shërohej plotësisht. Duke e përshkruar veten si agnostik, kirurgu tha se rasti i Klarkut binte në kundërshtim me të gjithë njohurinë e tij shkencore mbi dëmtimet neurologjike dhe se mund të përshkruhej vetëm si një mrekulli.

Ndërsa Klarku dhe Holli mbaruan së rrëfyeri këtë tregim të gjallë, unë e pata të vështirë të flisja. Nuk ishte thjesht për shkak të mrekullive të dukshme, por për shkak të një mrekullie më të madhe. Pata një përshtypje të thellë – një dëshmi shpirtërore – se Holli dhe secili prej pesë fëmijëve të bukur që ishin ulur në dhomën e ndenjjes rreth prindërve të tyre, kishin kaq shumë besim, sa që ata mund ta kishin pranuar çfarëdo rezultati atë ditë dhe prapë-prapë do të kishin përparuar shpirtërisht. Klarku dhe Holli dhe dy fëmijët e tyre më të rritur, Taji dhe Porteri, janë me ne sot në Qendrën e Konferencave.

Duke përsiatur mbi përvojën e familjes Fejlls, kam menduar shumë për rrethanat e kaq shumë të tjerëve. Çfarë mund të themi për morinë e shenjtoreve të ditëve të mëvonshme të mbushur me besim, që kanë marrë bekim priftërie, për të cilët janë bërë një pafundësi lutjesh, që i mbajnë besëlidhjet, që janë plot me shpresë, por për të cilët mrekullia nuk vjen kurrë? Të paktën ashtu si e kuptojnë ata mrekullinë. Të paktën në atë mënyrë siç duket se të tjerëve u ndodhin mrekulli.

Po ata që vuajnë nga pikëllime të thella – fizikisht, mendërisht, emocionalisht – për vite ose dekada apo për të gjithë jetën e tyre të vdekshme? Po ata që vdesin kaq të rinj?

Vetëm dy muaj më parë, dy çifte të martuara që mbanin rekomandim tempulli, me tre fëmijë misionarë me kohë të plotë dhe pesë fëmijë të tjerë, u nisën me një aeroplan të vogël për



një fluturim të shkurtër. Jam i sigurt se ata u lutën për siguri përpara fluturimit dhe se u lutën me zell kur aeroplani i tyre hasi probleme serioze mekanike përpara se të përplasej. Askush nuk mbijetoi. Po ata?

A kanë arsye njerëzit e mirë dhe të dashurit e tyre të bëjnë pyetjen që bëri Mormoni: “A mos ka pushuar dita e mrekullive?”¹

Njohuria ime e kufizuar nuk mund ta shpjegojë se përse disa herë ka një ndërhyrje hyjnore dhe herë të tjera jo. Por ndoshta neve na mungon kuptueshmëria e asaj çfarë përbën një mrekulli.

Shpesh ne e përshkruajmë një mrekulli si shërim pa një shpjegim të plotë nga shkencën mjekësore ose si shmangien e një rreziku katastrofik duke i vënë veshin një nxitjeje të qartë. Sidoqoftë, ta përkuftosh një *mrekulli* si “një ngjarje mirëbërëse, e cila ndodh nëpërmjet fuqisë hyjnore, që të vdekshmit nuk e kuptojnë”² jep një pikëpamje të zgjeruar mbi çështje me natyrë më të përjetshme. Ky përkuftim na lejon gjithashtu që të mendojmë mbi rolin jetësor të besimit në marrjen e një mrekullie.

Moroni dha mësim: “Dhe asnjëherë në ndonjë kohë ndonjë njeri nuk ka bërë mrekulli vetëm pas besimit të tij”³. Amoni shpalli: “Perëndia ka dhënë një mjet që njeriu, nëpërmjet besimit, të mund të punojë mrekulli të mëdha”⁴. Zoti i zbuloi Jozef Smithit: “Sepse unë jam Perëndi, . . . dhe unë do t’u tregoj mrekulli . . . gjithë atyre që besojnë në emrin tim”⁵.

Mbreti Nebukadnetsar kërkoi që Shadraku, Meshaku dhe Abednegoja të adhuronin imazhin e artë që ai e kishte vendosur si një perëndi, duke i kërcënuar: “Në rast se nuk do ta adhuroni, do t’ju hedhin . . . në mes të një furre të ndezur”. Më pas ai i përqeshi ata duke iu thënë: “Dhe cila është ajo perëndi që do të mund t’ju çlirojë nga duart e mia?”⁶

Këta tre dishepuj besnikë thanë: “Ja, Perëndia ynë, të cilit i shërbejmë, është në gjendje të na çlirojë nga furra e ndezur. . . . Por edhe sikur të mos e bënte, dije, o mbret, që ne nuk do t’u shërbejmë perëndive të tua.”⁷

Ata zotëronin mirëbesim të plotë se Perëndia mund t’i shpëtonte ata, “por edhe sikur të mos e bënte”, ata kishin besim të plotë në planin e Tij.

Në mënyrë të ngjashme, Plaku Dejvid A. Bednar e pyeti njëherë një të ri i cili kishte kërkuar një bekim priftërie: “Nëse vullneti i Atit tonë Qiellor është që ti të dërgohesh përmes vdekjes në rini në botën e shpirtave për të vazhduar shërbesën tënde, a e ke besimin për t’u nënshtruar vullnetit të Tij dhe për të mos u shëruar?”⁸ A e kemi *ne* besimin “për të mos u shëruar” nga pikëllimet tona tokësore në mënyrë që të shërohemi përjetësisht?

Një pyetje vendimtare për ta përsiatur është: “Ku e vendosim besimin tonë?” A është besimi ynë i përqendruar thjesht në dëshirën për të qenë të lehtësuar nga dhembja dhe vuajtja, apo është i përqendruar vendosmërisht mbi

Perëndinë, Atin, dhe planin e Tij të shenjtë dhe mbi Jezu Krishtin dhe në Shlyerjen e Tij? Besimi tek Ati dhe Biri na lejon ta kuptojmë dhe ta pranojmë vullnetin e Tyre ndërsa përgatitemi për përjetësinë.

Sot unë dëshmoj për mrekullitë. Të jesh një fëmijë i Perëndisë është një mrekulli.⁹ Të marrësh një trup sipas shëmbëlltyrës dhe ngjashmërisë së Tij, është një mrekulli.¹⁰ Dhurata e Shpëtimtarit është një mrekulli.¹¹ Shlyerja e Jezu Krishtit është një mrekulli.¹² Mundësia për jetën e përjetshme është një mrekulli.¹³

Ndërkohë që është mirë të lutemi dhe të punojmë për mbrojtje fizike dhe për shërim gjatë ekzistencës sonë në vdekshmëri, përqendrimi ynë më i lartë duhet të jetë te mrekullitë shpirtërore që janë në dispozicion për të gjithë fëmijët e Perëndisë. Pavarësisht etnisë sonë, pavarësisht kombësisë tonë, pavarësisht asaj që kemi bërë, nëse pendo kemi, pavarësisht asaj që mund të na jetë bërë – të gjithë ne kemi qasje të barabartë te këto mrekulli. Ne po jetojmë një mrekulli dhe mrekulli të tjera na presin përpara. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Moroni 7:35.
2. *Encyclopedia of Mormonism* (1992), "Miracles", 2:908.
3. Ethëri 12:18.
4. Mosia 8:18.
5. Doktrina e Besëlidhje 35:8.
6. Daniel 3:15.
7. Daniel 3:17–18.
8. David A. Bednar, "Accepting the Lord's Will and Timing", *Liahona*, gusht 2016, f. 19–20.
9. Shih Psalmeve 82:6; Veprat e Apostujve 17:29.
10. Shih Abraham 4:26.
11. Shih Isaia 9:6.
12. Shih Mateu 20:28; Alma 7:11–13; Doktrina e Besëlidhje 76:69.
13. Shih Gjonit 10:28; Moroni 7:41; Doktrina e Besëlidhje 45:8.



Nga Plaku Dejvid A. Bednar,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Premtimet e Çmueshme dhe Shumë të Mëdha

Plani madhështor i Atit Qiellor për lumturinë përfshin doktrinën, ordinancat, besëlidhjet dhe premtimet e çmueshme dhe shumë të mëdha, me anë të të cilave ne mund të bëhemi pjesëtarë të natyrës hyjnore.

Një nga sfidat e mëdha që ndesh secili prej nesh çdo ditë, është që të mos i lejojmë shqetësimet e kësaj bote të marrin kaq shumë nga koha dhe energjia jonë sa të lëmë pas dore gjërat e përjetshme që kanë më shumë rëndësi.¹ Ne mund të devijohemi shumë lehtë nga mbajtja mend e përparësive thelbësore shpirtërore dhe përqendrimi tek ato, për shkak të përgjegjësive të shumta dhe programeve të ngarkuara që kemi. Nganjëherë

përpiqemi të vrapojmë aq shpejt sa mund të harrojmë se ku po shkojmë dhe përse po vrapojmë.

Apostulli Pjetër na kujton se, për dishepujt e Jezu Krishtit, "fuqia e Tij hyjnore na dhuroi të gjitha gjërat që i takojnë *jetës dhe perëndishmërisë*, me anë të njohjes së atij që na thirri me lavdinë dhe virtytin e vet,

me anë të të cilave na u dhuruan *premtimet e çmueshme dhe shumë të mëdha*, që nëpërmjet tyre të bëheni *pjesëtarë të natyrës hyjnore*, duke i shpëtuar prishjes që është në botë për shkak të lakmisë"².

Mesazhi im thekson rëndësinë e premtimeve të çmueshme dhe shumë të mëdha të përshkruara nga Pjetri, si kujtues të vërtetë të asaj se ku po shkojmë në udhëtimin tonë në vdekshmëri dhe të arsyes së saj. Do të shtjelloj gjithashtu rolet përkatëse të ditës së Shabatit, të tempullit të shenjtë dhe të shtëpive tona, për të na ndihmuar që t'i kujtojmë këto premtime të rëndësishme shpirtërore.

Lutem me zell që Fryma e Shenjtë do ta udhëzojë secilin prej nesh ndërsa i marrim në shqyrtim së bashku këto të vërteta të rëndësishme.



Identiteti Ynë Hyjnor

Plani madhështor i Atit tonë Qiellor për lumturinë përfshin doktrinën, ordinancat, besëlidhjet dhe premtimet e çmueshme dhe shumë të mëdha, me anë të të cilave ne mund të bëhemi pjesëtarë të natyrës hyjnore. Plani i Tij përcakton identitetin tonë të përjetshëm dhe shtegun që duhet të ndjekim për të mësuar, për të ndryshuar, për t'u rritur dhe, përfundimisht, për të jetuar përgjithmonë me Të.

Siç shpjegohet te "Familja: Një Proklamata drejtuar Botës":

"Të gjitha qeniet njerëzore – meshkuj e femra – janë krijuar sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë. Secili është një bir ose bijë shpirtërore e dashur e prindërve qiellorë dhe, si i tillë, secili ka një natyrë dhe destinacion hyjnor. . . .

Në mbretërinë paratokësore, bijtë dhe bijat shpirtërore e njihnin dhe e adhuronin Perëndinë si Atin e tyre të Amshuar dhe e pranuan planin e Tij, me anë të të cilit fëmijët e Tij mund të merrnin një trup fizik, mund të fitonin përvojë tokësore për të përparuar drejt përsosjes dhe së fundi, mund të arrinin destinacionin e tyre hyjnor si trashëgimtarë të jetës së përjetshme."³

Perëndia u premtonte fëmijëve të Tij që, në qoftë se ata i ndjekin parimet e planit të Tij dhe shembullin e Birit të Tij të Dashur, i zbatojnë urdhërimet dhe durojnë me besim deri në fund, atëherë me anë të fuqisë së Shëlbimit të Shpëtimtarit, ata "do të kenë jetë të përjetshme, dhuratë e cila është më e madhja nga të gjitha dhuratat e Perëndisë"⁴. Jeta e përjetshme është premtimi përfundimtar i çmueshëm dhe shumë i madh.

Rilindja Shpirtërore

Ne i kuptojmë më plotësisht premtimet e çmueshme dhe shumë të mëdha dhe fillojmë të marrim nga natyra hyjnore duke iu përgjigjur pozitivisht



thirrjes nga Zoti për lavdi e virtyt. Ashtu siç përshkruhet nga Pjetri, kjo thirrje përmbushet duke u përpjekur fort që t'i largohemi prishjes që është në botë.

Ndërsa shkojmë përpara përlulësisht me besim te Shpëtimtari, atëherë për shkak të Shlyerjes së Tij dhe me anë të fuqisë së Frymës së Shenjtë "një ndryshim [i] madh [ndodh] te ne, ose në zemrat tona, që ne nuk kemi më prirje të bëjmë keq, por të bëjmë mirë vazhdimisht"⁵. Ne "lind[em] rishtaz; po, të lind[ur] nga Perëndia, të ndryshuar nga gjendja [jonë] e mishit dhe e rënë në një gjendje drejtësie, duke qenë të shëlbuar nga Perëndia"⁶. "Prandaj nëse dikush është në Krishtin, ai është një krijesë e re; gjërat e vjetra kanë shkuar; ja, të gjitha gjërat u bënë të reja."⁷

Një ndryshim i tillë gjithëpërfshirës i natyrës sonë zakonisht nuk ndodh shpejt apo menjëherë. Ashtu si Shpëtimtari, ne gjithashtu "nuk e m[arrim] plotësinë që në fillim, por [e] m[arrim] hir pas hiri"⁸. "Pasi vini re, kështu thotë Zoti Perëndi: Unë do t'u jap fëmijëve të njerëzve rresht pas rreshti, parim pas parimi, pak këtu dhe pak atje; dhe të bekuar janë ata që dëgjojnë parimet e mia dhe që i vënë veshin këshillës sime, pasi ata do të mësojnë urtësi."⁹

Ordinancat e priftërisë dhe besëlidhjet e shenjta janë thelbësore në këtë proces të vazhdueshëm të rilindjes shpirtërore; ato janë gjithashtu mjetet që ka caktuar Perëndia, me anë të të cilave ne marrim premtimet e Tij

të çmueshme dhe shumë të mëdha. Ordinancat që merren denjësisht dhe kujtohen vazhdimisht, hapin kanalet e qiellit, nëpërmjet të cilave fuqia e perëndishmërisë vërshon në jetët tona. Besëlidhjet që nderohen me vendosmëri dhe kujtohen gjithmonë, japin qëllim e siguri për bekimet si në vdekshmëri dhe në përjetësi.

Për shembull, Perëndia na premtonte, sipas besnikërisë sonë, shoqërimin e vazhdueshëm të anëtarit të tretë të Kreut-Perëndi, madje të Frymës së Shenjtë¹⁰, që nëpërmjet Shlyerjes së Jezu Krishtit ne të mund të marrim dhe gjithmonë të ruajmë një hecje të mëkateve tona¹¹, që ne të mund të marrim paqe në këtë botë¹², që Shpëtimtari i ka këputur litarët e vdekjes dhe doli fitimtar mbi varrin¹³ dhe se familjet mund të jenë së bashku për gjithë përjetësinë.

Kuptohet, të gjitha premtimet e çmueshme dhe shumë të mëdha që Ati Qiellor u ofron fëmijëve të Tij, nuk mund të llogariten apo të përshkruhen tërësisht. Megjithatë, edhe lista e pjeshme e bekimeve të premtuara që sapo paraqita, duhet ta bëjë secilin prej nesh të "qëndro[ë] plot habi"¹⁴ dhe "të b[jerë] përtokë dhe . . . ta adhurol[ë] Atin"¹⁵ në emrin e Jezu Krishtit.

Të Kujtuarit e Premtimeve

Presidenti Lorenzo Snou paralajmëroi: "Ne jemi shumë të prirur të harrojmë objektivin e madh të jetës,



motivin për të cilin Ati ynë Qiellor na ka dërguar këtu në vdekshmëri, si dhe thirrjen e shenjtë në të cilën jemi thirrur; dhe kështu, në vend që të ngrihemi mbi gjërat e vogla kalimtare . . . , ne tepër shpesh e lejojmë veten të biem në nivelin e botës pa përfituar nga ndihma hyjnore që Perëndia ka krijuar, e cila është e vetmja që mund të na aftësojë t'i kapërcejmë ato [gjëra kalimtare].¹⁶

Dita e Shabatit dhe tempulli i shenjtë janë dy burime të veçanta të ndihmës hyjnore të vendosura nga Perëndia që të na ndihmojë të ngrihemi mbi nivelin dhe prishjen e botës. Fillimisht ne mund të mendojmë se qëllimi kryesor i mbajtjes së ditës së Shabatit të shenjtë dhe i frekuentimit të tempullit janë të lidhura, porse të dallueshme. Sidoqoftë, unë besoj, se ato dy qëllime janë saktësisht të njëjta dhe funksionojnë së bashku për të na forcuar shpirtërisht si individë dhe në shtëpitë tona.

Shabati

Pasi Perëndia i krijoi të gjitha gjërat, Ai pushoi në ditën e shtatë dhe urdhëroi që një ditë, çdo javë, të jetë një kohë pushimi për t'i ndihmuar njerëzit ta kujtojnë Atë.¹⁷ Shabati është koha e Perëndisë, një **kohë e shenjtë**, e veçuar posaçërisht për ta adhuruar Atë dhe për të marrë e kujtuar premtimet e Tij të çmueshme e të mëdha.

Zoti ka udhëzuar në këtë periudhë ungjillore:

“Që të mund të ruash veten më tepër të panjollë nga bota, duhet të shkosh në shtëpinë e lutjes dhe t'i ofrosh sakramentet e tua në ditën time të shenjtë;

Sepse në të vërtetë kjo është një ditë e caktuar për ty që të prehesh nga punët e tua dhe t'i drejtosh lutje Më të Lartit.”¹⁸

Pra, në Shabat ne e adhurojmë Atin në emër të Birit, duke marrë pjesë në ordianca dhe duke mësuar rreth besëlidhjeve, duke i marrë, duke i kujtuar dhe duke i përtërirë ato. Në ditën e Tij të shenjtë, mendimet, veprimet dhe sjellja jonë, janë shenja që i japim Perëndisë dhe një tregues i dashurisë sonë për Të.¹⁹

Një qëllim tjetër i Shabatit është që ta ngremë largpamësinë tonë nga gjërat e botës drejt bekimeve të përjetësisë. Të veçuar gjatë kësaj kohe të shenjtë nga shumë prej rutinës së zakonshme të jetës sonë të ngarkuar, ne mund të “shikojmë] te Perëndia dhe jetojmë]”²⁰, duke i marrë dhe duke i kujtuar bekimet e çmueshme dhe të mëdha me anë të të cilave ne bëhemi pjesëtarë të natyrës hyjnore.

Tempulli i Shenjtë

Zoti e ka urdhëruar gjithmonë popullin e Tij që të ndërtojë tempuj, vende

të shenjta në të cilat shenjtorë të denjë kryejnë ceremoni dhe ordianca të shenjta të ungjillit për veten e tyre dhe për të vdekurit. Tempujt janë vendi më i shenjtë nga të gjitha vendet e adhurimit. Një tempull është vërtet shtëpia e Zotit, një **hapësirë e shenjtë**, e veçuar posaçërisht për adhurimin e Perëndisë dhe për marrjen e kujtimin e premtimeve të Tij të çmueshme e të mëdha.

Zoti ka udhëzuar në këtë periudhë ungjillore: “Organizoni veten tuaj; përgatisni çdo gjë të nevojshme; dhe ngrini një shtëpi, madje një shtëpi lutjeje, një shtëpi agjërimi, një shtëpi besimi, një shtëpi mësimi, një shtëpi lavdie, një shtëpi rregulli, një shtëpi të Perëndisë”²¹. Përqendrimi themelor i adhurimit në tempull është pjesëmarrja në ordianca dhe të mësuarit rreth besëlidhjeve, marrja dhe kujtimi i atyre besëlidhjeve. Në tempull mendojmë, veprojmë dhe vishemi ndryshe nga hapësirat e tjera që mund të frekuentojmë.

Një qëllim themelor i Shabatit është që ta ngremë largpamësinë tonë nga gjërat e botës drejt bekimeve të përjetësisë. Të veçuar për pak kohë nga mjediset e botës me të cilat jemi mësuar, ne mund të “shikojmë] te Perëndia dhe [të] jetojmë]”²², duke i marrë dhe duke i kujtuar bekimet e çmueshme dhe të mëdha me anë të të cilave ne bëhemi pjesëtarë të natyrës hyjnore.

Ju lutem, vini re se dita e Shabatit dhe tempulli, përkatësisht, janë një **kohë e shenjtë** dhe një **hapësirë e shenjtë**, të veçuara posaçërisht për adhurimin e Perëndisë dhe për marrjen e kujtimin e premtimeve të Tij të çmueshme dhe shumë të mëdha ndaj fëmijëve të Tij. Siç u vendos nga Perëndia, qëllimet themelore të këtyre dy burimeve hyjnore të ndihmës janë saktësisht të njëjta: ta përqendrojmë fuqishëm dhe vazhdimisht vëmendjen tonë tek Ati

Qiellor, Biri i Tij i Vetëmlindur, Fryma e Shenjtë dhe premtimet që shoqërohen me ordinancat dhe besëlidhjet e ungjillit të rivendosur të Shpëtimtarit.

Shtëpitë Tona

Më e rëndësishmja, një shtëpi duhet të jetë bashkimi më i mirë i **kohës dhe hapësirës**, ku individët dhe familjet i kujtojnë në mënyrën më të efektshme premtimet e çmueshme dhe të mëdha të Perëndisë. Largimi nga shtëpitë tona për të kaluar kohë në mbledhjet e së dielës dhe për të hyrë në hapësirat e shenjta të tempullit është jetik, por i pamjaftueshëm. Vetëm kur i sjellim shpirtin dhe forcën që burojnë nga këto veprimtari të shenjta, në shtëpitë tona, ne mund ta ruajmë përqendrimin tonë te qëllimet e mëdha të jetës në vdekshmëri dhe ta mposhtim prishjen që është në botë. Shabati ynë dhe përvojat e tempullit duhet të jenë katalizatorë shpirtërorë që i mbushin individët dhe familjet e shtëpitë tona me kujtues të vazhdueshëm të mësimave kyçe të mësuara, me praninë dhe fuqinë e Frymës së Shenjtë, me një kthim në besim të vazhdueshëm e të thelluar te Zoti Jezu Krisht, dhe me “një ndriçim të përkryer të shpresës”²³ në premtimet e përjetshme të Perëndisë.

Shabati dhe tempulli mund të na ndihmojnë të krijojmë në shtëpitë tona “një udhë më të shkëlqyer”²⁴ ndërsa “i sjellim” në një krye të vetëm, në Krishtin, të gjitha gjërat, ato që janë në qiejt dhe ato që janë mbi dhe”²⁵. Ajo çka bëjmë në shtëpitë tona me *kohën e [Tij] të shenjtë* dhe me atë çka mësojmë në *hapësirën e [Tij] të shenjtë* janë të nevojshme për t’u bërë pjesëtarë të natyrës hyjnore.

Premtim dhe Dëshmi

Ne mund të mposhtemi lehtë nga rutina dhe çështjet e rëndonmta të

vdekshmërisë. Të fjeturit, të ngrënit, të veshurit, të punuarit, të luajturit, të ushtruarit dhe shumë veprimtari të tjera të zakonshme janë të nevojshme dhe të rëndësishme. Por, përfundimisht, ajo çka ne bëhemi, është rrjedhojë e njohurisë sonë dhe e gatishmërisë për të mësuar nga Ati, Biri dhe Fryma e Shenjtë; ajo nuk është thjesht shuma e përgjithshme e kërkimit tonë të përditshëm gjatë gjithë jetës.

Ungjilli është shumë më tepër sesa një listë kontrolli rutinë e detyrave të veçanta që duhet të kryhen; më saktë, ai është një ndërthurje e mahnitshme e së vërtetës, “e lidhur mirë”²⁶ dhe e endur së bashku, me synimin për të na ndihmuar të bëhemi si Ati ynë Qiellor dhe Zoti Jezu Krisht, madje pjesëtarë të natyrës hyjnore. Me të vërtetë, ne verbohemi nga të shikuarit përtej shenjës²⁷, kur ky realitet më i lartë shpirtëror lihet nën hije nga hallet, shqetësimet dhe shkujdesja e botës.

Ndërsa tregohemi të mençur dhe e ftojme Shpirtin e Shenjtë të jetë udhërrëfytesë ynë²⁸, unë premtoj se Ai do të na e mësojë atë që është e vërtetë. [Ai] “për Krishtin do të dëshmoj”, [dhe] mendjet tona do ndriçoj”²⁹ ndërsa përpiqemi fort për ta përmbushur fatin tonë të përjetshëm dhe për t’u bërë pjesëtarë të natyrës hyjnore.

Jap dëshminë time se premtimet e çmueshme dhe shumë të mëdha të shoqëruara me ordinancat dhe besëlidhjet tona janë të vërteta. Zoti ka shpallur kështu:

“Unë ju jap udhëzime se si të vepëroni para meje, që të mund t’ju kthehet për shpëtimin tuaj.

Unë, Zoti, lidhem kur ju bëni çfarë ju them; por kur nuk e bëni çfarë ju them, ju nuk keni premtim.”³⁰

Dëshmoj se Ati ynë Qiellor jeton dhe është autori i planit të shpëtimtimit. Jezu Krishti është Biri i Tij i



Vetëmlindur, Shpëtimtari dhe Shëlbuesi ynë. Ai jeton. Dhe unë dëshmoj se plani dhe premtimet e Atit, Shlyerja e Shpëtimtarit dhe shoqërimi i Frymës së Shenjtë bëjnë të mundur “paqe në këtë botë dhe jetë të përjetshme në botën që vjen”³¹. Për këto gjëra unë dëshmoj, në emrin e shenjtë të Zotit Jezu Krisht, amen. ■

SHËNIME

1. Shih Doktrina e Besëlidhje 25:10.
2. 2 Pjetër 1:3–4; theksimi i shtuar.
3. “Familja: Një Proklamatë drejtuar Botës”, *Liahona*, nëntor 2010, f. 129.
4. Doktrina e Besëlidhje 14:7.
5. Mosia 5:2.
6. Mosia 27:25.
7. 2 Korintasve 5:17.
8. Doktrina e Besëlidhje 93:12.
9. 2 Nefi 28:30.
10. Shih Moroni 2:2; Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta, “Frymë e Shenjtë”, [f. 51–52], scriptures.lds.org.
11. Shih Mosia 4:10–12.
12. Shih Doktrina e Besëlidhje 59:23.
13. Shih Mosia 16:7–8.
14. “Qëndroj Plot Habi”, *Himne*, f. 113.
15. Doktrina e Besëlidhje 18:40.
16. *Mësimet të Presidentëve të Kishës: Lorenzo Snou* (2012), f. 105.
17. Shih Eksodi 20:8–11.
18. Doktrina e Besëlidhje 59:9–10.
19. Shih Rasëll M. Nelson, “Shabati Është një Kënaqësi”, *Liahona*, maj 2015, f. 130–132.
20. Alma 37:47; shih edhe Alma 37:46.
21. Doktrina e Besëlidhje 88:119.
22. Alma 37:47.
23. 2 Nefi 31:20.
24. 1 Korintasve 12:31; Ethëri 12:11.
25. Efesianëve 1:10.
26. Efesianëve 2:21.
27. Jakobi [LiM] 4:14.
28. Shih Doktrina e Besëlidhje 45:57.
29. “Shpirt’ i Shenjt’ na Udhëzofit’”, *Himne*, nr. 81.
30. Doktrina e Besëlidhje 82:9–10.
31. Doktrina e Besëlidhje 59:23.



Nga Peshkopi W. Kristofer Uadell,
Këshilltar i Dytë në Peshkopatën Kryesuese

Kthehu te Zoti

Ne nuk mund të kontrollojmë gjithçka që na ndodh, por ne kemi kontroll absolut mbi mënyrën se si reagojmë ndaj ndryshimeve në jetën tonë.

Në pranverën e 1998-ës, Karola dhe unë patëm mundësi të ndërthurnim një udhëtim biznesi me një pushim familjar dhe të shkoni për disa ditë në Havai me katër fëmijët tanë bashkë me vjehrrën time, e cila sapo kishte mbetur e ve.

Natën përpara fluturimit tonë për në Havai, djali ynë katërmuajsh, Xhonathani, u diagnostikua me një infeksion në të dy veshët dhe na thanë që ai nuk mund të udhëtonte për të paktën tre deri në katër ditë. Vendimi u mor që Karola të qëndronte në shtëpi me Xhonathanin, ndërsa unë do të udhëtoja me pjesën tjetër të familjes.

Shenja e parë që tregoi se ky nuk që udhëtimi që pata përfytyruar, ndodhi shpejt pas mbërritjes sonë. Duke ecur nëpër një shteg me palma nën dritën e hënës, me pamje të oqeanit përpara nesh, fillova të komentoj për bukurinë e ishullit dhe në atë çast romantik, në vend që të shihja Karolën, e gjeta veten duke parë në sy vjehrrën time, të cilën, mund të shtoj, e dua shumë. Thjesht nuk ishte ajo që kisha parashikuar. As Karola nuk kishte pritur që ta kalonte pushimin e vet në shtëpi vetëm me birin tonë foshnjë të sëmurë.

Do të ketë kohë në jetën tonë kur do ta gjejmë veten në një shteg të parashikuar, përballë rrethanash shumë

më të ashpra sesa një pushim veçmas. Si reagojmë ne kur ngjarje, shpesh jashtë kontrollit tonë, e ndryshojnë jetën që patëm planifikuar apo shpresuar?

Më 6 qershor 1944, Hajrëm Shamuej, një nëntoger i ri në ushtrinë e Shteteve të Bashkuara, zbarkoi në plazhin Omaha, si pjesë e pushtimit të Normandisë. Ai ia doli të zbarkonte shëndoshë e mirë por, më 27 qershor, duke qenë pjesë e përparimit aleat, u plagos rëndë

Hajrëm Shamuej, i verbuar gjatë Luftës së Dytë Botërore, la pas një trashëgimi besimi dhe mirëbesimi te Zoti për pasardhësit e tij.



nga një minë kundërtanke. Në një çast, jeta dhe karriera e tij e ardhshme në mjekësi u prekën në mënyrë dramatike. Pas shumë operacionesh që e ndihmuan të shëronte shumicën e plagëve të tij të rënda, Vëllai Shamuej nuk e rifitoi kurrë shikimin e vet. Si do të reagonte ai?

Pas tre vjetësh në një spital rehabilitimi, ai u kthye në shtëpi në Lovell të Uajomingut. Ai e dinte se ëndrra e tij për t'u bërë mjek nuk ishte më e mundur, por ai ishte i vendosur të shkonte përpara, të martohej dhe të mbështeste një familje.

Ai më në fund gjeti punë në Baltimorë, Merilend, si këshilltar rehabilitimi dhe specialist punësimi për të verbrit. Në procesin e rehabilitimit të vet, ai pati mësuar se të verbrit janë në gjendje të bëjnë shumë më tepër nga sa pati kuptuar ai dhe, gjatë tetë vjetëve në këtë pozicion, ai futi në punë më shumë të verbër sesa çdo këshilltar tjetër në gjithë vendin.

Tani, me vetëbesim në aftësinë e tij për të siguruar për familjen, Hajrëmi i propozoi të dashurës së tij të zemrës duke i thënë: "Nëse ti do të lexosh postën, ndash çorapet dhe ngasësh makinën, unë mund të bëj pjesën tjetër". Ata shpejt u vulosën në Tempullin e Solt-Lejkut dhe përfundimisht u bekuan me tetë fëmijë.


Në 1954-ën familja Shamuej u rikthye në Uajoming, ku Vëllai Shamuej punoi për 32 vjet si Drejtor Shteti i Arsimin për të Shurdhët dhe të Verbrit. Gjatë asaj kohe, ai shërbeu për shtatë vjet si peshkop i Lagies së Parë në Shajen, më vonë, 17 vjet si patriark kunji. Pas daljes në pension, Vëllai dhe Motra Shamuej shërbyen gjithashtu si çift në moshë në Misionin e Londrës, Anglia Jugore.

Hajrëm Shamuej ndërroi jetë në mars 2011, duke lënë pas një trashëgimi besimi dhe mirëbesimi të Zotit, madje në kushte sprovue, grupin e madh me fëmijë, nipër e mbesa, stërnipër e stërmbesa pasardhës të tij.¹

Jeta e Hajrëm Shamuejt mund të ishte ndryshuar nga lufta, por ai nuk dyshoi kurrë te natyra hyjnore dhe potenciali i përjetshëm i tij. Sikurse ai, ne jemi bij e bija shpirtërore të Perëndisë dhe ne e “pranua[m] planin e Tij, me anë të të cilit [ne] mund të merrni[m] një trup fizik, mund të fitoni[m] përvojë tokësore për të përparuar drejt përsosjes dhe së fundi, mund të arrini[m] destinacionin [tonë] hyjnor si trashëgimtarë të jetës së përjetshme”². Asnjë masë ndryshimi, sprove, apo vështirësi nuk mund ta ndryshojë kursin e përjetshëm – përveçse zgjedhjet tona, ndërsa ushtrime të lirinë tonë të zgjedhjes.

Ndryshimet dhe sfidat që vijnë prej tyre, që i ndeshim në jetën në vdekshmëri, vijnë me larmi formash e përmasash dhe ndikojnë secilin prej nesh në mënyra të veçanta. Si ju, edhe unë kam dëshmuar miq dhe pjesëtarë të familjes që përballen me sfida të shkaktuara nga:

- Vdekja e një të dashuri.
- Një shkurorëzim i hidhur martesë.
- Ndoshta nga mospasja kurrë e mundësisë për martesë.
- Një sëmundje apo plagosje e rëndë.
- Dhe madje katastrofa natyrore,



sikurse kemi dëshmuar së fundi përreth botës.

Dhe lista vazhdon. Edhe pse çdo “ndryshim” mund të jetë i pashoq në rrethanat tona vetjake, ka një element të përbashkët në sprovën apo sfidën që vjen si pasojë – shpresa dhe paqja janë gjithnjë të disponueshme nëpërmjet sakrificës shlyese të Jezu Krishtit. Shlyerja e Jezu Krishtit siguron masat vendimtare korrigjuese dhe shëruese për çdo trup të plagosur, shpirt të dëmtuar dhe zemër të thyer.

Ai e di, në një mënyrë si askush tjetër nuk mund ta kuptojë, se çfarë na nevojitet, individualisht, me qëllim që të shkojmë përpara në mes të ndryshimit. Ndryshe nga miqtë dhe të dashurit, Shpëtimtari jo vetëm që ka dhembshuri për ne, por Ai mund të na kuptojë përsosurisht, pasi Ai ka qenë atje ku ne jemi. Përveç pagimit të çmimit dhe vuajtjes për mëkatet tona, Jezu Krishti gjithashtu eci në çdo shteg, luftoi me çdo sfidë, u përball me çdo plagë – fizike, emocionale apo shpirtërore – që ne do të ndeshim ndonjëherë në vdekshmëri.

Presidenti Bojd K. Paker dha mësim: “Mëshira dhe hiri i Jezu Krishtit nuk kufizohen tek ata që kryejnë mëkatet . . . , por përfshijnë premtimin e paqes së pafundme për të gjithë ata që do ta pranojnë dhe ndjekin Atë. . . . Mëshira e Tij është shëruesi i fuqishëm,

madje edhe për të pafajshmin që është lënduar.”³

Në këtë përvojë në vdekshmëri, ne nuk mund të *kontrollojmë* gjithçka që na ndodh, por ne kemi kontroll absolut mbi mënyrën se si *reagojmë* ndaj ndryshimeve në jetën tonë. Kjo nuk nënkupton se sfidat dhe sprovat që hasim, janë pa pasoja dhe me të cilat mund të merresh apo të luftosh me lehtësi. Nuk nënkupton se ne do të jemi të lirë nga dhembja apo pikëllimi. Por kjo do të thotë se ka një shkak për shpresë dhe se, në saje të Shlyerjes së Jezu Krishtit, ne mund të shkojmë përpara dhe të gjejmë ditë më të mira – madje ditë plot gëzim, dritë dhe lumturi.

Te Mosia lexojmë tregimin për Almën, ish-prifti i Mbretit Noe, dhe popullin e tij që, “duke qenë [të] paralajmëruar nga Zoti . . . [të] u nisën për në vendin e shkretët, të ndjekur nga ushtritë e mbretit Noe”. Pas tetë ditësh, “ata arritën në një vend shumë të bukur e të këndshëm” ku “ata ngritën çadrat e tyre dhe filluan të punonin tokën, dhe filluan të ndërtonin ndërtesa”⁴.

Gjendja e tyre dukej premtuese. Ata e patën pranuar ungjillin e Jezu Krishtit. Ata qenë pagëzuar si një besëlidhje që do t’i shërbenin Zotit dhe do të mbanin urdhërimet e Tij. Dhe “ata u shtuan dhe u përparuan jashtëzakonisht në vend”⁵.

Sidoqoftë, rrethanat e tyre shpejt do të ndryshonin. “Një ushtri Lamanitësh ishte në kufijtë e vendit.”⁶ Alma dhe populli i tij shpejt ranë në robëri dhe “aq të mëdha qenë pikëllimet e tyre, saqë ata filluan t’i luteshin me shpirt Perëndisë”. Përveç kësaj, robëruesit e tyre i urdhëruan madje të ndalonin së luturi, përndryshe, “çdo njeri që do të gjendej duke iu lutur Perëndisë, do të vritej”⁷. Alma dhe populli i tij nuk patën bërë asgjë për ta merituar gjendjen e tyre të re. Si do të reagonin ata?



Në vend që të fajësonin Perëndinë, ata u kthyen drejt Tij dhe “ia derdhën zemrat e tyre atij”. Në përgjigje ndaj besimit dhe lutjeve të tyre të heshtura, Zoti u përgjigj: “Ngushëllohuni. . . Unë do t’ju lehtësoj gjithashtu barrat që ju janë vënë mbi shpatulla, që ju të mos i ndjeni në shpinat tuaja.” Shpejt pas kësaj, “Zoti i forcoi ata që të mund të duronin barrat e tyre me lehtësi dhe ata iu nënshtruan me gëzim dhe me durim gjithë vullnetit të Zotit”⁸. Edhe pse ende të paçliruar nga robëria, duke iu drejtuar Zotit dhe jo duke u larguar nga Zoti, ata u bekuan sipas nevojave të tyre dhe sipas urtësisë së Zotit.

Plaku Dallin H. Ouks na ka mësuar: “Bekimet e shërimit vijnë në shumë mënyra, secila e përshtatur me nevojat tona vetjake, siç janë të njohura për Atë që na do më shumë. Ndonjëherë një ‘shërim’ kuron sëmundjen tonë ose lehtëson barrën tonë. Por ndonjëherë ne ‘shërohemi’ duke na u dhënë forcë ose kuptueshmëri apo durim për të mbajtur barrët e vendosura mbi ne.”⁹

Përfundimisht, “kaq i madh qe besimi i tyre dhe durimi i tyre”, sa që Alma dhe populli i tij u liruan prej Zotit, siç do të lirohemi ne, dhe “ata i derdhën falënderimet . . . , pasi ata kishin qenë në robëri dhe askush nuk mund t’i çlironte veçse në ishte Zoti, Perëndia i tyre”¹⁰.

Ironia e trishtë është se, tepër shpesh, ata që janë më në nevojë, largohen nga burimi i tyre i vetëm e i përsosur i ndihmës – Shpëtimtari ynë, Jezu Krishti. Një tregim i njohur te shkrimet e shenjta me gjarprin prej bronzi, na mëson se ne kemi një zgjedhje kur përballemi me sfida. Pasi shumë nga

fëmijët e Izraelit u kafshuan nga “gjarprinjtë të helmuar që fluturonin”¹¹, “një simbol u ngrit . . . që kushdo që do të shikonte . . . të mund të jetonte. [Por ishte një zgjedhje.] Dhe shumë shikuan dhe jetuan.

. . . Por, pati shumë që ishin kaq të ngurtësuar, sa nuk donin të shikonin, prandaj ata mbaruan.”¹²

Si izraelitët e lashtë, edhe ne jemi ftuar dhe nxitur të shohim nga Shpëtimtari dhe të jetojmë – sepse zgjedhja e Tij është e ëmbël dhe barra e Tij është e lehtë, edhe kur tonat mund të jenë të rënda.

Alma i Riu e dha mësim këtë të vërtetë të shenjtë kur tha: “Unë e di se kushdo që vë besimin e tij në Perëndi, do të përkrahet në sprovat e tij dhe në vështirësitë e tij dhe në mjerrimet e tij dhe do të ngrihet në ditën e fundit”¹³.

Në këto ditë të mëvonshme, Zoti na ka siguruar burime të shumta, “gjarpëri[njtë tanë të] bronzë”, të cilët të gjithë janë për të na ndihmuar të shohim te Krishti dhe ta vendosim mirëbesimin tonë tek Ai. Përballja me sfidat e jetës nuk ka të bëjë me shpërfilljen e realitetit, por përkundrazi me atë se ku zgjedhim të përqendrohemi dhe me themelin mbi të cilin zgjedhim të ndërtojmë.

Këto burime përfshijnë [sa vijon], por nuk kufizohen vetëm në to:

- Studim i rregullt i shkrimeve të shenjta dhe i mësimëve të profetëve të gjallë.
- Lutje dhe agjërime të shpeshtë dhe të sinqertë.

- Marrje me denjësi të sakramentit.
- Frekuentim të rregullt në tempull.
- Bekimet e priftërisë.
- Këshillim të urtë nëpërmjet profesionistëve të trajnuar.
- Madje edhe mjekim, kur jepet siç duhet dhe përdoret siç autorizohet.

Pavarësisht nga ndryshimi që mund të na ndodhë në rrethanat e jetës, dhe pavarësisht se çfarë shtegu të papritur mund të na duhet të përshkujmë, mënyra se si ne reagojmë është zgjedhja [jonë]. Kthimi te Shpëtimtari dhe kapja e krahut të Tij të shtrirë është gjithmonë mundësia jonë më e mirë.

Plaku Riçard G. Skot na mësoi këtë të vërtetë të përjetshme: “Lumturia e vërtetë e që zgjat, me forcën, guximin, kurajën dhe aftësinë për të kapërcyer vështirësitë më sfiduese të cilat e shoqërojnë, vjen nga një jetë e përqendruar te Jezu Krishti. . . . Nuk ka garanci për rezultate brenda natës, por ka siguri absolute se, në kohën e Zotit, zgjidhjet do të vijnë, paqja do të triumfojë dhe zbrazëtia do të mbushet.”¹⁴

Për këto të vërteta unë jap dëshminë time. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Histori e marrë drejtpërdrejt nga Joseph Shumway, një pasardhës i Hyrum Smith Shumway-t.
2. “Familja: Një Proklamata drejtuar Botës”, *Liahona*, nëntor 2010, f. 129.
3. Bojd K. Paker, “Arsyeja për Shpresën Tonë”, *Liahona*, nëntor 2014, f. 7.
4. Mosia 23:1–5.
5. Mosia 23:20.
6. Mosia 23:25.
7. Mosia 24:10–11.
8. Mosia 24:12–15.
9. Dallin H. Ouks, “Ai e Shëron të Rënduarin”, *Liahona*, nëntor 2006, f. 7–8.
10. Mosia 24:16, 21, 22.
11. 1 Nefi 17:41.
12. Alma 33:19–20.
13. Alma 36:3.
14. Richard G. Scott, “Trust in the Lord”, *Ensign*, nëntor 1995, f. 17.



Nga Plaku W. Krejg Zuik,
Anëtar Nderi i Të Shtatëdhjetëve

Zot, A do të m'i Hapësh Sytë?

Ne duhet t'i vështrojmë të tjerët nëpërmjet syve të Shpëtimtarit tonë.

Mbrete Luan është një film vizatimor klasik rreth savanës afrikane. Kur mbreti luan vdes duke shpëtuar birin e tij, princi i ri dëbohet në mërgim ndërsa një sundues despot shkatërron ekuilibrin e savanës. Princi luan e rifiton mbretërinë nëpërmjet ndihmës së një mësuesi. Sytë e tij u hapën ndaj nevojës për ekuilibër në rrethin e madh të jetës në savanë. Duke e marrë me të drejtë vendin e tij si mbret, luani i vogël ndoqi këshillën që të “vështronte përtej asaj që shihet”¹.

Teksa mësojmë të jemi trashëgimtarë të gjithçkaje që Ati ynë ka, ungjilli na mëson të vështrojmë përtej asaj që shihet. Për të vështruar përtej asaj që shohim, ne duhet t'i vështrojmë të tjerët nëpërmjet syve të Shpëtimtarit tonë. Rrjeta e ungjillit është e mbushur me njerëz të larmishëm. Ne nuk mund t'i kuptojmë plotësisht zgjedhjet dhe formimet psikologjike të njerëzve në botën tonë, të bashkësive të Kishës dhe madje edhe të familjeve tona sepse ne rrallëherë e kemi tablonë e plotë të asaj që ata janë. Ne duhet të vështrojmë përtej hamendësimeve të lehta dhe stereotipave dhe duhet t'i zgjerojmë lentet e vogla të vetë përvojës sonë.

Mua m'u hapën sytë “për të vështruar përtej asaj që mund të shihja” ndërsa shërbeja si president misioni. Një Plak [Elder] i ri erdhi plot druajtje në sytë e tij. Ndërsa u takuam në një intervistë, ai tha i brengosur: “Dua të shkoj në shtëpi”. Unë mendova me vete: “Epo, ne mund ta ndreqim këtë”. E këshillova që të punonte fort dhe të lutej rreth kësaj për një javë dhe pastaj të më merrte në telefon. Një javë më vonë, thujse fiks në të njëjtën orë, ai më mori në telefon. Ai prapëseprapë donte të shkonte në

shtëpi. Unë sërish e këshillova që të lutej, të punonte fort dhe të më merrte në telefon pas një jave. Në intervistën tonë të radhës, gjërat nuk kishin ndryshuar. Ai këmbëngulte që të shkonte në shtëpi.

Unë thjesht nuk kisha ndër mend ta lejoja që kjo të ndodhte. Fillova t'i jap mësim rreth natyrës së shenjtë të thirrjes së tij. E nxita që “ta harronte [vetveten] dhe të shkonte në punë”². Por, pavarësisht nga formula që unë ofrova, mendja e tij nuk ndryshoi. Më në fund, më shkoi ndër mend që mund të mos e kisha kuptuar të gjithë situatën. Pikërisht në atë kohë ndjeva një nxitje për t'i bërë pyetjen: “Plak [Elder], çfarë është e vështirë për ty?” Ajo që ai tha, më theri në zemër: “President, unë nuk mund të lexoj”.

Këshilla e urtë që unë mendova se ishte kaq e rëndësishme që ai ta dëgjonte, nuk ishte fare me vend për nevojat e tij. Ajo për të cilën ai kishte më shumë nevojë, ishte që unë të vështroja përtej vlerësimit tim të nxituar dhe ta lejoja Shpirtin që të më ndihmonte të kuptoja se çfarë ishte me të vërtetë në mendjen e këtij Plaku [Elder]. Ai kishte



nevojë që unë ta shihja atë saktësisht dhe t'i ofroja një arsye për të shpresuar. Në vend të kësaj, unë vepra si një sferë gjigante për shembje ndërtimesh. Ky Plak [Elder] i guximshëm mësoi vërtetë të lexojë dhe u bë një dishepull shumë i dëlirë i Jezu Krishtit. Ai m'i hapi sytë ndaj fjalëve të Zotit: "Njeriu shikon pamjen, kurse Zoti shikon zemrën" (1 Samuelit 16:7).

Çfarë bekimi i madh është kur Shpirti i Zotit zgjeron këndvështrimin tonë. A e mbani mend profetin Eliseu, i cili u zgjua dhe pa që ushtria siriane e kishte rrethuar qytetin e tij me kuajt dhe qerret e saj? Shërbëtori i tij u frikësua dhe e pyeti Eliseun se çfarë do të bënin ata në këto kushte. Eliseu i tha atij të mos shqetësohej me fjalët e paharrueshme: "Mos ki frikë, sepse ata që janë me ne, janë më të shumtë se ata që janë me ta" (2 Mbretërve 6:16). Shërbëtori as që e kishte idenë se për çfarë po fliste profeti. Ai nuk mund të vështronte përtej asaj që mund të shihte. Megjithatë, Eliseu pa batalione engjëjsh gati për të shkuar në betejë për popullin e profetit. Kështu, Eliseu i lut Zotit që t'ia hapte sytë të riut,

"dhe ai pa; dhe ja, mali ishte plot me kuajt dhe me qerre të zjarra rreth e qark Eliseut" (2 Mbretërve 6:17).

Ne shpesh e veçojmë veten nga të tjerët sipas ndryshimeve në atë që ne shohim. Ne ndihemi rehat pranë atyre që mendojnë, flasin, vishen dhe veprojnë si ne dhe ndihemi në siklet me ata të cilët vijnë nga rrethana ose formime të ndryshme. Në të vërtetë, a nuk vijmë të gjithë ne nga vende të ndryshme dhe flasim gjuhë të ndryshme? A nuk e shohim të gjithë botën nëpërmjet kufizimeve të pamasa të vetë përvojës sonë në jetë? Sepse disa shohin dhe flasin me sy shpirtërorë, si profeti Eliseu, dhe disa shohin dhe komunikojnë me shikimin fizik, siç e përjetova unë me misionarin tim analfabet.

Ne jetojmë në një botë që ushqehet me krahasimet, etiketimet dhe kritikën. Në vend që të shikojmë nëpërmjet lenteve të medias shoqërore, ne duhet të shohim në brendësi për tiparet e perëndishme për të cilat të gjithë ne mund të pretendojmë. Këto cilësi dhe dëshira të perëndishme nuk mund të ruhen në Pinterest apo të publikohen në Instagram.

T'i pranojmë dhe t'i duam të tjerët nuk do të thotë që ne duhet t'i përqafojmë idetë e tyre. Sigurisht, e vërteta kërkon besnikërinë tonë më të lartë, edhe pse ajo nuk duhet të jetë kurrë një pengesë për mirësinë. T'i duash me të vërtetë të tjerët kërkon ushtrimin e vazhdueshëm të pranimin të përpjekjeve më të mira të njerëzve, përvojën e jetës dhe kufizimet e të cilëve ne mund të mos i dimë kurrë plotësisht. Vështrimi përtej asaj që mund të shohim, kërkon përqendrim të vetëdijshëm të Shpëtimtari.

Më 28 maj 2016, 16-vjeçari Bju Riçi dhe mikut e tij, Ostini, ishin në një fermë të familjes në Kolorado. Bju dhe Ostini kërcyen në automjetet e tyre për çdo lloj terreni, duke pritur me padurim të madh një ditë aventure. Ata nuk ishin larguar shumë kur u ndeshën me rrethana të rrezikshme dhe në atë çast ndodhi tragjedia. Mjeti që po ngiste Bju, u kthye befas përmbys, duke e bllokuar Bjunë poshtë 180 kilogramëve prej çeliku. Kur shoku i Bjusë, Ostini, arriti tek ai, ai e pa Bjunë që po luftonte për të mbijetuar. Me të gjithë forcën e tij, ai u mundua ta hiqte mjetin prej shokut të tij. Por mjeti nuk u tund. Ai u lut për Bjunë dhe pastaj vrapoi furishëm për ndihmë. Personeli i urgjencës erdhi më në fund, por disa orë më vonë Bju vdiq. Ai u lirua nga kjo jetë e vdekshme.

Prindërit e tij zemërthyer mbërritën. Ndërsa ata po qëndronin në spitalin e vogël me mikun më të ngushtë të Bjusë dhe anëtarët e familjes, një oficer i policisë hyri në dhomë dhe ia zgjati telefonin celular të Bjusë nënës së tij. Ndërsa ajo e mori telefonin, ra një alarm zanor. Ajo e hapi telefonin dhe pa alarmin ditor të Bjusë. Ajo e lexoi me zë mesazhin që djali i saj adoleshent, argëtimdashës dhe me shpirt aventure e kishte vendosur për ta lexuar çdo ditë. Aty thuhej: "Kujtohu që ta vësh Jezu Krishtin në qendër të jetës sate sot".



Përqendrimi i Bjusë te Shëlbuesi i tij nuk e pakëson pikëllimin e të dashurve të tij për mungesën e tij. Sidoqoftë, i jep shpresë dhe kuptim të madh jetës së Bjusë dhe zgjedhjeve të tij për jetën. Ai e lejon familjen dhe miqtë e tij të vështrojnë përtej mjerimit prej vdekjes së tij të hershme dhe drejt realiteteve të gëzueshme të jetës tjetër. Çfarë mëshirë e dhembshur ishte që prindërit e Bjusë të shihnin nëpërmjet syve të birit të tyre atë gjë që ai e çmonte më shumë.

Si anëtarë të Kishës, neve na janë dhuruar alarme shpirtërore të cilat na paralajmërojnë kur jemi duke parë vetëm me sytë tanë të vdekshëm larg prej shpëtimit. Sakramenti është kujtuesi ynë i përjavshëm që të përqendrohemi vazhdimisht te Jezu Krishti, që gjithmonë të mund ta kujtojmë Atë që të mund ta kemi gjithmonë Shpirtin e Tij me ne (shih DeB 20:77). Gjithsesi, ne nganjëherë i shpërfillim këto ndjenja kujtese dhe alarmi. Kur kemi Jezu Krishtin në qendër të jetës sonë, Ai do të bëjë që sytë tanë të mund të hapen ndaj mundësive më të mëdha, të cilat vetëm ne mund t'i kuptojmë.

Mora një letër me të vërtetë interesante rreth një alarmi mbrojtës të përjetuar nga një motër besnike. Ajo më tha se, në një përpjekje për ta ndihmuar bashkëshortin që të kuptonte se si ndihej, ajo filloi të mbante një listë elektronike në telefonin e saj me gjëra që ai bënte apo thoshte, të cilat e zemëronin atë. Ajo mendoi se, kur të ishte koha e duhur, ajo do të kishte hartuar prova me shkrim për t'ia treguar atij, gjë që sigurisht do të bënte që ai të dëshironte të ndryshonte sjellje. Sidoqoftë, një të diel duke marrë sakramentit dhe duke u përqendruar te Shlyerja e Shpëtimtarit, ajo e kuptoi se dokumentimi i ndjenjave të saj negative për bashkëshortin me të vërtetë po e

largonte Shpirtin prej saj dhe kurrë nuk do ta ndryshonte bashkëshortin.

Një alarm shpirtëror tingëlloi në zemrën e saj dhe tha: “Lëre, lëre fare. Fshiji ato shënime. Nuk janë të dobishme.” Ajo më pas shkroi dhe po citoj: “M’u desh ca kohë për të shtypur butonin ‘zgjidhi të gjitha’ dhe akoma më gjatë për të shtypur butonin ‘fshij’. Por teksa e bëra, të gjithë ato ndjenja negative u tretën në hapësirë. Zemra ime u mbush me dashuri – dashuri për bashkëshortin tim dhe dashuri për Zotin.” Ashtu si Sauli në rrugën për Damask, shikimi i saj u ndryshua. Luspat e shtrembërimit ranë prej syve të saj.

Shpëtimtari ynë shpesh u hapi sytë të verbërve fizikë dhe shpirtërorë. Hapja e syve tanë ndaj së vërtetës hyjnore, në mënyrë konkrete dhe të figurshme, na përgatit për t’u shëruar nga dritëshkurtesia e vdekshmërisë. Kur u kushtojmë vëmendje “alarmeve” shpirtërore që na sinjalizojnë për një nevojë për korrigjim drejtimi ose për këndvështrim më të

lartë të përjetshëm, ne jemi duke marrë premtimin e sakramentit që të kemi Shpirtin e Tij me ne. Kjo iu ndodhi Jozef Smithit dhe Oliver Kaudërit në Tempullin e Kirtlandit kur të vërteta detyruese u dhanë mësim nga Jezu Krishti, i cili premtoi se “veli” i kufizimeve të vdekshmërisë do të “h[iqe] nga mendjet [e tyre] dhe sytë e të kuptuarit [të tyre do të] hap[eshin]” (DeB 110:1).

Unë dëshmoj se, nëpërmjet fuqisë së Jezu Krishtit, ne bëhemi të aftë të vështrojmë shpirtërisht përtej asaj që shohim fizikisht. Teksa e kujtojmë Atë dhe e kemi shpirtin e Tij me ne, sytë e të kuptuarit tonë do të hapen. Më pas, realiteti i madh i hyjnisë brenda secilit prej nesh do të ngulitet më fuqishëm në zemrat tona. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Nga *The Lion King 1½* (2004); jashtë Amerikës Veriore, njihet si *The Lion King 3: Hakuna Matata*.
2. *Mësimet të Presidentëve të Kishës*: Gordon B. Hinkli (2016), f. 201.





Nga Presidenti Henri B. Ajring,
Këshilltar i Parë në Presidencën e Parë

Mos Kini Frikë të Bëni Mirë

Zoti na thotë që, kur qëndrojmë me besim mbi shkëmbin e Tij, dyshimi dhe frika veniten; dëshira për të bërë mirë rritet.

Vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, unë lutem me përlësi që Shpirti i Zotit të jetë me ne ndërkohë që flas sot. Zemra ime është plot mirënjohje për Zotin, Kisha e të cilin është kjo, për frymëzimin që e kemi ndier në lutjet gjithë shpirt, predikimet e frymëzuara dhe këngën engjëllore në këtë konferencë.

Prillin që shkoi, Presidenti Tomas S. Monson na dha një mesazh që i preku zemrat anekënd botës, përfshirë zemrën time. Ai foli për fuqinë e Librit të Mormonit. Ai na nxiti t'i studiojmë, përsiatim dhe vëmë në jetë mësimet e tij. Ai premtoi që, nëse i përkushtojmë kohë çdo ditë studimit e përsiatjes dhe i zbatojmë urdhërimet që i përmban Libri i Mormonit, ne do të kemi një dëshmi jetike për të vërtetën e tij dhe dëshmia pasuese për Krishtin e gjallë do të na çojë drejt sigurisë në kohë të vështira. (Shih "Fuqia e Librit të Mormonit", *Liahona*, maj 2017, f. 86–87.)

Si shumë prej jush, unë i dëgjova fjalët e profetit sikurse zërin e Zotit për mua. Dhe, gjithashtu si shumë prej jush, vendosa t'u bindem atyre fjalëve. Tani, që kur isha i vogël, e kam ndier dëshminë që Libri i Mormonit është

fjala e Perëndisë, që Ati dhe Biri iu shfaqën dhe i folën Jozef Smithit dhe që Apostujt e lashtë erdhën te Profeti Jozef për të rivendosur çelësat e priftërisë në Kishën e Zotit.

Me këtë dëshmi, e kam lexuar Librin e Mormonit çdo ditë për më shumë se 50 vjet. Prandaj, mbase mund të kisha menduar me arsye se fjalët e Presidentit Monson ishin për dikë tjetër.

Prapëseprapë, si shumë prej jush, unë i ndjeva nxitjen e profetit dhe premtimin e tij të më ftonin për të bërë një përpjekje më të madhe. Shumë prej jush kanë bërë atë që bëra unë: u lutët me qëllim më të madh, e përsiatët shkrimin e shenjtë më me vëmendje dhe u përpoqët më shumë për t'i shërbyer Zotit dhe të tjerëve për Të.

Rezultati i lumtur për mua dhe për shumë prej jush, ka qenë ajo që premtoi profeti. Ata prej nesh që e përvetësuan këshillën e tij të frymëzuar, e kanë dëgjuar Shpirtin në mënyrë më të dallueshme. Ne kemi gjetur fuqi më të madhe për t'i bërë ballë tundimit dhe kemi ndier një besim më të madh te një Jezu Krisht i ringjallur, në ungjillin e Tij dhe në Kishën e Tij të gjallë.

Në një stinë trazirash që janë gjithnjë duke u shtuar në botë, ato rritje në dëshmi e kanë larguar dyshimin e frikën dhe na kanë sjellë ndjenja paqeje. Të dëgjuarit e këshillës së Presidentit Monson ka pasur dy ndikime të tjera të mrekullueshme tek unë: Së pari, Shpirti që ai premtoi, ka prodhuar një ndjenjë



optimizmi rreth asaj që shtrihet përpara, madje teksa rrëmuja në botë duket se po shtohet. Dhe, së dyti, Zoti më ka dhënë mua – dhe juve – një ndjenjë edhe më të madhe të dashurisë së Tij për njerëzit që vuajnë. Ne kemi ndier një shtim të dëshirës për të shkuar në shpëtim të të tjerëve. Ajo dëshirë ka qenë në thelb të shërbesës dhe mësimdhënies së Presidentit Monson.

Zoti u premtoi dashuri për të tjerët dhe kurajë profetit Jozef Smith dhe Oliver Kaudërit kur detyrat përpara tyre mund të ishin dukur mbisunduese. Zoti tha se kuraja e nevojshme do të vinte nga besimi i tyre në Të si shkëmbin e tyre:

“Mos kini frikë të bëni mirë, bijtë e mi, sepse çfarë të mbillni, atë edhe do të korrni; prandaj, në qoftë se mbillni mirësi, ju gjithashtu do të korrni mirësi për shpërblimin tuaj.

Prandaj, mos ki frikë, tufë e vogël; bëni mirë; le të bashkohen toka e ferri kundër jush, sepse, nëse ju ndërtoheni mbi shkëmbin tim, ato s’mund të triumfojnë.

Vini re, unë nuk ju dënoj; shkoni në rrugët tuaja dhe mos mëkatoni më; kryeni me maturi punën që ju kam urdhëruar.

Shihni tek unë në çdo mendim; mos dyshoni, mos kini frikë.

Vini re plagët që tejshpuan ijën time dhe gjithashtu shenjat e gozhdëve në duart dhe këmbët e mia; jini besnikë, zbatoni urdhërimet e mia dhe ju do të trashëgoni mbretërinë e qiellit” (DeB 6:33–37).

Zoti u tha udhëheqësve të Tij të Rivendosjes dhe Ai na thonë neve se, kur qëndrojmë me besim mbi shkëmbin e Tij, dyshimi dhe frika veniten; dëshira për të bërë mirë rritet. Kur e pranojmë ftesën e Presidentit Monson për të mbjellë në zemrat tona një dëshmi për Jezun Krishtin, ne fitojmë fuqinë,



dëshirën dhe kurajën për të shkuar në shpëtimin e të tjerëve pa merak për vetë nevojat tona.

E kam parë atë besim e kurajë shumë herë kur shenjtorët besimtarë të ditëve të mëvonshme janë përballur me sprova të frikshme. Për një shembull, unë isha në Ajdaho kur diga Titon u çua më 5 qershor 1976. Një mur uji u derdh. Mijëra njerëz u larguan nga shtëpitë e tyre. Mijëra prej shtëpive dhe ndërmarrjeve u shkatërruan. Për mrekulli, u vranë më pak se 15 njerëz.

Atë që pashë atje, e kam parë kurdoherë që shenjtorët e ditëve të mëvonshme qëndrojnë pa u lëkundur mbi shkëmbin e një dëshmie për Jezun Krishtin. Ngaqë nuk kanë dyshim se Ai kujdeset për ta, ata bëhen të patrembur. Ata i shpërfillin sprovat e veta që t’iu shkojnë në ndihmë të tjerëve. Dhe e bëjnë këtë gjë për shkak të dashurisë për Zotin, duke mos kërkuar shpërblim.

Për shembull, kur u çua diga Titon, një çift shenjtorësh të ditëve të mëvonshme po udhëtonte shumë kilometra larg nga shtëpia e tyre. Sapo e dëgjuan lajmin në radio, ata nxituan të ktheheshin në Reksburg. Në vend që të shkonin në shtëpinë e tyre për të parë nëse u shkatërrua, ata shkuan të kërkonin peshkopin e tyre. Ai ishte në një ndërtesë që po përdorej si qendër shpëtimi.

Ai po ndihmonte të drejtoreshin mijëra vullnetarë, të cilët po mbërrinin me autobusët e verdhë të shkollave.

Çifti eci drejt peshkopit dhe tha: “Sapo u kthyem. Peshkop, ku mund të shkojmë për të ndihmuar?” Ai iu dha emrin e një familjeje. Ai çift qëndroi duke hequr baltë e ujë nga shumë shtëpi njëra pas tjetrës. Punuan nga mëngjesi deri në mbrëmje për shumë ditë. Më së fundi, bënë një ndërprerje që të shkonin të shihnin shtëpinë e tyre. Ishte përpirë nga përmbytja, duke mos lënë asgjë për t’u pastruar. Prandaj u kthyen me të shpejtë që të shkonin te peshkopi i tyre. Pyetën: “Peshkop, a ke dikë që mund ta ndihmojmë?”

Ajo mrekulli e kurajës paqësore dhe dashurisë hyjnore – dashurisë së pastër të Krishtit – është përsëritur përgjatë viteve dhe anembanë botës. Ajo ndodhi në ditët e tmerrshme të përndjekjeve dhe sprovave në kohën e Profetit Jozef Smith në Misuri. Ajo ndodhi kur Brigam Jangu e udhëhoqi eksodin nga Navuja dhe më pas i thirri shenjtorët drejt vendeve të shkreta nëpër të gjitha Shtetet e Bashkuara perëndimore, që ta ndihmonin njëri-tjetrin për të krijuar Sionin për Zotin.

Nëse i lexoni shkrimet e ditëve të atyre pionierëve, ju do të shihni mrekullinë e besimit që e largon dyshimin

dhe frikën. Dhe lexoni për shenjtorë që i lënë vetë interesat e tyre që të ndihmonin dikë tjetër për Zotin, përpara se të ktheheshin te vetë delet e tyre apo te vetë fushat e tyre të papluguara.

E pashë të njëjtën mrekulli pak ditë më parë pas pasojave të uraganit Irma në Porto-Riko, San-Tomas dhe Florida, ku shenjtorët e ditëve të mëvonshme u bashkuan me kisha të tjera, grupe vendore të komuniteteve dhe organizata kombëtare për të filluar përpjekjet e pastrimit.

Ashtu si miqtë e mi në Reksburg, një çift joanëtarësh në Florida u përqendruan që ta ndihmonin komunitetin, në vend që të punonin te vetë prona e tyre. Kur disa fqinjë shenjtorë të ditëve të mëvonshme u ofruan ndihmë për dy pemë të mëdha që e kishin bllokuar vendparkimin e tyre, çifti u shpjegoi se ata ishin shqetësuar shumë dhe kështu i ishin kthyer ndihmës ndaj të tjerëve, duke pasur besim se Zoti do të siguronte ndihmën që u nevojitej në vetë shtëpinë e tyre. Bashkëshorti atëherë na tregoi se, përpara se të arrinin anëtarët e Kishës sonë me ofertat për ndihmë, ata kishin qenë duke u lutur. Kishin marrë përgjigje se ndihma do t'iu vinte. Iu erdhi brenda pak orësh nga marrja e asaj mbrese sigurie.

Kam dëgjuar një raportim se disa kanë filluar t'i quajnë shenjtorët e ditëve të mëvonshme, të cilët veshin bluzat e verdha të Duarve Ndhimtare, "Engjëjt e Verdhë". Një shenjtorë e ditëve të mëvonshme e çoi makinën e saj për shërbim dhe burri që po e ndihmonte, përshkroi "përvojën shpirtërore" që e pati kur njerëzit me bluzat të verdha i hoqën pemët nga oborri i tij dhe më pas, tha ai, ata "më kënduan njëfarë kënge rreth të qenit fëmijë i Perëndisë".

Një tjetër banore e Floridës – gjithashtu jo e besimit tonë – tregoi se shenjtorët e ditëve të mëvonshme erdhën

te shtëpia e saj kur ajo po punonte në kopshtin e shkatërruar, po ndiente shqetësim e nxehtësi të madhe dhe ishte gati për të qarë. Vullnetarët krijuan, duke përdorur fjalët e saj, "një mrekulli të vërtetë". Ata shërbyen jo vetëm me zell, por edhe me të qeshura e buzëqeshje, duke mos pranuar asgjë si shpërblim.

E pashë atë zell dhe e dëgjova atë të qeshur kur, një të shtunë vonë, vizitova një grup shenjtorësh të ditëve të mëvonshme në Florida. Vullnetarët e ndalën punën e tyre të pastrimit për aq kohë sa të mund të shtrëngoja disa duar. Ata thanë se 90 anëtarë të kunjtit të tyre në Xhorxhia kishin krijuar një plan për të marrë pjesë në shpëtimin në Florida pikërisht një natë më parë.

Ata ishin nisur nga Xhorxhia në 4:00 të mëngjesit, ecën me makinë për disa orë, punuan gjatë gjithë ditës e deri natën dhe kishin në plan të punonin sërish të nesërmen.

Ma përshkruan atë gjithë buzëqeshje dhe humor të këndshëm. I vetmi shqetësim që ndjeva, ishte se ata donin që të ndaleshin falënderimet, në mënyrë që të ktheheshin përsëri në punë. Presidenti i kunjtit e kishte ndezur sërish sharrën e tij elektrike dhe po punonte te një pemë e rrëzuar dhe një peshkop po i lëvizte degët e pemës teksa u futëm në makinë për të shkuar tek ekipi tjetër i shpëtimit.

Më herët atë ditë, teksa po largoheshim nga një vend tjetër, një burrë eci drejt makinës, hoqi kapelën dhe na falënderoi për vullnetarët. Ai tha: "Nuk jam anëtar i kishës suaj. Nuk mund ta besoj atë që keni bërë për ne. Perëndia ju bekoftë!" Vullnetari SHDM që po qëndronte pranë tij me bluzën e tij të verdhë, buzëqeshi dhe mblodhi supet sikur nuk e meritonte lavdërimin.


Ndërkohë që vullnetarët nga Xhorxhia kishin ardhur për ta ndihmuar këtë burrë, i cili s'mund ta besonte

këtë gjë, qindra shenjtorë të ditëve të mëvonshme nga pikërisht ajo pjesë e shkretuar e Floridës kishin shkuar qindra kilometra drejt jugut në anën tjetër të Floridës ku kishin dëgjuar se njerëzit ishin goditur më rëndë.

Atë ditë m'u kujtuan dhe i kuptova më mirë fjalët profetike të Profetit Jozef Smith: "Një njeri i mbushur me dashurinë e Perëndisë nuk kënaqet vetëm me bekimin e familjes së tij, por endet në të gjithë botën, i dëshiruar që të bekojë të gjithë racën njerëzore" (*Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* [2009], f. 454).

Ne e shohim një dashuri të tillë në jetën e shenjtorëve të ditëve të mëvonshme kudo. Sa herë që ka një ngjarje tragjike diku në botë, shenjtorët e ditëve të mëvonshme dhurojnë e dalin vullnetarë në përpjekjet humanitare të Kishës. Rallëherë nevojitet një thirrje. Në fakt, në disa raste, na u desh t'u kërkonim atyre që do të dilnin vullnetarë, që të prisnin për të udhëtuar për te vendi i shpëtimit derisa ata që po e drejtonin punën, të ishin të përgatitur për t'i pritur ata.

Ajo dëshirë për të bekuar është fryti i njerëzve që janë duke marrë dëshmi për Jezun Krishtin, ungjillin e Tij, Kishën



e Tij të rivendosur dhe profetin e Tij. Ajo është arsyeja përse njerëzit e Zotit nuk kanë dyshim dhe frikë. Ajo është arsyeja përse misionarët dalin vullnetarë për shërbim në çdo cep të botës. Ajo është arsyeja përse prindërit luten me fëmijët e tyre për të tjerët. Ajo është arsyeja përse udhëheqësit vendorë i japin sfida rinisë së tyre që ta pranojnë kërkesën e Presidentin Monson për ta zhytur veten e tyre thellësisht në Librin e Mormonit. Fryti vjen jo nga të qenit të nxitur nga udhëheqësit, por nga rinia dhe anëtarët duke vepruar me besim. Ai besim, i vënë në veprim, i cili kërkon sakrificë vetëmohuese, sjell ndryshimin e zemrës, gjë e cila u lejon atyre ta ndiejnë dashurinë e Perëndisë.

Sidoqoftë, zemrat tona mbeten të ndryshuara vetëm për aq kohë sa vazhdojmë ta ndjekim këshillën e profetit. Nëse nuk vazhdojmë të përpiqemi pas një përpjekjeje domethënëse, ndryshimi do të venitet.

Shenjtorët besnikë të ditëve të mëvonshme e kanë shtuar besimin e tyre në Zotin Jezu Krisht, në Librin e Mormonit si fjala e Perëndisë dhe në rivendosjen e çelësave të priftërisë në Kishën e Tij të vërtetë. Ajo dëshmi e rritur na ka dhënë kurajë dhe interesim më të madh për fëmijë të tjerë të Perëndisë. Por sfidat dhe mundësitë përpara, do të kërkojnë edhe më shumë.

Ne nuk mund t'i parashikojmë hollësisht, por e dimë pamjen e përgjithshme të së ardhmes. Ne e dimë se në ditët e fundit, bota do të jetë në rrëmujë. Ne e dimë se në mes të çfarëdo telashi që do të vijë, Zoti do t'i udhëheqë shenjtorët besnikë të ditëve të mëvonshme që t'ia çojnë ungjillin e Jezu Krishtit çdo kombi, fisi, gjuhe dhe populli. Dhe ne e dimë se dishepujt e vërtetë të Zotit do të jenë të denjë dhe të përgatitur për ta pranuar Atë kur Ai të vijë përsëri. Nuk kemi pse të frikësohemi.



Prandaj, ngaqë e kemi formuar tashmë besimin dhe kurajën në zemrat tona, Zoti pret më shumë prej nesh – dhe nga brezat pas nesh. Ata do të kenë nevojë të jenë më të fortë e më të guximshëm, sepse do të bëjnë gjëra edhe më të mëdha e më të rënda nga ç'kemi bërë ne. Dhe ata do të përballen me kundërshtim në rritje nga armiku i shpirtave tanë.

Udhë e optimizmit teksa shkojmë përpara, u dha nga Zoti: “Shihni tek unë në çdo mendim; mos dyshoni, mos kini frikë” (DeB 6:36). Presidenti Monson na e tha se si ta bëjmë këtë gjë. Ne duhet t'i përsiatim dhe t'i vëmë në jetë Librin e Mormonit dhe fjalët e profetëve. Lutuni gjithmonë. Jini besues. Shërbejini Zotit me gjithë zemrën, fuqinë, mendjen dhe forcën tuaj. Ne duhet të lutemi me gjithë energjinë e zemrave tona për dhuratën e dashurisë hyjnore, dashurisë së pastër të Krishtit (shih Moroni 7:47–48). Dhe mbi të gjitha, ne duhet të jemi të qëndrueshëm dhe këmbëngulës në ndjekjen e këshillës profetike.

Kur udha është e vështirë, ne mund të mbështetemi te premtimi i Zotit – premtimi që Presidenti Monson na e ka kujtuar kur ai shpesh i ka cituar këto fjalë të Shpëtimtarit: “Kushdo që ju pranon ju, atje do të jem unë gjithashtu, sepse unë do të shkoj përpara fytyrës suaj. Unë do të jem në të djathtën e në të majtën tuaj dhe Shpirti im do të jetë

në zemrat tuaja e engjëjt e mi përreth jush, për t'ju ngritur lart” (DeB 84:88).

Unë dëshmoj se Zoti shkon përpara fytyrës suaj kurdoherë që jeni duke e bërë punën e Tij. Nganjëherë ju do të jeni engjëlli që Zoti e dërgon për t'i ngritur lart të tjerët. Nganjëherë ju do të jeni njeriu i rrethuar nga engjëjt për t'ju ngritur ju lart. Por gjithmonë do ta keni Shpirtin e Tij të jetë në zemrën tuaj, siç ju është premtuar në çdo shërbim të sakramentit. Vetëm ju duhet t'i zbatoni urdhërimet e Tij.

Ditët më të mira janë përpara për mbretërinë e Perëndisë në tokë. Kundërshtimi do ta forcojë besimin tonë te Jezu Krishti, siç e ka forcuar që nga koha e Profetit Jozef Smith. Besimi përherë e mund frikën. Qëndrimi së bashku prodhon unitet. Dhe lutjet tuaja për ata që janë nevojtarë, dëgjohej dhe marrin përgjigje nga një Perëndi i dashur. Ai as nuk dremit, as nuk fle.

Ju jap dëshminë time se Perëndia, Ati, jeton dhe dëshiron që ju të ktheheni në shtëpi tek Ai. Kjo është Kisha e vërtetë e Zotit Jezu Krisht. Ai ju njeh; Ai ju do; Ai kujdeset për ju. Ai shleu për mëkatet tuaja e të mijat dhe për mëkatet e të gjithë fëmijëve të Atit Qiellor. Ndjekja e Tij në jetën tuaj dhe në shërbimin tuaj ndaj të tjerëve është e vetmja udhë për te jeta e përjetshme.

Për këtë unë dëshmoj dhe ju lë bekimin tim dhe dashurinë time. Në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen. ■



Nga Plaku M. Rasëll Ballard,
i Kuoromit të Dymbëdhjetë Apostujve

Udhëtimi i Vështirë Vazhdon!

Një udhëtim i vështirë kthimi për tek Ati ynë Qiellor është udhëtimi i vështirë më i rëndësishëm në jetën tonë.

Njëqind e shtatëdhjetë vjet më parë, Brigam Jangu e hodhi vështrimin për herë të parë mbi luginën e Solt-Lejku dhe shpalli: “Ky është vendi i duhur!”¹ Ai e njohu vendin ngaqë Zoti ia kishte zbuluar atij.

Deri në vitin 1869, më shumë se 70000 shenjtorë kishin bërë një udhëtim të ngjashëm, të vështirë. Pavarësisht nga ndryshimet e shumta në gjuhë, kulturë e kombësi, ata kishin të përbashkët një dëshmi për Atin, Birin dhe Frymën e Shenjtë, Rivendosjen e ungjillit të Jezut Krishtit dhe një dëshirë për ta ndërtuar Sionin – një vend paqeje, lumturie dhe bukurie, në përgatitje për Ardhjen e Dytë të Shpëtimtarit.

Mes atyre shenjtorëve të parë që mbërritën në Jutë, ishte Xhejn Mening Xhejmsi – bija e një skllavi që i ishte dhënë liria, një e kthyer në besim në Kishën e rivendosur dhe një dishepulle e jashtëzakonshme, e cila u përball me sfida të vështira. Motra Xhejms qëndroi një shenjtoreshme besnike e ditëve të mëvonshme deri në vdekjen e saj, në vitin 1908.

Ajo shkroi: “Dua ta them pikërisht tani, që besimi im në ungjillin e Jezut Krishtit, siç m’u mësua nga Kisha e Jezut

Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, është po aq i fortë sot, jo, ai është, nëse është e mundur, më i fortë sesa në ditën kur u pagëzova fillimisht. I paguaj të dhjetat dhe ofertat e mia, e mbaj fjalën e urtësisë, shkoj në shtrat herët dhe ngrihem herët, përpiqem në pafuqinë time fizike që të jap një shembull të mirë për të gjithë.”²



Xhejn Mening Xhejmsi mbeti një shenjtoreshme besnike e ditëve të mëvonshme pavarësisht nga sfidat e vështira.

Motra Xhejms, ashtu si shumë shenjtorë të tjerë të ditëve të mëvonshme, jo vetëm që e ndërtoi Sionin me gjak, djersë e lot, por i kërkoi gjithashtu bekimet e Zotit duke i jetuar parimet e ungjillit në mënyrën më të mirë që mundte, duke u mbajtur ndërkohë te besimi në Jezut Krishtin – shëruesin e madh për të gjithë ata që e kërkojnë Atë me çiltërsi.

Shenjtorët e hershëm nuk ishin të përsosur, por ata ngritën një themel mbi të cilin ne po ndërtojmë familjet dhe një shoqëri që i do dhe i mban besëlidhjet, gjë e cila del në pah në histori të ndryshme lajmesh kudo në botë për shkak të zotimit tonë ndaj Jezut Krishtit dhe përpjekjeve tona vullnetare për t’i ndihmuar ata që janë pranë dhe larg.³

Presidenti Ajring, më lejoni të shtoj vlerësimin tim për dhjetëra mijëra engjëj të veshur me bluzë të verdhë që po shërbejnë në Teksas, Meksikë e në vende të tjera dhe për ndihmesën tuaj.

Kam bindjen e thellë që, nëse i humbasim lidhjet tona me ata që janë larguar përpara nesh, përfshirë etërit dhe nënat tona pioniere, ne do të humbasim një thesar shumë të çmuar. Kam folur rreth “Besimit në Çdo Hap” në të kaluarën dhe do të vazhdoj të flas në të ardhmen, ngaqë e di se brezat e rinj duhet të ketë të njëjtin lloj besimi që e patën shenjtorët e hershëm të Zotit Jezut Krisht dhe ungjilli i Tij i rivendosur.⁴

Vetë stërgjyshërit dhe stërgjyshet e mia pioniere ishin mes atyre pionierëve besnikë që i tërhoqën karrocet e dorës, nganë karrot dhe ecën në këmbë për në Jutë. Ata, sikurse Motra Xhejn Mening Xhejmsi, kishin besim të thellë në çdonjërin prej hapave të tyre tekta vazhdonin udhën e tyre të vështirë.

Ditarët e tyre janë të mbushur me përshkrime të vështirësive, urisë e sëmundjes dhe gjithashtu me dëshmi

të besimit të tyre në Perëndinë dhe në ungjillin e rivendosur të Jezu Krishtit.

Ata kishin pak të mira materiale, por gëzonin një bollëk të bekimeve nga vëllazëria dhe motëria që e gjetën në Kishën e Jezu Krishtit. Kur mundeshin, ata iu jepnin zemër të shtypurve dhe i bekonin të sëmuretë nëpërmjet shërbimit ndaj njëri-tjetrit dhe me anë të priftërisë së Perëndisë.

Motrat në luginën Kash, në Juta, u shërbyen shenjtorëve në frymën e Shoqatës së Ndhmës që të “punonin në unitet për t’i ndihmuar ata njerëz që ishin në nevojë”⁵. Stërgjyshja ime, Margarita Mek-Nill Ballardi shërbeu përkrah bashkëshortit të saj, Henrit, kur ai kryesoi si peshkop në lagjen e dytë të Loganit për dyzet vjet. Gjatë asaj kohe, Margarita ishte presidentja e Shoqatës së Ndhmës për lagjen për 30 vjet. Ajo i merrte në shtëpinë e saj të varfrit, të sëmuretë dhe të vejat e jetimët dhe madje i vishte të vdekurit me rrobat e tyre të pastra të tempullit.

Megjithëse është e përshtatshme dhe e rëndësishme që ta kujtojmë udhëtimin e vështirë historik të pionierëve mormonë të shekullit të 19-të, ne kemi nevojë të kujtojmë se “udhëtimi i vështirë përmes jetës vazhdon” për secilin prej nesh ndërsa e provojmë vetë “besimin [tonë] në çdo hap”.

Të kthyerit e rinj në besim nuk mblihdhen më në kolonitë pioniere në pjesën perëndimore të Shteteve të Bashkuara. Në vend të kësaj, të kthyerit në besim mblihdhen në bashkësitë e tyre vendore, ku shenjtorët e adhurojnë Atin tonë Qiellor në emrin e Jezu Krishtit.

Me më shumë se 30000 bashkësi të ngritura anembanë botës, të gjithë mblihdhen në vetë Sionin e tyre. Siç shënohet në shkrimet e shenjta: “Sepse ky është Sioni – të kulluarit në zemër”⁶.

Ndërkohë që ecim në rrugën e jetës, ne vihemi në provë për të parë nëse



do të “bëj[m]ë gjithçka që [Zoti ka] urdhëruar”⁷.

Shumë prej nesh janë në udhëtime të mahnitshme zbuluese – që çojnë drejt përbushjes vetjake dhe ndriçimit shpirtëror. Sidoqoftë, disa prej nesh janë në udhëtimin e vështirë që çon drejt përkëllimit, mëkatit, ankthit e dëshpërimit.

Lidhur me këtë, ju lutem pyeteni veten tuaj: Cila është vendmërritja juaj përfundimtare? Ku po ju çojnë hapat tuaj? Dhe a po ju çon udhëtimi juaj drejt asaj “shumëllojshmëri[e] bekimesh” që ka premtuar Shpëtimtari?⁸

Një udhëtim i vështirë kthimi për tek Ati ynë Qiellor është udhëtimi i vështirë më i rëndësishëm në jetën tonë dhe vazhdon çdo ditë, çdo javë, çdo muaj dhe çdo vit ndërsa e shtojmë besimin tonë tek Ai dhe Biri i Tij i Dashur, Jezu Krishti.

Duhet të jemi të kujdesshëm se ku na çojnë hapat tanë. Duhet të jemi syçelë dhe t’ia vëmë veshin këshillës së Jezusit dhënë dishepujve të Tij kur Ai iu përgjigj këtyre pyetjeve: “Na thuaj, kur do të ndodhin këto gjëra? Dhe cila do të jetë shenja e ardhjes sate dhe e mbarimit të botës?”

Dhe Jezusi duke u përgjigjur u tha atyre: ‘Ruhuni se mos ju mashtron ndokush!’⁹

Sot po përsërit një këshillë të hershme të dhënë nga udhëheqësit e Kishës.

- Vëllezër e motra, mbajeni të pastër doktrinën e Krishtit dhe kurrë mos u mashtroni nga ata që e ndryshojnë doktrinën. Ungjilli i Atit dhe i Birit u rivendos nëpërmjet Jozef Smithit, profeti për këtë periudhë të fundit ungjillore.
- Mos i dëgjoni ata që nuk janë shuguruar dhe/ose veçuar në thirrjet e tyre në Kishë dhe që nuk pranohen me anë të miratimit të përbashkët të anëtarëve të Kishës.¹⁰
- Jini në dijeni për organizata, grupe apo individë që pretendojnë se kanë përgjigje sekrete ndaj pyetjeve doktrimore, që ata thonë se apostujt dhe profetët e sotëm nuk i kanë apo nuk i kuptojnë ato.
- Mos i dëgjoni ata që ju joshin me skema mashtruese për t’u pasuruar. Anëtarët tanë kanë humbur tepër shumë para, prandaj jini të kujdesshëm.

Në disa vende, shumë nga njerëzit tanë janë duke parë përtej shenjës dhe duke kërkuar njohuri të fshehta në praktika të shtrenjta e të pasigurta për të gjetur shërim e mbështetje.

Një deklaratë zyrtare e Kishës, e lëshuar një vit më parë, thotë: “Ne i nxitim anëtarët e Kishës të jenë të kujdesshëm rreth pjesëmarrjes në ndonjë grup që premtton – në këmbim të parave – shërimë mrekullibërëse apo që pretendon se ka metoda të veçanta në përdorimin e fuqisë shëruese përtej mbajtësve të shuguruar siç duhet të priftërisë”¹¹.

Manuali i Kishës këshillon: “Anëtarët nuk duhet të përdorin praktika



mjekësore apo shëndetësore që janë të pasigurta etikisht apo ligjërisht. Udhëheqësit vendorë duhet t'i këshillojnë anëtarët që kanë probleme shëndetësore, që të këshillohen me mjekë të aftë profesionistë, të cilët janë të licencuar në vendet ku e ushtrojnë shërimin.”¹²

Vëllezër dhe motra, jini të mençur dhe të vetëdijshëm që praktika të tilla mund të jenë emocionalisht joshëse, por përfundimisht provojnë se janë të dëmshme shpirtërisht e fizikisht.

Për paraardhësit tanë pionierë, pavarësia dhe mbështetja te vetja ishin jetike, por ndjesia e tyre e komunitetit ishte po aq e rëndësishme. Ata punonin së bashku dhe e ndihmonin njëri-tjetrin që t'i kapërcenin sfidat fizike dhe emocionale të kohës së tyre. Për burrat ishte kuorumi i priftërisë dhe grave u shërbehej nëpërmjet Shoqatës së Ndihmës. Këto rezultate nuk kanë ndryshuar në kohën tonë.

Shoqata e Ndihmës dhe kuorumet e priftërisë sigurojnë për mirëqenien shpirtërore dhe materiale të anëtarëve tanë.

Qëndroni në shtegun e ungjillit duke pasur “besim në çdo hap”, në mënyrë që ju të ktheheni të sigurt në praninë e Atit Qiellor dhe të Zotit Jezu Krisht. Zoti është Shpëtimtari ynë i çmuar. Ai është Shëlbuesi i botës. Ne duhet ta nderojmë emrin e Tij të shenjtë dhe të mos e keqpërdorim atë në asnjë mënyrë, duke u përpjekur gjithmonë fort për t'i zbatuar urdhërimet e Tij. Nëse e bëjmë këtë, Ai do të na bekojë dhe do të na kthejë të sigurt në shtëpi.

E ftoj këdo që e dëgjon tingullin e zërit tim, që ta mirëpresë e përqafojë çdo njeri që po bën sot udhëtimin e tij apo të saj të vështirë, pavarësisht se ku janë në udhëtimin e tyre.

Ju lutem, mbajeni mend se nuk ka bekim më të madh që ndonjë njeri mund të japë, sesa mesazhi i Rivendosjes, i cili, kur pranohet dhe jetohet, premtion gëzim dhe paqe të përherëshme – madje jetë të përjetshme. Le t'i përdorim energjinë, forcën e dëshmitë tona për t'i ndihmuar misionarët tanë që të gjejnë, t'u japin mësim dhe t'i pagëzojnë fëmijët e Perëndisë, që fuqia

e doktrinës së ungjillit të mund ta udhëheqë jetën e tyre të përditshme.

Ne kemi nevojë që t'i përqafojmë me dhembshuri fëmijët e Perëndisë dhe ta largojmë çdo paragjykim, përfshirë racizmin, seksizmin dhe nacionalizmin. Le të jetë e qartë se ne me të vërtetë besojmë se bekimet e ungjillit të rivendosur të Jezu Krishtit janë për çdo fëmijë të Perëndisë.

Dëshmoj se “udhëtimi i vështirë vazhdon” dhe ju ftoj të qëndroni në shtegun e ungjillit ndërsa vazhdoni të ecni përpara duke i ndihmuar të gjithë fëmijët e Perëndisë me dashuri e dhembshuri, që bashkërisht të mund t'i bëjmë zemrat tona të kulluara dhe duart tona të pastra, për të marrë “shumëllojshmëri[në] e bekimeve” që i presin të gjithë ata që e duan me të vërtetë Atin tonë Qiellor dhe Birin e Tij të Dashur, për të cilat unë lutem përlësisht në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Brigham Young, sikurse kujtohet nga Wilford Woodruff, në *The Utah Pioneers* (1880), f. 23.
2. Autobiografia e Jane Manning James, rreth 1902, Biblioteka e Historisë së Kishës, Salt-Lejk-Siti; shih edhe James Goldberg, “The Autobiography of Jane Manning James”, 11 dhjetor 2013, history.lds.org.
3. Shih, për shembull, Jill DiSanto, “Penn Research Shows That Mormons Are Generous and Active in Helping Others”, *Penn News*, 17 prill 2012.
4. Shih M. Russell Ballard, “Faith in Every Footstep”, *Ensign*, nëntor 1996, f. 23–25.
5. “The Purpose of Relief Society”, lds.org/callings/relief-society/purposes; shih edhe *Handbook 2: Administering the Church* (2010), 9.1.1.
6. Doktrina e Besëlidhje 97:21.
7. Doktrina e Besëlidhje 97:25.
8. Doktrina e Besëlidhje 97:28.
9. Mateu 24:3–4.
10. Shih Doktrina e Besëlidhje 26:2; 28:13; 43:6–7.
11. Zëdhënës i Kishës Eric Hawkins, në Daniel Woodruff, “The Business behind Christ-Centered Energy Healing”, 28 shtator 2016, kutv.com.
12. *Handbook 2*, 21.3.6.



Nga **Ted R. Kelister**,
President i Përgjithshëm i Shkollës të së Dieles

Dëshmitari i Fuqishëm i Perëndisë: Libri i Mormonit

Libri i Mormonit është dëshmia e fuqishme e Perëndisë për hyjninë e Jezu Krishtit, thirrjen profetike të Jozef Smithit dhe të vërtetën tërësore të kësaj Kise.

Libri i Mormonit nuk është vetëm gurthemeli i fesë sonë, por mund të bëhet edhe gurthemeli i dëshmisë sonë që, kur vihemi përballë sprovave ose pyetjeve pa përgjigje, ai të mund t'i mbajë të patundura dëshmitë tona. Ky libër është e vetmja peshë në peshoren e së vërtetës që e tejkalon peshën e ndërthurur të të gjithë argumentimeve të kritikëve. Përse? Sepse nëse është i vërtetë, atëherë Jozef Smithi ishte një profet dhe kjo është Kisha e rivendosur e Jezu Krishtit, pavarësisht nga ndonjë argumentim historik apo argumentime të tjera për të kundërt. Për këtë arsye, kritikët kanë për qëllim që ta përgënjeshtrojnë Librin e Mormonit, por pengesat me të cilat përballen janë të pakapërcyeshme, për arsye se ky libër është i vërtetë.

Së pari, kritikët duhet të shpjegojnë se si Jozef Smithi, një djalë fermer 23-vjeçar me arsimim të kufizuar, krijoi një libër me qindra emra e vende të përveçëm, si edhe me histori e ngjarje të hollësishme. Sipas kësaj, shumë

kritikë hedhin mendimin se ai ishte një gjeni krijues, i cili u mbështet në libra të shumtë dhe burime të tjera vendore për ta krijuar përmbajtjen historike të Librit të Mormonit. Por, në kundërshtim me pohimin e tyre, nuk ka qoftë edhe një dëshmitar që pretendon se

e ka parë Jozefin me ndonjë nga këto burime të hamendësuara përpara se të fillonte përkthimi.

Edhe po të ishte i vërtetë ky argumentim, është krejtësisht i pamjaftueshëm për ta shpjeguar ekzistencën e Librit të Mormonit. Dikush duhet t'i përgjigjet patjetër pyetjes: Si i lexoi Jozefi të gjitha këto burime të hamendësuara, si i hoqi gjërat e parëndësishme, si e ruajti lidhjen logjike lidhur me faktin se kush ishte në cilin vend dhe kur, si dhe më pas ta diktonte atë me një kujtesë të përsosur? Sepse kur përktheu Jozef Smithi, ai sidoqoftë nuk kishte kurrfarë shënimesh. Në fakt, bashkëshortja e tij Ema tregon: "Ai nuk kishte as dorëshkrim as libër nga i cili të lexonte. . . . Nëse do të kishte pasur diçka të tillë, nuk do të ma kishte mbajtur të fshehtë."¹

Kështu që si e kreu Jozefi këtë vepër mbresëlënëse duke diktuar një libër me 500 faqe a më shumë pa asnjë shënim? Për ta bërë këtë, ai jo vetëm që duhet të ketë qenë një gjeni krijues, por duhet të ketë pasur edhe një kujtesë pamore me përmasa gjeniale. Por, nëse kjo është e





tuaj” (Mosia 2:17) ose “Njerëzit janë, që ata të mund të kenë gëzim” (2 Nefi 2:25). Këto janë mesazhe që kanë fuqi – mesazhe që janë të gjalla, që janë jetike dhe që frymëzojnë. Të hamendësosh që Jozef Smithi në moshën 23-vjeçare i zotëronte aftësitë e nevojshme për ta shkruar këtë vepër të madhërishtme vetëm me një variant fillestar për përafërsisht 65 ditë pune, thjesht bie ndesh me realitetet e jetës.

Presidenti Rasëll M. Nelson, një shkrimtar me përvojë dhe i zoti, tregoi se ai kishte bërë mbi 40 rishkrime të një bisede të konferencës së përgjithshme të kohës së fundit. Po tani a duhet të besojmë se Jozef Smithi, vetë, e diktoi tërë Librin e Mormonit në një variant të vetëm me ndryshime tepër të vogla gramatikore, të bëra më pas?

Bashkëshortja e Jozefit, Ema, e pohoi pamundësinë e një sipërmarrjeje të tillë: “Jozef Smithi [kur ishte i ri] nuk mund të shkruante dhe as të diktonte një letër me lidhje logjike dhe të formuluar mirë, dhe jo më të diktonte një libër si Libri i Mormonit”².

Dhe së fundi, edhe nëse dikush i pranon të gjitha argumentimet e lartpërmendura, megjithëse të dyshimta, kritikët sërish hasin një tjetër pengesë të madhe. Jozefi shpalli se Libri i Mormonit ishte shkruar në fletë të arta. Ky pretendim u kritikua pa pushim në kohën e tij – pasi “gjithkush” e dinte se historitë e lashta ishin shkruar në papiruse ose pergamena, deri pas shumë vitesh, kur [doli se] u zbuluan fletë prej metali me shkrime të lashta. Përveç këtyre, kritikët pretendonin se përdorimi i çimentos, siç përshkruhet në Librin e Mormonit, e tejkalonte njohurinë teknike të këtyre amerikanëve të hershëm – derisa [doli se] u gjetën struktura çimentoje në Amerikën e lashtë. Çfarë shpjegimesh japin tani kritikët për këto zbulime dhe të tjera të ngjashme me to?

vërtetë, përse kritikët e tij nuk i kushtuan vëmendje këtij talenti mbresëlënës?

Por ka edhe diçka tjetër. Këto argumentime vlejné vetëm për përmbajtjen historike të librit. Problemi i vërtetë qëndron ende: Si e shkroi Jozefi një libër që përçohet nga Shpirti dhe ku e gjeti ai një doktrinë kaq të thellë, pjesa më e madhe e së cilës i sqaron ose kundërshton bindjet e të krishterëve të kohës së tij?

Për shembull, Libri i Mormonit jep mësim, ndryshe nga besimet e shumë të krishterëve, se Rënia e Adamit ishte një hap pozitiv që çon përpara. Ai i sjell në dritë besëlidhjet e bëra në pagëzim, të cilat nuk trajtohen në Bibël.

Përveç këtyre, dikush mund të pyesë: Ku e mori Jozefi mbresën e fuqishme se, për shkak të Shlyerjes së Krishtit, Ai jo vetëm që na pastron por edhe na përsos? Ku e gjeti predikimin e mrekullueshëm mbi besimin tek Alma 32? Ose predikimin e mbretit Beniamin për Shlyerjen e Shpëtimtarit, ndofta predikimi më mbresëlënës mbi këtë temë në të gjitha shkrimet e shenjta? Apo alegorinë e pemës së ullirit me të gjitha ndërlikimet dhe pasurinë e saj doktrinale? Kur e lexoj këtë alegori, më duhet të vizatoj një diagramë për t’i ndjekur ndërlikimet e saj. Po tani a duhet të besojmë se Jozef Smithi thjesht i diktoi këto predikime nga mendja e vet pa kurrfarë shënimi?

Në kundërshtim me një përfundim të tillë, gjurmët e Perëndisë janë në të

gjithë Librin e Mormonit, siç vërtetohet nga të vërtetat e tij të madhërishtme doktrinale, veçanërisht predikimet e tij mjeshtërore mbi Shlyerjen e Jezu Krishtit.

Nëse Jozefi nuk ishte profet, atëherë me qëllim që t’i shpjegojnë këto pikëpamje mbresëlënëse doktrinale dhe shumë të tjera, kritikët duhet të ngrenë argumentimin se ai ishte edhe një gjeni në teologji. Por, nëse do të ishte kështu, dikush mund të pyesë: Përse ishte Jozefi i vetmi, 1800 vjet pas shërbesës së Krishtit, që shkroi një vëllim me doktrina të pashoqe dhe qartësuese? Sepse burimi i këtij libri ishte zbuluesi e jo mjeshtëria gjeniale.

Por edhe nëse hamendësojmë se Jozefi ishte një gjeni krijues dhe një gjeni në teologji, me një kujtesë pamore – vetëm këto talente nuk e bëjnë atë një shkrimtar të zotë. Për të shpjeguar ekzistencën e Librit të Mormonit, kritikët duhet të pretendojnë gjithashtu që Jozefi ishte një shkrimtar me një talent të lindur që në moshën 23-vjeçare. Në të kundërt, si i ndërthuri ai një mori emrash, vendesh dhe ngjarjesh në një tërësi harmonike pa pasur mospërputhje? Si i shkroi ai strategjitë e hollësishtme të luftërave, si i krijoi predikimet plot shprehje dhe si shpiku fraza që theksohen, mësohen përmendsh, citohen dhe vendosen te dyert e frigoriferëve nga miliona njerëz, të tilla si: “Kur jeni në shërbimin e bashkëqenieve tuaja, ju jeni vetëm në shërbimin e Perëndisë

Jozefi, siç e kuptoni, duhet të ketë qenë edhe një hamendësues me shumë, shumë fat. Sidoqoftë, pavarësisht të gjitha pretendimeve të çuditshme kundrejt tij, në kundërshtim me gjithë njohurinë ekzistuese shkencore dhe akademike, ai hamendësoi drejt kur gjithë të tjerët e kishin gabim.

Pasi i kemi marrë parasysh të gjitha këto, një njeri mund ta pyesë veten se si mund të besojë dikush se të gjithë këta faktorë të pretenduar dhe dogma, siç supozohen nga kritikët, u ndërthurën rastësisht në një mënyrë të tillë sa që e bënë të mundur që Jozefi të shkruante Librin e Mormonit dhe, si rrjedhojë, të nxirrte një vepër mashtruese dhe djallëzore. Po si mund të ketë kuptim kjo? Duke e kundërshtuar drejt-përdrejt një pohim të tillë, ky libër ka frymëzuar miliona veta që ta refuzojnë Satanin dhe të jetojnë më shumë një jetë si e Krishtit.

Ndërkohë që dikush mund të zgjedhë të besojë vijën e arsytimit të kritikëve, për mua, kjo është një rrugë intelektuale dhe shpirtërore pa krye. Për të besuar një gjë të tillë, do të më duhet të pranoj njëri pas tjetrit shumë

hamendësime të pavërtetuara. Përveç të tjerave, do të më duhet të shpërfill dëshminë e çdonjërit prej 11 dëshmitarëve³, ndonëse çdonjëri mbeti i vërtetë ndaj dëshmisë së vet deri në fund; do të më duhet të hedh poshtë doktrinën hyjnore që i mbush faqet njëra pas tjetres të këtij libri të shenjtë me të vërtetat e veta të hyjnishme; do të më duhet ta shpërfill faktin që njerëz të shumtë, përfshirë dhe veten, i janë afuar më shumë Perëndisë duke e lexuar këtë libër në vend të ndonjë libri tjetër dhe, mbi të gjitha do të më duhet të mohoj pëshpëritjet pohuese të Shpirtit të Shenjtë. Kjo do të binte ndesh me gjithçka që unë e di se është e vërtetë.

Një nga miqtë e mi të mirë e të mençur u largua nga Kisha për një kohë. Ai kohët e fundit më shkroi për rikthimin e tij: “Në fillim, doja që Libri i Mormonit të më vërtetohej nga ana historike, gjeografike, gjuhësore dhe kulturore. Por, kur e ktheva vëmendjen tek ajo që na mësohet rreth ungjillit të Jezu Krishtit dhe misionit të Tij shpëtues, fillova të marr dëshmi për vërtetësinë e tij. Një ditë, ndërsa po e lexoja Librin e Mormonit në dhomën time, ndalova, u

gjunjëzova dhe bëra një lutje me gjithë zemër, dhe ndjeva me siguri të madhe që Ati Qiellor i pëshpëriti shpirtit tim se Kisha dhe Libri i Mormonit ishin pa dyshim të vërtetë. Periudha ime prej tre vitesh e gjysmë duke kërkuar sërish për Kishën më ktheu me gjithë zemrën dhe bindshëm drejt vërtetësisë së tij.”

Nëse dikush do të shpenzojë kohë për ta lexuar me përlulësi dhe përsiatur Librin e Mormonit, sikurse bëri miku im, dhe ua vë veshin fryteve të ëmbla të Shpirtit, atëherë ai ose ajo do të marrë më në fund dëshminë e dëshiruar.

Libri i Mormonit është një nga dhuratat më të çmueshme të Perëndisë për ne. Ai është edhe shpatë edhe mburojë – ai dërgon fjalën e Perëndisë në fushëbetejë për të luftuar për zemrën e të drejtit dhe shërben si një mbrojtës kryesor i së vërtetës. Si shenjtore, ne jo vetëm që kemi privilegjin ta mbrojmë Librin e Mormonit, por kemi edhe mundësinë për ta përdorur atë – për të predikuar me fuqi për doktrinën e tij hyjnore dhe për të dhënë dëshmi për dëshmimin kurorëzues të Jezu Krishtit.

Unë jap dëshminë time solemne se Libri i Mormonit u përkthye nëpërmjet dhuratës dhe fuqisë së Perëndisë. Ai është dëshmia e fuqishme e Perëndisë për hyjninë e Jezu Krishtit, thirrjen profetike të Jozef Smithit dhe të vërtetën tërësore të kësaj Kise. U bëftë ai gurthemeli i dëshmimeve tona, që të mund të thuhet për ne, ajo që u tha për lamanitët e kthyer në besim, se ata “nuk hoqën dorë kurrë” (Alma 23:6). Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Emma Smith, në “Last Testimony of Sister Emma”, *Saints' Herald*, 1 tetor 1879, f. 289, 290.
2. Emma Smith, në “Last Testimony of Sister Emma”, f. 290.
3. Shih “Dëshmia e Tre Dëshmitarëve” dhe “Dëshmia e Tetë Dëshmitarëve”, Libri i Mormonit.





Nga Plaku Soni L. Koh,
i Të Shtatëdhjetëve

Veças, por Ende Një

Në Kishë, pavarësisht dallimeve tona, Zoti pret që ne të jemi një!

Në qershor 1994, po ngisja makinën me ankth për t'u kthyer nga puna në shtëpi për të parë në televizor kombëtare tonë të futbollit që do luante për Kupën e Botës. Pak pasi nisa udhëtimin tim, pashë nga larg në trotuar një burrë që po bënte përpara me nxitim në një karrige me rrota që vura re se ishte e zbukuruar me flamurin tonë brazilian. E dija se edhe ai po shkonte në shtëpi për të parë ndeshjen.

Kur rrugët tona u kryqëzuan dhe ne u pamë në sy, për një çast të shkurtër u ndjeva i bashkuar fuqishëm me atë burrë! Ne po shkonim në drejtime të ndryshme, nuk e njihnim njëri-tjetrin, kishim rrethana shoqërore dhe fizike qartësisht të ndryshme, por pasioni ynë i njëjtë për futbollin dhe dashuria për vendin tonë na bëri të ndiheshim një në atë çast! Nuk e kam parë atë burrë që nga ajo kohë, por sot, dekada më pas, mund t'i shoh ende ata sy dhe të ndjej atë lidhje të fortë me atë burrë. Në fund të fundit, ne e fituam ndeshjen dhe Kupën e Botës atë vit!

Në Kishë, pavarësisht nga dallimet tona, Zoti pret që ne të jemi një! Ai tha në Doktrinën e Besëlidhjet: “Jini një; dhe nëse nuk jeni një, nuk jeni të mitë”¹.

Ndërsa të gjithë ne hyjmë në një godinë kishitare për të adhuruar si grup, ne duhet t'i lëmë pas dallimet tona, duke përfshirë racën, pozitën

shoqërore, parapëlqimet politike, arrijtet akademike e profesionale dhe në vend të kësaj të përqendrohemi tek objektivat tona shpirtërore të përbashkëta. Së bashku ne këndojmë himne, meditojmë për të njëjtat besëlidhje gjatë sakramentit dhe themi njëkohësisht me zë një “amen” pas bisedave, mësimëve dhe lutjeve – që do të thotë se jemi dakord bashkërisht me atë që u tha.

Këto gjëra që ne bëjmë bashkërisht, ndihmojnë për të krijuar një ndjesi të fortë uniteti përbrenda bashkësisë.

Sidoqoftë, ajo që me të vërtetë e përcakton, forcon apo shkatërron unitetin tonë, është mënyra se si ne sillemi

kur jemi veças anëtarëve tanë të Kishës. Siç e dimë të gjithë, është e pashmangshme dhe normale që përfundimisht ne do të flasim për njëri-tjetrin.

Në varësi të asaj që vendosim të themi për njëri-tjetrin, fjalët tona ose do bëjnë që “zemrat [tona të] thur[en] në bashkim”², siç u dha mësim Alma atyre që u pagëzuan në ujërat e Mormonit, ose ato do t'i gërryejnë dashurinë, mirëbesimin dhe dashamirësinë që duhet të ekzistojë mes nesh.

Ka komente që pa u kuptuar e shkatërrojnë unitetin, të tilla si: “Po, ai është një peshkop i mirë; o, por duhet ta kishit parë atë kur ishte i ri!”

Një variant më dobiprurës i kësaj mund të jetë: “Peshkopi është kaq i mirë dhe ai është rritur kaq shumë në pjekuri dhe urtësi gjatë viteve”.

Shpesh herë ne vendosim etiketa të përhershme mbi njerëzit duke thënë diçka si: “Me presidenten tonë të Shoqatës së Ndihmës është e kotë; ajo është kaq kokëfortë!” Në të kundërt, ne mund të themi: “Presidentja e Shoqatës së Ndihmës ka qenë më pak elastike së fundmi; ndoshta po kalon një kohë të



vështirë. Le ta ndihmojmë dhe mbështesim atë!”

Vëllezër dhe motra, ne nuk kemi asnjë të drejtë ta paraqesim dikë, përfshirë nga rrethi ynë i Kishës, si një produkt i shkuar dëm! Përkundrazi, fjalët tona rreth bashkëqenieve tona duhet të pasqyrojnë besimin tonë në Jezu Krisht dhe në Shlyerjen e Tij dhe se në Të dhe me anë të Tij, ne gjithmonë mund të ndryshojmë për më mirë!

Disa fillojnë të kritikojnë dhe të bëhen të veçar nga udhëheqësit dhe anëtarët e Kishës për gjëra që janë kaq të vogla.

I tillë qe rasti i një burri të quajtur Simonds Ryder, i cili u bë anëtar i Kishës në 1831-in. Pasi lexoi një zbulim që i përkiste atij, ai u hutua kur pa se mbiemri i tij ishte shkruar gabimisht *Rider*, me shkronjën *i* në vend të shkronjës *y*. Reagimi i tij ndaj kësaj ngjarjeje kontribuoi në vënien në dyshim të profetit prej tij dhe përfundimisht çoi në përndjekjen ndaj Jozefit dhe në largimin nga Kisha³.

Gjithashtu ka gjasa që të gjithë ne do të përjetojmë ndonjë korrigjim nga udhëheqësit tanë kishtarë, gjë e cila do të jetë një provë ndaj asaj se sa të bashkuar jemi ne me ta.

Isha vetëm 11 vjeç, por mbaj mend që 44 vite më parë, shtëpia e mbledhjeve ku shkonte në kishë familja ime, do t'i nënshtrohej një rimodelimi madhor. Përpara se të niste ajo sipërmarrje, pati një mbledhje në të cilën udhëheqësit vendorë dhe zonalë diskutuan se si anëtarët do të merrnin pjesë me punë në atë përpjekje. Babai im, i cili më parë kishte kryesuar në atë njësi për vite, shprehu mendimin e tij të fortë se kjo punë duhej bërë nga një kontraktues dhe jo nga amatorë.

Jo vetëm që mendimi i tij u hodh poshtë, por ne dëgjuaam se atë e qortuan rreptësisht dhe publikisht në atë



rast. Tani, ky ishte një burrë i cili ishte shumë i përkushtuar ndaj Kishës dhe kishte qënë një ushtar i luftës së Dytë Botërore në Europë, i cili ishte i mësuar të rezistonte dhe të luftonte për atë që ai besonte! Dikush mund të pyeste veten se cili do të ishte reagimi i tij pas këtij incidenti. A do të këmbëngulte në mendimin e tij dhe do të vazhdonte ta kundërshtonte vendimin që tashmë ishte marrë?

Ne kishim parë familje në lagjen tonë, të cilat ishin bërë më të dobëta në ungjill dhe kishin reshtur së marri pjesë në mbledhjet sepse nuk mund të ishin një me ata që po drejtonin. Unë vetë gjithashtu dëshmoja shumë prej miqve të mi nga Fillorja që nuk qëndruan besnikë në rininë e tyre, për shkak se prindërit e tyre vazhdimisht gjenin gabime te njerëzit brenda Kishës.

Im atë, sidoqoftë, vendosi të qëndronte një me bashkëshenjtorët tanë. Disa ditë më vonë, kur anëtarët po mbledheshin për të ndihmuar në ndërtim, ai “e ftoi” familjen tonë që ta ndiqte atë drejt shtëpisë së mbledhjeve, ku ne do të viheshim në dispozicion për të ndihmuar në çfarëdo mënyrë.

Isha shumë i inatosur. Unë desha ta pyesja: “Babi, përse vallë po shkojmë të ndihmojmë në ndërtim nëse ti ishe kundra që ta bënë anëtarët këtë gjë?” Por shikimi në fytyrën e tij më

shkurajoi nga të bërit këtë. Unë desha të isha shëndoshë e mirë për ripërkushtimin. Pra, fatmirësisht, unë vendosa të heshtja dhe thjesht të shkoja dhe të ndihmoja në ndërtim!

Babai nuk e pa dot godinën kishtare të re, pasi ai ndërroi jetë përpara përfundimit të kësaj pune. Por ne në familje, tani të udhëhequr nga mamaja ime, vazhduam ta bënim pjesën tonë derisa puna mbaroi dhe kjo na mbajti të bashkuar me babin tim, me anëtarët e Kishës, me udhëheqësit tanë dhe, më e rëndësishmja, me Zotin!

Vetëm pak çaste përpara përvojës së Tij torturuese në Gjetseman, kur Jezusi po i lutej Atit për Apostujt e Tij dhe për të gjithë ne, shenjtorët, Ai tha: “Që të gjithë të jenë një, ashtu si ti, o Atë, je në mua dhe unë në ty”⁴.

Vëllezër dhe motra, unë dëshmoj se, ndërsa vendosim të jemi një me anëtarët dhe udhëheqësit e Kishës – si kur jemi të mbledhur së bashku dhe veçanërisht kur jemi veçar – do të ndihemi gjithashtu më përsosurisht të bashkuar me Atin tonë Qiellor dhe Shpëtimtarin. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Doktrina e Besëlidhje 38:27.
2. Mosia 18:21.
3. Shih Milton V. Backman Jr., *The Heavens Resound: A History of the Latter-day Saints in Ohio, 1830–1838* (1983), f. 93–94.
4. Gjoni 17:21.



Nga Plaku Stenli G. Ellis,
Anëtar Nderi i Të Shtatëdhjetëve

A i Mirëbesojmë Atij? Vështirësia Është e Mirë

Pavarësisht nga çështja, vështirësia mund të jetë e mirë për ata që do të ecin përpara me besim dhe i mirëbesojnë Zotit dhe planit të Tij.

Përpara se të filloj, si një përfaqësues i të gjithëve që jemi prekur nga shkatërrimi prej uraganeve dhe tërmeteve të kohëve të fundit, shpreh nga zemra vlerësimin tim për të gjithë Duart Ndhimtare dhe mbështetësit e tyre, që na dhanë ndihmë dhe shpresë.

Në tetorin e 2006-ës, unë dhashë bisedën time të parë në konferencën e përgjithshme. Unë ndjeva një mesazh të rëndësishëm për Kishën në mbarë botën përfshirë sigurinë që “Zoti na mirëbeson ne!”

Ai realisht na mirëbeson në aq shumë mënyra. Ai na ka dhënë ungjillin e Jezu Krishtit dhe, në këtë periudhë ungjillore, plotësinë e tij. Ai na mirëbeson me autoritetin e priftërisë së Tij të plotësuar me çelësat për përdorimin e duhur të tij. Me atë fuqi, ne mund të bekojmë, shërbejmë, marrim ordianca dhe bëjmë besëlidhje. Ai na mirëbeson me Kishën e Tij të rivendosur, përfshirë tempullin e shenjtë. Ai u mirëbeson shërbëtorëve të Tij fuqinë vulosëse – për të lidhur në tokë dhe për ta pasur atë të lidhur në qiell! Ai madje na mirëbeson si prindër, mësues dhe kujdestarë tokësorë të fëmijëve të Tij.

Pas këtyre viteve shërbimi si Autoritet i Përgjithshëm në shumë pjesë të botës, unë deklaroj madje me më shumë siguri: Ai na mirëbeson neve.

Tani pyetja për këtë konferencë është: “A i mirëbesojmë Atij?”

A i Mirëbesojmë Atij?

Presidenti Tomas S. Monson shpesh na kujton të “k[emi] besim tek Zoti me



gjithë zemër dhe [të] mos mbështet[emi] në gjykimin [tonë];

[ta] pranoj[më] në të gjitha rrugët [tona], dhe ai do të drejtojë shtigjet [tona].

Mos [ta] mbaj[më] veten të ditur në sytë [tana]” (Fjalët e Urta 3:5–7).

A mirëbesojmë që urdhërimet e Tij janë për të mirën tonë? Që udhëheqësit e Tij, edhe pse të papërkryer, janë për të na udhëhequr mirë? Që premtimet e Tij janë të sigurta? A mirëbesojmë që Ati Qiellor e Jezu Krishti na njohin dhe duan të na ndihmojnë? Madje mes sprovash, sfidash e kohësh të vështira, a mirëbesojmë akoma tek Ai?

Duke vështruar pas, disa nga mësimet më të mira i mora gjatë kohëve më të vështira – qoftë si i ri, në mision, kur fillova një karrierë të re, kur përpiqesha të lartësoja thirrjet e mia, kur rrisja një familje të madhe, ose kur përpiqesha të isha i vetëmbështetur. Duket qartë që vështirësia është e mirë!

Vështirësia Është e Mirë

Vështirësia na bën më të fortë, na përul dhe na jep një mundësi për ta provuar veten. Pionierët tanë të dashur të karrocave të dorës arritën ta njohin Perëndinë *në rrethana vështirësie të skajshme*. Përse u deshën dy kapituj për Nefin dhe vëllezërit e tij që të merrnin fletët prej tunxhi dhe vetëm tri vargje për bindjen e familjes së Ishmaelit që të shkante me ta në vendin e shkretë? (shih 1 Nefi 3–4; 7:3–5). Duket që Zoti donte ta forconte Nefin nëpërmjet përpjekjes për të marrë fletët.

Gjërat e vështira në jetën tonë nuk duhet të na vijnë si befasi. Një nga besëlidhjet më të para që bëjmë me Zotin, është që ta jetojmë ligjin e sakrificës. Sakrifica, si përkufizim, përfshin heqjen dorë nga diçka e dëshirueshme. Me anë të përvojës ne kuptojmë se ai është një çmim i vogël për t’u paguar për sa u përket bekimeve që pasojnë. Nën



dhe shumë të tjerë u zbutën për shkak të vuajtjeve të tyre, aq sa u përlën para Perëndisë” (Alma 62:41).

Secili nga ne zgjedh reagimin e vet ndaj vështirësisë.

Jini të Kujdesshëm me të Lehtën

Përpara kësaj thirrjeje, unë isha këshilltar financiar në Hjuston të Teksasit. Pjesa më e madhe e punës sime ishte me multimilionerë që kishin sipërmarrjet e tyre. Thujse të gjithë i kishin krijuar sipërmarrjet e tyre të suksesshme nga hiçi me anë të një pune të madhe dhe të vështirë. Gjëja më dëshpëruese për mua ishte të dëgjoja disa prej tyre të thoshin se donin ta bënin më të lehtë për fëmijët e tyre. Ata nuk dëshironin që fëmijët e tyre të vuanin si ata. Me fjalë të tjera, ata do t'i privonin fëmijët e tyre pikërisht nga ajo që i pati bërë ata të suksesshëm.

Në të kundërt, ne njohim një familje që zgjodhi një mënyrë tjetër. Prindërit u frymëzuan nga përvoja e J. C. Penit, ku babai i tij i tha se, kur të arrinte moshën tetë vjeç, financat do t'i siguronin vetë. Ata krijuan variantin e tyre: kur diplomoheshin në shkollën e mesme, fëmijët e tyre bëheshin të pavarur financiarisht – për arsimim të mëtejshëm (kolegj, shkollë pas kolegjit) dhe për nevojat e tyre financiare (vërtet të mbështetur te vetja) (shih DeB 83:4). Lumturisht, fëmijët reagueshan urtësisht. Të gjithë janë të diplomuar nga kolegj dhe disa mbaruan gjithashtu shkollë pas kolegj – të gjithë vetë. Nuk ishte e lehtë, por ata e kryen. Ata e arritën me punë të vështirë dhe me besim.

Besim për t'i Mirëbesuar Atij

Pyetja: “A i mirëbesojmë Atij?” mund të thuhet më mirë: “A e kemi *besimin* t'i mirëbesojmë Atij?”

A e kemi *besimin* që t'u mirëbesojmë premtimeve të Tij lidhur me të

drejtimin e Jozef Smithit, u tha se “një fe që nuk kërkon sakrificën e të gjitha gjërave nuk ka kurrë fuqi të mjaftueshme për të prodhuar besimin e mjaftueshëm për jetën e për shpëtimin”¹.

Anëtarëve të Kreut-Perëndi sigurisht që nuk u mungon njohja për gjërat e vështira. Perëndia Ati flijoi birin e Tij të Vetëmlindur në vuajtjen e tmerrshme të Shlyerjes, përfshirë vdekjen nëpërmjet kryqëzimit. Shkrimi i shenjtë thotë se Jezu Krishti mësoi “të jetë i bindur nga ato që pësoi” (Hebrenjve 5:8). Ai e vuajti vullnetarisht agoninë e Shlyerjes. Fryma e Shenjtë duhet të jetë shumë i duruar për të na nxitur, paralajmëruar dhe drejtuar, ndonjëherë vetëm për t'u shpërfillur, keqinterpretuar apo harruar.

Pjesë e Planit

Vështirësia është pjesë e planit të ungjillit. Një nga qëllimet e kësaj jete për ne është që të jemi të provuar (shih Abraham 3:25). Janë të paktë ata që, pa e merituar, kanë vuajtur më shumë se populli i Almës. Ata u arratisën nga mbreti i lig Noa, vetëm që më pas të bëheshin skllëvër të lamanitëve! Nëpërmjet atyre sprovave, Zoti u mësoi atyre se Ai e ndëshkon popullin e Tij dhe “provon durimin e [tij] dhe besimin e [tij]” (Mosia 23:21).

Gjatë ditëve të tmerrshme në Burgun e Libertisë, Zoti i mësoi Jozef Smithit t'i “duron[te] mirë ato” (DeB 121:8) dhe i premtoi se, në qoftë se do

ta bënte këtë, “gjithë këto gjëra do [t'i jepnin] përvojë dhe do të [ishin] për të mirën [e tij]” (DeB 122:7).

Presidenti Tomas S. Monson është lutur: “E zgjedhshim përherë të drejtën më të vështirë në vend të së gabuarës më të lehtë”². Në lidhje me tempujt tanë, ai deklaroi se “nuk ka sakrificë tepër të madhe, nuk ka çmim tepër të lartë, nuk ka betejë tepër të vështirë, me qëllim që të marrim ato bekime [të tempullit]”³.

Në botën e natyrës, vështirësia është pjesë e ciklit të jetës. Është e vështirë për një zogth që ta çajë atë lëvozhgë të fortë të vezës. Por, kur dikush përpjeket t'ia bëjë më të lehtë, zogu nuk e zhvillon forcën e nevojshme për të jetuar. Në të njëjtën mënyrë, përpjekja e fluturës për t'i shpëtuar fshikëzës e forcon për jetën që do të jetojë.

Nëpërmjet këtyre shembujve, shohim se vështirësia është *konstantja!* Në të gjithë kemi sfida. *Ndryshori* është reagimi ynë ndaj vështirësisë.

Njëherë, disa njerëz te Libri i Mormonit vuajtën “përndjekje të mëdha” dhe “shumë fatkeqësi” (Helamani 3:34). Si reagueshan ata? “Ata agjëruan dhe u lutën shpesh dhe u bënë gjithnjë e më të fortë në përlësinë e tyre dhe gjithnjë e më të vendosur në besimin e Krishtit, në mbushjen e shpirtave të tyre me gëzim dhe ngushëllim” (Helamani 3:35). Një shembull tjetër ndodhi pas vitesh luftime: “Për shkak të luftës jash-tëzakonisht të gjatë mes Nefitëve dhe Lamanitëve, shumë u ashpërsuan . . .

dhjetën, që me 90 për qind të rritjes sonë *plus ndihmën e Zotit*, ne jemi më mirë sesa me 100 për qind *më vite*?

A kemi mjaft *besim* që të mirëbesojmë se Ai do të na vizitojë në hidhërimet tona (shih Mosia 24:14), se Ai do të luftojë ata që na luftojnë (shih Isaia 49:25; 2 Nefi 6:17) dhe se Ai do t'i shenjtërojë hidhërimet tona për të mirën tonë? (shih 2 Nefi 2:2).

A do ta ushtrojmë ne *besimin* e nevojshëm për t'i zbatuar urdhërimet e Tij në mënyrë që Ai të mund të na bekojë si materialisht ashtu edhe shpirtërisht? Dhe a do të vazhdojmë besnikë deri në fund që Ai të mund të na marrë në praninë e Tij? (Shih Mosia 2:41.)

Vëllezër dhe motra, ne mund ta kemi besimin për t'i mirëbesuar Atij! Ai do më të mirën për ne (shih Moisiu 1:39). Ai do t'u përgjigjet lutjeve tona (shih DeB 112:10). Ai do t'i mbajë premtimet e Tij (shih DeB 1:38). Ai ka fuqinë t'i mbajë ato premtime (shih Alma 37:16). Ai di gjithçka! Dhe më e rëndësishmja, Ai e di se cila është më e mira (shih Isaia 55:8–9).

Një Botë e Rrezikshme

Bota jonë është e vështirë. Ne kemi një ligësi të shfrenuar, korrupsion në çdo komb, terrorizëm që arrin edhe vende të sigurta, dështim ekonomik, papunësi, sëmundje, katastrofa natyrore, luftëra civile, udhëheqës despotikë e kështu me radhë. Çfarë duhet të bëjmë? Të arratisemi apo të luftojmë? Cila është e drejtë? Secila nga zgjedhjet mund të jetë e rrezikshme. Ishte e rrezikshme për Xhorxh Uashingtonin dhe ushtritë e tij të luftonin, por gjithashtu për paraardhësit tanë pionierë që të arratiseshin. Ishte e rrezikshme për Nelson Mandelën të luftonte për liri. Është thënë se, që të triumfojë e liga, mjafton që njerëzit e mirë të mos bëjnë asgjë.⁴



Mos u frikësoni!

Në çfarëdo që bëjmë, ne nuk duhet as të vendosim as të veprojmë me një shpirt frike. Vërtet, “Perëndia nuk na ka dhënë frymë frike” (2 Timoteut 1:7). (A e kuptoni idenë përse [frazja] “mos u frikëso” është theksuar kudo në shkrimet e shenjta?) Zoti më ka mësuar se shkura-jimi dhe frika janë mjete të kundërshtarit. Përgjigjja e Zotit për kohët e vështira është që të ecim përpara me besim.

Çfarë Është Vështirësia?

Secili nga ne mund të ketë mendim të ndryshëm rreth asaj që është e vështirë. Disa mund ta konsiderojnë të vështirë të paguajnë të dhjetën kur financat janë të shtrënguara. Udhëheqësve ndonjëherë i duket e vështirë të presin që i varfri të paguajë të dhjetën. Mund të jetë e vështirë për disa nga ne që të ecim përpara me besim për t'u martuar apo për të pasur familje. Ka nga ata që i duket e vështirë “të [jenë të] kënaqur me [atë] që [u ka] dhënë Zoti” (Alma 29:3). Mund të jetë e vështirë të jemi të kënaqur me thirrjen tonë të tanishme (shih Alma 29:6). Disiplina e Kishës mund të duket shumë e vështirë, por për disa ajo shënon fillimin e procesit të pendimit të vërtetë.

Pavarësisht nga çështja, e vështira mund të jetë e mirë për ata që do të ecin përpara me besim dhe i mirëbesojnë Zotit dhe planit të Tij.

Dëshmia Ime

Vëllezër e motra të mia, unë dëshmoj se këta udhëheqës ulur prapa kësaj foltoreje janë thirrur nga Perëndia. Dëshira e tyre është t'i shërbejnë mirë Zotit dhe të na ndihmojnë që ta vendosim ungjillin në zemrat tona. Unë i dua dhe i mbështet ata.

Unë e dua Shpëtimtarin tonë, Jezu Krishtin. Unë mrekullohem që Ai e don-te Atin dhe ne aq sa të bëhej Shpëtimtari dhe Shëlbuesi ynë, që, duke bërë këtë, Atij iu desh të vuante aq shumë sa e bëri Atë “të dridhej] për shkak të dhembjes e [t'i dilte] gjak nga çdo por dhe të vua[nte] si në trup e në shpirt” (DeB 19:18). Prapëseprapë, përballë kësaj gjendjeje të tmerrshme dhe domosdoshmërisë së saj, Ai i pohoi Atit: “Mos u bëftë vullneti im, por yti” (Lluka 22:42). Unë u gëzohem fjalëve të engjëllit: “Ai nuk është këtu, sepse u ringjall” (Mateu 28:6).

Shembulli i Tij vërtet është “udha, e vërteta dhe jeta” (Gjoni 14:6). Vetëm duke e ndjekur atë shembull ne mund të gjejmë “paqe në këtë botë dhe jetë të përjetshme në botën që vjen” (DeB 59:23). Duke ndjekur shembullin e Tij dhe duke zbatuar mësimet e Tij, unë kam mësuar vetë se secili nga “premtimet e çmueshme dhe shumë të mëdha” të Tij (2 Pjetër 1:4) është i vërtetë.

Dëshirat e mia më të mëdha janë të qëndroj me Mormonin si një dishepull i vërtetë i Jezu Krishtit (shih 3 Nefi 5:13) dhe që një ditë të dëgjoj nga buzët e Tij: “Të lumtë shërbëtor i mirë dhe besnik” (Mateu 25:21). Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. *Lectures on Faith* (1985), f. 69.
2. Tomas S. Monson, “Zgjedhje”, *Liahona*, maj 2016, f. 86.
3. Tomas S. Monson, “Tempulli i Shenjtë – Një Fener për Botën”, *Liahona*, maj 2011, f. 92.
4. Shih John Stuart Mill, *Inaugural Address: Delivered to the University of St. Andrews, Feb. 1, 1867* (1867), f. 36.



Plaku Adilson de Paula Parreja,
i Të Shtatëdhjetëve

Të Vërteta Thelbësore – Nevoja Jonë për të Vepruar

Vegimi i Parë dhe Profeti Jozef Smith nxorën në dritë njohuri dhe të vërteta që janë thelbësore për lumturinë tonë në këtë jetë dhe për ekzaltimin tonë.

Kur isha rreth shtatë vjeç, e pyeta nënën time: “Kur unë dhe ti të vdesim dhe të shkojmë në qiell, a do të jesh ende nëna ime?” Ajo nuk e priste një pyetje të tillë. Por, duke u përgjigjur sipas njohurisë së saj më të mirë, ajo tha: “Jo, në qiell ne do të jemi vëllezër dhe motra. Unë nuk do të jem nëna jote.” Kjo nuk ishte përgjigja që po shpresoja të merrja.

Pak kohë pas asaj bisede të shkurtër, dy të rinj erdhën te porta e shtëpisë sonë. Nga njëfarë mrekullie, babai im i lejoi të hynin. Ata thanë që ishin misionarë nga Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme.

Këta pleq [eldra], siç u mësuam t'i thërrasim, filluan ta mësonin familjen tonë. Unë i mbaj mend shumë mirë ndjenjat tona të lumturisë dhe emocionet sa herë që ata na vinin në shtëpi. Ata na treguan se një i ri pati shkuar në një korie për ta pyetur Perëndinë se cila kishë ishte e vërtetë dhe se ai pa Perëndinë dhe Jezu Krishtin.¹ Misionarët na treguan një ilustrim të atij vegimi dhe,

kur e pashë, unë e dija se Jozef Smithi e kishte parë me të vërtetë Perëndinë dhe Jezu Krishtin. Misionarët thanë se në saje të këtij vegimi, Kisha e vërtetë e Jezu Krishtit ishte përsëri në tokë.²

Misionarët na mësuam gjithashtu planin e Perëndisë për lumturinë dhe iu përgjigjen pyetjeve të familjes sonë rreth fesë. Ata na mësuam se familjet vërtet mund të jenë së bashku pas kësaj jete si baba, nënë dhe bij e bija.



Familja jonë u pagëzua. Rruga drejt ndryshimit të zakoneve të vjetra, heqjes dorë nga traditat dhe të bërit anëtarë aktivë të Kishës ishte ndonjëherë me vështirësi. Por në saje të mëshirës dhe dashurisë së Perëndisë dhe me ndihmën e shumë udhëheqësve dhe anëtarëve, ne ia dolëm në vitet e para sfiduese.

Miliona njerëz që i janë bashkuar tashmë Kishës, si dhe shumë të tjerë që po kthehen në besim dhe pagëzohen çdo javë, kanë fituar një dëshmi për Vegimin e Parë. Fryma e Shenjtë mund t'ia përsëritë këtë dëshmi shpesh secilit prej nesh ndërsa përpiqemi t'i jetojmë të vërtetat e thjeshta të ungjillit të Krishtit.

Vegimi i Parë dhe Profeti Jozef Smith nxorën në dritë njohuri dhe të vërtetë shtesë që janë thelbësore për lumturinë tonë në këtë jetë dhe për ekzaltimin tonë në praninë e Perëndisë. Unë do të përmend tri nga të vërtetat që fituam dhe sipas të cilave duhet të veprojmë, ngaqë një djalosh i ri u gjunjëzua në lutje të sinqertë.

Perëndia Thërret Profetë për të na Udhëhequr dhe Udhërrëfyer

Një e vërtetë thelbësore që mësojmë nga Vegimi i Parë dhe Profeti Jozef Smith, është se Perëndia thërret profetë³, shikues dhe zbulues për të na udhëzuar, udhërrëfyer, paralajmëruar e udhëhequr.⁴ Këta burra janë zëdhënësit e Perëndisë në tokë⁵, me autoritetin për të folur e për të vepruar në emrin e Zotit.⁶ Duke e ndjekur saktësisht këshillën e tyre, ne do të jemi të mbrojtur dhe do të marrim bekime të mrekullueshme në udhëtimin tonë në këtë tokë.

Kur studioja në Universitetin “Brigam Jang” si misionar i ri i kthyer e beqar, mora pjesë në një sesion të priftërisë të konferencës së përgjithshme në Tabernakullin të Sheshi i Tempullit. Presidenti Ezra Taft Benson, atëherë President i Kishës, e nxiti çdo misionar të kthyer

që ta merrte seriozisht martesën dhe ta bënte përparësi kryesore në jetën e tij.⁷ Pas sesionit, unë e dija se isha thirrur për pendesë dhe duhej të veproja sipas këshillës së profetit.

Kështu që vendosa të shkoj në vendlindjen time, Brazil, për të gjetur një bashkëshorte. Përpara se të nisësja për në Brazil për një praktikë 2-mujore mësimore, e mora në telefon nënën dhe disa miq dhe arrita të krijoja një listë me rreth 10 të reja – secila prej tyre një bashkëshorte e mundshme.

Ndërsa isha në Brazil, pas shumë përsiatjeje dhe lutjeje, u takova, dola dhe u fejova e caktova një datë për t'u martuar me një nga të rejat e listës. Krahasuar me studentët në Provo të Jutas nuk kisha arritur ndonjë rekord kohor për dalje në takime dhe për t'u fejuar, por ishte kohë e shkurtër sipas standardeve braziliane.

Pak muaj më vonë, unë u martova me Ileinën. Ajo është dashuria e jetës sime dhe një bekim i mrekullueshëm.

Nuk po sugjeroj që secili duhet të bëjë një listë të ngjashme, por po sugjeroj – ndoshta më shumë sesa sugjerim – që ne gjithmonë duhet të veprojmë kur profetët tanë të gjallë flasin.

Profeti i Perëndisë sot është Presidenti Tomas S. Monson dhe ne do të bekohemi nga ndjekja me saktësi e këshillës së tij.

Njohja e Natyrës së Vërtetë të Perëndisë

Një e vërtetë tjetër që ne mësojmë në saje të Vegimit të Parë dhe Profetit Jozef Smith, është natyra e vërtetë e Perëndisë. Thjesht përfytyroni sa të bekuar jemi të dimë se Perëndia është një qenie me trup prej mishi e kockash po aq të prekshëm sa edhe yni⁸, që ne mund të adhurojmë një Perëndi që është i vërtetë, të cilin mund ta kuptojmë dhe që ua ka shfaqur dhe zbuluar Vetën dhe Birin e Tij profetëve të Tij – profetëve në



lashtësi si dhe profetëve në këto ditë të mëvonshme.⁹ Ai është Perëndi që i dëgjon dhe u përgjigjet lutjeve tona¹⁰; Perëndi që na vështron nga lart në qiell¹¹ dhe është vazhdimisht i shqetësuar rreth mirëqenies sonë shpirtërore e tokësore; një Perëndi që na dha liri zgjedhjeje që të vendosim vetë për ta ndjekur Atë dhe për t'iu bindur urdhërimeve të Tij pa shtrengim¹²; një Perëndi që na jep bekime dhe na lejon të përballemi me sprovën për t'iu rritur e bërë si Ai.

Ai është një Perëndi i dashur që siguroi një plan nëpërmjet të cilit mund të gëzojmë lumturi në këtë jetë dhe në përjetësi.

Jezu Krishti Është Shpëtimtari Ynë

Nga Vegimi i Parë dhe Profeti Jozef Smith, ne morëm njohuri për realitetin dhe misionin e shenjtë të Zotit Jezu Krisht, i cili është guri i qoshes i fesë sonë.

Për shkak se vdekja hyri në botë, po me aq siguri sa jetojmë tani, ne të gjithë do të vdesim një ditë. Një nga ndikimet e vdekjes do të ishte humbja e përherëshme e trupit tonë fizik; ne nuk do të ishim në gjendje të bënim asgjë për ta rifituar atë. Përveç kësaj, ngaqë të gjithë mëkatojmë gjatë udhëtimit tonë këtu në tokë, ne nuk do të ishim kurrë në gjendje të riktheheshim në praninë e Atit tonë Qiellor.

A mund t'i përfytyroni pasojat e të qenit të ndaluar nga prania e Perëndisë dhe e të mos pasurit kurrë një trup?

Një Shpëtimtar dhe Shëlbues nevojitet për të na çliruar nga vdekja dhe nga mëkati. Nën drejtimin e Atit Qiellor,

Jezu Krishti erdhi në tokë, vuajti, vdiq në kryq dhe u ringjall që edhe ne të mund të ringjallemi dhe, me pendim të sinqertë dhe duke bërë e mbajtur besëlidhje të shenjta, të jemi edhe një herë në praninë e Perëndisë.

Jakobi shpjegoi: “O sa e madhe mirësia e Perëndisë sonë, që përgatit një udhë për udhëdaljen tonë nga kapja e këtij përbindëshi të tmerrshëm; po, ai përbindësh, vdekja dhe ferri, që unë e quaj vdekja e trupit dhe gjithashtu vdekja e shpirtit”¹³.

Jezusi është Mesia i premtuar, Ligjdhënësi, I Shenjti i Izraelit, Zoti ynë, Shpëtimtari ynë, Shëlbuesi ynë, Mbreti ynë, Gjithësia ynë.

Vazhdojmë të gjithë të veprojmë sipas këtyre të vërtetave dhe kësaj njohurie thelbësore, duke i ofruar bindjen tonë Perëndisë dhe Birit të Tij të Dashur. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih Joseph Smith—Historia 1:17–18.
2. Shih Doktrina e Besëlidhje 1:30.
3. Shih Amosi 3:7.
4. Shih, për shembull, lidhur me mësoj: Mateu 28:20; 2 Nefi 9:48; *udhërrëfeje: Mësime të Presidentëve të Kishës: Gordon B. Hinkli* (2016), f. 262–263; *lajmëroj: Ezekieli 3:17; udhëheq: Doktrina e Besëlidhje 124:45.*
5. Shih 2 Nefi 3:18.
6. Shih Ezekieli 3:4; Lluca 1:70; Veprat e Apostujve 3:21; Doktrina e Besëlidhje 1:38.
7. Shih Ezra Taft Benson, “To the Single Adult Brethren of the Church”, *Ensign*, maj 1988, f. 51–53.
8. Shih Doktrina e Besëlidhje 130:22.
9. Shih Doktrina e Besëlidhje 110:2–3.
10. Shih Mosia 9:18.
11. Shih Doktrina e Besëlidhje 1:1.
12. Shih 2 Nefi 2:27; Helamani 14:30; Doktrina e Besëlidhje 58:28.
13. 2 Nefi 9:10.



Nga Plaku Jan S. Arden,
i Të Shtatëdhjetëve

Kërkoni nga Librat më të Mirë

Kur studiojmë nga librat më të mirë, ne mbrohemi kundrejt nofullave kërcënuese të atyre që kërkojnë t'i brejnë rrënjët tona shpirtërore.

Herët një mëngjes, pashë një vemje të uritur dhe të maskuar mirë në një shkurre të bukur trëndafilash. Nga pamja e disa prej kërcenjve pa gjethe, ishte e qartë edhe për vëzhguesin e pavëmendshëm që ajo e kishte brejtur udhën e vet përmes gjetheve të njoma me nofullat e saj dëmtuese. Në mënyrë alegorike, nuk mund të mos mendoja se ka disa njerëz që janë si kjo vemje; ata gjenden anembanë botës dhe disa maskohen me kaq zgjuarsa sa ne mund t'i lejojmë të hyjnë në jetën tonë dhe përpara se ta kuptojmë, ata do t'i kenë ngrënë rrënjët tona shpirtërore dhe rrënjët e pjesëtarëve të familjes sonë dhe të miqve tanë.

Ne jetojmë në një kohë në të cilën po lulëzon keqinformimi ndaj gjërave që ne besojmë. Në kohë si këto, dështimi në mbrojtjen dhe forcimin e rrënjëve tona shpirtërore është një ftesë për t'i lënë ato rrënjë të brehen nga ata që përpiqen ta shkatërrojnë besimin tonë te Krishti dhe të besuarin tonë te Kisha e Tij e rivendosur. Në kohët e Librit të Mormonit, ishte Zizromi që u përpoq ta shkatërronte besimin e besimtarëve.

Veprimet dhe fjalët e tij ishin “një grackë e kundërshtarit, që e . . . v[uri]

për t[a] zënë . . . popull[in], që të mund [ta] nënshtro[nte], që të mund [ta] rretho[nte] me zinxhirët e tij” (Alma 12:6). Po ato gracka ekzistojnë sot dhe, nëse nuk jemi vigilentë shpirtërisht dhe nuk ndërtojmë një themel të sigurt mbi Shëlbuesin tonë (shih Helamani 5:12), ne mund ta gjejmë veten të lidhur me zinxhirët e Satanit dhe duke u çuar me kujdes nëpër shtigje të ndaluara, për të cilat flitet në Librin e Mormonit (shih 1 Nefi 8:28).



Apostulli Pal dha një paralajmërim në kohën e tij, që është i zbatueshëm në kohën tonë: “Në fakt unë e di se, . . . vetë midis jush do të dalin njerëz që do të flasin gjëra të çoroditura që të tërheqin pas vetes dishepujt” (Veprat e Apostujve 20:29–30).

Paralajmërimi i tij dhe paralajmërimet e profetëve dhe apostujve tanë na kujtojnë se duhet të bëjmë gjithçka mundemi për ta fuqizuar veten tonë shpirtërisht kundrejt fjalëve të kundërshtimit dhe mashtrimit. Teksa vizitohet lagje e kunje të Kishës, lartësohem moralisht nga ajo që shoh, dëgjoj e ndiej teksta shenjtoret u përgjigjen pozitivisht e besnikërisht mesimeve të Shpëtimtarit dhe të shërbëtorëve të Tij.

Shtimi i respektimit të ditës së Shabatit është vetëm një shembull i anëtarëve që po e fuqizojnë veten e tyre shpirtërisht duke ua vënë veshin ftesave profetike. Forcimi i mëtejshëm është vënë re në shtimin e punës në tempull dhe për historinë familjare, teksa familjet i mbledhin së bashku paraardhësit e tyre nëpërmjet ordinarit të tempullit. Rrënjët tona shpirtërore futen më thellë kur lutjet e sinqerta vetjake dhe familjare bëhen fortesat e besimit tonë dhe kur pendo kemi çdo ditë, kërkojmë shoqërimin e Frymës së Shenjtë, mësojmë për Shpëtimtarin tonë dhe tiparet e Tij dhe përpiqemi fort të bëhemi si Ai (shih 3 Nefi 7:27).

Shpëtimtari ynë, Jezu Krishti, është Drita e Botës dhe Ai na bën thirrje ta ndjekim Atë. Ne duhet të shohim tek Ai në të gjitha kohët dhe veçanërisht kur ka net të zymta e të stuhishme, kur furtuna e dyshimit dhe e pasigurisë, si një mjegull e dendur, hyn vjedhurazi. Nëse gishtat e drejtuar “nga ana tjetër e lumit të ujit, [ku qëndron] një ndërtesë [e] gjerë dhe [e] madhe” (1 Nefi 8:26) do të shfaqen të treguar drejt jush me një qëndrim përqeshës, poshtërues e



ndjellës, ju kërkoj që të largoheni menjëherë, që të mos t’ju mbushet mendja nga mjetet djallëzore dhe dinake për t’u larguar nga e vërteta dhe bekimet e saj.

Megjithatë, vetëm kjo gjë nuk do të jetë e mjaftueshme në këtë kohë kur gjëra të çoroditura po fliten, shkruhen e portretizohen. Plaku Robert D. Hejls na mësoi: “Në qoftë se nuk jeni tërësisht të përfshirë në të jetuarin e ungjillit – duke e jetuar atë me gjithë ‘zemrën, fuqinë, mendjen dhe forcën’ tuaj – ju nuk mund të prodhoni mjaft dritë shpirtërore për ta davaritur errësirën” (“Out of Darkness into His Marvelous Light”, *Liahona*, korrik 2002, f. 78). Sigurisht, dëshira jonë për ta ndjekur Krishtin, i cili është Drita e Botës (shih Gjoni 8:12), do të thotë që ne duhet të veprojmë sipas mësimëve të Tij. Ne forcohemi, fuqizohemi dhe mbrohemi shpirtërisht kur veprojmë sipas fjalës së Perëndisë.

Sa më e madhe drita në jetën tonë, aq më të pakta hijet e dyshimit. Sidoqoftë, edhe në një bollëk drite, ne ndeshemi me njerëz e komente që i keqinterpretojnë bindjet tona dhe e vënë në provë besimin tonë. Apostulli Jakob shkroi se “sprova e besimit [tonë] sjell qëndrueshmëri” (Jakob [Bibël] 1:3). Me këtë këndvështrim, Plaku Nil A. Maksuell dha mësim: “Një dishepull i qëndrueshëm . . . nuk do të habitet, as nuk do të shkatërrohet kur Kisha paraqitet në mënyrë të gabuar” (“Patience” [takim shpirtëror në

Universitetin “Brigam Jang”, 27 nëntor 1979], speeches.byu.edu).

Patjetër që do të dalin pyetje rreth historisë së Kishës sonë dhe bindjeve tona. Vendi se ku shkojmë për t’i gjetur përgjigjet e sakta, kërkon kujdes të madh. Nuk fitohet asgjë nga shqyrtimi i pikëpamjeve dhe opinioneve të njerëzve më pak të informuar apo të zhgënjyer. Këshilla më e mirë u dha nga Apostulli Jakob: “Por në qoftë se ndonjërit nga ju i mungon urtia, le të kërkojë nga Perëndia” (Jakob [Bibël] 1:5).

Kërkimi nga Perëndia duhet të paraprihet nga një studim i kujdesshëm, sepse ne kemi marrë porosi nga shkrimi i shenjtë që të kërkojmë “nga librat më të mirë fjalët e urtësisë” dhe të “kërkojmë” të mësojmë, madje me anë të studimit dhe gjithashtu me anë të besimit” (DeB 88:118). Ka një pasuri të madhe të këtyre librave, të shkruar nga udhëheqës të Kishës, të frymëzuar nga qielli, dhe nga studiues të mirënjohur, të sigurt e të besueshëm të historisë dhe doktrinës së Kishës. Pavarësisht nga kjo, asnjëri prej këtyre librave nuk e kapërcen madhësitinë e fjalës së zbuluar nga Perëndia në shkrimin e shenjtë të kanonizuar. Nga ato fletë të holla, por të mbushura me ide shpirtërore, ne e mësojmë të vërtetën nëpërmjet Frymës së Shenjtë dhe, si rrjedhojë, na shtohet drita.

Presidenti Tomas S. Monson na është përgjyeruar “që me lutje ta studiojmë

dhe ta përsiatim Librin e Mormonit çdo ditë” (“Fuqia e Librit të Mormonit”, *Liahona*, maj 2017, f. 87).

Disa vite më parë, ndërkohë që po shërbeja si president i Misionit të Suvës në Fixhi, disa misionarë patën një përvojë që e përforcoi tek ata fuqinë e Librit të Mormonit për t’i kthyer njerëzit në besim. Në një ditë të nxehtë e të lagësht, dy misionarë mbërritën te një shtëpi në një koloni të vogël të Labasës.

Trokitjes në derë iu përgjig një burrë i rrahur nga jeta, i cili dëgjonte teksa misionarët dëshmonin për vërtetësinë e Librit të Mormonit. Ata i dhanë një kopje dhe e ftuan që ta lexonte e të lutej për të ditur, sikurse ata, se ai libër është fjala e Perëndisë. Përgjigja e tij ishte e shkurtër: “Nesër do të shkoj sërish të peshkoj. Do ta lexoj kur të jem në det dhe kur të kthehem, ju mund të më vizitoni përsëri.”

Ndërkohë që ai ishte i larguar, u bënë transferimet e misionarëve dhe, disa javë më vonë, një dyshe e re misionarësh u kthye për ta vizituar peshkatarin. Gjatë kësaj kohe, ai e kishte lexuar të gjithë Librin e Mormonit, kishte marrë një pohim për vërtetësinë e tij dhe dëshironte të mësonte më shumë.

Ky burrë ishte kthyer në besim nëpërmjet Frymës së Shenjtë, që i dëshmoi për të vërtetën e fjalëve të çmuara në çdo faqe ngjarjesh dhe për doktrinën e dhënë mësim shumë kohë më parë dhe të ruajtur për kohën tonë në Librin e Mormonit. Po ai bekim është në dispozicion për secilin prej nesh.

Shtëpia është një vend i përsosur për familjet që të studiojnë e diskutojnë ide të vlefshme nga shkrimet e shenjta dhe fjalët e profetëve dhe që të përdorin materiale të Kishës tek LDS.org. Atje do të gjeni një bollëk informacioni rreth temave të ungjillit, të tilla si rrëfimet e Vegimit të Parë. Kur studiojmë nga librat më të mirë, ne mbrohemi

kundrejt nollave kërcënuese të atyre që kërkojnë t'i brejnë rrenjët tona shpirtërore.

Pavarësisht nga gjithë lutja, studimi e përsiatja jonë, mund të mbeten akoma disa pyetje që ende nuk kanë përgjigje, por ne nuk duhet ta lejojmë këtë gjë që të na e shuajë flakën e besimit që regëtin brenda nesh. Pyetje të tilla janë një ftesë për ta ngritur besimin tonë dhe nuk duhet ta ushqejnë një çast kalimtar të dyshimit mashtrues. Është vetë thelbi i fesë që të mos kemi një përgjigje të sigurt ndaj çdo pyetjeje, sepse ky është një nga qëllimet e besimit. Lidhur me këtë, Plaku Xhefri R. Holland na ka dhënë mësim se “kur ato çaste vijnë dhe shqetësimet shfaqen, zgjidhja e të cilave nuk po afrohet menjëherë, *mbahuni fort tek ajo që tashmë e dini dhe qëndroni të paepur derisa të vijë dija e mëtejshme*” (“Unë Besoj, o Zot”, *Liahona*, maj 2013, f. 94).

Ne shohim përreth nesh gëzimin e kaq shumë njerëzve që qëndrojnë të paepur, duke i ushqyer vazhdimisht rrenjët e tyre shpirtërore. Besimi dhe bindja e tyre janë të mjaftueshme për t'iu dhënë shpresë të madhe të Shpëtimtari i tyre dhe nga ajo buron lumturi e madhe. Ata nuk shpallin se i dinë të gjitha gjërat, por e kanë paguar çmimin që të dinë aq sa të kenë paqe e të jetojnë me durim, ndërkohë që përpiqen të dinë më shumë. Rresht pas rreshti, besimi i tyre çimentohehet te Krishti dhe ata qëndrojnë të paepur si bashkëqytetarë me shenjtorët.

Jetoftë secili prej nesh në mënyrë të tillë që nollat kërcënuese të vemjeve të maskuara të mos gjejnë vend, as tani e as kurrë, në jetën tonë, që ne të mbetemi “të vendosur në besimin e Krishtit, madje deri në fund” (Alma 27:27). Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■



Nga Plaku Hoze L. Alonso,
i Të Shtatëdhjetëve

Ta Duam Njëri-Tjetrin sikurse Ai na Ka Dashur

Duke u shërbyer të tjerëve e duke i falur ata me dashuri të vërtetë, ne mund të shërohemi e të marrim forcën për të kapërcyer vetë sfidat tona.

Gjatë Darkës së Fundit, Shpëtimtari u dha një urdhërim të ri dishepujve të Tij, duke u thënë: “Po ju jap një urdhërim të ri: ta doni njëri-tjetrin; sikurse unë ju kam dashur, ashtu edhe ju ta doni njëri-tjetrin.

Prej kësaj do t'ju njohin të gjithë që jeni dishepujt e mi, nëse keni dashuri për njëri-tjetrin.”¹

Dishepujve të Shpëtimtarit iu dha një urdhërim i ri për të bërë diçka më shumë, diçka më të madhe dhe diçka më hyjnore. Ky urdhërim dhe ftesë e re është përmbledhur në frazën kyçe: “Sikurse unë ju kam dashur”.

Dashuria Është Veprim; Dashuria Është Shërbim

“Dashuria është një ndjenjë përkushtimi, interesimi dhe dhembshurie të thellë. Shembulli më i madh i dashurisë së Perëndisë për fëmijët e Tij shprehet te Shlyerja e pafundme e Jezu Krishtit.”² “Sepse Perëndia e deshi aq botën”, shënoi Gjoni, “sa dha Birin e tij të vetëmlindurin, që, kushdo që beson në të, të mos humbasë, por të ketë jetë të përjetshme.”³ “Dashuria për Perëndinë dhe bashkënjëzërit është një veti e dishepujve të Jezu Krishtit.”⁴

Disa vite më parë, kur nipi ynë më i madh, Hozeja, ishte katër vjeç, ai po luante me bashkëshorten time. Ndërkohe që po qeshnin dhe kalonin një kohë të mirë së bashku, nipi ynë e pyeti: “Gjyshe, a më do ti mua?”

Ajo iu përgjigj: “Po, Hoze, unë të dua”.

Pastaj ai i bëri një pyetje tjetër: “Si e di ti që më do mua?”

Ajo i shpjegoi ndjenjat e saj dhe gjithashtu i tregoi gjithçka që kishte bërë dhe donte të bënte për të.





Më vonë bashkëshortja ime i bëri Hozesë të njëjtat pyetje, përfshirë këtë pyetje depërtuese: “Si e di ti se më do mua?”

Me një përgjigje të pafajshme, por të sinqertë, ai tha: “Unë të dua sepse e ndiej brenda zemrës sime”. Sjellja e dashur e Hozesë ndaj gjyshes së vet atë ditë dhe gjithmonë tregon se dashuria është një ndërthurje e veprimeve si edhe e ndjenjave të thella.

Mbreti Beniamin dha mësim: “Dhe vini re, unë jua them këto gjëra që ju të mund të mësoni urtësi; që ju të mund të mësoni se kur jeni në shërbimin e bashkëqenieve tuaja, ju jeni vetëm në shërbimin e Perëndisë tuaj”⁵.

Në botën e sotme të aq shumë vuajtjeve për shkak rrethanash të ndryshme, dërgimi i një mesazhi me tekst me një simbol argëtues ose postimi i një figure të këndshme me fjalët “unë të dua” është i mirë dhe me vlerë. Por ajo që shumë nga ne duhet të bëjnë, është që t’i lëmë pas pajisjet telefonike dhe, me duart e këmbët tona, të ndihmojmë të tjerë që janë në nevojë të madhe. Dashuria pa shërbim është si besimi pa vepra; është vërtet e vdekur.

Dashuria Është Falje

Dashuria e pastër e Krishtit, që është dashuri hyjnore⁶, na frymëzon jo vetëm për të vepruar e dhënë shërbim, por gjithashtu për të pasur forcën për të

falur, pavarësisht nga situata. Me lejoni t’ju tregoj një përvojë që e ka ndikuar dhe ndryshuar jetën time. Tedi dhe Sheroni, prindërit e Kuperit, që ndodhen sot këtu, më kanë dhënë leje për ta treguar atë që ndodhi në familjen e tyre më shumë se nëntë vite më parë. Unë do ta tregoj përvojën nga këndvështrimi i Tedit, babait të Kuperit:

“21 gushti i 2008-s ishte dita e parë e shkollës dhe tre vëllezërit më të mëdhenj të Kuperit, Ivani, Gerrëti dhe Logani, ishin të gjithë të stacioni i autobusit duke pritur të hipnin në autobusët e shkollës. Kuperi, që ishte katër vjeç, ishte në biçikletën e vet; bashkëshortja ime, Sheroni, po ecte në këmbë.

Bashkëshortja ime ishte matanë rrugës dhe i bëri shenjë Kuperit që të kalonte rrugën. Në të njëjtën kohë, një makinë bëri shumë ngadalë një kthesë majtas dhe e shtypi Kuperin.

Mora një telefonatë nga një fqinj që më tregoi se Kuperi qe goditur nga një makinë. Me shpejtësi shkova me makinë te stacioni i autobusit për ta parë. Kuperi ishte shtrirë në bar, duke pasur vështirësi në frymëmarrje, por nuk kishte plagë të dukshme.

Unë u gjunjëzova pranë Kuperit dhe i thashë gjëra inkurajuese si: ‘Çdo gjë do të shkojë mirë. Mbahu.’ Në atë çast, udhëheqësi i grupit tim të priftërinjve të lartë, Neithëni, u duk me

bashkëshorten e tij. Ajo sugjeroi që t’i jepnim Kuperit një bekim priftërie. Ne vumë duart mbi kokën e Kuperit. Nuk më kujtohet çfarë thashë te bekimi, por kujtoj qartë praninë e të tjerëve përreth nesh dhe ishte në atë çast që unë e dija se Kuperi do të ndërronte jetë.

Kuperi u mor me helikopter për në spital, por, në fakt, vërtet ndërroi jetë. Ndjeva se Ati Qiellor po më thoshte se kujdestaria ime tokësore kishte mbaruar dhe se Kuperi tani ishte nën kujdesin e Tij.

Ne qemë në gjendje të kalonim pak kohë me Kuperin në spital. Punonjësit atje e përgatitën që të mund ta mbanim në krahë dhe t’i thoshim lamtumirat tona, dhe na lanë të kalonim aq kohë me të, duke e mbajtur, sa të dëshironim.

Rrugës për në shtëpi, unë dhe bashkëshortja ime e mposhtur nga hidhërimi pamë njëri-tjetrin dhe filluam të bisedonim rreth djalit që ngiste makinën. Ne nuk e njihnim, edhe pse ai jetonte vetëm një rrugë larg nesh dhe ishte brenda kufijve të lagjes sonë.

Dita tjetër ishte shumë vështirë për ne ngaqë ishim të gjithë plotësisht të pushtuar nga hidhërimi. Rashë në gjuhë dhe bëra lutjen më të sinqertë që pata bërë ndonjëherë. I kërkova Atit Qiellor në emrin e Shpëtimtarit tim që të ma hiqte hidhërimin dërrmues. Ai e bëri atë.

Më vonë atë ditë, një nga këshilltarët në presidencën e kunjit tonë e organizoi që ne të takoheshim me të riun – drejtuesin e makinës – dhe prindërit e tij në shtëpinë e këshilltarit. Sheroni dhe unë pritëm djalin dhe prindërit e tij që të arrinin. Kur u hap dera, ne u takuam me ta për herë të parë. Peshkopi im më pëshpëriti në vesh: ‘Shko te [djali]’. Sheroni dhe unë e përqafluam në një përqaflim të madh në grup. Ne qamë së bashku për një periudhë kohe që na u duk e gjatë.

Ne i thamë se e dinim që ajo që pati ndodhur, ishte thjesht aksident.

Për mua dhe Sheronin ishte mrekulli edhe mënyra se si u ndiem, edhe se ende ndihemi po ashtu. Me hirin e Perëndisë, ne qemë në gjendje të merrnim shtegun e madh, shtegun e dukshëm, të vetmin shteg dhe ta duam këtë të ri të mirë.

Ne jemi bërë shumë të afërt me të dhe familjen e tij ndër vite. Ai ka ndarë me ne çastet domethënëse më të çmueshme të jetës së vet. Ne madje shkua në tempull me të kur përgatitej për misionin e vet.⁷

Vëllezër dhe motra, Tedi e di pa asnjë dyshim se Ati ynë Qiellor na do. Ai e di se të jesh në gjendje të falësh dhe

të çliroh veten nga barra në atë mënyrë, është po aq e kënaqshme sa të jesh i falur. Kjo kënaqësi vjen nga ndjekja e modelit të Shembullit tonë më të madh. Në Librin e Mormonit, Alma shpalli për Shpëtimtarin: “Dhe ai do të shkojë përpara, duke vuajtur dhimbje dhe hidhërime dhe tundime të çdo lloji; dhe kjo, që të plotësohet fjala që thotë se ai do të marrë përsipër dhembjet dhe sëmundjet e popullit të tij”⁸.

Vëllezër e motra, çfarë historie e mrekullueshme e dashurisë dhe faljes së vërtetë. Ne, po ashtu, mund të kemi gëzim dhe lumturi kur u shërbejmë të tjerëve dhe i falim ata. Xhorxhi, një tjetër nga nipërit tanë, shpesh thotë: “Çfarë lloj familjeje jemi ne?” Dhe ai përgjigjet: “Ne jemi një familje e lumtur!”

Presidenti Tomas S. Monson na ka këshilluar duke thënë: “Le ta shqyrtojmë jetën tonë dhe të vendosim ta ndjekim shembullin e Shpëtimtarit duke qenë të mirë, të dashur dhe me dashuri hyjnore”⁹.

Unë e di se Ati ynë Qiellor dhe Biri i Tij, Jezu Krishti, na duan dhe janë të gatshëm të na ndihmojnë për të vepruar kur ne e duam njëri-tjetrin sikurse Ata na kanë dashur ne. Dhe unë e di se, duke u shërbyer të tjerëve e duke i falur ata me dashuri të vërtetë, ne mund të shërohem i të marrim forcën për t'i kapërcyer sfidat tona vetjake. Dhe unë i deklaroj këto në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Gjoni 13:34–35.
2. “Love [Dashuria]”, Gospel Topics [Temat e Ungjillit], topics.lds.org.
3. Gjoni 3:16.
4. “Love [Dashuria]”, Gospel Topics [Temat e Ungjillit], topics.lds.org.
5. Mosia 2:17.
6. Shih Moroni 7:47.
7. Shkëputur dhe përshtatur nga Ted Mardesich, dorëshkrim i pabotuar.
8. Alma 7:11.
9. Thomas S. Monson, “Mirësia, Dashuria Hyjnore dhe Dashuria”, *Liahona*, maj 2017, f. 67.





Nga Plaku Nil L. Andersen,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Zëri i Zotit

*Unë dëshmoj se në këtë konferencë ne e kemi dëgjuar zërin e Zotit.
Prova për secilin prej nesh është mënyra se si përgjigjemi.*

Së pari, një fjalë të ëmbël për fëmijët e vegjël. Po, ky është sesioni përfundimtar dhe unë jam folësi i fundit.

Kohët e fundit, teksa po vizitoja Tempullin e Provo-Siti-Sentërit, pashë me admirim një pikturë të titulluar *Vegimi i Parë nga Larg*. Piktura paraqet dritën dhe fuqinë nga qielli, kur Ati dhe Biri vizituan të riun Jozef Smith.

Ndërkohë që nuk bëj krahasim me ngjarjen shumë të shenjtë që e filloi Rivendosjen, unë mund të përfytyroj një pamje të ngjashme që do ta pasqyronte dritën dhe fuqinë shpirtërore të Perëndisë duke zbritur mbi këtë konferencë të përgjithshme dhe, më pas, atë fuqi dhe dritë duke u përhapur anembanë botës.

Ju jap dëshminë time që Jezusi është Krishti, që Ai i drejton punët e kësaj veprë të shenjtë dhe që konferenca e përgjithshme është një nga rastet shumë të rëndësishme kur Ai i jep drejtim Kishës së Tij dhe neve personalisht.

Të Mësuar nga Lart

Në ditën kur u organizua Kisha, Zoti e caktoi Jozef Smithin si profet, shikues dhe apostull të Zotit Jezu Krishtit¹ dhe i tha Kishës:

“Sepse fjalën e tij duhet ta merrni si nga goja ime, plot durim e besim.

Pasi duke i bërë këto gjëra, portat e ferrit nuk do të hapen kundër jush; . . . dhe Zoti Perëndi do t’i shpërndajë fuqitë e errësirës përpara jush dhe do të bëjë që qiejt të dridhen për të mirën

tuaj dhe për lavdinë e emrit të tij.”²

Më vonë, të gjithë anëtarët e Presidencës së Parë dhe të Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve gjithashtu u mbështetën dhe u shuguruan si profetë, shikues e zbulues.³

Tani, teksa mblidhemi nën drejtimin e Presidentit Tomas S. Monson, ne presim të dëgjojmë “vullnetin e Zotit, . . . mendijen e Zotit, . . . zërin e Zotit dhe fuqinë e Perëndisë për shpëtim”⁴. Ne mirëbesojmë në premtimin e Tij: “Qoftë nëpërmjet zërit tim apo nëpërmjet zërit të shërbëtorëve të mi është njësoj”⁵.

Në rrëmujën dhe trazirën e botës sonë bashkëkohore, mirëbesimi dhe besimi ynë te fjalët e Presidencës së Parë dhe të Kuorumit të Dymbëdhjetëve janë jetikë për rritjen dhe qëndresën tonë shpirtërore.⁶

Ne jemi mbledhur së bashku për këtë konferencë të mrekullueshme. Miliona shenjtore të ditëve të mëvonshme dhe njerëz të tjerë besimtarë në më shumë se 200 vende, duke folur më shumë se 93 gjuhë, i ndjekin këto sesione apo i lexojnë mesazhet e konferencës.

Ne vijmë pasi jemi lutur dhe përgatitur. Për shumë prej nesh, ka shqetësime të ngutshme dhe pyetje të çiltra. Ne duam ta ripërtërijmë besimin tonë te Shpëtimtari ynë, Jezu Krishti, dhe ta forcojmë aftësinë tonë për t’i bërë



Piktura *Vegimi i Parë nga Larg* ilustron dritë dhe fuqi nga qielli.



Drita dhe fuqia shpirtërore e Perëndisë zbresin mbi konferencën e përgjithshme.



Fuqia dhe drita nga konferenca e përgjithshme, më pas, përhapen anembanë botës.

ballë tundimit dhe për t'iu shmangur shpërqendrimeve. Ne vijmë që të mësohemi nga lart.

Mendja dhe Vullneti i Zotit

Për Presidencën e Parë dhe Të Dymbëdhjetët, të cilët normalisht flasin në çdo konferencë, përgjegjësia e pamasë për përgatitjen e mesazheve të tyre është një barrë e përsëritur si edhe një mirëbesim i shenjtë.

Shumë vite më parë, përpara se të shërbeja si Autoritet i Përgjithshëm, e pyeta Plaku Dallin H. Ouks nëse ai përgatiste një bisedë të veçantë për çdo konferencë kunji. Ai u përgjigj se nuk e bënte, por shtoi: “Por bisedat e mia të konferencës së përgjithshme janë ndryshe. Mund të kaloj në duar 12 deri në 15 formulime paraprake që të jem i sigurt se po them atë që Zoti do të më donte ta thosha.”⁷

Kur dhe si vjen frymëzimi për bisedat e konferencës së përgjithshme?

Pa u caktuar temat, ne shohim qiellin që i bashkërendon kaq bukur çështjet dhe temat e së vërtetës së përgjithshme për çdo konferencë.

Një prej Vëllezërve të mi më tha se tema e tij për këtë konferencë iu dha menjëherë pas bisedës së tij prillin e shkuar. Një tjetër përmendi para tri javësh se ai akoma po lutej dhe po priste nga Zoti. Një tjetër, kur e pyetën se sa kohë i ishte dashur ta hartonte një bisedë veçanërisht të ndjeshme, u përgjigj: “Njëzet e pesë vjet”.

Me raste ideja qendrore mund të vijë shpejt, por përmbajtja dhe hollësitë ende kërkojnë përpjekje të jashtëzakonshme shpirtërore. Agjërimi dhe lutja, studimi dhe besimi janë gjithmonë pjesë të procesit. Zoti nuk dëshiron asnjë shtirje që e pakëson zërin e Tij tek shenjtoret e Tij.

Drejtimi për një bisedë të konferencës së përgjithshme shpesh vjen natën



ose në orët e para të mëngjesit, kur biseda është shumë larg prej mendimeve që vijnë në mendje. Befas, ideja e papritur dhe, me raste, fjalë dhe fraza të veçanta rrjedhin si një zbulësë e pastër.⁸

Teksa dëgjoni, mesazhet që i merrni, mund të jenë shumë të mirëfillta ose mund të jenë të përshtatura pikërisht për ju.

Duke folur shumë vjet më parë në konferencën e përgjithshme, unë tregova për një frazë që erdhi në mendjen time ndërkohë që pyesja veten nëse isha i përgatitur për të shërbyer në një mision. Frazja ishte: “Ti nuk di gjithçka, por di mjaftueshëm!”⁹ Një e re e ulur në konferencën e përgjithshme atë ditë më tha se po lutej mbi një propozim për martesë, duke pyetur veten se sa mirë e njihje të riun. Kur i thashë fjalët: “Ti nuk di gjithçka, por di mjaftueshëm”, Shpirti ia pohoi asaj se *vërtet* e njihje të riun mjaftueshëm. Ata kanë qenë të martuar lumturisht për shumë vjet.

Ju premtoj se, kur e përgatitni shpirtin tuaj dhe vini me pritshmërinë se do ta dëgjoni zërin e Zotit, mendime dhe ndjenja do të vijnë në mendjen tuaj që janë përshtatur veçanërisht

për ju. Ju tashmë i keni ndier ato në këtë konferencë ose do t'i ndieni ndërkohë që i studioni mesazhet në javët në vazhdim.

Për Tani dhe për Muajt e Ardhshëm

Presidenti Monson ka thënë:

“Ta gjejmë kohën që t'i lexojmë mesazhet e konferencës”¹⁰.

“Meditoni për [to]. . . Kam zbuluar . . . se përfitoj edhe më shumë nga këto predikime të frymëzuara kur i studioj me thellësi më të madhe.”¹¹

Mësimet e konferencës së përgjithshme janë gjërat që Zoti dëshiron që t'i kemi përpara nesh tani dhe në muajt e ardhshëm.

Bariu “shkon para [deleve të tij]; dhe delet e ndjekin, sepse njohin zërin e tij”¹².

Shpesh, zëri i Tij na drejton që të ndryshojmë diçka në jetën tonë. Ai na fton të pendohejmë. Ai na fton ta ndjekim Atë.

Mendoni për këto thënie nga kjo konferencë:

Presidenti Henri B. Ajring nga sot në mëngjes: “Ju jap dëshminë time se Perëndia, Ati, jeton dhe dëshiron që ju



të ktheheni në shtëpi tek Ai. Kjo është Kisha e vërtetë e Zotit Jezu Krisht. Ai ju njeh; Ai ju do; Ai kujdeset për ju.”¹³

Presidenti Diter F. Uhtdorf nga dje: “Unë dëshmoj se, kur nisemi ose e vazhdojmë rrugëtimin e jashtëzakonshëm që na çon te Perëndia, jeta jonë do të jetë më e mirë . . . dhe Zoti do të na përdorë në mënyra mbresëlënëse për t’i bekuar ata që janë përreth nesh dhe për të bërë të ndodhin qëllimet e Tij të përjetshme”¹⁴.

Presidenti Rasëll M. Nelson nga dje pasdite: “Ju premtoj se, ndërsa e zhytni veten përditë në Librin e Mormonit, ju mund të fitoni imunitet kundër të ligave të ditës, përfshirë edhe murtajën

dërrmuese të pornografisë dhe varësive të tjera që na mpijnë mendjen”¹⁵.

Plaku Dallin H. Ouks dje: “Dëshmoj se proklamata për familjen është një shpallje e të vërtetës së përjetshme, vullneti i Zotit për fëmijët e Tij të cilët kërkojnë jetën e përjetshme”¹⁶.

Dhe Plaku M. Rasëll Ballard nga vetëm pak minuta më parë: “Ne kemi nevojë që t’i përqafojmë me dhembshuri fëmijët e Perëndisë dhe ta largojmë çdo paragjykim, përfshirë racizmin, seksizmin dhe nacionalizmin”¹⁷.

Ngaqë kemi pak kohë më shumë, do të doja të shtoja një mendim të shkurtër rreth Plakut Robert D. Hejls. Presidenca e Parë i kishte thënë Plakut Hejls se

mund të jepte një mesazh të shkurtër në sesionin e mëngjesit të së dielës nëse e lejonte shëndeti i tij. Ndërkohë që shëndeti i tij nuk e lejoi, ai përgatiti një mesazh, të cilin e mbaroi javën që shkoi dhe ma tregoi mua. Meqë ai ndërroi jetë gati tri orë më parë, unë do të lexoj vetëm tri fjali nga biseda e tij.

Duke cituar Plakun Hejls: “Kur zgjedhim të kemi besim, ne përgatitemi që të qëndrojmë në praninë e Perëndisë. . . . Pas Kryqëzimit të Shpëtimtarit, Ai iu shfaq vetëm atyre që ‘kishin qenë besnikë në dëshminë e [Tij], ndërkohë që jetuan në vdekshmëri’. [DeB 138:12.] Ata ‘që i mohuan dëshmitë . . . e profetëve . . . , nuk [mund ta shihnin] praninë e [Shpëtimtarit], as nuk e panë fytyrën e Tij. [DeB 138:21.] . . . Besimi ynë na përgatit që të jemi në praninë e Zotit.”

Ç’mirësi nga ana e Zotit që t’i jepte mbresë Presidentit Rasëll M. Nelson pikërisht në mbarim të sesionit të mëngjesit që me të shpejtë të largohej nga godina, të mos hante drekë dhe të nxitonte pranë shtratit të Plakut Hejls, ku ai, presidenti i tij i kuorumit, mund të arrinte dhe të ishte me engjëlloren Meri Hejlsin ndërkohë që Plaku Hejls e përfundoi shkollimin në vdekshmëri.



Në vitin 1979, dr. Nelsoni pati një ndjenjë se duhej ta ndiqte këshillën e Presidentit Spenser W. Kimball për të studiuar gjuhën kineze mandarine.



Dëshira e dr. Nelsonit për ta ndjekur këshillën e Presidentit Kimball solli si pasojë vizitën e dr. Vu Jingkait në Solt-Lejk-Siti si dhe dhënien e leksioneve dhe kryerjen e operacioneve prej dr. Nelsonit në Kinë.



Në tetor 2015, Presidenti Rasëll M. Nelson u nderua me një shpallje zyrtare, duke e quajtur atë “mik i vjetër i Kinës”.



Përgjigjja ndaj Zërit të Zotit

Unë dëshmoj se në këtë konferencë ne e kemi dëgjuar zërin e Zotit.

Nuk duhet të shqetësohemi shumë kur fjalët e shërbëtorëve të Zotit janë të kundërta me të menduarit e botës dhe, me raste, vetë të menduarin tonë. Ka qenë gjithmonë kështu. Unë jam në gjunjë në tempull së bashku me Vëllëzërit e mi. Jap dëshmi për mirësinë e shpirtrave të tyre. Dëshira e tyre më e madhe është që ta kënaqin Zotin dhe t'i ndihmojnë fëmijët e Perëndisë që të kthehen në praninë e Tij.

Të Shtatëdhjetët; Peshkopata; Presidentat e Përgjithshme të Shoqatës së Ndihmës, Të Rejave dhe Filllores; dhe udhëheqësit e organizatave të tjera ndihmëse kanë shtuar frymëzim të jashtëzakonshëm në këtë konferencë, sikurse ka shtuar muzika e bukur dhe lutjet plot mendim.

Ka një thesar të drejtimit qiellor që pret të zbulohet nga ju në mesazhet e konferencës së përgjithshme. Prova për secilin prej nesh është mënyra se si përgjigjemi ndaj asaj që dëgjojmë, ndaj asaj që lexojmë dhe ndaj asaj që ndiejmë.

Lejomëni të tregoj për një përvojë rreth përgjigjes ndaj fjalëve profetike nga jeta e Presidentit Rasell M. Nelson:

Në vitin 1979, pesë vjet përpara thirrjes së tij si Autoritet i Përgjithshëm, Vëllai Nelson mori pjesë në një mbledhje pikërisht përpara konferencës së përgjithshme. Presidenti Spenser W. Kimball u drejtoi një sfidë të gjithë atyre që ishin të pranishëm, për të bërë hapa më të mëdhenj që ta çonin ungjillin në mbarë botën. Mes vendeve që Presidenti Kimball i përmendi veçanërisht ishte Kina, duke shpallur: 'Ne duhet t'u japim shërbim kinezëve. Duhet ta mësojmë gjuhën e tyre. Duhet të lutemi për ta dhe t'i ndihmojmë ata.'¹⁸

Në moshën 54-vjeçare, Vëllai Nelson pati një ndjenjë gjatë mbledhjes se ai duhej të studioje gjuhën mandarine. Edhe pse një kirurg zemre shumë i zënë me punë, ai menjëherë siguroi shërbimet e një mësuesi.

Jo shumë kohë pas fillimit të studimeve, dr. Nelsoni duke marrë pjesë në një konventë, papritmas u gjend i ulur pranë "një kirurgu të shquar kinez,

dr. Vu Jingkai. . . Ngaqë [Vëllai Nelson] e kishte studiuar gjuhën mandarine, ai filloi [një] bashkëbisedim [me dr. Vunë]."¹⁹

Dëshira e dr. Nelsonit për ta ndjekur profetin çoi tek ardhja e dr. Vusë për të vizituar Solt-Lejk-Sitin dhe në udhëtimin e dr. Nelsonit për në Kinë që të jepte leksione dhe të kryente operacione kirurgjikale.

U shtuan dashuria e tij për popullin kinez dhe dashuria dhe respekti i tyre për të.

Në shkurt të vitit 1985, dhjetë muaj pas thirrjes së tij në Kuorumin e Të Dymbëdhjetëve, Plaku Nelson mori një telefonatë të papritur nga Kina që i lutej dr. Nelsonit të shkonte në Pekin për të operuar zemrën e dëmtuar të këngëtarit më të famshëm të operës në Kinë. Me nxitjen e Presidentit Gordon B. Hinkli, Plaku Nelson u rikthye në Kinë. Operacioni i fundit kirurgjik që ai kreu ndonjëherë, ishte në Republikën Popullore të Kinës.

Vetëm dy vjet më parë, në tetor 2015, Presidenti Rasell M. Nelson u nderua edhe një herë me një shpallje zyrtare, ku ai u quajt një "mik i vjetër i Kinës".

Më pas dje ne e dëgjuam Presidentin Rasell M. Nelson, tashmë 93-vjeçar, të na fliste për përgjërimitin e Presidentit Tomas S. Monson drejtuar "secilit prej nesh [në konferencën e prillit të shkuar që] me lutje ta studiojmë dhe ta përsiatim Librin e Mormonit çdo ditë".

Ashtu siç bëri kur ishte një kirurg zemre plot punë, kur mori një mësues të gjuhës mandarine, Presidenti Nelson e pranoi menjëherë këshillën e Presidentit Monson dhe e vuri në jetë. Më shumë sesa thjesht leximi, ai tha: "Kam bërë lista se çfarë është Libri i Mormonit, çfarë pohon, çfarë përgënjeshtrohet, çfarë përmbush, çfarë qartëson dhe çfarë zbulon"²⁰.

Dhe më pas, mjaft interesante, pikërisht këtë mëngjes, si një dëshmitar i dytë, Presidenti Henri B. Ajring gjithashtu foli për mënyrën e vet se si iu përgjigj këshillimit të Presidentit Monson. A ju kujtohen këto fjalë? “Si shumë prej jush, unë i dëgjova fjalët e profetit sikurse zërin e Zotit për mua. Dhe, gjithashtu si shumë prej jush, vendosa t’u bindem atyre fjalëve.”²¹

I shikofshim këta si shembuj për vetë jetën tonë.

Një Premtim dhe një Bekim

Unë premtoj se, kur e dëgjoni zërin e Zotit për ju në mësimet e kësaj konference të përgjithshme dhe më pas veproni sipas atyre nxitjeve, ju do ta ndieni dorën e qiellit mbi ju dhe jeta juaj dhe jeta e njerëzve përreth jush do të bekohen.²²

Gjatë kësaj konference, ne kemi menduar për profetin tonë të dashur. Ne ju duam, Presidenti Monson. Po e mbyll me fjalët e tij të dhëna prej kësaj foltoreje. Besoj se ky është një bekim që ai do të donte t’ia jepte çdonjërit prej nesh sot, nëse do të ishte në gjendje të ishte me ne. Ai tha: “Ndërsa largohemi nga kjo konferencë, i kërkoj bekimet e qiellit mbi secilin prej jush. . . . Lutem që Ati ynë Qiellor do t’ju bekojë ju dhe familjet tuaja. Mesazhet dhe shpirti i kësaj konference gjatshin zbatim në gjithçka që bëni – në shtëpitë tuaja, në punën tuaj, në mbledhjet tuaja dhe në të gjitha aktivitetet tuaja.”

Ai e mbylli: “Unë ju dua. Lutem për ju. Perëndia ju bekoftë. Paqja e Tij e premtuar qoftë me ju tani dhe gjithmonë.”²³

Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih Doktrina e Besëlidhje 21:1.
2. Doktrina e Besëlidhje 21:5–6.
3. Jozef Smithi raportoi se ndodhi sa vijon gjatë përkushtimit të Tempullit të Kirtlandit më 27 mars 1836:

“Pastaj unë mbajta një fjalim të shkurtër dhe u bëra thirrje kuorumeve të ndryshme dhe gjithë kongregacionit të shenjtoreve, që të praninin Presidencinë [e Parë] si Profetë e Shikues dhe t’i mbështetnin ata me anë të lutjeve të tyre. Ata të gjithë u besëlidhën ta bënin këtë, duke u ngritur.

Pastaj unë u bëra thirrje kuorumeve dhe kongregacionit të shenjtoreve që të praninin të Dymbëdhjetë Apostujt, që qenë të pranishëm, si Profetë, Shikues, Zbulues dhe dëshmitarë të veçantë për të gjitha kombet e tokës, që mbajnë çelësat e mbretërisë, për ta shlycur atë, ose për të bërë që kjo të kryhet, ndër ta, dhe që t’i mbështetnin ata me anë të lutjeve të tyre, gjë të cilën e miratuan duke u ngritur” (*Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* [2009], f. 208–209).

4. Doktrina e Besëlidhje 68:4.

5. Doktrina e Besëlidhje 1:38.

6. Presidenti Henri B. Ajring njëherë tha:

“Por zgjedhja për të mos e zbatuar këshillën profetike e ndryshon vetë terrenin mbi të cilin qëndrojmë. Ai bëhet më i rezikshëm. Mospranimi i këshillës profetike zvogëlon fuqinë tonë për të marrë këshillë të frymëzuar në të ardhmen. Rasti më i mirë për të vendosur që Noeu të ndihmohej për të ndërtuar arkën, ishte kur ai kërkoi ndihmë për herë të parë. Çdo herë që ai kërkoi ndihmë pas kësaj, çdo dëshitim për t’u përgjigjur, do ta zvogëlonte ndjeshmërinë ndaj Shpirtit. Kështu që çdo herë që ai kërkonte ndihmë, do të ishte dukur më e pamend, derisa erdhi shiu. Por atëherë ishte tepër vonë.

Çdo herë në jetën time, kur kam zgjedhur ta vonoj ndjekjen e këshillës së frymëzuar apo kur kam vendosur se bëja përjashtim, unë arrita të kujtoj se e kisha vënë veten në rrezik. Çdo herë që ia kam vënë veshin këshillës së profetëve, që e kam ndier të më pohohej në lutje dhe më pas e ndoqa atë, unë kam zbuluar se po ecja drejt sigurisë” (“Finding Safety in Counsel”, *Ensign*, maj 1997, f. 25).

7. Shih Neil L. Andersen, “Teaching Our Children to Love the Prophets”, *Ensign*, prill 1996, f. 47.

8. Bojd K. Paker dikur tha:

“E dëgjova Presidentin Harold B. Li t’i fillonte shumë shpallje rreth çështjeve që përfshinin zbulësë, me një shprehje të tillë si kjo: ‘Në orët e para të mëngjesit, teksa po përsiatja mbi atë çështje. . . .’ Ai e bëri zakon që të punonte në orët e freskëta, të vëmendshme herët në mëngjes me problemet që kërkonin zbulësë.

Zoti dinte diçka kur Ai dha këshillën në Doktrina e Besëlidhje: ‘Pushoni së fjeturi më gjatë se ç’është e nevojshme;

shkoni në shtrat herët, që të mos jini të lodhur; ngrihuni herët, që trupat tuaja dhe mendjet tuaja të mund të fuqizohen.’ (DeB 88:124.) . . .

E kam mësuar fuqinë e thënies: ‘Herët në shtrat, herët të ngrihesh’. Kur jam nën trysni, nuk do të më gjeni duke harxhuar dritën në mesnatë. Do të dëshiroja më shumë të isha në shtrat dhe të çohesha në orët e para të mëngjesit, kur mund të jem pranë Atij që e udhërrëfen këtë punë” (*Teach Ye Diligently* [2005], f. 244–245).

9. Nil L. Andersen, “Ju Dini Mjafuëshëm”, *Liahona*, nëntor 2008, f. 13.

10. Tomas S. Monson, “Kur Prapë të Takohe mi”, *Liahona*, maj 2014, f. 115.

11. Tomas S. Monson, “Perëndia me Ju Qoftë kur Prapë të Takohe mi”, *Liahona*, nëntor 2012, f. 110.

12. Gjoni 10:4.

13. Henri B. Ajring, “Mos Kini Frikë të Bëni Mirë”, *Liahona*, nëntor 2017, f. 103.

14. Diter F. Uhtdorf, “Dëshirim për Shtëpinë”, *Liahona*, nëntor 2017, f. 22, 24.

15. Rasëll M. Nelson, “Libri i Mormonit: Si do të Ishte Jeta Juaj pa Të?” *Liahona*, nëntor 2017, f. 62.

16. Dallin H. Ouks, “Plani dhe Proklamata”, *Liahona*, nëntor 2017, f. 31.

17. M. Rasëll Ballard, “Udhëtimi i Vështirë Vazhdon!” *Liahona*, nëntor 2017, f. 106.

18. Spencer J. Condie, *Russell M. Nelson: Father, Surgeon, Apostle* (2003), f. 215.

19. Spencer J. Condie, *Russell M. Nelson*, f. 215.

20. Rasëll M. Nelson, “Libri i Mormonit: Si do të Ishte Jeta Juaj pa Të?” f. 61.

21. Henri B. Ajring, “Mos Kini Frikë të Bëni Mirë”, f. 100.

22. Gordon B. Hinkli dikur tha:

“Prova do të vijë me zbatimin e mësimet të dhëna. Këtë e tutje, nëse jemi pak më dashamirës, nëse jemi pak më të mirësjellshëm, nëse jemi afruar më pranë Shpëtimtarit, me një vendosmëri më të qëndrueshme për t’i ndjekur mësimet e Tij dhe shembullin e Tij, atëherë kjo konferencë do të ketë qenë një sukses i mrekullueshëm. Nëse, nga ana tjetër, nuk ka përmirësim në jetën tonë, atëherë ata që kanë folur, do të kenë dështuar në një përmasë të madhe.

Ato ndryshime mund të mos jenë të matshme brenda një dite apo një jave apo një muaji. Vendimet merren shpejt dhe harrohen shpejt. Por, pas një viti prej sot, nëse po veprojmë më mirë sesa kemi bërë në të shkuarën, atëherë përpjekjet e këtyre ditëve nuk do të jenë të kota” (“An Humble and a Contrite Heart”, *Ensign*, nëntor 2000, f. 88)

23. Tomas S. Monson, “Një Fjalë në Mbyllje”, *Liahona*, maj 2010, f. 113.

Lista vijuese e përvojave të përzgjedhura, të treguara gjatë konferencës së përgjithshme, mund të përdoret për studim vetjak, mbrëmje familjare dhe mësimdhënie tjetër. Numri i referohet faqes së parë të bisedës.

Folësi	Ngjarja
Hoze L. Alonso	(119) Nipi i Hoze L. Alonsos vë në dyshim dashurinë e gjyshes së tij për të. Prindërit, djali i të cilëve vdiq në një aksident, e heqin barrën e tyre nëpërmjet faljes.
Nil L. Andersen	(122) Fryma e Shenjtë e ndihmon një vajzë të re të pranojë një propozim për martesë. Rasëll M. Nelsoni e bekon popullin kinez, sepse ai e ndoqi këshillën profetike.
Jan S. Ardern	(117) Një peshkatar merr një dëshmi për Librin e Mormonit kur ishte në det.
M. Rasëll Ballard	(104) Pionierja shenjtore e ditëve të mëvonshme, Xhejn Mening Xhejmsi, qëndron besnike pavarësisht nga sfidat. Stërgjyshërit e M. Rasëll Ballardit shërbejnë me besnikëri për dekada.
Xhin B. Bingham	(85) Xhin B. Binghami e mëson përmendsh dokumentin "Krishti i Gjallë". Një motër kroate udhëton për në tempull për t'u vulosur me bashkëshortin dhe prindërit e vdekur.
Ted R. Kelister	(107) Një mik i Ted R. Kelisterit kthehet në Kishë pas marrjes së një dëshmie për Kishën dhe Librin e Mormonit.
D. Tod Kristoferson	(36) Një president misioni pendohet dhe e ndryshon zemrën pas një ëndrre.
Kuentin L. Kuk	(51) Hibër C. Kimballi ndërmerr një mision në Angli. Gjatë takimit me Tomas B. Marshin, Jozef Smithi merr si zbulësë seksionin e 112-të të Doktrinës e Besëlidhjeve.
Stenli G. Ellis	(112) Një baba dhe një nënë i forcojnë fëmijët e tyre duke mos i ndihmuar ata financiarisht pas mbarimit të shkollës së mesme.
Sheron Iubank	(6) Një grua e ndryshon drejtimin e familjes së saj duke u penduar. Një zinxhir njerëzor shpëton notarët e rrëmbyer nga një rrymë bregu. Vajzat e reja i dërgojnë sms një vajze që po zhvendosej në lagjen e tyre.
Dejvid F. Evans	(68) I riu Dejvid F. Evans gjen përgjigje ndaj pyetjeve të ungjillit dhe fiton një dëshmi për Librin e Mormonit. Një grua fiton një dëshmi për ordinancat e tempullit.
Henri B. Ajring	(81) Një sekretar i kuorumit të dhjakëve e fton një djalë më pak aktiv për të ardhur në Kishë. Një i ri në moshë madhore lutet që peshkopi Henri B. Ajring të frymëzohet për t'i dhënë atij këshillë. Brigam Jangu dëshmon për thirrjen profetike të Jozef Smithit. (100) Henri B. Ajringu bekohet për bindjen ndaj këshillës së Presidentit Monson për ta studiuar Librin e Mormonit. Shenjtorët e ditëve të mëvonshme ndihmojnë viktimat e fatkeqësisë natyrore.
O. Vinsent Halek	(58) Një çift të moshuarish bën sakrificë për t'u bashkuar me Kishën. Një kryetar samoas e hap fshatin e tij për ungjillin. Shenjtorët samoas japin prej "skamjes" së tyre për të ndërtuar një tempull.
Donald L. Hallstrom	(88) Një anëtar i Kishës në Kaliforni i mbijeton rënies nga një shkëmb. Dejvid A. Bednari pyet një të ri nëse ai ka besim "edhe kur nuk shërohet".
Xhefri R. Holland	(40) Në një tregim nga Leon Tolstoi, një prift i papërkryer e mbron shtegun që ai e ndjek papërsosurisht.
Xhoi D. Xhons	(13) Fryma e Shenjtë u konfirmon tri grave vlerën e tyre hyjnore si bija të Perëndisë.
Soni L. Koh	(110) Soni L. Koh "ndihet një" me një tifoz futbolli brazilian. Babai i Soni L. Kohut vendos "të qëndrojnë një" me bashkëshenjtorët, pavarësisht talljes ndaj tij.
Nil F. Mariot	(10) Djemtë e Fillores i tregojnë një anëtarit të vetmuar të klasës arsye përse ai është i veçantë. Nil F. Marioti lutet për ndihmë për të dashur një të afërme "të vështirë".
Riçard J. Meinis	(75) Riçard J. Meinisi mëson nga babai që kurrë të mos ta cenonte integritetin e tij moral.
Rasëll M. Nelson	(60) Rasëll M. Nelsoni i paraqit një Libër të Mormonit një mbreti të një fisi afrikan. Rasëll M. Nelsoni ndjek këshillën e Presidentit Monson për ta studiuar Librin e Mormonit. Si kirurg, Rasëll M. Nelsoni dëshiron shumë t'u mësojë pjesëtarëve të familjeve në hidhërim se vdekja është pjesë e ekzistencës sonë të pavdekshme.
Boni L. Oskarson	(25) Një vajzë 10 vjeçe dhe një djalë 17 vjeç kërkojnë mënyra për t'u shërbyer pjesëtarëve të familjes. Një presidente e Shoqatës së Ndhmës merr një mbresë për t'iu shërbyer fqinjëve të saj.
Stiven W. Ouen	(48) Stiven W. Oueni kupton se misionarët e rinj "kanë përjetuar besim deri në pendim". Një misionar i kthyer punon për ta mbajtur vetveten "në udhën e drejtë".
Adilson de Paula Parreja	(115) Misionarët i japin mësim familjes Parreja që ata mund të jenë bashkë përgjithmonë. Kur ishte student kolegji, Adilson de Paula Parreja ndjek këshillën profetike për të gjetur bashkëshorte.
Xhon C. Pingri i Ri	(32) Një anëtar i Kishës nga Nepali u shërben refugjatëve nepalezë në Jutë dhe ndihmon për përkthimin e Librit të Mormonit në nepalisht. Fryma e Shenjtë e ndihmon Xhon C. Pingri të Riun të kuptojë qëllimin e "detyrave hyjnore". Zoti punon nëpërmjet dhuratave shpirtërore dhe sprovave për t'i bekuar fëmijët e Tij.
Ronald A. Rasband	(55) Mbesa e Ronald A. Rasbandit gëzohet nga një takim emocional me vëllanë e saj gjatë misionit të tij. Ronald A. Rasbandi takon një motër misionare në Sheshin e Tempullit, të cilën ai e ndihmoi duke e sjellë në Kishë.
Dejll G. Renland	(64) Dejll G. Renlandi gëzohet për rivendosjen e bekimeve priftërore të një të riu.
Geri E. Stivenson	(44) Shenjtorët festojnë ditëlindjen e Presidentit Monson. Një eklips diellor në Shtetet e Bashkuara magjepsi miliona njerëz.
Diter F. Uhtdorf	(21) Një qen i humbur ecën 3220 km për t'u kthyer në shtëpi. Udhëheqës të hershëm të Kishës bëhen realë për Diter F. Uhtdorf gjatë një vizite familjare në vendet historike të Kishës.
W. Kristofer Uadell	(94) Pushmet e familjes Uadell nuk realizohen ashtu si ishin planifikuar. Një shenjtor i ditëve të mëvonshme i verbuar gjatë Luftës II Botërore lë pas një trashëgimi besimi, shërbimi dhe mirëbesimi të Zotit.
W. Krejg Zuik	(97) Fryma e Shenjtë e ndihmon W. Krejg Zuikun të kuptojë nevojat e një misionari analfabet. Përqendrimi te Shpëtimtari i një biri përpara vdekjes, e ndihmon familjen e tij të mendojë me gëzim për jetën tjetër. Një bashkëshorte mbushet me dashuri pasi heq dorë nga ndjenjat e saj negative ndaj bashkëshortit të saj.



Plaku Huan A. Uceda

Presidenca e Të Shtatëdhjetëve

Teksa ngjitej për te rrënojat e Maçu-Piçut në Peru, kur ishte misionar i ri, Plaku Huan A. Uceda rrëshqiti nga shtegu i ngushtë. I kapur me dëshpërim te disa degë dhe i varur 610 metra mbi një lumë, ai u lut fuqimisht për ndihmë. Më herët atë ditë, ishte lutur me buzë, tha ai, por, “kur ish[te] gati të vdis[te], u lut . . . me zemër”. Pikërisht ndërsa ishte gati duke rënë, një misionar tjetër e tërhoqi drejt sigurisë.

Një nga mësimet e shumta, tha ai, që i mësoi atë ditë, ishte që “gjithmonë, gjithmonë, të lutej[] ‘me një zemër të singertë, me qëllim të vërtetë duke [ushtruar] besim në Krisht’ (Moroni 10:4)”.

Plaku Uceda u mbështet si një Autoritet i Përgjithshëm I Shtatëdhjetë më 3 prill 2010. Ai po shërbente si Ndihmësdrejtor Ekzekutiv në Sektorin e Misionarëve dhe si Ndihmës Zone në Zonën Juglindore të Amerikës Veriore kur u thirr në Presidencën e Të Shtatëdhjetëve më 1 gusht 2017.

Nga viti 2010 deri në 2013, ai shërbeu si këshilltar në Presidencën e Zonës Veriperëndimore të Amerikës së Jugut dhe nga viti 2013 deri në 2016 si President i Zonës Veriperëndimore të Amerikës së Jugut.

Plaku Uceda u arsimua në Peru. Ai u regjistrua në Institutin “Hose Karlos Mariategui” në Lima, ku studioi për financë dhe marrëdhënie publike. Gjithashtu studioi administrim biznesi në Institutin Sentro Andino de G.E. Ai u diplomua në Universitetin “San Luis Gonsaga”, ku iu dha një diplomë universitare në marrëdhëniet publike.

Plaku Uceda punoi në Sistemin Arsimor të Kishës si drejtor zone për Perunë dhe Bolivinë. Ai u largua nga Peruja në vitin 2003 dhe u shpërngul për në Nju-Xhersi të SHBA-së, për të ndihmuar të atin në biznesin e familjes.

Që kur u bashkua me Kishën në vitin 1972, Plaku Uceda ka shërbyer në thirrje të shumta, përfshirë si misionar kohëplotë në Misionin e Limës në Peru, në presidencën e Shkollës të së Dielës të kunjit, peshkop, këshilltar i lartë, këshilltar në një presidencë kunj, president kunj, president i Misionit të Limës, Peruja Veriore (1992–1995) dhe si I Shtatëdhjetë Zonal.

Ai u martua me Maria Isabel Bendesun në mars të 1979-s. Ata janë prindërit e pesë fëmijëve. ■



Plaku Patrik Kiëron

Presidenca e Të Shtatëdhjetëve

Teksa shërbente si President i Zonës së Europës, Plaku Patrik Kiëron ishte dëshmitar i udhëtimit të dy milionë refugjatëve nga Lindja e Mesme e rrënuar nga lufta drejt sigurisë në Europë. “Pasi i pashë në sy dhe i dëgjova historitë e tyre, si të terrorit prej të cilit u arratisën, edhe të udhëtimit të rrezikshëm për të gjetur strehim, unë nuk do të jem më kurrë i njëjti”, tha ai. “Ka qenë frymëzuese të shihja se çfarë kanë dhuruar bujarisht anëtarët e Kishës nga e gjithë bota, për t’i ndihmuar këta individë dhe familje, të cilët kanë humbur kaq shumë.”

Plaku Kiëron, i cili u mbështet si Autoritet i Përgjithshëm I Shtatëdhjetë më 3 prill 2010, u thirr në Presidencën e Të Shtatëdhjetëve më 1 gusht 2017.

Plaku Kiëron u lind në Karlajll, në Kamberland të Anglisë, në korrik 1961, nga prindërit Padi dhe Patricia Kiëron. Meqë babai shërbente në Forcën Ajrore Mbretërore Britanike, Plaku Kiëron u edukua në Lindjen e Mesme dhe në Mbretërinë e Bashkuar.

Ndërkohë që ishte kërkues në Kishë, ai hasi në një shkrim në Librin e Mormonit që thotë: “Njerëzit janë, që ata të mund të kenë gëzim” (2 Nefi 2:25). “Ai shkrim më kumboi në veshë”, thotë Plaku Kiëron. “Në ato që kisha ndeshur, unë kisha parë se jeta jonë mund të pasurohet pa masë duke ndjekur këshillën e Shpëtimtarit për të qenë të gëzuar.” Ai u bashkua me Kishën në pragun e Krishtlindjes së vitit 1987.

Ai u takua me Xhenifer Kerëll Hjulmin kur ajo studioje në Angli me programin e Universitetit “Brigam Jang”. Ata u martuan në Tempullin e Oklandit në Kaliforni në 1991 dhe jetuan në Angli deri në thirrjen e tij në 2010-ën. Ata janë prindër të katër fëmijëve.

Ai ka jetuar e punuar në Mbretërinë e Bashkuar, Arabinë Saudite dhe Shtetet e Bashkuara në industri të ndryshme, përfshirë kujdesin shëndetësor, ushqimin, transportin, automjetet dhe drejtoi kompaninë e vet të konsultimit për komunikacionet. Angazhimi i tij qytetar dhe komunitar ka përfshirë shërbimin në borde të organizatave bamirëse, të një shkolle, të një agjencie sipërmarrjeje dhe të një kolegji.

Plaku Kiëron ka shërbyer në thirrje të shumta në Kishë, përfshirë thirrjen si ndihmësnëpunës i lagjes, president i Të Rinjve të lagjes, këshilltar në peshkopatë, president dege, president kunj dhe si I Shtatëdhjetë Zonal. ■

Ndihmë në Kohë Vështirësie

Pas një uragani dhe përmbytjes së rëndë në Hjuston, në Teksas të SHBA-së, një grua e moshuar vështroi shenjtore të ditëve të mëvonshme, të veshur me bluzat e verdha të Duarve Ndihmëtare, në udhë e sipër që të ndihmonin viktimat e shkatërrimit. “E dija që mormonët do të vinin!” tha ajo.

Kjo ngjarje, e raportuar si njoftim në Facebook nga presidenti i Misionit të Hjustonit në Teksasin Jugor, Aaron T. Holli, tregon se si Kisha u vjen në ndihmë si anëtarëve, ashtu edhe fqinjëve gjatë kohëve të vështirësisë. “Nuk ka sfidë tepër të madhe për anëtarët e Kishës së Zotit!” shkroi Presidenti Holl.

Kur fatkeqësia natyrore ndodh, Kisha është shpesh mes të parëve që përgjigjen, dhe, në zonat e ndikuara, ndihma humanitare e Kishës shpesh vazhdon gjatë rindërtimit si afatshkurtër ashtu edhe afatgjatë, me synimin e krijimit të mbështetjes te vetja. Udhëheqësit vendorë bashkëpunojnë me zyrat qendrore të Kishës për vlerësimin dhe sigurimin e nevojave dhe për organizimin e anëtarëve që të ndihmojnë për shpërndarjen e burimeve, pastrimin, riparimin dhe rindërtimin.

Nëpërmjet LDS Charities [Organizata Bamirëse SHDM] dhe duke bashkëpunuar me agjenci ndihme të ngritura në zonat e dëmtuara, kohët e fundit Kisha ka siguruar ndihmë për viktimat e përmbytjes në Peru; të rrëshqitjeve të dheut në Sierra-Leone; të zjarreve të mëdha në Montana të SHBA-së dhe Alberta të Kanadasë; të uraganeve në Teksas, Florida dhe ishujt e Karaibeve, përfshirë Porto-Rikon, Haitin dhe Republikën Domenikane; dhe të dy tërmeteve të fuqishme në Meksikë.

Në shtator, Kisha shpalli se do të jepte 11 milionë dollarë amerikanë që të përkrahen projektet e ndihmës ndaj zisë së bukës dhe të ushqehen fëmijë të kequshqyer në tetë vende në Afrikë dhe në Lindjen e Mesme. LDS Charities [Organizata Bamirëse SHDM] po bashkëpunon me 11 organizata në 25 projekte për ta shpërndarë ndihmën.

LDS Charities [Organizata Bamirëse SHDM] ka dhënë gati 2 miliardë dollarë për të ndihmuar miliona njerëz në 189 vende që nga viti 1985, duke filluar me ndihmën e dhënë për viktimat e zisë së bukës në Etiopi. ■

Ata që dëshirojnë të dhurojnë në Fondin e Ndihmës Humanitare të Kishës, mund ta bëjnë këtë gjë në fletën e tyre të së dhjetës.

Përkushtohen Tre Tempuj

Që nga Konferenca e Përgjithshme e Prillit 2017, janë përkushtuar ose ripërkushtuar tre tempuj. Tempulli i Parisit në Francë u përkushtua në maj, Tempulli i Ajdaho-Follsit në Ajdaho (SHBA) në qershor dhe Tempulli i Tusonit në Arizonë (SHBA) në gusht.

Tempulli i Meridianit në Ajdaho (SHBA) do të përkushtohet më 19 nëntor 2017; Tempulli i Sidër-Sitit në Jutë (SHBA) më 10 dhjetor; dhe Tempulli i Xhordan-Riverit në Jutë (SHBA) do të ripërkushtohet më 20 maj 2018.

Plane janë shpallur, ose përgatitja dhe ndërtimi vazhdojnë, për 23 tempuj anekënd botës. Gjashtë tempuj janë tani të mbyllur për restaurim dhe pesë tempuj janë planifikuar të mbyllen për restaurim në vitin 2018. ■

Gjeni përditësimet dhe informacionin në temples.lds.org.



Profetët dhe Apostujt Japin Shërbesë në Mbarë Botën

Profetët dhe apostujt thirren si “dëshmitarët e veçantë të emrit të Krishtit në gjithë botën” (DeB 107:23). Ja disa prej veprimtarive të tyre që nga konferenca e përgjithshme e prillit.

Presidenti Tomas S. Monson e kremtoi qetësisht ditëlindjen e tij të 90-të në **Jutë të SHBA-së**, më 21 gusht. Ai ritheksoi një dëshirë për ditëlindjen, të cilën e ka shprehur më parë, se dhurata më e mirë që ai mund të merrte, do të ishte për njerëzit që të “gjeljnë] dikë që po kalon një kohë të vështirë, apo që është i sëmurë, apo i vetmuar dhe [të bëjnë] diçka për të”.

Në Hamilton të **Zelandës së Re**, Presidenti Henri B. Ajring përkushtoi godinat e Tempëll-Viuit, më parë i njohur si kompleksi universitar i Kolegjit Kishtar të Zelandës së Re. Pas uraganit Irma, ai vizitoi **Porto-Rikon, San-Tomasin** dhe vullnetarë të Kishës që po ndihmonin në përpjekjet për pastrim në **Floridë të SHBA-së**.

Presidenti Diter F. Uhtdorf vizitoi **Teksasin në SHBA**, pa ekupe shenjtorësh të ditëve të mëvonshme në Hjuston duke punuar përkrah fqinjëve të tyre pas uraganit Harvi dhe tha se sjellja “ndihmo-sido-që-të-mundesh” është e zakonshme për shenjtorët e ditëve të mëvonshme anembanë botës.

Presidenti Rasëll M. Nelson i paraqiti guvernatorit të **Nebraskës në SHBA** një vëllim të historisë familjare, vizitoi udhëheqës e misionarë në **Nju-Jork të SHBA-së** dhe u tha studentëve të institutit në **Jutë** që Bibla është “e mbushur me profeci rreth . . . Rivendosjes”.

Pasi vizitoi anëtarë në **Japoni** dhe **Kore**, Plaku Dallin H. Ouks tha: “Zoti kujdeset për fëmijët e Tij. Ai i di rrethanat dhe shqetësimet e tyre dhe

është i hirshëm në dashurinë e Tij.” Në veprimtarinë Ballë për Ballë në Kore, ai iu përgjigj pyetjeve nga rinia. Ai u takua me ministrin e ngarkuar për Lojërat Olimpikë të Tokios në 2020-ën. Dhe me kërkesën e presidentit të **Perusë**, Plaku Ouks e takoi që të merrte falënderimet e presidentit për ndihmën e Kishës gjatë përmbytjeve.

Në **Jutë**, Plaku Ballard i nxiti të rinjtë në moshë madhore beqarë që ta respektojnë Shabatin si “një kohë të mrekullueshme dhe të lavdishme” dhe të studiojnë parimet e doktrinat themelore të Kishës. Ai u tha punonjësve të tempullit se tempujt e ndërtuar tani do të përdoren gjithashtu gjatë Mijëvjeçarit. Së bashku me Plakun Ronald A. Rasband, ai vizitoi **Teksasin** për t’u dhënë nxitje vullnetarëve që po pastronin shkatërrimin nga uragani dhe përmbytja.

Plaku Robert D. Hejls mori Çmimin e Presidentit për Pionierët e Përparimit 2017 nga një organizatë komunitare në **Jutë**. “Të jemi në gjendje ta ndihmojmë njëri-tjetrin, ta lartësojmë njëri-tjetrin, ta forcojmë njëri-tjetrin është cilësia më e mrekullueshme, mendoj unë, e të qenit një pionier”, tha ai.

Në **Rusi** dhe **Ukrainë**, Plaku Xhefri R. Holland dha mësim se jeta ka për qëllim që të ketë sprovë, por ungjilli siguron këndvështrim, shpresë dhe nxitje. Në **Angli**, në Konferencën e Dytë të Uinsërit mbi Përndjekjen Fetare, ai tha se besimi i ndihmon shumë njerëz që të mëkëmben nga statusi i refugjatit dhe të japin ndihmesë në shoqëri. Pas konferencës, ai u ofroi këshillë anëtarëve të Kishës, presidentëve të misioneve dhe misionarëve në **Portugali** e **Spanjë**.

Plaku Dejvid A. Bednar vizitoi tri kombe të Afrikës Perëndimore,



të pavizituara më parë nga ndonjë Apostull: **Senegalin**, ku ai ofroi lutjen përkushtuese, **Guinenë** dhe **Malin**. Ai gjithashtu u takua me anëtarë në **Nigeri** e **Ganë**. Gjatë një takimi shpirtëror mbarëbotëror, që u nis nga **Karolina e Veriut në SHBA**, ai i nxiti të rinjtë në moshë madhore që të jenë “një hallkë bashkëlidhëse” në zinxhirin e familjes së tyre të përjetshme.

Plaku Kuentin L. Kuk u takua me anëtarë e misionarë në **Tajvan, Hong-Kong, Indi** e **Tajlandë**, duke vënë në dukje se “anëtarët janë të entuziazmuar rreth Kishës, duke u përqendruar tek tempulli dhe puna misionare”. Në **Nju-Xhersi të SHBA-së** ai foli në Seminarin e Institutit Sejmur mbi Lirinë Fetare. “Ne duhet t’i vazhdojmë përpjekjet tona të qëndrueshme dhe jetike për ta shtuar moralshmërinë dhe për t’i mbrojtur familjet”, tha ai. Në **Kaliforni**



Në drejtimin orar, nga e majta lart fare: Presidenti Henri B. Ajring merr pjesë në përkushtimin e Tempëll-Viuit në Zelandën e Re; Presidenti Diter F. Uhtdorf përqafton një vullnetar të vogël të Duarve Ndhimëtare pas uraganit Harvi në Teksas të SHBA-së; Plaku Xhefri R. Holland flet me baroneshën Ema Nikolson në Konferencën e Dytë të Uinsërit mbi Përndjekjen Fetare; Plaku Ronald A. Rasband përshëndet një motër gjatë vizitës së tij në Afrikën e Jugut; Plaku Kristoferson përshëndet nxënëse në shkollën Kamalabai Joshi në Kenjal të Indisë; Plaku Kuentin L. Kuk takohet me anëtarë të Kishës në Tajvan.

të SHBA-së ai i nxiti anëtarët e shoqatës avokatore që të ruajnë besim dhe baraspeshë në jetën e tyre dhe që ta mbrojnë lirinë fetare.

Në **Ekuador** e **Kolumbi**, Plaku D. Tod Kristoferson dha mesim se besimi në Ringjalljen e Krishtit do të na ngushëllojë dhe mbështetë. Në **Indi**, ai pranoi një Çmim për Paqen Botërore në emër të Kishës dhe u paraqiti kopje të Librit të Mormonit në nepalishte presidentit dhe zëvendëspresidentit të **Nepalit**, si edhe degës së Katmandusë.

Muaj përpara uraganeve dhe përmbytjeve, Plaku Nil A. Andersen vizitoi **Porto-Rikon, Haitin** dhe **Republikën Domenikane**, ku foli rreth mbështetjes te vetja, arsimimit dhe përgatitjes për të marrë bekimet e tempullit. Natën e Edukimit Familjar SHDM në Universitetin Shtetëror të Arizonës në **Arizonë të SHBA-së**, ai i nxiti shenjtorët e ditëve

të mëvonshme që t'i "hapim dyert tona, t'i vlerësojmë bindjet e të tjerëve [dhe] të mësojmë më shumë rreth tyre". Plaku Andersen krijoi kunjën e 100-të në **Filipine** dhe përkushtoi qendrën e zgjeruar të trajnimit të misionarëve në Manila.

Në **Afrikën e Jugut** dhe në **Republikën Demokratike të Kongos**, Plaku Ronald A. Rasband vuri në dukje se, me tre tempuj në funksionim në Afrikë dhe pesë të tjerë që po ndërtohen ose janë njoftuar, "Zoti po i përgatit popujt afrikanë që t'i marrin të gjitha bekimet e Tij".

Plaku Geri E. Stivenson vizitoi **Vanuatun, Australinë, Zelandën e Re, Polinezinë Franceze** dhe Universitetin "Brigam Jang" – Havai në **Havai të SHBA-së**. "Kur . . . i shohim sfidat tona nëpërmjet lenteve të ungjillit, ne do të gjejmë përgjigje të cilat na sjellin lumturi dhe gëzim", tha ai. Ai u takua me

presidentin dhe kryeministrin e Vanuatut dhe arqipeshkvin e Papitit në Tahiti.

Plaku Dejl G. Renland vizitoi pesë vende në qershor: **Guatemalën, Kosta-Rikën, El-Salvadorin, Nikaraguën** dhe **Hondurasin**, ku organizoi kunjën e parë në gjuhën kekçi në Guatemala dhe mori pjesë në një konferencë për liritë fetare dhe në një konferencë të rinisë. Në gusht, ai dhe bashkëshortja e tij, Motra Ruth L. Renland, morën pjesë në mbrëmjen e parë Ballë për Ballë të nisur nga **Akra në Ganë** dhe në shtator ai i nxiti studentët e Universitetit "Brigam Jang" – Ajdaho në **Ajdaho të SHBA-së** që të mbështeten te doktrina e Krishtit. ■

Informacion i përditësuar mbi shërbesën e këtyre udhëheqësve të Kishës mund të gjendet në faqet e tyre përkatëse në Facebook dhe në prophets.lds.org.

Burime për Njerëzit që Kanë Probleme me Dëgjimin

“Për t’iu ardhur në ndihmë anëtarëve që kanë probleme me dëgjimin, në tempuj dhe në shtëpitë e mbledhjeve janë në dispozicion teknologji të siguruara nga Kisha”, thotë një njoftim dërguar udhëheqësve anembanë botës më 14 shtator 2017. “Udhëheqësit duhet t’i njohin këto teknologji dhe të sigurohen që të gjithë ata që mund të përfitojnë prej tyre, të jenë në dijeni për to dhe të kenë të drejtë përdorimi të pajisjeve.”

Në tempuj, anëtarët që kanë probleme me dëgjimin, mund të kërkojnë kufje të cilat përdorin një sistem me teknologji rrezesh infra të kuqe që përhapet brenda tempullit. Në shtëpitë e mbledhjeve, anëtarët mund të përdorin një sistem me frekuencë radioje ose nëpërmjet 1) marrësve ndihmues për dëgjimin me frekuencë radioje (RF), aparate xhepi që përdorin sistemin zanor të godinës kishtarë ose të sallës kulturore për t’i ngritur zërin tingullit në kufje, ose me 2) varëset kabllorë me sistemin ndihmues për dëgjimin (ALS) që e transmetojnë tingullin drejtpërsëdrejti te një pajisje vetjake ndihmëse për dëgjimin që ka një marrës sinjali.

Njoftimi më tej udhëzon se “lagjet dhe degët duhet të kenë marrës [RF] dhe varëse kabllorë [ALS] të shumta. Sipas nevojës, mund të kërkojnë aparate të tjera nëpërmjet përfaqësuesit të godinave fizike të kungjit.” ■

Në adresën mhtech.lds.org është në dispozicion më tepër informacion rreth sistemeve ndihmuese për dëgjimin. Për më tepër informacion rreth humbjes së dëgjimit, shurdimit dhe gjuhës së shenjave, shihni disabilities.lds.org.

Përkthime të Reja të Shkrimeve të Shenjta

Projekte të reja të përkthimit të shkrimeve të shenjta, të miratuara gjatë disa viteve të fundit, përfshijnë Librin e Mormonit në birmanisht, efikisht, gjeorgjisht, navahoisht, ponpeianisht, sesotoisht e tshilubaisht dhe përkthimin e kombinimit tresh të shkrimeve të shenjta në gjuhën afrikane, amerikane të shenjave, amharike, arabisht, bislamisht, greqisht, hmongisht, iligajnisht, indisht, jorubaisht, laosianisht, lingalaisht, malajaisht, persisht, polonisht, serbisht, setsuanaisht, sinhalezisht, sllovakisht, slovenisht, tahitisht, tamilisht, teluguisht, tok-pisinisht, turqisht, tuisht dhe urduisht.

Në një letër të datës 9 tetor 2017, Presidenca e Parë i renditi këto projekte dhe paraqiti një proces të ri që do t’i lejojë individët të studiojnë pjesë paraprake të përkthimeve përpara botimit të përkthimeve përfundimtare.

“Ndërkohë që përkthimet përparojnë, pjesë të përfunduara mund të botohen me radhë, herë pas here”, thotë letra. “Këto pjesë të njëpasnjëshme, edhe pse nuk konsiderohen përfundimtare derisa të përfundohet përkthimi i plotë, do të vihen në dispozicion te LDS.org dhe në programin kompjuterik Gospel Library [Biblioteka e Ungjillit].” Ky botim fillestar për disa gjuhë të përzgjedhura do të fillojë më 30 nëntor 2017. Kur përkthimet të përfundohen, me rishikimet dhe miratimet e nevojshme, pjesët e njëpasnjëshme, të botuara më herët do të zëvendësohen nga variantet përfundimtare, me botimet e shtypura që do të pasojnë.

Projektet e përkthimeve kërkojnë disa vjet pasi tekstet e shkrimeve të shenjta përkthehen me kujdes. Si rrjedhim, projektet janë tani në faza të ndryshme. Botimi fillestar i përkthimeve paraprake



të miratuara do të përfshijë përmbajtjen që është përkthyer dhe rishikuar nga udhëheqësit vendorë. Pjesët shtesë të përkthimeve do të vazhdojnë të botohen herë pas here. Për përkthimet që janë tashmë afër përfundimit, nuk do të botohen përkthime paraprake.

Presidenca e Parë kërkon që, ndërsa projektet e përkthimit janë në vazhdim e sipër ose të mbetura pezull, anëtarët dhe udhëheqësit të “vazhdojnë të përdorin përkthimet e tanishme të Neneve të Besimit, lutjeve të sakramentit dhe lutjes së pagëzimit derisa të përfundohen përkthimet e reja”.

Botimet SHDM të shkrimeve të shenjta janë përkthyer dhe në dispozicion në numrin vijues të gjuhëve: Bibla e Shenjtë, 3; botime të parapëlqyera jo-shdm të Biblës së Shenjtë, 95; Libri i Mormonit, 90; Përzgjedhje nga Libri i Mormonit, 21; dhe Doktrina e Besëlidhje dhe Perla me Vlerë të Madhe, 58. ■

Qendrat e Trajnimit të Misionarëve

Një qendër e re e trajnimit të misionarëve në Akra të Ganës dhe një qendër e zgjeruar e trajnimit të misionarëve në Provo të Jutës në SHBA, e shprehin rëndësinë e vazhdueshme të shërbimit misionar.

QTM-ja e sapombaruar në Ganë, ngjitur me tempullin e Akrës në Ganë, ka vendqëndrim për 320 misionarë dhe ka vend edhe për t'u shtuar. Godina më e madhe siguron vendqëndrim për misionarët që nisen nga Afrika perëndimore dhe juglindore, si edhe për misionarët nga e gjithë bota që janë thirrur të shërbejnë në Afrikë. Godinat e reja e bëjnë më të lehtë për misionarët që të mësojnë në gjuhën e tyre amtare – anglisht ose frëngjisht – dhe të mësojnë gjuhën dhe kulturën e zonës ku janë caktuar të punojnë.

Zgjerimi i QTM-së në Filipine e dyfishon kapacitetin e saj deri në 280

misionarë. Ai zgjerim përfshin dy godina të reja në një kompleks prej pesë godina, të vendosura përkrah zyrave të Zonës së Filipineve dhe nga ana tjetër e rrugës përballë Tempullit të Manilës në Filipine. Që kur QTM-ja në Filipine u hap në vitin 1983, ajo u ka shërbyer misionarëve që vinin apo shkonin në 60 kombe.

Zgjerimi i QTM-së në Provo përfshin dy godina të reja gjashtëkatëshe me 200 klasa të reja për mësim, më shumë se 100 dhoma për ushtrimin e mësimëve dhe 13 laboratorë kompjuterikë ku misionarët marrin trajnim përpara se të dërgohen në zonat e tyre të caktuara anembanë botës. QTM-ja në Provo ka kapacitetin për të trajnuar njëkohësisht deri në 3700 misionarë të rinj, të reja dhe në moshë.

Kisha ka 15 qendra të trajnimit të misionarëve në vendndodhje të ndryshme në mbarë botën. ■



Një mësues në Qendrën e re të Trajnimit të Misionarëve në Ganë dëgjon teksa misionarët diskutojnë se si ta japin mësim ungjillin.



Motra Bingham në Organizatën e Kombeve të Bashkuara

Duke folur gjatë një diskutimi në një grup me baza fetare rreth integritet të refugjatëve, në Organizatën e Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork-Siti më 13 prill 2017, Presidentja e Përgjithshme e Shoqatës së Ndhmës, Xhin B. Binghami, shprehu shpresë që organizatat me baza fetare “do të punojnë të gjitha së bashku nëpërmjet mjeteve të vogla e të thjeshta që të përmbushin gjëra të jashtëzakonshme”.

Gjatë raportimit vjetor “Përqendrimi të Besimi Fetar”, Motra Bingham diskutoi përpjekjet humanitare të Kishës ndaj refugjatëve dhe shprehu vlerësim të sinqertë për të gjithë ata që përfshihen në “veprën sfiduese, por thellësisht shpërblyese” të lehtësimit të vuajtjes anembanë botës.

Motra Bingham kohët e fundit ishte kthyer nga një vizitë në terren e organizuar nga Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF-i) në Uganda, së bashku me Motrën Sheron lubank, Këshilltare e Parë në Presidencën e Përgjithshme të Shoqatës së Ndhmës dhe drejtoreshë e LDS Charities [Organizatës Bamirëse SHDM]. Motra lubank mori pjesë gjithashtu në mbledhjen e OKB-së në Nju-Jork-Siti. ■

Për më shumë informacion rreth asaj që mund të bëni për t'i ndihmuar refugjatët, shkoni te IWasAStranger.lds.org.

Një Drejtim i Ri për Mbledhjet e Priftërisë Melkizedeke dhe të Shoqatës së Ndihmës

Programi i ri mësimor sjell ndryshime emocionuese në mbledhjet tona të së dielës, të cilat bazohen te manuali Mësimdhënia sipas Mënyrës së Shpëtimtarit. Mbledhja jonë e së dielës së parë do të jetë një kohë për t'u këshilluar së bashku rreth përgjegjësi, mundësi dhe sfidave tona, ndërkohë që bëjmë punën e Zotit. Në të dielat e tjera, në vend të një manuali të ri të Mësimeve të Presidentëve të Kishës, ne do të përqendrohemi te dhënia mësimi dhe mesazheve nga konferenca më e fundit e përgjithshme dhe një temë e përzgjedhur nga udhëheqësit tanë të përgjithshëm të Kishës. Por këto ndryshime nuk janë thjesht temat që do të studiojmë – programi i ri mësimor gjithashtu ndikon te mënyra se si përgatitemi, japim mësim, këshillohemi dhe mësojmë së bashku, si edhe marrim frymëzim dhe veprojme sipas tij. Anëtarë dhe udhëheqës në Meksikë dhe në Jutë, Kaliforni e Xhorxhia në Shtetet e Bashkuara morën pjesë në një provë të materialeve të reja. Ja tek janë disa prej ideve dhe përvojave të tyre:

“Çfarë do të bëj unë pa një manual?” mendoi Nensi Ferageni, një mësuese e Shoqatës së Ndihmës, kur shqyrtoi për herë të parë një kopje të programit *Eja, Më Ndiq – Për Priftërinë Melkizedeke dhe Shoqatën e Ndihmës*. “Fillimisht më zuri paniku”, pranoi ajo. “Më pas më erdhi mendimi: Zoti dëshiron që ne të marrim përsipër më shumë përgjegjësi për vetë të mësuarin tonë dhe ta shtojmë shpirtshmërinë tonë si vëllezër e motra në ungjill.”

“Është pak e frikshme t'i mirëbesosh Zotit dhe të vish e përgatitur që

të udhëheqësh një diskutim pa shumë material”, tha Linda Harmëni, një presidente e Shoqatës së Ndihmës, “por pasi e bën këtë – nëse je përgatitur nëpërmjet lutjes, studimit, vajtjes në tempull dhe çfarëdo gjëje tjetër që frymëzohesh të bësh – është e mahnitshme.”

MËSIMDHËNIA SIPAS MËNYRËS SË SHPËTIMTARIT

“Një sfidë lidhur me programin e ri mësimor është t'i bëjmë njerëzit të mos japin mësim sipas 'mënyrës së vjetër', tha Peshkopi Bojd Roberts. “Ne duhet ta ndalim thjesht përhapjen e

informacionit, të largohemi nga udha dhe ta lëmë Shpirtin të japë mësim.”

“Kjo është një mënyrë e re mësimdhënieje që mund të jetë e vështirë për disa njerëz”, tha Liza Smithi, një presidente e Shoqatës së Ndihmës, duke iu referuar manualit *Mësimdhënia sipas Mënyrës së Shpëtimtarit*. “Kjo është arsyeja përse është e rëndësishme që të përdorim metoda të mira mësimdhënieje dhe t'i nxitim udhëheqësit që t'i frekuentojnë vazhdimisht, së bashku me mësuesit, mbledhjet e këshillit të mësuesve”, tha ajo.

PËRGATITJA DHE MËSIMDHËNIA

Dejvid Mikëlsioni, një mësues i grupit të priftërinjve të lartë, tha se fraza “i mësoni me zell” te Doktrina e Besëlidhje 88:78 “ka të bëjë me përgatitjen tonë që më parë dhe aftësinë tonë për ta ndjekur me zell Shpirtin ndërkohë që japim mësim. Nëse japim mësim me zell, hiri i Shpëtimtarit do të na qëndrojë pranë dhe neve do të na jepet mësim më përsosurisht. Mendoj se ajo është mënyra e përsosur e Zotit për mësimdhënien. Mësuesi – personi që po e udhëheq diskutimin – duhet të jetë i gatshëm që të mësohet nga Shpirti.”

Adam Bushmani, një mësues i kuorumit të pleqve, u përgatit për mësimet duke shqyrtuar bisedën e përzgjedhur të konferencës së përgjithshme [dhe] duke marrë parasysh me lutje më pas se cilat koncepte janë më



të rëndësishmet për kuorumin. “Për t’i ndihmuar burrat që të kenë më shumë kohë për të përsiatur”, shpjegon ai, “një mesazh me postë elektronike dërgohet gjatë javës që thotë: ‘Kjo është biseda që do të diskutojmë, dhe ne do të dëshironim që ju të merrnit parasysh pyetjet vijuese.’”

KËSHILLIMI DHE TË MËSUARIT SË BASHKU

“Të dielat në Shoqatën e Ndihmës nuk janë më thjesht përgjegjësia e udhëheqëseve”, tha Bruk Xhenseni, një këshilltare në një presidencë të Shoqatës së Ndihmës. “Secila anëtare luan një rol aktiv.”

Plaku Bushman mendoi se ulja në një rreth solli ndryshim. “Më pëlqen shumë”, tha ai. “E ndryshon natyrën e bashkëbisedimit. I ndryshon pritshmëritë e njerëzve. Tani ka shumë më tepër pjesëmarrje. Në vend të dy ose tre vëllezërve që zakonisht i përgjigjen pyetjes, po bëjnë komente njerëz të tjerë.”

Kur Rebeka Sibak, një motër e Shoqatës së Ndihmës, fillimisht dëgjoi rreth përqendrimit të ri në këshilla, ajo menjëherë mendoi për mikësia që ishin bërë më pak aktive. “I dija shqetësimet e tyre”, tha ajo. “Ato kishin qenë të çiltra me mua rreth pasigurive dhe vështirësive të tyre për të ardhur në kishë dhe unë mendova se kjo është mundësia e përkryer për t’iu afruar atyre dhe për t’iu thënë: ‘Na nevojiteni në këshillin tonë! Ju lutemi, ejani dhe tregoni!’”

“Kur më së fundi fola gjatë një mbledhjeje të këshillit”, tha Lona-Mëri Kuk, një këshilltare në një presidencë të Shoqatës së Ndihmës, “ishte e mrekullueshme që kishte njerëz të cilët e pohuan atë që po mendoja, dhe që isha pjesë e atij komuniteti.”

MARRJA E FRYMËZIMIT DHE VEPRIMI SIPAS TIJ

“Ne po krijojmë një mjedis për Shpirtin që të na japë mësim, dhe për ne që të dëgjojmë e vëmë vesh”, tha Peshkopi Roberts. “Atëherë Shpirti

bëhet mësuesi, duke na treguar atë që na nevojitet të bëjmë në jetën tonë vetjake, në familjet dhe thirrjet tona. Ajo që bëjmë si rrjedhojë e atyre nxitjeve, është ajo që na çon drejt kthimit të vërtetë në besim dhe shërbimit.”

Suzan Fari, një presidente e Shoqatës së Ndihmës, tha: “Kjo metodë na shtyn të çohemi e të bëjmë, jo thjesht të largohemi nga mësimi duke menduar ‘ai ishte frymëzues’, por më pas shpejt ta harrojmë atë. Këshillimi së bashku na ndihmon ta kuptojmë se të mësuarit dhe veprimet na takojnë neve të gjithave – jo vetëm mësueses.”

“Teksa i mbajmë shënim mbresat tona dhe më pas veprojmë sipas tyre, ne ushtrojmë një ndryshim zemre dhe bëhemi shërbëtorë më të mira të Zotit”, tha Suzan Miçelli, një këshilltare në një presidencë të Shoqatës së Ndihmës.

“Dijenja se do të mbahemi përgjegjëse për diçka dhe se dikush do të na pyesë se si u ndiem”, tha Motra Smith, “të bën një pjesëmarrëse aktive në ndërtimin e dëshmisë tënde.”

Lendën Rondi, një udhëheqës i grupit të priftërinjve të lartë, tha se dërgimi i shënimeve me postë elektronike për atë që u diskutua dhe u planifikua, “i ndihmon anëtarët të dallojnë raste përvoja që i kanë gjatë javës, të cilat mund të dëshirojnë t’i tregojnë të dielën e ardhshme”.

“Nga këto shënime”, shtoi Peshkopi Roberts, “unë kam parë një shpirt të vazhdueshëm të dhënies së ideve dhe të mësuarit gjatë gjithë javës, teksa vëllezërit diskutojnë nëpërmjet postës elektronike mendime dhe ndjenja shtesë, duke e forcuar kuorumin e tyre.”

“Zoti dëshiron që ne t’i kthejmë zemrat tona tek njëra-tjetra dhe kjo mund të bëhet kur mblidhemi me një qëllim”, e përfundoi Motra Sibak. “Ky program i ri mësimor na ndihmon të përcaktojmë tema interesi, të caktojmë synime, të shohim te burimi i duhur për përgjigje, të marrim zbulesë vetjake dhe të lartësohemi nga njëra-tjetra teksa drejtohemi te profetët e gjallë për përgjigjet që na nevojiten në kohën tonë.” ■

SI MUND TË PËRGATITEMI?

Burimet e reja *Eja, Më Ndiq* për mbledhjet e Priftërisë Melkizedeke dhe të Shoqatës së Ndihmës do të përdoren nëpër tërë Kishën duke filluar nga janari 2018. Prandaj çfarë mund të bëjnë njësitë e Kishës që të përgatiten për këtë ndryshim?

- Shpenzoni ca kohë në një këshill të ardhshëm të lagjes duke i shikuar burimet së bashku dhe duke diskutuar atë që mund të jetë e ndryshme. Çfarë përfitimesh do të vijnë?
- Ftojini këshillin e lagjes që të sugjerojë tema për mbledhjet e këshillit të së dielës së parë, të cilat do të ndihmojnë për të plotësuar nevojat e lagjes ose të degës. Udhëheqësit e Priftërisë dhe udhëheqëset e Shoqatës së Ndihmës mund të vendosin se kur dhe se si do t’iu drejtohen organizatat e tyre këtyre nevojave.
- Paraqitini dhe diskutojini burimet e reja gjatë një mbledhjeje të ardhshme të kuorunit, grupit ose Shoqatës së Ndihmës. Çfarë mund të bëjë çdo anëtar që të përgatitet për këto ndryshime?
- Nxitini mësuesit dhe udhëheqësit e priftërisë dhe të Shoqatës së Ndihmës që të frekuentojnë mbledhjet e këshillit të mësuesve që të tregojnë e diskutojnë përvojat, sfidat dhe pyetjet e tyre rreth burimeve të reja.

Një Vështrim i Shpejtë brenda një Mbledhjeje të Këshillit

Është e diel në mëngjes dhe 45 motra të Lagjes Bugambillas në Guadalajara të Meksikës janë të ulura në këshill. Pas himnit të hapjes, presidentja e Shoqatës së Ndihmës, Jara Ramiresi, i fton disa prej tyre që të tregojnë përvoja nga mësimi i tyre i javës së shkuar.

Pasi motrat i tregojnë përvojat e tyre për pak minuta, Motra Ramires shkruan një fjalë të vetme në tabelë përpara se të ulet sërish në vendin e saj në rreth.

“Bashkim”, është fjala.

Nën drejtimin e Motrës Ramires, ato shkojnë te Mosia 18:21 dhe lexojnë: “. . . duke pasur zemrat e tyre të thurura në bashkim dhe në dashuri kundrejt njëri-tjetrit”.

“Çfarë mund të bëjmë ne si Shoqatë e Ndihmës që ta vëmë këtë shkrim të shenjtë në jetë?” pyet ajo.

Motrat mendojnë për pak çaste.

“Epo, të rinjtë e të rejtat nuk mund të shkojnë në tempull”, thotë një motër. “Nuk ka mjaft motra të rritura që të shkojnë me ta.”

“Nuk e dija”, thotë një tjetër, me një pamje të habitur. “Nëse nuk e di se ekziston një nevojë”, pyet ajo, “si mund të ndihmohet?”

“Kjo është arsyeja përse jemi këtu”, përgjigjet Motra Ramires. “Ka nevoja si kjo për të cilat mësoj gjatë këshillit të lagjes dhe për të cilat ne të gjitha mund të ndihmojmë.”

“Përse të mos bëjmë një kalendar?” sugjeron dikush. Tani grupi bëhet më i interesuar. “Mendoj se rinia ka një kohë të caktuar në tempull një të enjte në muaj.”

“Unë e kam të vështirë vetë të shkoj në tempull”, shprehet një nënë e re në grup. “Nuk kam qenë atje prej shumë kohe dhe jam ndier paksa e

përqendruar në vetvete. Do të doja shumë të shkoja e të shërbeja”, thotë ajo.

Disa motra të tjera tundin kokën si shenjë miratimi. Edhe ato e shohin të vështirë ta frekuentojnë tempullin aq shpesh sa duan.

Një tjetër nënë e re sugjeron që të shkëmbejnë mbajtjen e fëmijëve me njëra-tjetrën dhe ta bëjnë me radhë për të shkuar në tempull.

Më pas motrat fillojnë ta pyetin njëra-tjetrën se ku jetojnë dhe kush jeton pranë secilit të riu apo të reje. Ato diskutojnë se si mund ta bëjnë me radhë duke i ndihmuar të rinjtë e të rejtat që të shkojnë te veprimtaritë e tyre.

“Epo, do të kemi nevojë të fillojmë ta njohim edhe njëra-tjetrën”, thotë dikush. “Ne duhet të kemi veprimtari!”

Motrat vazhdojnë të bëjnë komente, të ofrojnë sugjerime dhe të bëjnë pyetje.

Në fund të këshillit, Motra Ramires i kërkon sekretares së vet që ta përmbledhë procesverbalin. “Si u ndiet ju të gjitha gjatë këshillit?” pyet ajo.

Ato përgjigjen se u ndien më të ndërgjegjshme ndaj nevojave të çdonjëres, që shërbimi i tyre ishte i nevojshëm dhe që ato ishin mes shoqesh.

“Bazuar në atë që e kemi përjetuar sot, te cilat veprime të veçanta duam të përqendrohemi këtë muaj si Shoqatë e Ndihmës?” pyet ajo.

Si grup, ato vendosin të hanë një vakt ushqimi së bashku duke sjellë secila diçka atë të diel pas kishës, të fillojnë të luajnë volejball netët e të enjteve, të bëjnë një kalendar për frekuentimin e tempullit dhe të planifikojnë se si t'i ndihmojnë të rinjtë e të rejtat që të shkojnë te veprimtaritë.

“Kemi përjetuar bashkim sot”, përfundon Motra Ramires, duke e ftuar secilën motër të mendojë mënyra se si ajo mund të shërbejë gjatë javës.

“Fryma e Shenjtë do të vazhdojë të na japë nxitje kur veprojmë individualisht dhe si Shoqatë e Ndihmës. Ju ftoj të jeni gati që t'i tregoni përvojat tuaja të dielën e ardhshme.” ■

SUGJERIME PËR MBLEDHJET E KËSHILLIT

- Jini të duruar dhe lejojeni Zotin t'jua mësojë se çfarë do të thotë të këshilloheni së bashku.
- Ka parime që mund t'i mbajmë parasysh: Ndiqeni Shpirtin, jepni mendimet tuaja dhe veproni sipas mbresave.
- Mbajini zemrën dhe mendjen tuaj të hapura ndaj ideve, pikëpamjeve dhe zgjidhjeve të reja.
- Përpara se të mbarojë çdo mbledhje, mendoni rreth asaj që Shpirti ju ka dhënë mësim; më pas vendosni se si do të veproni sipas nxitjeve të Tij.




Motra të Shoqatës së Ndihmës në Guadalajara të Meksikës, të ulura në këshill.



Eja, Më Ndiq – Për Priftërinë Melkizedeke dhe Shoqatën e Ndihmës



Gjejini këto burime te programi
Biblioteka e Ungjillit dhe te
ejamendiq.lds.org.



Çfarë Ka Ndryshuar?

Në këto ditë të fundit, Perëndia e ka rivendosur priftërinë dhe kuorimet e organizuara të priftërisë si dhe Shoqatën e Ndhmës për të ndihmuar në përmbushjen e veprës së Tij (shih Moisiu 1:39). Prandaj çdo të diel, kur mbledhemi në mbledhjet e Priftërisë Melkizedeke dhe të Shoqatës së Ndhmës, ne mbledhemi që të diskutojmë e planifikojmë se si do ta përmbushim veprën e Tij. Kjo është arsyeja

përse këto mbledhje kanë nevojë të jenë më shumë sesa orë mësimore. Ato janë gjithashtu mundësi për t'u këshilluar rreth punës së shpëtimit, për të mësuar së bashku nga mësimet e udhëheqësve të Kishës rreth asaj pune dhe për ta organizuar përmbushjen e saj. Këto ndryshime në mbledhjet tona të së dielës do të na ndihmojnë për t'i plotësuar këto qëllime.

Një Program Mujor

Mbledhjet e së dielës për Priftërinë Melkizedeke dhe Shoqatën e Ndhmës do të ndjekin këtë program mujor:

JAVA	QËLLIMI
E Diela e Parë	Këshillohuni së bashku mbi përgjegjësitë, mundësitë e sfidat vendore dhe bëni plane për të vepruar
E Diela e Dytë dhe e Tretë	Studioni mesazhe nga konferenca më e fundit e përgjithshme, të zgjedhura nga presidenca ose udhëheqësit e grupit apo, sipas rastit, nga peshkopi ose presidenti i kunjit
E Diela e Katërt	Diskutoni një temë të veçantë, të zgjedhur nga Presidenca e Parë dhe Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve
E Diela e Pestë	Diskutoni një temë të zgjedhur nga peshkopata



Një Model për Mbledhjet Tona

Në secilën nga mbledhjet tona të Priftërisë Melkizedeke dhe të Shoqatës së Ndhmës, ne ndjekin një model për ta përmbushur veprën e Perëndisë.

1. *Tregoni përvoja* që rrjedhin nga mbresa dhe ftesa të marra në mbledhjet e mëparshme të priftërisë ose të Shoqatës së Ndhmës (të udhëhequra nga një anëtar/e i/e presidencës apo udhëheqësi i grupit).
2. *Këshillohuni së bashku* (e diela e parë, e udhëhequr nga një anëtar/e i/e presidencës apo udhëheqësi i grupit) ose *mësoni së bashku* (të dielat e dyta, të treta dhe të katërta, të udhëhequra nga një mësues/e i/e thirrur).
3. *Planifikoni të veproni* si grup ose si individë (të udhëhequr nga një anëtar/e i/e presidencës apo udhëheqësi i grupit).



MBLEDHJET E KËSHILLIT TË DIELËN E PARË

Në të dielën e parë të çdo muaji, mbledhjet e kuorunit, grupit dhe të Shoqatës së Ndhmës *nuk do të përfshijnë një mësim të dhënë nga një mësues/e*. Në vend të kësaj, presidentat ose udhëheqësit e grupit do të udhëheqin një mbledhje të këshillit. Çdo kuorum, grup ose Shoqatë

e Ndhmës do të këshillohet së bashku rreth përgjegjësi-ve, mundësive dhe sfidave vendore; do të mësojnë nga idetë dhe përvojat e njëri-tjetrit; dhe do të planifikojnë mënyra për të vepruar sipas mbresave të marra nga Shpirti.

Përpara Mbledhjes së Këshillit


- Udhëheqësit/et përcaktojnë përgjegjësi, mundësi e sfida vendore dhe me lutje zgjedhin një temë për ta diskutuar.
- Çdo njeri kërkon udhërrëfimin e Shpirtit.
- Çdo njeri përgatitet për të dhënë mendime dhe për të treguar përvoja.

Gjatë Mbledhjes së Këshillit

- Udhëheqësit/et i ftojnë anëtarët që të tregojnë përvoja ku vepruan sipas mbresave që i kishin marrë nga mbledhjet e mëparshme.
- Të gjithë njerëzit këshillohen së bashku rreth temës, dëgjojnë njëri-tjetrin dhe kërkojnë udhërrëfimin e Shpirtit.
- Udhëheqësit/et përmbledhin pikat kyçe dhe bëjnë ftesa për të vepruar.

Pas Mbledhjes së Këshillit

- Çdo njeri vepron sipas mbresave dhe ftesave, së bashku dhe si individë.
- Çdo njeri përgatitet që t'i tregojë përvojat e tij/saj në mbledhjet e ardhshme.



“ZBULESA ËSHTË E PËRHAPUR MIDIS NESH.”¹

Plaku Nil L. Andersen

“NE JEMI DUART E TIJ.”²

Presidenti Diter F. Uhtdorf

SHËNIME

1. Neil L. Andersen, në Adam C. Olson, “Handbook Training Emphasizes Work of Salvation”, *Liahona*, prill 2011, f. 76.
2. Diter F. Uhtdorf, “Ju Jeni Duart e Mia”, *Liahona*, maj 2010, f. 68.

Parimet e Këshillimit së Bashku

Jo të gjitha mbledhjet e këshillit duken njësoj. Lëreni Zotin t'ju japë mësim. Ja disa parime se si ta filloni:

1. Qëllimi i një mbledhjeje të këshillit është që anëtarët/et të këshillohen së bashku rreth përgjegjësive, mundësi-ve dhe sfidave vendore; të mësojnë nga idetë dhe përvojat e njëri-tjetrit; dhe të planifikojnë mënyra për të vepruar sipas mbresave të marra nga Shpirti.
2. Një mbledhje e këshillit duhet të çojë drejt veprimit – planeve individuale dhe si grup, të frymëzuara nga Shpirti, për të vepruar jashtë mbledhjes që të përmbushet vepra e Zotit (shih DeB 43:8–9).
3. Këshillat duhet t'i përdorin shkrimet e shenjta dhe fjalët e profetëve dhe të apostujve të ditëve të mëvonshme, të Autoriteteve të tjera të Përgjithshme dhe të Drejtuesve të Përgjithshëm për ta udhërrëfyer e përkrahur diskutimin. Në këtë mënyrë, fjalët e udhëheqësve të frymëzuar të Kishës mund t'i ndihmojnë kuorumet, grupet dhe Shoqatat

e Ndihmës që të diskutojnë nevojat e rëndësishme.

4. Diskutimet nuk duhet të prekin gjëra sekrete apo të ndjeshme rreth anëtarëve ose familjeve individuale.
5. Edhe pse mbledhja e këshillit udhëhiqet nga një anëtar/e i/e presidencës ose udhëheqës i grupit, ai ose ajo nuk e mbizotëron dhënien e ideve. Udhëheqësi/ja paraqet një çështje për diskutim dhe e fton çdo njeri që të japë mendime dhe përvoja, siç udhëhiqen nga Shpirti.
6. Ndërkohë që askush nuk duhet të ndihet i detyruar që të marrë pjesë, çdo njeri duhet të ndihet i sigurt në dhënien e komenteve dhe të ideve pa frikën se do të kritikohet.
7. Ku është e mundur, ulja në rreth mund të ndihmojë për të kultivuar një shpirt të dhënies së ideve dhe të diskutimit të hapur.

Temat e Mundshme për Mbledhjet e Këshillit të Dielën e Parë

Idetë për temat që do të diskutohen në mbledhjet e këshillit, mund të vijnë nga

këshilli i lagjes, mbledhjet e presidencës, plani i zonës, mbresat e udhëheqësve prej shërbesës ndaj anëtarëve dhe nga mbresat prej Frymës së Shenjtë. Temat më poshtë janë vetëm sugjerime. Udhëheqësit/et mund të jenë në dijeni të nevojave të tjera të cilat ata ndihen të frymëzuar t'i diskutojnë.

- Si mund t'u japim përparësi më mirë të gjitha përgjegjësive tona të ndryshme?
- Si mund të vijmë më pranë Perëndisë dhe të marrim më shumë udhërrëfim nga Shpirti në jetën tonë dhe në shtëpitë tona?
- Si do ta shpërndajmë ungjillin te miqtë dhe fqinjët tanë? (Shih Alma 17.)
- Si mund t'i mbrojmë veten tonë dhe familjet tona nga mjetet e papërshtatshme të informacionit dhe pornografia? (Shih DeB 42:22–23.)
- Çfarë do të bëjmë për t'i këshilluar e forcuar fëmijët tanë dhe rininë në lagjen tonë?
- Si e shtojmë unitetin në kuorumin, grupin ose Shoqatën tonë të Ndihmës? (Shih Mosia 18:19–22.)
- Si mund të jemi më të përfshirë në punën për historinë familjare dhe adhurimin në tempull?
- Si e ftojmë ndihmën e Zotit kur kërkojmë përgjigje për pyetjet tona dhe një kuptueshmëri më të thellë të ungjillit?
- Si mund të bëhen prindërit udhëheqës më të mirë në shtëpi?
- Si mund t'i forcojmë dëshmitë tona për Zotin dhe ungjillin e Tij dhe t'i ndihmojmë familjet tona që të bëhen të mbështetura shpirtërisht te vetja?
- Çfarë do të thotë të japësh shërbesë? Si po u japim shërbesë njerëzve përreth nesh? (Shih 1 Pjetër 4:11.)

Nëse është e mundur, udhëheqësit/et mund të duan t'ua bëjnë të ditur anëtarëve temën që më parë, në mënyrë që ata të mund të vijnë të përgatitur për ta diskutuar atë.



MBLEDHJET E TË DIELËS SË DYTË DHE TË TRETË

Në të dielat e dyta dhe të treta të çdo muaji, kuorumet e Priftërisë Melkizedeke dhe Shoqatat e Ndihmës studiojnë mësimet e profetëve të gjallë, të apostujve dhe udhëheqësve të tjerë të Kishës nga konferenca e përgjithshme më e fundit.

Mund të diskutohet çfarëdo mesazhi nga konferenca më e fundit.

Në shumicën e rasteve, presidenca e kuorumit, udhëheqja e grupit, ose presidenca e Shoqatës së Ndihmës do të përzgjedhë një mesazh nga konferenca për ta studiuar në bazë të nevojave të anëtarëve, ndonëse peshkopi ose presidenti i kunjit mund të japë sugjerime. Udhëheqësit mund të zgjedhin një mesazh të lidhur me temën e diskutuar në mbledhjen e këshillit të dielën e parë ose mund të zgjedhin një mesazh tjetër në bazë të frymëzimit të Shpirtit. Udhëheqësit dhe mësuesit duhet të gjejnë mënyra për t'i nxitur anëtarët që t'i lexojnë mesazhet e përzgjedhura paraprakisht dhe të vijnë të përgatitur për të shprehur mendime. Veprimtaritë mësimore të sugjeruara më poshtë, të cilat bazohen në parimet e manualit *Mësimdhënia sipas Mënyrës së Shpëtimtarit*, mund t'i përfshijnë anëtarët që të mësojnë nga mesazhet e konferencës së përgjithshme.

Sheron Iubank, “Ndizeni Dritën Tuaj”

Kërkojuni anëtarëve të kuorumit tuaj ose Shoqatës së Ndihmës që të mendojnë se si është ndikuar jeta e tyre për mirë nga një grua e drejtë dhe besnike. Merrni parasysh t'i ftoni disa anëtarë që të tregojnë se si kjo grua ilustron një ose më shumë karakteristika të grave të drejta që përvijohen në mesazhin e Motrës Iubank. Çfarë mësojmë nga Motra Iubank rreth mënyrës se si mund të bëhemi “një *forcë domethënëse* në rritjen numerike dhe atë shpirtërore të Kishës në ditët e fundit”?

Nil F. Mariot, “Banimi në Perëndinë dhe Riparimi i të Çarës”

Ky mesazh mund t'i ndihmojë anëtarët që mund të ndihen të shkëputur nga Ati Qiellor ose njerëzit përreth. Çfarë do t'i ndihmonte ata të cilëve u jepni mësim,



se çfarë është një e çarë? Ndoshta mund të sillni fotografi të llojeve të ndryshme të të çarave. Si e përkufizon të çarën Motra Mariot? Çfarë mund të shkaktojë të çara në marrëdhëniet tona me Perëndinë dhe të tjerët? Ftojini anëtarët të kërkojnë në mesazhin e Motrës Mariot sugjerime mbi atë që mund të bëjmë për t'i riparuar të çarat në jetën tonë. Jepuni anëtarëve kohë për ta shkruar atë që Shpirti i nxit ata të bëjnë për t'iu afruar më shumë Perëndisë dhe të tjerëve.

Xhoi D. Xhons, “Vlerë e Pamasë”

Çfarë bekimesh rrjedhin në jetën tonë kur e kuptojmë identitetin tonë hyjnor? Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje, anëtarët e kuorumit tuaj ose të Shoqatës së Ndihmës mund t'i shqyrtojnë së bashku historitë e Mariamës, Renusë dhe Tajanës në mesazhin e Motrës Xhons. Çfarë këshille na jep Motra Xhons për të na ndihmuar “ta kuptojmë dhe ta përqafojmë identitetin tonë hyjnor”? Ftojini anëtarët të gjejnë dhe diskutojnë një fragment nga shkrimi i shenjtë ose një citim në mesazhin e Motrës Xhons që i ndihmon ato ta kuptojnë vlerën e tyre të vërtetë përpara Perëndisë. Ftojini ata t'ia thonë një nga këto shkrime të shenjta ose citime dikujt që ka nevojë ta kuptojnë për natyrën e vet hyjnore.

Diter F. Uhtdorf, “Tri Motra”

Një mënyrë për ta shqyrtuar mesazhin e Presidentit Uhtdorf do të ishte duke e ndarë kuorumin ose Shoqatën e Ndihmës në grupe të vogla. Mund t'i caktoni secilit grup të lexojë për njërin nga motrat në mesazhin e Presidentit Uhtdorf. Çdo grup mund t'i shkruajë një letër asaj motre duke e përmbledhur këshillën e tij dhe t'ia tregojë grupeve të tjerë atë që shkroi. Çfarë mund të bëjmë ne për të qenë më shumë si motra e tretë? Si mund ta bëjmë kuorumin ose Shoqatën e Ndihmës një “shtëpi të sigurt” për ata që po hasin vështirësi?

Diter F. Uhtdorf, “Dëshirim për Shtëpinë”

Si mund t'i ndihmoni ata të cilëve u jepni mësim, që ta kuptojnë se si po i përdor Perëndia ata për t'i bekuar të tjerët? Mund t'i ftoni ata ta shqyrtojnë pjesën e mesazhit të Presidentit Uhtdorf të titulluar “Perëndia do t'Ju Përdorë”, duke kërkuar premtimet që u bëhen atyre që përpiqen të shërbejnë në mbretërinë e Perëndisë pavarësisht nga dobësitë e tyre. Leximi i këtij mesazhi mund t'iu kujtojë anëtarëve përvoja në të cilat Perëndia i përdori ata për t'i bekuar të tjerët – ose kohën kur Ai i përdori të tjerët për t'i bekuar ata. Jepuni anëtarëve kohë për ta përsiatur atë që ndihen të frymëzuar të bëjnë për shkak të këtij diskutimi.

Boni L. Oskarson, “*Nevojat përpara Vetvetes*”

Një mënyrë për ta nisur diskutimin rreth mesazhit të Motrës Oskarson është që t'i jepni gjithsecilit një fletë letre me fjalinë “Kush ka nevojë për mua sot?” të shkruar në krye. Anëtarët/ët e Shoqatës së Ndihmës ose të kuorumit tuaj mund të kalojnë disa minuta duke përsiatur dhe duke renditur përgjigje për këtë pyetje. Pastaj ata mund të kërkojnë në mesazhin e Motrës Oskarson ide rreth mënyrës se si mund t'u shërbejnë njerëzve në listën e tyre – ose të shtojnë emra sipas frymëzimit. Ndoshta disa prej tyre mund të tregojnë se çfarë kanë mësuar.

Dallin H. Ouks, “*Plani dhe Proklamata*”

Si do të veprojnë anëtarët e kuorumit, grupit tuaj ose të Shoqatës së Ndihmës sipas ftesës së Plakut Ouks për të “dhënë mësim [dhe] [për të] jetuar sipas” proklamatsë së familjes, në shtëpi, në komunitet dhe në Kishë? Ftojini t'i japin ide njërit-tjetrit. Mund t'ju ndihmojë edhe që të kërkonin në mesazh disa pohime doktrinale nga proklamata e familjes. Si na ndihmojnë këto pohime për të reaguuar ndaj “sfidave” të tanishme që ka familja? Pjesa IV e mesazhit të Plakut Ouks përmban disa shembuj të pohimeve të tilla.

D. Tod Kristoferson, “*Buka e Gjallë që Zbriti nga Qielli*”

Ja tek janë disa pyetje që anëtarët e Shoqatës së Ndihmës dhe anëtarët e kuorumit mund të kenë në mendje tekta e shqyrtojnë mesazhin e Plakut Kristoferson: Çfarë është shenjtëria? Si e kërkojmë shenjtërinë? Si i ndihmon përpjekjet tona marrja e sakramentit? Anëtarët mund të thonë fjalë nga mesazhi i Plakut Kristoferson që mund të ndihmojnë për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve. Si e ndihmojmë njërit-tjetrit si “bashkëshenjtorë” në përpjekjet tona për t'u bërë më të shenjtë?

Xhefri R. Holland, “*Jini, pra, të Përkryer – Përfundimisht*”

Disa prej atyre të cilëve u jepni mësim, mund të ndiejnë që nuk janë në lartësinë e duhur kur është fjala për t'iu jetuar

mësimet e Shpëtimtarit. Çfarë na mëson Plaku Holland se mund t'i ngushëllojë dhe nxitë ata që mund të ndihen kështu? Mund t'i ftoni anëtarët e Shoqatës së Ndihmës ose anëtarët e kuorumit që të kërkojnë në këtë mesazh diçka të cilën mund t'ia thonë dikujt që e ka të vështirë ta ndiejë se është “aq i mirë sa duhet”. Ose ata mund të gjejnë në mesazh diçka që i frymëzon të ndiejnë “një dashuri dhe admirim më të madh për [Krishtin] dhe një dëshirë më të madhe për të qenë si Ai”.

Geri E. Stivenson, “*Eklipsi Shpirtëror*”

A ka përjetuar ndonjë prej anëtarëve të kuorumit ose të Shoqatës së Ndihmës një eklips diellor? Nëse po, mund ta ftoni njërin prej tyre të shpjegojë analogjinë që tregon Plaku Stivenson rreth një “eklipsi shpirtëror”. Çfarë pengesash mund “ta bllokojnë madhësinë, shkëlqimin, ngrohtësinë e dritës së Jezu Krishtit dhe të ungjillit të Tij”? Si mund të na shpërqendrojë media shoqërore nga “bukuri[a], ngrohtësi[a] dhe drit[a] qiellore [e] ungjillit”? Si i vëmë “syzet ungjillore” që na mbrojnë nga verbëria shpirtërore? Çfarë na mëson analogjia e Plakut Stivenson rreth ruajtjes së një këndvështrimi ungjillor?

Kuentin L. Kuk, “*Të Përditshmen si Përjetësinë*”

Mesazhi i Plakut Kuk na kujton rëndësinë e përpjekjes për të qenë të përlulur në mënyra të ndryshme. Një mënyrë për ta diskutuar atë që ai jep mësim, është që t'i ndani anëtarët në dy grupe. Kërkojini njërit grup të gjejë në mesazhin e Plakut Kuk sugjerime që mund të na ndihmojnë të zhvillojmë përlulësi, dhe grupit tjetër të gjejë mënyra në të cilat njerëzit e shfaqin krenarinë. Ftojini secilin grup që t'ia tregojë përkrahimin e vet grupit tjetër. Anëtarët mund të thonë edhe mënyra në të cilat mund të tregojnë më tepër “përlulësi [të] përditshme” në jetën e tyre dhe të marrin parasysh se si mund t'i ndihmojë kjo përlulësi që të përgatiten për të takuar Perëndinë.

Ronald A. Rasband, “*Sipas Qëllimit Hyjnor*”

Për ta nxitur diskutimin rreth mesazhit të Plakut Rasband, mund të jetë

e dobishme që t'i ftoni disa anëtarë të sjellin një model për qëndisje, një skicë projekti ose një recetë dhe të flasin rreth arsyes përse këto gjëra të vijnë në ndihmë. Çfarë shembujsh ose mësimesh nga mesazhi i Plakut Rasband i frymëzojnë anëtarët që ta dallojnë qëllimin e Perëndisë për jetën e tyre? Ndoshta anëtarët e klasës mund të tregojnë përvoja në të cilat e panë që Zoti po e drejtonte jetën e tyre. Çfarë kanë bërë ata për t'iu treguar Perëndisë që e “çmojnë” drejtimin e Tij? Përse është e rëndësishme që ta dallojmë “qëllimin hyjnor” të Perëndisë?

Rasëll M. Nelson, “*Libri i Mormonit: Si do të Ishte Jeta Juaj pa Të?*”

Presidenti Nelson i ftoi anëtarët të mendonin për tri pyetje: 1) “Si do të ishte jeta juaj pa Librin e Mormonit?” 2) Çfarë nuk do të dinit? 3) Çfarë nuk do të kishit? Ftojini anëtarët e kuorumit, grupit tuaj ose të Shoqatës së Ndihmës që t'i përsiatin këto pyetje dhe të thonë se si do t'iu përgjigjeshin atyre. Çfarë gjejnë ata në këtë mesazh që i frymëzon ta vlerësojnë Librin e Mormonit më shumë se “diamantet ose rubinët”?

Dejll G. Renland, “*Priftëria dhe Fuqia Shlyese e Shpëtimtarit*”

Si mund t'i ndihmoni anëtarët e kuorumit tuaj ose të Shoqatës së Ndihmës që ta kuptojnë mënyrën se si i ndihmon priftëria që të kenë në dispozicion bekimet e Shlyerjes së Shpëtimtarit? Mund t'i shkruani këta dy krerë në tabelë: “Përse na nevojitet Shlyerja e Jezu Krishtit” dhe “Si na i ‘dorëzon’ priftëria bekimet e Shlyerjes”. Më pas, ftojini anëtarët të kërkojnë në mesazhin e Plakut Renland, duke kërkuar fraza për t'iu shkruar nën secilin prej krerëve. Si na ndihmojnë priftëria dhe ordinancat e saj për t'iu përmbushur qëllimet e Atit Qiellor për fëmijët e Tij?

Diter F. Uhtdorf, “*Mbatës të Dritës Qiellore*”

Ftojini anëtarët të kërkojnë në mesazhin e Presidentit Uhtdorf dhe të dallojnë se si mund të ndikojë në jetën tonë

prania ose mungesa e dritës hyjnore. Mund të ftoni disa anëtarë që t'i studiojnë disa prej shkrimeve të shenjta të cilat Presidenti Uhtdorf i jep si referenca, dhe t'i përcaktojnë të vërtetat e lidhura me dritën shpirtërore. Çfarë na mëson metafora mbi eklipsin rreth rolit të lirisë së zgjedhjes te kërkimi i dritës shpirtërore? Çfarë mund të bëjmë për ta shpërndarë dritën hyjnore të Jezu Krishtit tek të tjerët, veçanërisht te familjet tona dhe tek “të rinjtë” tanë që po kërkojnë dritë?”

Henri B. Ajring, “Zoti e Udhëheq Kishën e Tij”

Ftojini anëtarët e kuorumit tuaj ose të Shoqatës së Ndhimës që të tregojnë përvoja në të cilat iu nevojitej të zhvillonin besim se thirrja e tyre ose thirrja e një tjetri erdhi nga Perëndia. Si e ushtruan besimin e tyre? Si arritën ta mësonin se thirrja ishte nga Perëndia? Ftojini anëtarët të kërkojnë në mesazhin e Presidentit Ajring dhe t'i përcaktojnë të vërtetat që ai mësoi nga përvoja vetjake, të cilat mund të na ndihmojnë të kemi mirëbesim dhe të jemi të duruar me veten dhe të tjerët që Zoti i ka thirrur.

Xhin B. Bingham, “Që Gëzimi Juaj të Jetë i Plotë”

Mesazhi i Motrës Bingham mund t'i ndihmojë anëtarët e Shoqatës së Ndhimës dhe anëtarët e kuorumit tuaj që ta kuptojnë mënyrën se si të gjejnë gëzim pavarësisht nga vështirësitë e jetës, teksa vijmë te Krishti. Një mënyrë për ta diskutuar mesazhin e saj mund të jetë që të vizatoni një shteg në tabelë, i cili të çon drejt fjalës *gëzim*. Ftojini disa anëtarë që të shkruajnë mbi shteg një sugjerim nga mesazhi i Motrës Bingham që të çon drejt gëzimit të vërtetë. Nxitini anëtarët të marrin parasysh mënyra në të cilat mund të veprojnë sipas këshillës së Motrës Bingham. Ftojini disa anëtarë që të japin mendimet e tyre.

Dejvid A. Bednar, “Premtimet e Çmueshme dhe Shumë të Mëdha”

Për t'i ndihmuar anëtarët e Shoqatës së Ndhimës ose anëtarët e kuorumit tuaj



që ta diskutojnë mesazhin e Plakut Bednar, mund të vendosni fotografi në tabelë që përfaqësojnë Shabatit, tempullin dhe shtëpitë tona. Ftojini disa anëtarë që t'i lexojnë pjesët përkatëse të mesazhit të Plakut Bednar dhe të shkruajnë në tabelë se si na ndihmojnë dita e Shabatit, tempulli dhe shtëpitë tona që të përqendrohemi te premtimet e Perëndisë ndaj nesh. Çfarë gjërash në jetën tonë mund të na e kenë tërhequr vëmendjen nga këto premtime? Çfarë hapash mund të hedhim që të sigurohemi se i mbajmë mend ato?

Henri B. Ajring, “Mos Kini Frikë të Bëni Mirë”

Mesazhi i Presidentit Ajring mund t'i ndihmojë ata të cilëve u jepni mësim, që të gjejnë kurajën dhe besimin për të bërë mirë në botë. Mund të ftoni disa anëtarë që t'i përmbledhin shembujt e njerëzve besnikë për të cilët tregon Presidenti Ajring. Çfarë na mësojnë këta shembuj rreth mënyrës se si t'u shërbejmë të tjerëve? Çfarë na mësojnë këta shembuj rreth mënyrave se si mund të shërbejmë si kuorum ose si Shoqatë e Ndhimës?

Një mënyrë tjetër për ta diskutuar këtë mesazh është duke shqyrtuar bekimet që pa Presidenti Ajring nga zbatimi i këshillës së Presidentit Tomas S. Monson për ta studiuar Librin e Mormonit. Çfarë bekimesh kemi parë nga studimi i Librit të Mormonit?

M. Rasëll Ballard, “Udhëtimi i Vështirë Vazhdon!”

Për të filluar një diskutim mbi mesazhin e Plakut Ballard, ju mund të ftoni dikë që të tregojë një përvojë rreth kohës kur kishin një vendmbërritje, por zbuluan se ishin në drejtimin e gabuar. Si lidhen këta shembuj me “udhëtimin” tonë vetjak të kthimit për tek Ati Qiellor? Anëtarët më pas mund të kërkojnë këshillat dhe paralajmërimet që jepen nga Plaku Ballard, të cilat mund të na ndihmojnë ta dimë nëse po shkojmë në drejtimin e duhur në vetë jetën tonë. Jepuni anëtarëve kohë për të përsiatuar mbi shtigjet e tyre vetjake dhe për të diskutuar mënyrat në të cilat mund t'i ndihmojnë e t'i nxitin të tjerët në “udhëtimin” e tyre të kthimit drejt Atit Qiellor.

Nil L. Andersen, “Zëri i Zotit”

Ndoshta anëtarët e Shoqatës së Ndhimës ose anëtarët e kuorumit tuaj mund të tregojnë një përvojë në të cilën një mesazh nga konferenca e përgjithshme iu duk veçanërisht kuptimplotë atyre. Përse qenë kuptimplote këto mesazhe? Çfarë na mëson Plaku Andersen rreth domethënies së mesazheve nga konferenca e përgjithshme dhe rreth përpjekjeve dhe procesit që përfshihet në përgatitjen e tyre? Si duhet të ndikojë kjo dijeni te ngutja me të cilën i studiojmë dhe ua vëmë veshin këtyre fjalëve? Merreni parasysh të bëni një listë ftesash nga konferenca më e fundit. Çfarë kemi bërë për të vepruar sipas këtyre ftesave?

MBLEDHJET E TË DIELËS SË KATËRT

Në të dielën e katërt të çdo muaji, kuoromet, grupet dhe Shoqatat e Ndhmës diskutojnë një temë të përzgjedhur nga Presidenca e Parë dhe Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve. Këto tema do të përditësohen për çdo konferencë të përgjithshme. Tema deri në konferencën e përgjithshme të ardhshme do të jetë dita e Shabatit. Udhëheqësit ose mësuesit mund të zgjedhin nga doktrinat dhe veprimtaritë e të mësuarit, të sugjeruara më poshtë, mund të ndërthurin disa prej tyre ose të krijojnë nga vetja sipas nevojave të anëtarëve.

Shabati është një ditë për të kujtuar atë që Perëndia ka bërë për ne.

Gjatë gjithë historisë, Perëndia i ka lidhur disa vepra të fuqishme me Shabatin. Këto vepra të fuqishme përfshijnë Krijimin (shih Zanafilla 2:1–3), eksodin e fëmijëve të Izraelit nga Egjipti (shih Ligji i Përtërirë 5:15) dhe Ringjalljen e Shpëtimtarit (shih Gjoni 20:1–19; Veprat e Apostujve 20:7). Ftojini anëtarët që t'i shqyrtojnë këto fragmente dhe të diskutojnë se si të kujtuarit e secilës prej këtyre ngjarjeve mund të na ndihmojë ta nderojmë ditën e Shabatit. Cilat janë disa prej veprave të fuqishme që ka bërë Perëndia për ne? Si mund t'i kujtojmë këto gjëra në ditën e Shabatit? Kur gjen zbatim, ftojini anëtarët që të diskutojnë pyetje si këto me familjet e tyre.

Jezu Krishti është Zoti i Shabatit.

Shabati gjithashtu quhet dita e Zotit (shih Zbulesa 1:10). Si mendoni ju, përse Jezu Krishti quhet Zoti i Shabatit? (shih Mateu 12:8). Shqyrtoni së bashku disa vargje që mund të ndihmojnë për t'i frymëzuar anëtarët që të mendojnë për mënyra se si t'i përqendrojnë te Jezu Krishti përvojat e tyre të ditës së Shabatit (për shembull, Helamani 5:12; Ethëri 12:41; Moroni 10:32 dhe DeB 6:36–37). Çfarë vargësh të tjera mund të japin anëtarët, që mund t'i ndihmojnë për ta bërë Shabatin më të

përqendruar te Krishti? Çfarë synimesh mund të vendosim për të na ndihmuar që të përqendrohemi te Shpëtimtari gjatë gjithë ditës së Shabatit?

Jezu Krishti është shembulli ynë i nderimit të Shabatit.

Gjatë shërbesës së Tij në vdekshmëri, Shpëtimtari gjeti mundësi për të dhënë mësim rreth ditës së Shabatit. Kërkojuni anëtarëve të lexojnë tregimet vijuese dhe të bëjnë një listë të gjërave që Jezusi i bëri në Shabat dhe të parimeve që Ai i dha mësim: Lluca 6:1–11; 13:11–17; Gjoni 5:1–20; 9:1–16. Çfarë parimesh të tjera rreth Shabatit mësojmë nga vargjet vijuese? Eksodi 20:8–11; 31:12–18; Isaia 58:13–14 dhe DeB 59:9–19. Ftojini anëtarët të tregojnë se çfarë mund të bëjnë për ta ndjekur shembullin e Shpëtimtarin.

Shih edhe Rasëll M. Nelson, “Shabati Është një Kënaqësi”, *Liahona*, maj 2015, f. 129–132.

Shabati është një ditë për të adhuruar.

Shkruajeni fjalën *adhuroj* në tabelë dhe kërkojuni anëtarëve të klasës që të shkruajnë pranë saj fjalë të tjera që lidhen me të. Më pas bëni tri kolona me fjalët *përpara*, *gjatë* dhe *pas* të shkruara në krye të secilës kolonë. Çfarë mund të bëjmë përpara, gjatë dhe pas kishës që ta adhurojmë Zotin në ditën e Tij të shenjtë? Anëtarët e klasës mund të lexojnë së bashku Mosian 18:17–29 dhe Moronin 6 për ide. Ftojini anëtarët të përsiatin se si qëndrimet dhe veprimet e tyre në ditën e Shabatit po i ndihmojnë që ta adhurojnë Zotin në atë ditë (shih Eksodi 31:16–17). Çfarë mund të bëjmë që t'i ndihmojmë familjet tona dhe anëtarët e lagjeve tona për ta përmirësuar përvojën e adhurimit që e kanë gjatë mbledhjeve të Kishës?

Marrja e sakramentit na lejon ta kemi Shpirtin gjithmonë me ne.

Shkruajeni në tabelë pyetjen vijuese: Si po e ndikon sakramenti jetën tuaj? Për t'u përgjigjur kësaj pyetjeje, ftojini anëtarët që të punojnë në dyshe për të përzgjedhur e diskutuar një frazë nga lutjet e sakra-

mentit të Doktrina e Besëlidhje 20:77, 79 dhe këshillën të Doktrina e Besëlidhje 59:9. Jepini secilës dyshe kohë për t'i gjetur shkrimet e shenjta që i ndihmojnë ta kuptojnë më mirë frazën e tyre dhe të diskutojnë se si do t'i përgjigjeshin pyetjes në tabelë. Gjithashtu mund të ftoni anëtarët të tjerë të klasës që të zgjedhin himne të parapëlqyera të sakramentit dhe t'i këndonin ato së bashku.

Shih edhe Sheril A. Esplin, “Sakramenti – Një Përtëritje për Shpirtin”, *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2014, f. 12–14.

Shabati është një ditë për t'u shërbyer të tjerëve.

Çfarë mund të mësojmë rreth shërbimit ndaj të tjerëve në Shabat, nga mënyrat se si Shpëtimtari u shërbeu njerëzve përreth Tij dhe i bekoji ata? Nxitini anëtarët të shqyrtojnë e diskutojnë Mateun 9:10–13; Llukën 19:1–9; Gjoni 11:32–46; 13:1–5, 12–17 dhe 3 Nefin 17:5–10. Kërkojuni anëtarëve të mendojnë rreth këtyre shkrimeve të shenjta teksa marrin parasysht se si mund të shërbejnë në Shabat. Për shembull, ata mund t'u shërbejnë pjesëtarëve të familjes, mund të ndihmojnë individët dhe familjet të cilave u japin shërbesë si mësues shtëpie dhe mësuese vizitore, mund të punojnë me historinë familjare, të vizitojnë të sëmurët dhe të shpërndajnë ungjillin. Ndofta anëtarët mund të kenë një këshill familjar që të planifikojnë mënyra se si mund t'u shërbejnë të tjerëve në Shabat.





© KATHLEEN PETERSON, NUK LEJOHET TË KOPJOHET

“Plani i ungjillit që çdo familje duhet ta ndjekë për t’u përgatitur për jetën e përjetshme dhe ekzaltimin, përvijohet në proklamatën e Kishës të vitit 1995, “Familja: Një Proklamatë drejtuar Botës”. . . .

. . . Ajo ka qenë baza e mësimdhënies dhe praktikës së Kishës për 22 vitet e fundit dhe do të vazhdojë të jetë kështu në të ardhmen. Mendojeni atë si të tillë, mësojeni atë, jetoni sipas saj dhe do të bekoheni ndërsa shkoni përpara drejt jetës së përjetshme.

Dyzet vjet më parë, Presidenti Ezra Taft Benson dha mësim se “çdo brez ka sprovat e tij dhe mundësinë e tij për t’u bërë ballë dhe për ta vënë në provë veten”. Unë besoj se qëndrimi ynë ndaj proklamatës për familjen dhe përdorimi i saj, është një nga ato sprova për këtë brez.”

Plaku Dallin H. Oaks, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, “Plani dhe Proklamata”, f. 29-31.

Vallëzimi,
nga Kathleen Peterson



“Unë ju jap dëshminë time solemne dhe prapëseprapë të gëzuar se Zoti Jezu Krisht është në timon. Ai e udhëheq Kishën e Tij dhe shërbëtorët e Tij”, tha Presidenti Henri B. Ajring, Këshilltar i Parë në Presidencën e Parë, gjatë Konferencës së Përgjithshme Gjysmëvjetore të 187-të të Kishës. “Unë jap dëshmi se Tomas S. Monsoni është i vetmi njeri i cili i mban dhe i ushtron të gjitha çelësat e priftërisë së shenjtë në tokë në këtë kohë. Dhe unë lutem për bekime për të gjithë shërbëtorët e përlur, të cilët shërbejnë me kaq gatishmëri dhe mirë në Kishën e rivendosur të Jezu Krishtit, të cilën Ai e udhëheq personalisht. Unë dëshmoj se Jozef Smithi e pa Perëndinë, Atin dhe Jezu Krishtin. Ata i folën atij. Çelësat e priftërisë u rivendosën për bekimin e të gjithë fëmijëve të Atit Qiellor. Është misioni ynë dhe na është mirëbesuar neve që të shërbejmë në pozicionin tonë në kauzën e Zotit”.